

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E
KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

Shaban Demiraj – figurë e shquar
e albanologjisë dhe ballkanologjisë

(sesion shkencor – 21 nëntor 2014)

- 8 -



Shkup, 2015

Boton:
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE –
SHKUP

Vëllimi 8 – 2015

Biblioteka: **SCUPI**

Për botuesin:
Dr. Skender Asani

Kryeredaktor:
Dr. Zeqirija Ibrahim

Këshilli redaktues:
Dr. Shëfqet Zekolli
Dr. Sefër Tahiri
Dr. Mixhait Pollozhani
Mr. Hidajete Azizi

Sekretar i redaksisë: *Mr. Agron Salih*

Redaktor teknik: *Naser Fera*

Copyright© ITSHKSH, 2015
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për botuesin.

ISBN 978–608–4653–24–0

www.itsh.edu.mk

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

Shaban Demiraj – figurë e shquar
e albanologjisë dhe ballkanologjisë

(sesion shkencor – 21 nëntor 2014)

- 8 -

SCUPI

Shkup, 2015

TRYEZA E LËNDËS:

DY FJALË PËR KËTË VËLLIM.....	7
QEMAL MURATI: GJUHËTAR KLASIK QË I PESHON RËNDË FJALA.....	9
XHEVAT LLOSHI: VËSHTRIMET E PROF. SH. DEMIRAJT PËR LEKSİKUN E SHQIPES.....	15
EMIL LAFE: PROF. SHABAN DEMIRAJ PËR KULTURËN E GJUHËS DHE NORMËN LETRARE	23
DIMITAR PANDEV: BAZA TEORIKE E “GJUHËSISË BALLKANIKE” TË SHABAN DEMIRAJT.....	33
BARDHYL DEMIRAJ: VEPRA SHKENCORE E SHABAN DEMIRAJT ME MUNDËSITË POTENCIALE DHE REALE TË RIBOTIMIT TË SAJ	39
HAKI YMERI – BINA: NJË BISEDË ME PROF. SHABAN DEMIRAJN LIDHUR ME FONIN [ë] NË REALITETIN LINGUISTIK MAQEDONAS.....	51
NEXHIP MËRKURI: GJUHËSIA E PËRGJITHSHME DHE KËNDVËSHTRIMET BASHKËKOHORE PËR EPIRIN DHE MESAPËT	57
XHEMALUDIN IDRIZI: DISA FJALË PËR KONTRIBUTIN E SHABAN DEMIRAJT PËR GJUHËSINË BALLKANIKE	69
BARDHOSH GAÇE: KONTRIBUTI I PROF. SHABAN DEMIRAJT NË STUDIMIN E LETËRSISË SHQIPE	89
MYRVETE DRESHAJ–BALIU & BEGZAD BALIU: PROFESOR SHABAN DEMIRAJ: ÇËSHTJE TË METODËS.....	101
KUJTIM KAPLLANI: NDERIMI I PROF.SHABAN DEMIRAJT PËR ALBANOLOGËT	119
HYSEN MATOSHI: SHABAN DEMIRAJ – LETRAR.....	127
ZEQIRJA NEZIRI: NDIHMESA E AKADEMIK SHABAN DEMIRAJT PËR AFIRMIMIN E LETËRSISË ARBËRESHE	133

AGIM POLOSKA: GJUHA SHQIPE NË KONTEKST BALLKANIK NË “GJUHËSINË BALLKANIKE” TË AKADEMIK SHABAN DEMIRAJT	145
ASLLAN HAMITI: NDIHMESA E PROF. SHABAN DEMIRAJT PËR BALLKANOLOGJINË	153
MIRUSHE HOXHA: MËNYRA DËSHIRORE NË MORFOLOGJINË HISTORIKE TË GJUHËS SHQIPE NGA SHABAN DEMIRAJ	159
VALBONA TOSKA: ÇËSHTJA E RIMARRJES SË KUNDRINËS NË „GJUHËSINË BALLKANIKE” TË SHABAN DEMIRAJT	167
ISMET OSMANI: STUDIME TË PROF. SHABAN DEMIRAJT NË LËMË TË TRASHËGIMISË KULTURORE	173
MUSTAFA IBRAHIMI: SHABAN DEMIRAJ PËR ETNOSIN ARBËRESH DHE PËR RËNDËSINË E GJUHËS ARBËRESHE .	177
BERTON SULEJMANI: TERMINOLOGJIA GJUHËSORE NË TEKSTET MËSIMORE PËR SHKOLLAT TONA TË MESME TË PROF. SHABAN DEMIRAJT	187
BUKURIE MUSTAFA: STUDIUES ME KONTRIBUTE THELBËSORE NË FUSHËN E MORFOLOGJISË HISTORIKE TË SHQIPES DHE TË BALLKANOLOGJISË	199
HIDAJETE AZIZI: NJË BALLKANIZËM NGA PIKËPAMJA E PROF. DEMIRAJT	207
ZEQIRIJA IBRAHIMI: “GJUHËSIA BALLKANIKE” – NJË SHEMBULL PËR BALLKANISTIKËN	219
BIBLIOGRAFIA E BOTIMEVE TË PROFESOR SHABAN DEMIRAJT	227

DY FJALË PËR KËTË VËLLIM

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup në frymë të takimeve e tubimeve tradicionale shkencore, më 21 nëntor 2014 e organizoi konferencën shkencore me temë “Shaban Demiraj – figurë e shquar e albanologjisë dhe ballkanologjisë”.

Siç tashmë dihet, prof. Shaban Demiraj i mbylli sytë dhe u nda nga kjo botë më 30 gusht 2014, ndërsa kjo ishte një arsye më shumë që të kujtohej personaliteti dhe vepra e rëndësishme e këtij kolosi të albanologjisë dhe ballkanologjisë.

Me këtë rast u mbledhën në Shkup njohësit më të mirë të veprës dhe figurës së prof. Demirajt nga Shqipëria, Kosova dhe nga Maqedonia, disa nga të cilët ish studentë e bashkëpunëtorë të tij, ndërsa disa të tjerë nxënës dhe admirues të veprës së tij. Ata i shpalosën kundrimet e tyre për veprën e Profesorit dhe hapën shtigje të reja të studimit të saj. Mes tjerash, në këtë konferencë mori pjesë edhe i biri i Profesorit, po ashtu albanolog – Bardhyl Demiraj, i cili përveç si përfaqësues i familjes, pati edhe kumtesën e tij që po botohet në këtë vëllim. Madje, ai – në shenjë mirënjohjeje ndaj organizimit tonë – përveç kumtesës na e dorëzoi për botim edhe një bibliografi të zgjeruar të veprimtarisë shkencore të prof. Shaban Demirajt, që s’do mend se e ka pasuruar veçmas këtë vëllim të SCUPI-t.

Kumtesat e këtij vëllimi janë një edhe një mirënjohje për punën e madhe që ka lënë pas vetes profesor Shaban Demiraj, por edhe një dëshmi se emri dhe personaliteti i tij çmohet njësoj si në Shkup, ashtu edhe në Tiranë dhe Prishtinë. Madje, vepra e tij i ka tejkaluar edhe përmasat e kombëtare dhe është bërë pronë edhe e gjuhëve të tjera, për çka dëshmon edhe kjo konferencë dhe emrat e pjesëmarrësve në të. Në këtë kontekst, njëri nga referuesit e kësaj konferencë do të shprehët se “Prof. Demiraj, ashtu si Sokrati, ishte i mundur vetëm në Ballkan. Ai do të mbetet një sokrat i kohës sonë”.

Punimet e kësaj konference i përshëndeti edhe ministri i Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë, z. Abdilqim Ademi, përfaqësuesi i Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Shkup, z. Ahmet Lala, drejtori i Institutit, dr. Skender Asani, si dhe mikut e prof. Demirajt nga Shkupi, prof. Remzi Nesimi.

Konferenca “Shaban Demiraj – figurë e shquar e albanologjisë dhe ballkanologjisë” ka ndriçuar aspekte deri tash të pastudiuara të veprës së Profesorit, ndërsa ka hapur edhe mundësi të reja që vepra e rëndësishme e Profesorit të jetë gjithnjë e më shumë e pranishme në opinionin shkencor e arsimor jo vetëm shqiptar, sepse ajo është një kapital që e ka nderuar jo vetëm autorin e saj, por edhe kombin të cilit ai i përkiste.

QEMAL MURATI,

ITSHK – Shkup

GJUHËTAR KLASIK QË I PESHON RËNDË FJALA

Pak kohë më parë albanologjia shqiptare mbeti edhe pa klasi—kun e saj të fundit. Më 30 gusht 2014 iku albanologu dhe ballkanologu i shquar i radhëve të para, profesor Shaban Demiraj. U nda nga kjo jetë në moshën 94-vjeçare, si mund të themi “*me merakun për ndryshimet e shumëpërfolura në drejtshkrimin e gjuhës shqipe*”. E mbi ndryshimet shumë të diskutuara për gjuhën standarde shqipe, profesor Shaban Demirajt (në një intervistë dhënë për Top Channel në korrik të vitit 2012, atëherë kur sëmundja po rëndonte shëndetin e tij.), jepte këto fjalë porosi për Këshillin Ndërkademiak për gjuhën shqipe: “*Të ecet me mendtë në kokë, të bëhen ato ndryshime që prishin më pak punë, ky komision ka lëndë të punojë, megjithëse po punon ngadalë, po këto ndryshime në gjuhë nuk bëhen kështu, i teket njeriut ta shkruaj anëtar apo antar. Nuk bëhen këto me nisma teke, se atëherë krijohet një anarki*”. Natyrisht, ky qëndrim i prof. Shaban Demirajt duhet të mbahet si vath në vesh nga të gjithë ata që kanë marrë kadmën rrënimtare kundër gjuhës shqipe, sepse vjen nga filologu më i ditur e më punëmbarë i shqipes, e jo të marrin turrin pseudofilologët e t'i vërsulen kodit drejtshkrimor të shqipes sikur ta kishin gjetur atë në zullum.

Ndihmesa e prof. Demirajt veçanërisht është e dukshme për pastrimin dhe pasurimin e gjuhës letrare shqipe. Për këtë gjë dëshmon edhe përfshirja aktive e tij në organizimin dhe zhvillimin e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, por dhe përpjekjet e tij të mëpastajme. Do të jetë gjithmonë a—

ktuale thirrja kuptimplote që ai bënte duke përkujtuar 25-vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, ku u vendos përfundimisht përdorimi i një gjuhe letrare të përbashkët për të gjithë shqiptarët: *“Të përpiqemi të gjithë për të shpëtuar nga rreziqet që po i kërcënohen gjuhës sonë të bukur, e cila është jo vetëm thesari më i çmuar që kemi trashëguar nga të parët tanë, por edhe shenja dalluese kryesore e kombit shqiptar”*.

E, kur binte puna të bënte një bilanc të përdorimit të shqipes së sotme letrare në prag të shekullit XXI, në 25-vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit, përkatësisht nëse vendosja e gjuhës letrare të përbashkët që kemi sot në përdorim, ka qenë një veprim i arsyeshëm apo jo, prof. Demiraj ngrinte dy pyetje të tilla: *Si ka funksionuar kjo gjuhë e standardizuar deri sot dhe a do t’i qëndrojë dot kohës në të ardhmen?* Për t’u dhënë vetë një përgjigje të argumentuar: Përvoja e këtyre dhjetëvjeçarëve të fundit e bën të mundur që t’i jepet një përgjigje pohuese pyetjes nëse vendimi i vitit 1972 ishte i drejtë dhe i marrë në kohën e duhur. Edhe ata që patën shprehur rezerva ose kundërshtim për vendimin, tashmë duhet të jenë bindur se shqipja e sotme letrare, e cila në të vërtetë është fryt i punës së madhe të disa breza intelektualësh – shkrimtarë, gjuhëtarë dhe shkencëtarë të ndryshëm etj. – i ka plotësuar mirë kërkesat bashkëkohore të një gjuhe letrare. Natyrisht, nevoja për zhvillimin dhe përsosjen e saj të mëtejshme mbetet një kërkesë e vazhdueshme – përsiaste prof. Demiraj. Porse, zhvillim dhe përsosje nuk do të thotë që në gjuhë të mund të bëhen ndërhyrje arbitrare nga një tifoza krahinarist, siç po preten- dohet në këta dy dhjetëvjeçarët e fundit.

I lidhur fort pas gjuhës shqipe

I lidhur fort pas gjuhës shqipe, ai i ka sjellë kësaj gjuhe përmendoret më të mira, vepra themeltare me vlera të padiskutueshme shkencore. Prejardhja e gjuhës shqipe ishte obsesioni kryesor i tij, të cilën profesor Shaban Demiraj e lidh ngushtësisht me historinë dhe jetën e popullit shqiptar. Në këtë çështje madhore, ai ka parashtruar pikëpamjet kryesore të studiuesve të huaj e vendas, të cilat herë kanë qenë të karakterit historik, herë gjuhësor e herë gjeografik, për të paraqitur më pas dhe pikëpamjet e veta të argumentuara në formë sintezuese. Temat e trajtuara për historinë e shqiptarëve nëpërmjet gjuhës shqipe kanë si bosht kryesor tek ai objektivitëtin shkencor. Për sa u takon përpjekjeve të disave për të sqaruar gjuhën e pellazgëve me anë të mbishkrimeve etruske dhe këto të fundit me anë të gjuhës shqipe, përpjekjet e tilla për prof. Demirajn janë të bëra shpesh me paragjykime joshkencore dhe nuk e kapërcejnë prapësinë e fantazisë apo të dëshirës për të mbrojtur një tezë të pambrojtur, duke bërë krahasime me fjalë të shqipes së sotme, pa marrë aspak parasysh se fjalët e shqipes së sotme, edhe kur janë të trashëguara, në kohën e pellazgëve apo të etruskëve kishin përbërje fonetike të ndryshme nga ato të shqipes së dokumentuar. Dhe sjell si shembull për këtë mendimin e shprehur nga disa studiues shqiptarë se emri i *Toscana*-s në Itali lidhet me emrin *toskë* të Shqipërisë Jugore. Ndaj hamendësimeve të tilla prof. Shaban Demiraj mban qëndrim të fortë kritik dhe na jep modelin se si duhet të punohet në shkencë me argumente e jo me fjalë boshe e me etimologjizime qesharake që nuk i hyjnë në punë askujt.

Në rrafshin e ndërdikimeve gjuhësore, një fushë po kështu e pëlqyer e tij, ai ka lënë postulate me vlerë për gjuhën shqipe:

“Ndikimi gjuhësor, në shumicën e rasteve, kufizohet në fushën e fjalorit. Më pak të prekshme janë struktura gramatikore dhe sistemi fonologjik. Kur ndikimi i huaj prek thellë edhe këto dy fusha të një gjuhe, atëherë ajo merr rrugën e bastardimit e me kohë edhe mund të zhduket fare”. Si një autoritet shkencor dhe njeri gjithmonë i drejtpeshuar, me përgatitje filologjike të admirueshme par excellence, kërkonte që edhe ata që operojnë me materien e gjuhës të jenë të drejtpeshuar, t’i njohin mirë ligjësitë e saj, të merren me pasurimin, të mbajnë një qëndrim të përkorë ndaj huazimeve, e jo të merren me çserbizimin, çmaqedonizimin, çromanizimin apo me çgreqizimin e saj, sepse kjo nuk do të ishte një gjë e dobishme: “Nuk mund dhe nuk duhet të nxirret përfundimi që gjuha e shqiptarëve të Kosovës, të Maqedonisë e të Malit të Zi duhet çserbizuar apo çmaqedonizuar, ashtu siç nuk është rasti të flitet për nevojën e çromanizimit apo të çgreqizimit të të folmeve të Shqipërisë. Përdorimi i termave të tillë jo vetëm që u jep shkas polemikave të panevojshme dhe të pabukë, por edhe nuk mbështetet nga gjendja e vërtetë e gjuhës shqipe, të folur e të shkruar përkëtej dhe përtej kufijve të shtetit shqiptar. Nuk është fjala për një qëndrim purist të tepruar, por për një qëndrim të drejtpeshuar”.

Për evolucionin e shqipes dhe ndikimin që ka pësuar në rrjedhë të kohëve, argumenton me maturi e qëndrim kritik: “Për sa i takon gjuhës shqipe, e cila është zhvilluar nga evolucioni i njërës prej gjuhëve të lashta indoevropiane të Ballkanit, nuk është e tepërt të pohohet se është një nga “të papriturat” e historisë që ajo e ka ruajtur mëvetësinë e saj, me gjithë trysinë e fuqishme, që është ushtruar mbi të në rrymë të shekujve. Këtu kam parasysh sidomos ndikimin e madh të latinishtes, të greqishtes, të gjuhëve sllave fqinje, të turqishtes etj. Madje,

serbishtja dhe maqedonishtja e kanë vazhduar ndikimin e tyre mbi të folmet periferike të shqipes edhe gjatë shekullit XX. Si rrjedhim, *shqipja mbahet me të drejtë si një ndër gjuhët më të ndikuara të Evropës*”.

Në gjykimet e veta prof. Demiraj nuk është kurrë absolut, që është një cilësi tjetër e dijetarit të vërtetë, e për t’i mbështetur ato sjell edhe mendimin e ndonjë autoriteti tjetër shkencor, me referencën të *kihet parasysh edhe pohimi i...*: “Edhe ndryshimet fonetike midis dialekteve të gjuhës sonë nuk janë të tilla, që të mund të pengojnë përvetësimin e shpejtë të shqipes standarde edhe nga banorët e Veriut. *Të kihet parasysh pohimi i Pedersenit* rreth tetëdhjetë vjet më parë (shih “Ylli i Mëngjesit”, vol. 2, 31 tetor 1917, f. 235), që “Ndryshimi midis të dy dialekteve të gjuhës shqipe është shumë më i vogël sesa ndryshimet dialektore, që vihen re në shumë gjuhë të tjera; nga pikëpamja praktike ndryshimi midis dialekteve të gjuhës shqipe nuk ka asnjë rëndësi” (*Gjuha shqipe – Probleme dhe disa figura të shquara të saj*, Tiranë, 2003, f. 288).

I mbetemi borxh për shumëçka

Prof. Shaban Demiraj është nga ata pak të rrallët gjuhëtar klasik të albanologjisë dhe të ballkanologjisë që i peshon rëndë fjala. Atij të gjithë i mbetemi përjetësisht borxh për diçka. Brezat e shumtë të studentëve i mbeten borxh për leksionet e tij me të cilat i ngriti e i formoi, studiuesit për veprat e tij themeltare shumëdimensionale, për metodën shkencore dhe të menduarit kritik, ku qëndroi i patundur në krye të shqipes e të studimeve shqiptare. Mjeshtri pasionant i gjuhës shqipe, Shaban Demiraj, gjuhëtar dhe njeri me dimensione të gjera, i ka ndenjur shqipes ndër këmbë e ndër krye. “*Të gjithë ata që*

shqipen e quajnë gjuhë të tyre të nënës, të mos heqin dorë nga mbrojtja e saj” – përsiaste prof. Demiraj.

Vepra e profesor Sh. Demiraj, i gjithë kontributi i vëllimshëm prej 10 000 faqesh që mban autorësinë e tij, shquhet për pasurinë e informacionit, për arsyetimin rigoroz, për analizën kritike të dokumenteve, për vështrimin kompleks të dukurive historike në ndërlidhjet e tyre të shumanshme dhe me faktorët veprues të brendshëm e të jashtëm. Fakti që analizat dhe arsyetimet e këtij gjuhëtari të shquar qëndrojnë në bazë të punës së studiuesve të gjuhës shqipe qofshin shqiptarë a të huaj, flet mbi të gjitha për objektivitetin shkencor të trajtimit të historisë së gjuhës shqipe (Mimoza Karagjozi Kore).

Figura dhe ikja e tij është cilësuar me epitetet më të larta: *Gjuha shqipe ka humbur pasionantin e saj më të madh. Shaban Demiraj, gjuhëtar i klasit të parë, autoritet shkencor elitar, një nga përfaqësuesit më të shquar të fushës së gjuhësisë brenda dhe jashtë Shqipërisë, Kur njeriut i flet vepra*, etj. E, kur njeriut i flet vepra, ai mbetet i pavdekshëm. Pa e tepruar fare, mund të thuhet se profesor Shaban Demiraj është një nga përfaqësuesit më të shquar të gjuhësisë shqiptare, dalëzotës me kompetencë të rrallë në fushën e ideve të morfologjisë historike, të etimologjisë, të gjuhës letrare shqipe dhe të gjuhësisë ballkanistike. Ai mbetet ajka e gjuhësisë shqiptare. Figurës së prof. Shaban Demirajt do t’i shkonin fjalët që E. Çabej i thoshte për Aleksandër Xhuvanın: *“Personaliteti i tij përmban anë njerëzore të forta, ai ka qenë i rrafshët e i thjeshtë në jetë e në marrëdhëniet e tij me të tjerët”*. Modele të tilla madhështie e thjeshtësie të njëkohshme të shkruara tek i njëjti person historia nuk i përsërit shpesh, prandaj ky dijetar i klasit të parë do ta na mungojë gjithmonë, por jo dhe vepra e tij drejtimdhënëse.

XHEVAT LLOSHI,

Tiranë

VËSHTRIMET E PROF. SH. DEMIRAJT PËR LEKSIKUN E SHQIPES

Në lëmin e gjuhësisë shqiptare prof. Sh. Demiraj ka dalë që më 1953 si autor në fillim me trajtesa për gjuhën e disa shkrimtarëve të së kaluarës dhe për shqipen e shkruar deri në fund të shek. XIX. Prej tyre ai përgatiti më 1962 dispensën *Historia e gjuhës së shkruar shqipe* prej dy pjesësh.¹

Te J. Variboba² janë vënë në dukje 54 fjalë me veçoritë e tyre kuptimore dhe 16 shprehje, duke i krahasuar edhe me autorë të tjerë për të dëshmuar natyrën arkaike të gjuhës së Varibobës. Te S. Frashëri³ nxirren në dukje përpjekjet e tij për pasurimin e zhvillimin e shqipes si gjuhë kulture, sidomos nëpërmjet neologjizmave dhe me shfrytëzimin e ndajshesave të larmë. Edhe në përpjekjen e parë⁴ për një vështrim përgjithësues mbi veprat e autorëve të shek. XIX, para së gjithash është hulumtuar puna për mënjanimin e huazimeve dhe pasurimin me neologjizma e me rikuptimesime të fjalëve nga gjuha e folur, po edhe me rastet e përfshirjes së fjalëve prej njërit dialekt të shkruar në tjetrin. Te veprat e autorëve arbëreshë të Italisë⁵ leksiku është parë si pasqyrë e të folmeve të katundeve arbëreshe, po edhe si përpjekje për ta pasuruar ligjërimin amtartar. Ndërkaq, këtu vërehet që ata kanë marrë fjalë prej shkrimtarëve bashkëkohorë shqiptarë dhe ndonjë prej të folmesh së Shqipërisë, porse neologjizmat nuk i kanë pranuar prej njëri-tjetrit. Ishte e natyrshme që do të binte në sy një mori huazimesh nga italishtja dhe greqishtja.

Në vitet 1960 prof. Sh. Demiraj, pa u shkëputur përfundi-misht nga shkrimtarët e së kaluarës,⁶ kaloi gjerësisht në fushën e morfologjisë së shqipes jo vetëm me punime studimore, por edhe me tekste për shkollën e mesme dhe të lartë. Është e kuptueshme që vështrimet leksikore atëherë do të ishin të rastësishme. Ndërsa në dhjetëvjeçarin pasues vëmendja kryesore do të ndalej te gramatika historike e shqipes. Përfundimisht, ai e rroku në horizontin më të hapët e më të thelluar historinë e gjuhës shqipe, duke ardhur më 1988 te libri *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, më 1994 te *Gjuhësi ballkanike* dhe te *Fonologjia historike e gjuhës shqipe* më 1996. Ky shqyrtim i gjerë historik i gjuhës nga ana e prof. Sh. Demirajt në mënyrë të natyrshme do të përfshinte edhe leksikun e saj.

Duke e parë shqipen si gjuhë indo-europiane,⁷ e ka nisur pikërisht me fjalorin, për të vënë në pah se gjuha jonë ka rruajtur një pjesë jo të vogël të fjalëve të trashëguara, deri te një shifër rreth 2000, pa numëruar fjalët e prejardhura prej tyre. Ndryshimet fonetike kanë ecur sipas ligjësisë së sistemit fonetik të saj.

Në rrethin më të ngushtë ballkanik, shqipja pranohet se është një ndër gjuhët ballkanike më tipike.⁸ Nga ana leksikore bien në sy sidomos 60–70 fjalë të vjetra, të përbashkëta për shqipen e rumanishten; ndërkaq, ato janë të trashëguara dhe jo të veçuara në shqipen. Të ngjashme jo vetëm nga domethënia, por edhe nga tipi i ndërtimit, janë një numër jo i vogël frazeologjish ndërballkanike, të cilat me përhapjen e tyre dëshmojnë se janë relativisht të vjetra.

Pamja tërësore e historisë së shqipes në këtë punim sintetizues do të përmbante tashmë një kapitull të veçantë (kap. VI) për shtresimin kohësor të fjalorit të kësaj gjuhe. Para së gjithash dëshiroj të nxjerr në pah se prof. Sh. Demiraj ka marrë qen-

drim të shprehur lidhur me trashëgiminë indo-europiane të leksikut të shqipes. Me të drejtë ai fjalët e burimit të hershëm i.e. i quan se janë trashëguar nëpërmjet “nënës” së saj. Shumica e studiuesve të mëparshëm kanë folur për etimologjitë i.e. të fjalëve të shqipes, duke e kapërcyer një periudhë mjaft të gjatë kohore. Për ta konkretizuar këtë paqartësi, do të sillja shembullin e italishtes. Nuk mund të flitet për etimologjitë i.e. të leksikut të italishtes, duke kaluar drejtpërdrejt te indo-europianishtja. Etimologjitë italiane shkojnë pas te latinishtja dhe nga latinishtja mund të kalohet më prapa te prejardhja i.e. Demiraj ka përdorur shpesh në thonjëza fjalën “nëna” e saj, duke nënkuptuar ilirishten. Po edhe sikur një studiues të mos e pranojë prejardhjen nga ilirishtja, sepse dihet që ka teza të nryshme për këtë pikë, përsëri vlen koncepti i “nënës” së shqipes dhe vetëm prej asaj mund të shkohet pas te burimi i.e. Rrjedhimisht, së pari vijnë fjalët që kanë pësuar dukuri të lashta fonetike, pastaj vijnë fjalët që nuk u janë nënshtruar këtyre ndryshimeve. Këto të dytat ose janë krijuar brenda ilirishtes, ose janë huazime nga gjuhë të tjera. Në këtë rastin e fundit, krahasimi do të bëhet me greqishten e vjetër dhe latinishten (duke lënë mënjane çështjen e substratit). E quaj të rëndësishme ta vë në dukje këtë qëndrim të Demirajt, sepse edhe sot shpesh lexojmë, për shembull, për huazimet nga greqishtja e vjetër në shqipen, ndërkohë që Sh. Demiraj e ka formuluar qartë: “Huazimet nga greqishtja e vjetër dhe nga latinishtja që kanë depërtuar në ilirishte dhe që nëpërmjet kësaj kanë kaluar edhe në shqipe, kanë pësuar më shumë ndryshime të karakterit fonetik, sesa huazimet që vetë shqipja i ka marrë drejtpërdrejt nga gjuhët e tjera”.⁹

Për mendimin tim, është koha të ndërmerret një rishikim tërësor i gjithçkaje që është hulumtuar për shqipen si gjuhë

i.e. dhe, mbi bazën e përfundimeve të qëndrueshme të arritura, të ndërtohet një tablo e ilirishtes, apo qoftë edhe gjuhës ‘nënë’. Po sjell vetëm një shembull. Sipas N. Joklit, fjala ‘natë’ është një temë me $-i-$ prej një baze $\star nakti$. Atëhere kjo është pikënisja i.e. për ilirishten, e cila mund të krahasohet me lat. *nox*, gr. *νύξ*, got. *nahts*, lit. *naktis*. Kurse nga ilirishtja, nëpërmjet asimilimit të grupit $-kt-$ është kaluar te shqipja *natë*. Kjo do të thotë se *natë* do të krahasohet me burimin e vet ilir dhe jo me latinishten etj. Për fonetikën kjo do të thotë se ka pasur një grup $-kt-$ në ilirishten, i cili ka pësuar asimilimin, duke kaluar në shqipen.

Vëmendjen e Demirajt këtë radhë e kanë tërhequr si fjalët e trashëguara, që kanë dalë jashtë përdorimit para formimit të shqipes, ashtu edhe fjalët e prejardhura në ilirishten, që janë përcjellë si të tilla. Është e vërtetë, që këto janë çështje tejet të vështira për t’i zgjidhur, por është meritë e autorit se i ka cekur dhe kështu ka hapur rrugë të reja hulumtimi. Ndërkaq, jepet e zgjeruar lista e fondit të fjalorit i.e. të shqipes. Duke e çuar më tej idenë e pranisë konkrete të ilirishtes, studiuesi edhe për huazimet ngulmon që të dallohen huazimet në ilirishten prej huazimeve, që ka bërë shqipja drejtpërdrejt nga gjuhët, me të cilat ka qenë në kontakt. Pranini se elementë nga greqishtja e vjetër ishin të pranishëm në ilirishten, domethënë si periudhë jo më vonë sesa shek. V i erës së re, shërben si një argument, që paraardhësit tanë kanë pasur kontakte më të hershme me grekët e vjetër, ndonëse ndikimi i kësaj mbi ilirishten do të ketë qenë i kufizuar. Shembulli më i njohur është fjala *mokën/mokër*, e cila vërteton se evolucioni $-ā->-o-$ ka ndodhur në ilirishten dhe ka prekur edhe shtresën më të vjetër të huazimeve greke, ndërsa rotacizmi dëshmon se ka ndodhur përpara dyndjeve sllave.

Pa u zgjatur më hollësisht për këtë çështje, e cila na del tashti në një dritë të re dhe interesante, po përmend se nocioni i ‘romanizimit të shqipes’ duhet ndryshuar në ‘romanizimi i ilirishtes’ dhe, për pasojë, do të riformulohej thënia e mëparshme, duke u bërë kështu: “ilirishtja i shpëtoi romanizimit të plotë” dhe jo shqipja, e cila iu nënshtrua ndikimeve të mëtejshme sidomos nga sllavishtja e turqishtja, si dhe besoj që duhet ta mendojmë që me kohë ka humbur huazime latine të latinishtes, ndërsa ka shtuar huazime prej italishtes e venetishtes. Kështu, në rast se nuk do të ishte ndërprerë ndikimi i turqishtes, nuk do të ishte e papritur që një huazim latin si *fytyrë* do të ishte zëvendësuar me *surrat*, *qytet* me *shehër*, *kasaba*, *i varfër* me *fukara* etj.

Po këtu bën pjesë tema e huazimeve kishtare. Krishterini erdhi në trevat shqiptare nga Perëndimi, domethënë latinisht, pas shek. III të erës së re. Atëhere fjalë si *benedicere*, *maledicere* nuk janë kuptuar nga ata folës si të përbëra, madje janë dëgjuar kryesisht në vetën e parë *benedicam*. Për pasojë, *bekoj* nuk vjen nga *benedicere*, siç e japin gjithë autorët e etimologjive, por nga *benedicam*. Me sa duket, për shkak të një theksimi më të fortë në rrokjen nistore, së pari janë rrëgjuar dy rrokjet e para dhe më pas i janë përshtatur zgjedhimit pas tingullit -k-. Dhe nëpër këtë proces kanë ardhur te shqipja *bekoj*, *mallkoj*. Për pasojë, brenda ilirishtes duhet ndërtuar një trajtë ilire e ndërmjetme: lat. *benedicam* – ilir. ★... – shq. *bekoj*. Përfundimisht, mendoj se pohime të tilla, si: “në gjuhën shqipe ndeshen disa fjalë prej burimi latin, që i përkasin një faze relativisht të vjetër të latinishtes”, do të ishte historikisht më e drejtë të riformuloheshin kështu: “në gjuhën shqipe ndeshen disa fjalë të trashëguara prej ilirishtes me burim latin, që i përkasin një faze relativisht të vjetër të latinishtes”.

Me një metodë sistematike më tej Demiraj ka vështruar me radhë huazimet greke, romane, sllave, turke, si edhe ndër-kombëtarizmat. Natyrisht, për pika të veçanta këtu mund të bëhen vërejtje. Për shembull, *janicar* nuk është huazuar prej turqishtes, por nëpërmjet greqishtes dhe prandaj del në atë trajtë fonetike edhe te arbëreshët, ashtu si edhe fjala *cohë*. Gjithashtu nuk qëndron mendimi se autorët e letërsisë orientaliste, të quajtur bejtexhinj, kanë shumë fjalë turke, arabe e persiane, që ishin fare të panjohura për masat e gjera populllore. Historikisht, letërsia orientaliste te ne në fillim nuk ka qenë aspak shqip, madje edhe emrat e letrarëve që përmend E. Çelebiu në shek. XVII nuk u përkasin aspak poetëve shqiptarë. Më pas, me rënien hap pas hapi të Perandorisë Osmane, orientalistët e huaj u larguan nga trevat tona dhe në letërsinë orientaliste shqiptare nisin të depërtojnë fjalë të shqipes. Shkurt, te bejtexhinjtë nuk ndeshen shumë fjalë të huaja orientale, por përkundrazi, në krijimet e tyre sipas estetikës orientale nisin të depërtojnë fjalë shqipe dhe prandaj ato nuk shërbejnë si dëshmi për gjendjen e leksikut të shqipes përgjithësisht.

Pavarësisht prej këtyre vërejtjeve, në punimet e Sh. Demirajt kemi një pasqyrë më të përditësuar të përbërjes historike të leksikut të shqipes, ku jo vetëm janë përthithur arritjet më të qëndrueshme të autorëve të mëparshëm, por ato janë edhe më të sistemuara dhe në një varg pikash janë çuar më tej. Për më tepër, këto tashti e bëjnë edhe më të argumentuar trajtimin e çështjes madhore të prejardhjes së shqipes dhe, si rrjedhojë e saj, çështjen e vendit dhe të kohës së formimit të gjuhës sonë. Librin *Gjuhësi ballkanike* të vitit 1994 Demiraj e ribotoi të plotësuar dhe të përditësuar më 2000. Kreu i fundit u kushtohet bashkëpërkimeve në fushën e fjalorit. Tashmë kërkimet zgjerohen në disa anë, domethënë huazimet romane e greke

shqyrtohen kundrejt disa gjuhëve ballkanike njëherësh, por edhe fjalët sllave që kanë depërtuar në shqipen, në rumani-shten dhe në greqishten. Do të shtoja me këtë rast, se ndryshe, për shembull, nga greqishtja, jo vetëm kontaktet u përkasin periudhave të ndryshme, por bashkë me këtë janë të ndryshme edhe gjuhët sllave jugore gjatë këtyre periudhave. Prandaj ka dallime të ndjeshme ndërmjet tri gjuhëve të mësipërme, që kanë ndier ndikimin, i cili me epitetein “sllav” mbulon shtresa jo të njëta fjalësh si gjuhë dhe si kronologji.

Vështrimet e prof. Sh. Demiraj për leksikun e shqipes i japin atij një vend në leksikologjinë historike të shqipes, në të cilën jo vetëm ka bërë risistemimin e dijes së mëparshme, por edhe ka dhënë ndihmesa të veçanta, duke hapur shtigje të reja hulumtimi në këtë fushë.

SHËNIME DHE REFERIME

1. Në ‘Bibliografinë’ e përgatitur nga E. Lafe dhe botuar në “Gjuha jonë”, 1996, nr. 1–4, f. 15–26, kjo dispensë vendoset në vitin 1968 dhe e ribotuar në Prishtinë më 1970, por botimi i parë i shaptilografuar është i vitit 1962.
2. DEMIRAJ, SH. (1953): *Disa shënime të krahasuara mbi gjuhën e Jul Varibobës*. BSHSH, nr. 1, f. 66–75; nr. 2, f. 16–31; nr. 3, f. 39–50.
3. DEMIRAJ, SH. (1955): *Gjuha e Sami Frashërit*. BSHSH, nr. 3, f. 191–234.
4. DEMIRAJ, SH. (1956): *Historia e gjuhës së shkruar shqipe. Shekujt XVIII–XIX*.
5. DEMIRAJ, SH. (1956): *Historia e gjuhës së shkruar të arbëreshëve të Italisë (shekujt XVI–XIX)*.
6. Te *Fan Noli dhe gjuha e tij* (SF, 1982, nr. 1, f. 87–91) do të vinte në dukje se Noli ndërton mjaft fjalë të reja, në pjesën

më të madhe kalke gjuhësore, ndërsa ishte treguar shumë do-rëmbarë me fjalët e përbëra. Ndërkaq, qëndron vërejtja që i ishte bërë, për përdorimin e tepruar të fjalëve të huaja.

7. DEMIRAJ, SH. (1988): *Gjuha shqipe dhe historia e saj*. SHBLU, f. 35.

8. DEMIRAJ, SH. (1983): *Shqipja gjuhë ballkanike*, në “Gjuha jonë”, nr. 1, f. 38–45.

9. DEMIRAJ, SH. (1988): *Gjuha shqipe dhe historia e saj*. SHBLU, f. 93.

EMIL LAFE,

Tiranë

PROF. SHABAN DEMIRAJ PËR KULTURËN E GJUHËS DHE NORMËN LETRARE

Prof. Shaban Demiraj është themeluesi i lëndës së morfologjisë në Universitetin e Tiranës. Me tekstin e tij “Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe” (Demiraj 1961), që është ribotuar edhe në Kosovë, kanë studiuar breza të tërë studentësh të degës së gjuhës shqipe e të gjuhëve të huaja. Ata janë përgatitur si mësues, redaktorë, kërkues shkencorë, përkthyes etj. dhe prej këtij teksti kanë mësuar teorinë dhe praktikën e morfologjisë së shqipes letrare. Veçori themelore të tekstit të prof. Sh. Demirajt janë: së pari, përpunimi teorik më i thelluar e më i plotë i kategorive gramatikore të shqipes dhe, së dyti, përcaktimi më sistemor e më i mirë i normës letrare gramatikore, duke marrë parasysh zhvillimin e gjuhës së shkruar shqipe në kohën kur u botua teksti.

Përcaktimi i normës morfologjike në periudhën e pasluftës ka kaluar nëpër disa shkallë. Së pari, dy gramatikat e Kostaq Cipos të vitit 1949: “Gramatika e shqipe” e Institutit të Shkencave dhe “Gramatika e gjuhës shqipe” për shkollat shtatëvjeçare (klasat V, VI, VII). Ndonëse nga i njëjti autor, norma letrare të gramatika shkollore është më e përcaktuar, kurse të gramatika e Institutit të Shkencave K. Cipoja ka dhënë herëherë një shumësi formash, duke përfshirë edhe forma thjesht dialektore, madje edhe të arbërishtes. Në mënyrë të veçantë për sistemin foljor këto i ka vënë në dukje studiuesja Adelina Çerpja (Çerpja 2012). Më tej vjen “Ortografia e gjuhës shqi-

pe” e vitit 1951 (Ortografia 1951), e ripunuar gjatë viteve 1953–1954 (Projekti 1954) dhe e zbatuar te “Fjalor i gjuhës shqipe” i botuar atë vit (Fjalor 1954). Një hap të ri shënon “Ortografia e gjuhës shqipe” e vitit 1956 (Ortografia 1956). Teksti i prof. Sh. Demirajt shënon një hap të rëndësishëm përpara, pasi është konceptuar dhe hartuar si gramatikë (morfologji); në të janë vështuar e trajtuar në mënyrë sistimore të gjitha pjesët e ligjëratës dhe janë bërë përpjekje për kodifikimin e format e tyre letrare.

Prof. Sh. Demiraj ka drejtuar punën e grupit hartues të vëllimit “Morfologjia” të asaj që njihet si “Gramatika e Akademisë”. Në këtë vëllim¹ prof. Sh. Demiraj ka hartuar edhe kreun “Folja”, që është jo vetëm kreu më i vëllimshëm i veprës, por edhe më problemori për sa i përket larnisë së formave dhe probleme të tjera. Mbi këtë gramatikë janë mbështetur edhe veprat e mëvonshme normative. Arritjet e gramatikës së re të Akademisë iu dhanë pa vonesë edhe shkollës me tekstin e hartuar nga S. Demiraj e N. Cikuli për shkollat pedagogjike, botini i parë 1973 (Demiraj 1973/b). Për sa u takon foljeve, duhet përmendur doracaku i “Zgjedhimi i foljeve” i Zijadin Munishit (Prishtinë, 1998), i cili shkruan në parathënie se është mbështetur te klasifikimi i foljeve në “Gramatikën” e Akademisë; po ashtu edhe doracakë të tjerë për foljet e gjuhës shqipe².

¹ Vëllimi u hartua në dorë të parë e u diskutua në vitin 1972; u botua si libër më 1976.

² Stefanllari, Rozeta; Hintz, Bruce: *541 Albanian Verbs fully conjugated in all tenses in an easy-to-learn format*. Albatros. Tiranë, 2006, 653 f.; Bega, Bato; Bega, Sokol Bega: *Albanian verbs the art of conjugation*. Albanian as a Second Language (A.S.L.). Printed in Albania by “Pegi”. Tirana, 2007, 265 f. + CD.

Krahas kësaj pune për tekstet dhe veprat shkencore, që janë tashmë të mirënjohura, prof. Sh. Demiraj ka dhënë një ndihmesë të shënueshme edhe në diskutimet për normën letrare e për gjuhën letrare shqipe në përgjithësi. Ai ka qenë një mbrojtës i vendosur e parimor i shqipes letrare të njësuar dhe disa herë ka sjellë argumente bindëse se kjo gjuhë letrare që u sanksionua në Kongresin e Drejtshkrimit (1972), nuk është një krijim arbitrar e artificial i ideologjisë sunduese të kohës, por kurorëzim i një procesi të gjatë të përpunimit dhe të lëvrimit të vetë gjuhës letrare. Ky proces që u zhvillua me një intensitet më të lartë vitet e pasluftës me zhvillimin e madh që morën arsini, kultura e shkenca, i dha dorë gjuhësisë shqiptare të përpunojë dhe të hartojë veprat e nevojshme kodifikuese për drejtshkrimin, gramatikën, fjalorin dhe terminologjinë.

Në kumtesën që mbajti në Kongresin e Drejtshkrimit prof. Sh. Demiraj vëren me të drejtë se përcaktimi i rregullave të drejtshkrimit “mbështetet në përgjithësi në gjendjen e kristalizuar të normës drejtshkrimore në një kohë të dhënë, ose në prirjen e fiksimit të kësaj norme, kur ajo nuk është kristalizuar ende. Në rastin e fundit vendosja e normës drejtshkrimore paraqitet njaft e vështirë dhe kërkon një punë të kujdesshme, të mbështetur në një studim të thelluar, ku kjo apo ajo çështje e veçantë të shqyrtohet në lidhje të ngushtë me çështjet e tjera të ngjashme.” (Demiraj 1973/a, f. 323). Duke mbajtur këtë pikëpamje, ai nuk i ka miratuar hapat e nxituar të disave për një reformë të thellë të drejtshkrimit si kusht për të mos u shtuar zërat kundër standardit, që mund të shkojnë edhe deri në përmbysjen e tij.

Duke kaluar në çështje konkrete, në këtë kumtesë prof. Sh. Demiraj vlerëson si më të përligjura si nga ana morfologjike, ashtu dhe nga ana fonetike, ortogramet të *jashtëmve*, të *nder-*

shëmve, të vdekshëmve etj. në krahasim me *të jashtnëve, të ndershmëve, të vdekshmëve* etj., që përmbante Projekti i vitit 1967; ai shprehet se përcaktimi i këtyre formave (për të cilat vërehen edhe sot mjaft luhatje) është më fort çështje e gramatikës sesa e drejtshkrimit. Duke pasur parasysh edhe këtë vërejtje, në ripunimin e Projektit ato u lanë jashtë për t'u trajtuar nga gramatika.

Në Projektin 1967 ishte propozuar që trajta e shkurtër **i** e përremrit vetor në rasën dhanore, kur ndiqet nga një trajtë tjetër e shkurtër ose nga pjesëza u, të shkruhet **j**, si në pozicion proklitik, ashtu edhe në pozicion enklitik, d.m.th.: **ja** *morën këngës – mer**ja** këngës*. Kështu njësohej mënyra e shkrimit të kësaj trajte. Në këtë mes duhet përmendur se për shkrimin me **ja** ose **ia** në pozicion proklitik ka pasur shumë luhatje atëherë, kurse në pozicion enklitik shkruhej gjithnjë **ja** (*mer**ja**, jep**ja**, thu**ja*** etj. dhe jo *mer**ria**, jep**ia**, thu**ia***). Komisioni nuk ka qenë i njëzëshëm dhe i bindur për këtë zgjidhje, por ka dashur të marrë edhe mendimin e publikut. Prof. Sh. Demiraj ishte ndër ata që argumentuan se drejtshkrimi në këtë rast duhet të zbatojë parimin morfologjik, d.m.th. të ruhen struktura dhe njësia e trajtave. Gjatë ripunimit të Projektit, kjo rregull u ndryshua në atë që kemi sot, d.m.th. shkruajmë *ia dhe, ia mori*, por *mer**ja**, jep**ja***. Kjo rregull, që ka fituar tashmë qëndrueshmëri dhe nuk vihet më në diskutim, dëshmon se edhe në drejtshkrim nuk mund të zgjidhen të gjitha çështjet duke ndjekur me rreptësi vija të drejta.

Dihet se në fillim të viteve '90, pra menjëherë pas kthesës politike në Shqipëri e në rajon, shpërtheu një valë kundërshtimesh për gjuhën standarde dhe për Kongresin e Drejtshkrimit. Në këtë atmosferë në nëntor 1992 u mbajt në Tiranë konferenca “Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare

sot”. Një nga argumentet “e forta” të kundërshtarëve të standardit atëherë (po edhe sot), është mungesa e paskajores. Prof. Sh. Demiraj trajtoi pikërisht këtë temë në konferencën e vitit 1992 (Demiraj 2002/a), duke e vështruar problemin edhe historikisht, edhe në rrafshin e gjuhës letrare. Ai vuri ndikje se zgjerimi i funksioneve të mënyrës lidhore përbën një prirje të qartë të zhvillimit konvergjent të strukturës gramatikore të dy dialekteve të shqipes dhe kjo është karakteristike edhe për gjuhë të tjera të Ballkanit. Një tjetër zhvillim konvergjent krahas kësaj është krijimi i formës *për të shkuar/ për të shkue*, që përdoret me shumicën e funksioneve karakteristike të paskajores. Duke pasur këto mundësi, d.m.th. format e lidhore dhe formën e pashtjelluar *për të shkuar*, – vëren prof. Sh. Demiraj, – mungesa e paskajores së tipit *me punue*, e cila në burimet e shkruara dëshmohet vetëm për dialektin verior, nuk e ka penguar shqipen letrare të kohës sonë t’i plotësojë të gjitha kërkesat e një gjuhe kombëtare të zhvilluar, dhe këtë e dëshmojnë qartë jo vetëm veprat e autorëve shqiptarë, por edhe përkthimet e shumta nga gjuhët e huaja. Në vijim të argumentimeve të tij prof. Sh. Demiraj arrin në përfundimin se “futja e paskajores së tipit *me punue* në shqipen letrare të njësuar do të ishte gjuhësisht e panevojshme. Për më tepër, një gjë e tillë nuk do të ishte në përputhje me sistemin bazë të kësaj letraristeje standard.”³ (Demiraj 2002/a f. 59).

³ Që të mos merret ky pohim në mënyrë absolute, ai shton se kur vjen puna për të karakterizuar sa më mirë një personazh, që në gjuhën e përditshme flet dialektin verior, përdorimi i formave dialektore, ndër to edhe i kësaj paskajoreje, është i pranueshëm dhe i përligjur. Për këtë ai kërkon që trajtimi i formës së pashtjelluar e tipit *me punue* në gramatikat shkencore të zërë një vend më të gjerë. (Po aty).

Temës së shqipes letrare prof. Sh. Demiraj i është kthyer katër vjet më pas te artikulli “Shqipja e sotme letrare dhe e ardhmja e saj”, i botuar te përmbledhja “Shekulli 21” (Demiraj 1996). Disa ide, pohime e përgjithësime të tij duhen pasur parasysh, veçanërisht në rrethanat e debateve të vijueshme për këtë problem. Së *pari*, çështja se kjo gjuhë letrare e njësuar në Shqipëri u vendos në rrethanat e diktaturës komuniste. Me të drejtë ai vëren se gjuha letrare e njësuar u vendos si vullnet i përbashkët i gjithë shqiptarëve dhe se ishte Konsulta e Pri-shtinës (prill 1968) ajo që ia hapi rrugën Kongresit të Drejtshkrimit, se pa vullnetin e shqiptarëve në ish RF të Jugosllavisë (me të cilën Shqipëria në atë kohë ishte në marrëdhënie të acaruar), shqipja letrare e njësuar nuk mund të fitonte këtë përmasë mbarëkombëtare. Prandaj “teoria e zgjidhjes së dhunshme” nuk i përgjigjet së vërtetës. Së *dyti*, shqipja letrare e njësuar nuk u krijua në Kongresin e Drejtshkrimit, por është rezultat i një procesi të gjatë e të vijueshëm zhvillimi, kristalizimi dhe kodifikimi nga ana e gjuhëtarëve. Së *treti*, fakti që shqipja letrare e njësuar i ka qëndruar provës së kohës në të gjithë hapësirën e zbatimit të saj, tregon se ajo është ndërtuar mbi baza të drejta shkencore, duke u mbështetur në elementet e përbashkëta të strukturës së gjuhës dhe duke integruar elemente të veçanta dialektore funksionale (p.sh. emrat si *mësues*, *shikues*, mbienrat si *i arsyeshëm*, *i punueshëm* etj.). Së *katërti*, dialekti i jugut ishte më homogjen dhe më i lëvruar sidomos nga shek. XIX, kur fillon lëvizja e Rilindjes.

Duke hedhur vështrimin drejt së ardhmes prof. Sh. Demiraj shprehet me bindje se shqipja standarde do t’i përballojë gjithnjë e më mirë kërkesat e shoqërisë shqiptare në zhvillim, por për të arritur këtë, duhet të punohet më shumë për ta bërë më të qëndrueshme dhe për ta pasuruar me fjalë e

shprehje nga gjuha popullore (detyrë në radhë të parë e shkrimtarëve), dhe me formime të reja e veçanërisht me terma të fushave të ndryshme të shkencave, teknikës dhe arteve. Në këtë mes mbetet si detyrë e përhershme ruajtja e veçantisë kombëtare të shqipes dhe mënjanimi i fjalëve, shprehjeve e ndërtimeve të huaja të panevojshme.

Në konferencën “Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot” me rastin e 30-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit, prof. Sh. Demiraj iu rikthye disa çështjeve thelbësore të shqipes standarde (Demiraj 2003). Edhe një herë argumentoi se shqipja standarde mbështetet mbi baza shkencore dhe është kurorëzim i një procesi letrar gjatë të cilit varianti letrar jugor përthithi edhe elemente të varianteve letrare veriore, duke lënë mënjanim herë–herë elemente të vetat në gjithë strukturën e gjuhës, dhe kështu arriti të ngrihej në shkallën e një gjuhe letrare të njësuar e të përbashkët. Fakti që territori i bazës dialektore të shqipes standarde është më i ngushtë sesa territori i dialektit verior nuk është diçka e panjohur edhe për gjuhë të tjera, p.sh. italishtja, frëngjishtja, gjermanishtja. Prof. Sh. Demiraj, duke analizuar strukturën e përgjithshme të gjuhës shqipe (sidomos në rrafshin fonetik e gramatikor) vëren se mbizotërojnë elementet e përbashkëta. I vetmi ndryshim ndërmjet dialekteve tona në rrafshin gramatikor është mungesa e paskajores së tipit *me punue*. Por kjo nuk ka përbërë një pengesë në funksionimin e shqipes standarde dhe me këtë rast ai risjell dhe përforcon argumentet e parashtruara në kumtesën e konferencës së vitit 1992 (Demiraj 2002/a).

Dihet se me kohë prof. Sh. Demiraj iu përkushtua studimit të gramatikës historike dhe të historisë së gjuhës shqipe. Por veprat tij për shqipen e sotme letrare dhe trajtesat e tjera të kësaj fushe mbeten themelvënëse e orientuese. Ato shquhen për

arsyetimin dhe argumentimin e qartë e bindës, për gjuhën e rrjedhshme, pa ndërlikime të panevojshme intelektualiste. Kjo i bën të lexohen gjithnjë me përfitim të drejtpërdrejtë. Merita e prof. Sh. Demirajt në fushën e normës letrare dhe të kultures së gjuhës është e dyfishtë: nga njëra ai është hartues dhe drejtues i veprave kryesore normative në fushën e morfologjisë së shqipes letrare dhe, nga ana tjetër, ai është ndërmbrojtësit e vendosur të shqipes letrare, duke treguar me argumente shkencore e bindëse drejtësinë e zgjidhjeve dhe të vendimeve që ka marrë gjuhësia shqiptare në këtë fushë në kohën e duhur.

Literatura

Çerpja 2012 = Çerpja, Adelina: Dallime të formave foljore në dy gramatikat e vitit 1949 të Kostaq Cipos. – *Gjurmime albanologjike – Shkencat filologjike* 41/42/2011/2012, f. 161–169.

Demiraj 1961, I, II = Demiraj, Shaban: *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*. Universiteti Shtetëror i Tiranës, Tiranë, 1961, Pjesa I, 96 f.; Pjesa II, 304 f.

Demiraj 1973/a = Demiraj Shaban: Rreth disa çështjeve gramatikore në rregullat e drejtshkrimit të shqipes. – *Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe 20–25 nëntor 1972. II*. Redaksia: Androkli Kostallari (redaktor përgjegjës), Mahir Domi, Eqrem Çabej, Emil Lafe, Jani Thomai, Xhevat Lloshi, Nikoleta Cikuli. Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë, 1973, f. 323–329.

Demiraj 1973/b = Demiraj, Shaban; Cikuli, Nikoleta: *Gramatika e gjuhës shqipe, 1*. Tiranë, 1973.

Demiraj 1996 = Demiraj, Shaban: Shqipja e sotme letrare dhe e ardhmja e saj. – in: *Shekulli 21 Mendime dhe opinione*.

Ideja dhe sponsorizimi i botimit Dino Asanaj. Gjonlekaj Publishing Company. New York USA, 1996, f. 119–122.

Demiraj 2002/a = Demiraj, Shaban: *Gjuha letrare shqipe e njësuar dhe çështja e paskajores.* – *Konferenca Shkencore “Gjuha Letrare Kombëtare dhe Bota shqiptare sot”* Tiranë, 20–21 nëntor 1992. Redaksia: Jorgo Bullo, Emil Lafi, Seit Mansaku, Enver Hysa. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Shtëpia botuese “Shkenca”. Tiranë, 2002, f. 56–59.

Demiraj 2002/b = Demiraj, Shaban: *Rreth foljeve fyej e fëjëj dhe disa formave të tyre.* – *Gjuha jonë* 22/2002, 1–2, 82–84.

Demiraj 2003 = Demiraj, Shaban: *Rreth disa çështjeve thelbësore të shqipes standarde.* – *Konferenca shkencore “Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot”.* Tiranë, 11–12 nëntor 2002. Redaksia: Jorgo Bullo, Emil Lafi, Seit Mansaku, Enver Hysa. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Shtëpia botuese “Shkenca”. Tiranë, 2003, 30–35.

Fjalor 1954 = *Fjalor i gjuhës shqipe. E punoi një komision i përbërë nga K. Cipo (kryetar), E. Çabej, M. Domi, A. Krajin, O. Myderrizi.* Instituti i Shkencave e Sekcioni i gjuhës e i letërsisë. Tiranë, 1954, 648 f.

Ortografia 1951 = *Ortografia e gjuhës shqipe.* Punuar prej A. Xhuvanit, K. Cipo dhe E. Çabejt. Instituti i Shkencave. Tiranë, 1951, 27 f.

Ortografia 1956 = *Ortografia e gjuhës shqipe.* Komisioni: Aleksandër Xhuvani, Eqrem Çabej, Androkli Kostallari dhe Mahir Domi. – *Buletin për shkencat shoqërore* 10/1956, 4, f. 38–65.

Projekti 1954 = *Projekti i ortografisë së gjuhës shqipe,* hartuar nga Aleksandër Xhuvani, Eqrem Çabej, Mahir Domi. Instituti i Shkencave. Tiranë, 1954 44 f. (me shaptilograf).

DIMITAR PANDEV,

Fakulteti i Filologjisë “Bllazhe Koneski” – Shkup

BAZA TEORIKE E “GJUHËSISË BALLKANI- KE” TË SHABAN DEMIRAJT

Linguistikës ballkanike Demiraj i hyn, para së gjithash, nga pozicionet e indoevropëistikës strukturore–funksionale diakronike, e cila e ndjek zhvillimin e gjuhëve indoevropiane gjatë kalimit të tyre nga sintetizmi në analitizëm. Për Demirajn ballkanistika është formë e parapëlqyer e indoevropëistikës, ndërsa gjuhët ballkanike – gjuhë me një shkallë të lartë analitizmi.

Në të vërtetë, kalimi nga sintetizmi drejt analitizmit në linguistikën strukturore–funksionale është i pranuar si proces zhvillimor i përgjithshëm i brendshëm, i cili në masë më të vogël ose më të madhe i përfshin të gjitha gjuhët indoevropiane. Doemos, ky proces është i përforcuar edhe nga proceset zhvillimore të jashtme, që ndodh me gjuhët ballkanike, në këtë kontekst pra edhe me gjuhën shqipe.

Sa për krahasim: Qasja strukturore–funksionale drejt zhvillimit historik të gjuhës shqipe, si dhe ndaj gjuhëve të tjera ballkanike, e Demirajt gjen paralelen në qasjen gjegjëse në shikimet më të reja të proceseve ballkanistike në studimet e Zuza-na Topolinjskës dhe korrespondojnë me ato gjegjëse në më shumë qendra linguistike evropiane (të Moskës etj.).

Duke u përcaktuar për këtë qasje, Demiraj u kushton vëmendje të domosdoshme qasjeve të ndryshme ndaj problematikave gjuhësore ballkanike në dy shekujt e kaluar, që nga koha e Jernej Kopitarit, pastaj Afanisj Selishçevit, deri te studimet

strukturore–funksionale bashkëkohore të cilat ndërlidhen me teoritë e formuara në shkollën linguistike të Pragës.

Të precizojmë: Qasja strukturale tregon për zhvillimin paralel të dukurive gjuhësore, edhe atë nga paralelet në leksik, përmes paraleleve në gramatikë, që është vatër funksionale themelore e proceseve ballkanistike, me perspektivat e paraleleve në fonetikë.

Që të formohet ky shikim në zhvillimin e gjuhëve, nuk ka qenë gjë e thjeshtë, sikurse nuk ka qenë e thjeshtë që të kup-tohet thjeshtimi i strukturës gramatikore, pavarësisht nga shkaqet që e kanë sjellë atë, si progres në zhvillimin dhe/ose perspektivën e zhvillimit, veçmas nëse dalëse kanë qenë shikimet thjesht filologjike dhe veçanërisht klasike–filologjike, do të kishim thënë, për strukturën jashtëzakonisht të nrekul-lueshme të gjuhëve klasike.

Demiraj u takon atyre linguistëve të cilët duke shënjuar kre-don e tyre linguistike, nuk i minimizojnë paraardhësit e tyre, por përkundrazi e theksojnë kontributin e tyre në ndriçimin e problematikës që bëhet përcaktim i tyre. Në këtë drejtim, me interes është raporti midis Hyrjes në “Linguistikën ballkanike” të Demirajt dhe elaborimi i çështjeve të ndryshme gjuhësore, përkatësisht ballkanizmave. Do ta kishim definuar si raport midis teorive të paraqitura socio–linguistike (para paraqitjes së socio–linguistikës) dhe përshkrimeve strukturore–funksionale të treguara të gjuhëve në botë dhe, në këtë kontekst, të gjuhëve në Gadishullin Ballkanik (para paraqitjes së strukturalizmit):

1. Pikëpamjet e Kopitarit në gjuhën si mjet për komunikim në kontekst të filozofisë së gjuhës të Humboltit. Pamja gjuhësore ballkanike në botë, përkatësisht modeli ballkanik i botës (T. Civjan) që paraqet kalim nga kognitivistika në kulturologji.

Raporti i Demirajt ndaj idesë origjinale të Kopitarit dhe ndaj aktualizimit të ideve të Kopitarit ("një formë gjuhësore, me tri lloje gjuhësore të materialit gjuhësor") kundrejt Ilievskit: "një formë gjuhësore e gërshtetuar në një materie të trefishtë gjuhësore", Rudolf Filipoviq: raporti teori gjuhësore – materiali gjuhësor.

Demiraj korrespondon me teorinë për gjuhët në kontakt të Vajnrajhut dhe të Rudolf Filipoviqit, e cila ndërlidhet me atë të Andre Martinesë dhe me linguistikën funksionale të Pragës, sidomos me teorinë për interferencën gjuhësore.

Në kohën e Humboldit, fjala sistem ka pasur domethënien e paradigmes, ndërsa fjala organizëm ka shprehur sistemin. Ilievski është më afër kuptimit fjalë për fjale, ndërsa Demiraj pranë kuptimit që vjen si detyrim nga linguistika historike. Fjala shqipe LËNDË është më afër të dhënës gjuhësore, përkatësisht faktit gjuhësor, pra lëndës/lëndëve.

Në një të kuptuar të këtillë, nocioni material gjuhësor përputhet me rëndësinë që ka në linguistikën historike, e cila parapëlqen materiale gjuhësore, përkatësisht të dhëna gjuhësore para gjuhëve, përkatësisht para sistemeve. Edhe me tezën e Humbodit për objektivitetin e gjuhës dhe për vazhdimësinë e formës së gjuhës. Kjo ide e Humboldit korrespondon me teorinë e meta-gjuhës ballkanike të Civjanit. Idetë e Civjanit korrespondojnë me idetë e Topolinjskës, e ato janë ide të pranuar në linguistikën reale.

2. Pikëpamjet e Miklloshiqit, të cilat gjejnë mbështetje në ballkanistikën e Vajgandit, por edhe në neolinguistikën italiane, përkatësisht në linguistikën gjeografike me kahe idealiste, në teorinë për substratin trako-ilir.

3. Pikëpamjet e Shuhardit dhe të Kurtenesë për kryqëzimet gjuhësore (kyçe në teorinë e Koneskit, i cili i formulon edhe si sinteza gjuhësore).

4. Pikëpanjjet e Sandfeldit, i cili e afirmon teorinë për gjuhët me prestigj. Kjo teori korrespondon edhe me teoritë gjegjëse për raportin gjuhë – individ, gjuhë – shoqëri tek Jasperseni. Teoria për gjuhën greke si gjuhë me prestigj, e pranishme edhe në filologjinë sllave, por edhe në bazën e gjuhës së shkruar dhe, patjetër, në planin e gjuhës së individit, përkatësisht të idiolektit të folësit, teori prej së cilës del edhe të kuptuarit se kontakti midis gjuhëve realizohet tek folësi, që në bazë është qasje kognitivistike.

5. Pikëpanjjet e Selishçevit, i cili i ka parasysh kushtet e përbashkëta dhe raportet e ndërsjella të hapësirës gjuhësore ballkanike në të kaluarën dhe në të sotmen (me të cilën gjë ndërvihen njëra në tjetrën teoritë për substratin dhe për bilinguizmin).

Nga aspekti strukturor – funksional, interesin tonë do ta kishim drejtuar kah ideja për gramatikalizimin në gjuhët ballkanike, e lindur tek Sandfeldi dhe e kuptimësuar tek Jesperseni. Demiraj i kushton vëmendje adekuate gramatikalizimit (të kohës së ardhshme) në kontekst të tendencës për përcaktim formal të kohës së ardhshme, do të kishim përgjithësuar, në gjuhët indoevropiane, si veçori strukturore–funktionale edhe në gjuhën shqipe edhe në gjuhët tjera ballkanike. Citojmë: “Shembuj për gramatikalizime të tilla ka në të gjitha gjuhët evropiane.” (Shaban Demiraj, „Балканска лингвистика“ /Gjuhësi ballkanike/, 1994, Shkup, f. 121). Interesin e tij Demiraj e zgjeron edhe në shprehjen e veprimeve që mund të realizohen pas një çasti të caktuar në të kaluarën, për të cilën gjë jep shembuj përkatës nga anglishtja, gjermanishtja, italishtja dhe gjithsesi shqipja.

Nga aspekti funksional–strukturor për zhvillimin e gjuhëve ballkanike interes paraqet teoria për ndarjen aktuale në

gjymtyrë të fjalisë, e cila, ndërkaq, nuk mund të përgjithësohet te të gjitha gjuhët indoevropiane. E apostrofojmë këtë pohim të Demirajt ("dyfishimi, përkatësisht anticipimi i lëndës... nuk gjendet në të gjitha gjuhët i.e., bile edhe në ato gjuhë i.e. të cilat gjatë evoluimit të tyre historik kanë krijuar edhe forma të reduktuara (të patheksuara) të përmrave vetore, si p.sh. në gjuhën serbokroate, çeke, polake.

Dyfishimin e objektit Demiraj e lidh me një tjetër teori, që është karakteristike për ndërtimin e rrëfimit dhe të fjalisë, përkatësisht me teorinë e redundancës, me ç'rast duhet pasur parasysh se redundanca është me rëndësi në strukturën e gjuhëve indoevropiane, përkatësisht fleksive.

Por, do të kishim shtuar jo edhe tek ato aglutinative! Raporti midis fleksionit dhe aglutinacionit, ndërkaq, është një ndër temat kyç të afiksacionit në linguistikën strukturale, bile edhe për sa u përket gjuhëve klasike, siç është latinishtja, me të cilën gjë prekemi me një temë të dashur të Sosirit.

Demiraj, ndërkaq, vëmendje të veçantë i kushton aglutinacionit në strukturën e fjalës shqipe, veçmas në lidhje me admirativin: ("Mënyra admirative në gjuhën shqipe ka lindur si rezultat i aglutinacionit të formës së përmbysur të kohës së shkuar të pacaktuar", aty, f. 186). Si aglutinative Demiraj i promovon përmrat shqip të tipit di-kush, di-sa, si dhe fjalët përmërore: kush-do, ndo-kush dhe e thekson ngjashmërinë e tyre me përmrat gjegjës të rumanishtes.

Nga aspekti strukturor-funksional, me interes është pohimi se aglutinacioni paraqitet në forma në të cilat më së shumti qëndron fleksioni.

Theksojmë, raporti midis fleksionit dhe aglutinacionit në strukturën e fjalës, sidomos në neologjizma të cilat janë sfidë e jetës bashkëkohore dhe sfidë edhe për indoevropistikën a-

ktuale, edhe për linguistikën funksionale aktuale, e cila vëmendje të veçantë u kushton ngarkesave funksionale të fjalëve të pandryshueshme në diskurs.

Baza e gjerë indoevropëistike (strukture–funksionale) e librit „Gjuhësi ballkanike“ të Shaban Demirajt i jep një tingëllimë bashkëkohore. Në të vërtetë, nuk janë të pashikueshme vetëm studimet e thella kognitive–kulturologjike të panjes ballkanike për botën, por edhe struktura morfemore e fjalës, e besës në gjuhët ballkanike.

BARDHYL DEMIRAJ,

LMU München

VEPRA SHKENCORE E SHABAN DEMIRAJT ME MUNDËSITË POTENCIALE DHE REALE TË RIBOTIMIT TË SAJ

Hyrje

“U largua edhe shtërgu i fundit” – me këtë përjasje, të hua-
zuar prej krijimeve të poetit të madh lirik Lasgush Poradeci, u
cilësua ndarja e Shaban Demirajt (01.01.1920 – 30.08.2014)
prej nesh. Është në fakt një largim i përhershëm fizik i perso-
nit në fjalë, por që mëngon t’i rishfaqet shumëkujt kohë pas
kohe e rast pas rasti i sendërtuar pazgjidhshmërisht në veprën
që la pas, çka vjen me thënë, sa herë që na duhet a duam të
dimë, të njohim e mësojmë kumtin e tij për njërën a tjetrën
çështje që ka të bëjë sidomos me gjuhën shqipe, historinë e saj
dhe kulturën e shkrimit shqip në përgjithësi. Lidhur me ven-
din e tij në historinë e albanologjisë si shkencë komplekse
rajonale sigurisht që – edhe pse deri sot nuk është thënë e
shkruar pak e kalimthi – është ende herët të skaliten e limo-
hen fjalët e fundit, meqë, si për këdo studiues albanolog, do
mëtuar ende kohë e mot derisa të përpunohet në detaj, sa e
siç duhet, produkti i tij shkencor.

1. Tipare të përgjithshme të veprës së Shaban Demirajt

Sa i përket prurjes dhe vlerësimit të veprës së Shaban Demirajt
në historinë e albanologjisë, kohët e motet detyrimisht shu-
mëfishohen, e kjo për arsye në dukje fare të thjeshta:

Së pari: Shaban Demiraj ka shkruar e botuar shumë; aq shumë sa një studiues në kohën tonë e ka vërtet të vështirë të rrokë e studiojë në mënyrë intensive gjithë veprën e tij, pa investuar kohë që varjon një deri disa vjet. Janë rreth 10.000 faqe të botuara ose në dorëshkrim, të shpërndara në: a) 16 vepra shkencore (pa bashkëpunim) dhe b) 8 syresh në bashkëpunim me autorë të tjerë; c) 19 tekste mësimore për shkollën e lartë dhe të mesme; d) 7 transkriptime veprash letrare të autorëve të vjetër dhe romantikë shqiptarë; e) tri përkthime; f) rreth 250 punime të mirëfillta shkencore; së bashku me g) një numër të madh artikujsh me karakter kryesisht divulgativ; gj) recensionesh e relacionesh nga më të ndryshmet; pa marrë parasysh këtu atë h) korrespondencë të pasur me kolegë e miq shqiptarë e të huaj. Madje nuk mungojnë as krijime të tij letrare-poetike, të hedhura në letër e botuar dikur në moshë fijane, e që nuk i përmend kurrë më pas, se me s duket nuk ishte as i bindur më pas për vlerën e tyre të mirëfilltë.

Së dyti: Shaban Demiraj ka qenë aktiv në angazhimin e tij intelektual-shkencor për një periudhë bukur të gjatë; diku aty te 70 vjet, çka parakupton natyrshëm që një pjesë e mirë e veprave të tij – pra jo vetëm ato punime në formë artikujsh shkencorë e divulgativë – të mos kenë më qasje në rrethet e studiuesve albanologë (sidomos syresh të rinj), pasi mungojnë ndërkohë krejtësisht në tregun bashkëkohor të letërsisë shkencore albanologjike. Do theksuar fort ky fakt, edhe pse shumë vepra të tija – si rrallëkujt në albanologji – kanë përjetuar fatin të ribotohen dikur qoftë në Tiranë ashtu edhe në Prishtinë e Shkup⁴.

⁴ Mund të sjellim këtu sa për shembëllzim, ndër të tjera, botimin e veprës monumentale: „Gramatikë historike e gjuhës shqipe“. Botim i Universitetit të Tiranës. Shtëpia Botuese “8 Nëntori”. Tiranë 1986, f. 1167 (me një

Së treti: Shaban Demiraj ka shkruar dhe botuar vepra e studi-me në disa gjuhë; përpos se në shqip, të paktën në të gjitha gjuhët ndërkombëtare (anglisht; italisht; gjermanisht; frëngjisht); madje nuk mungojnë syresh as në maqedonisht etj.⁵ E në kohën tonë është vështirë të gjesh një studiues shqiptar albanolog që është në gjendje të lexojë, e jo më të shkruajë rrjedhshëm, në të gjitha këto gjuhë ndërkombëtare.

Së fundi: Shaban Demiraj ka përkujdesur e mbarështuar një spektër të gjerë fushash studimi albanologjik: mjafton të numërojmë këtu çështje të përshkrimit dhe klasifikimit sistematik të shqipes letrare bashkëkohore; të studimit filologjik, transliterimit dhe transkriptimit të autorëve të vjetër, sikurse edhe syresh të shek. XIX; për të vijuar sidomos me probleme të mprehta të sistemit fonologjik dhe të gramatikës historike të gjuhës shqipe, sikurse edhe të historisë së saj e të popullit shqiptar. Janë bash këto çështje që ngërthejnë doemos qerthullin kryesor të aktivitetit të tij shkencor, d.m.th. fusha të gjuhësisë, që parakuptojnë pa e ekzagjeruar aspak një formim shkencor albanologjik afatgjatë, qoftë ky për të nxënë e për-typur objektin, qëllimin dhe perspektivat e studimit diakronik të shqipes, ashtu edhe për të marrë guximin me vënë sinorë

përmbledhje anglisht); dhe Shtëpia Botuese “Rilindja”. Prishtinë 1988², f. 1047; apo botimin bio-bibliografik „Eqrem Çabej – një jetë kushtuar shkencës“. Shtëpia Botuese “8 Nëntori”. Tiranë 1990, f. 272; Shtëpia Botuese “Akademia e Shkencave të Shqipërisë”. Tiranë 2008², f. 322.

⁵ Khs. ndër të tjera: Historische Grammatik der albanischen Sprache (kurze Fassung). Botuar nga Österreichische Akademie der Wissenschaften; Philosophisch – historische Klasse. Schriften der Balkan-Kommission. Verlag der Österreichischen Akademie der Wissenschaften. Wien 1993, f. 366; Balkanska lingvistika = Gjuhësi ballkanike. Shtëpia botuese “Logos A”. Shkup 1994, f. 294 (me një përmbledhje anglisht).

orientues në hetimin e çështjeve të ndryshme të historisë së gjuhës shqipe.

Lejohem të ndalem shkurt pikërisht në këtë pikë të fundit, pasi bëhet fjalë për një formim shkencor që arrin ta arrijë vetëm ai dikush, i cili i ka vënë vetes një qëllim jetësor në jetë: bash njohjen dhe studimin me përkushtim të gjuhës shqipe dhe të historisë së saj. Parë nga kjo perspektivë, nuk është, pra, aspak rastësi, por thjesht dhe vetëm domosdoshmëri që të vetmen vepër me karakter në dukje thjesht bio-bibliografik Shaban Demiraj jo pa qëllim ia kushton kolegut të tij, të madhit Eqrem Çabej, duke e titulluar thukët: “Eqrem Çabej – Një jetë kushtuar shkencës” (Tiranë 1990, 2008²). Për më tepër, nuk është poashtu aspak rastësi por thjesht dhe vetëm domosdoshmëri që, falë këtij përkushtimi jetësor, Shaban Demiraj kundroi shqipen dhe evolucionin e saj në kohë e hapësirë nga disa perspektiva: a) si gjuhë sa indoeuropiane, b) aq edhe ballkanike, madje pa cenuar aspak c) mëvetësinë e saj si një gjuhë e gjallë bashkëkohore që gjëllin sa e unifikuar aq edhe në varietete, të kushtëzuara këto qoftë nga mjedisi historik–gjeografik ashtu edhe ai social–kulturor i bartësve të saj; sikurse nuk heziton aspak d) të rrënihë te rrënjët e saj, te njëra apo tjetra rrënojë gjuhësh të atyre popujve që gjëllinin dikur në trevat e Ballkanit antik.

2. Dy fjalë mbi projektin e ribotimit të veprës shkencore të Shaban Demirajt

Një ribotim qoftë edhe selektiv i veprës shkencore të Shaban Demirajt, sidomos i atyre studimeve monografike që kanë si objekt studimi gjuhën shqipe në fazat e ndryshme të zhvillimit të saj diakronik, përkatësisht të matriksit të kulturës etnike–gjuhësore të asaj bashkësie që ka përdorur gjithherë e përdor

ende sot e kësaj këtë gjuhë si njet të përbashkët komunikimi në kohë e hapësirë është një plotësim sa i nevojshëm aq edhe i domosdoshëm i formimit të plotë shkencor–universitar në këto fusha të albanologjisë historike; një formim, i cili për fat të keq po përjeton në kohën tonë një depresion të thellë të kërkimit shkencor në hapësirën jetike gjithëshqiptare, meqë është tkurrur deri aty ku vërtet nuk vete dot më tej. Nuk përjashtojmë me këtë rast as programet e degëve albanologjike në universitetet shtetërore, të cilat i bëjnë vend kalimthi ndonjë lëndë të historisë së gjuhës thjesht dhe vetëm në nivelin II <Master>, madje edhe aty me zgjedhje, që vjen me thënë shqip: me rënie të lirë vetëvrasëse. Fakt është gjithashtu që studiues shqiptarë me interesa të posaçme në studimin diakronik të shqipes i numërojmë sot me gishtat e njërës dorë, ndërkohë që mosha mesatare e atyre pak studiuesve të mirëfilltë në gjuhësinë historike të shqipes shkon aty te 55–60 vjeç. Ribotimi i veprës së Shaban Demirajt do të ndihmojë kështu në një mënyrë a një tjetër në formimin e përsheptuar e, pse jo, edhe autodidakt të një brezi të ri studiuesish, që kanë vërtet interes të merren me hetimin diakronik të shqipes, por që u mungon sigurimi i materialit shkencor bazë, ashtu siç mëtohet sot me të drejtë të jetë vepra e Shaban Demirajt.

3. Domosdoshmëria e këtij ribotimi me parametrat e sotëm të botimit shkencor

Ribotimi i veprës shkencore të Shaban Demirajt sipas parametrave të sotëm të botimit shkencor është bërë ndërkohë thuajse një *conditio sine qua non*, meqë një numër botimesh të derisotme, sidomos veprat e dy dhjetëvjeçarëve të fundit janë shtypur me një sasi të konsiderueshme gabimesh marra–mendëse. E kjo nuk është thjesht dhe vetëm pasojë e mënj-

nimit të punës redaksionale në shumë shtëpi botuese bashkëkohore, e cila do të mund të shmangte në masë të madhe vetëm gabime te natyrës ortografike. Në këto botime peshojnë shumë më shumë shtëmangie të karakterit shkencor që sendërtohen kryesisht në leximin e gabuar të shembujve të marrë nga gjuhë të tjera, të huaja, klasike e të vdekuara, hapax legomena e sidomos nga leximi po aq i gabuar kompjuterik i formave të rindërtuara për protoshqipen dhe indoeuropianishten, të cilat realizohen vetëm me fonde (= <fonts>) speciale për shenja e simbole specifike në gjuhësinë historike, ose me kombinime (= <macros>) të sajura nga vetë autori. Këtë situatë aspak fatlume të botimit e përkeqëson edhe rrethana po aq fatkeqe e mungesës së kuadrit të specializuar në këto fusha dhe e personelit të paaftë pedagogjik në universitete, që në shumësinë e rasteve i përcjell këto gabime në auditor si fakte gjuhësore të mirëqena në lëndët përkatëse gjatë formimit universitar.

Domosdoshmëria e ribotimit të veprave (të paktën e atyre) kryesore të Shaban Demirajt konsiston edhe në faktin që autori u është kthyer herë pas here e rast pas rasti punimeve të tij të mëparshme, a) duke përmirësuar vise-vise mendime të mëparshme, b) duke pasuruar, përkatësisht kundërshtuar me ndonjë argument të ri teza të ndryshme, qofshin këto vetjake, ose syresh të studiuesve të tjerë për probleme nga më të ndryshmet që lidhen me historinë e gjuhës shqipe dhe rindërtimin e fazave të ndryshme e evolucionit të saj në kohë e hapësirë.

Një vend të veçantë në aktivitetin shkencor intelektual të Shaban Demirajt zënë edhe botimet e tij në gjuhë të huaj. Duke qenë një njohës dhe zotërues shumë i mirë i disa gjuhëve ndërkombëtare, ai ka mundur e bërë të njohur me

veprën e tij në të njëjtën kohë edhe rrethet intelektuale—albanologjike jashtë hapësirës kompakte shqipfolëse me probleme të historisë së gjuhës shqipe dhe të etnogjenezës së shqiptarëve në kohë dhe hapësirë, duke përcjellë tek ta një—herësh edhe mendimin albanologjik shqiptar. Ribotimi i këtyre veprave në gjuhë të huaj, të cilat në shumicën e tyre dërmuese nuk janë më në qarkullim në tregun ndërkombëtar, do të ndihmojë formimin e studiuesve të rinj albanologë të huaj për ato probleme të mprehta në hetimin e gjuhës shqipe dhe të etnogjenezës shqiptare, duke i përditësuar ata sidomos me mendimin albanologjik të shkencës shqiptare në hapësirën kompakte shqipfolëse.

4. Mundësitë potenciale të përgatitjes për shtyp të veprës së Shaban Demirajt

Dëshirojmë t'i kumtojmë lexuesit në këtë rubrikë nismën dhe gjendjen aktuale të projektit afatgjatë që është ndërmarrë tash dy vjet prej shkruarit të këtyre radhëve për ribotimin e veprës shkencore dhe biobibliografike të Shaban Demirajt. Nuk mund të lemë pa përmendur këtu edhe shkasin e parë që nxiti këtë ndërmarrje fanmirë. Me këtë rast duhet të rikthehemi aty te viti 2011, kur miku dhe kolegu ynë prof. Xhevat Lloshi iu përgjigj pozitivisht pyetjes për një këshillë, drejtuar atij prej një shtëpie botuese në Shkup, së cilës ai i propozoi bash botimin e veprës complete të Shaban Demirajt. Gjatë bisedimeve të para me botuesin, sigurisht që u miratua në parim syzimi i saj vullnetmirë, edhe pse iu bë e qartë që një ribotim i menjëhershëm i kësaj vepre në atë gjendje që paraqitet ajo në momentin aktual, do të ishte më shumë se kundërproduktiv, madje në shumë pikëpamje dezinformues; dhe se nevojitej një investim i madh jo vetëm në kohë, por sidomos në gjetjen e

forcave të përshtatshme shkencore bashkë me përkushtimin e nevojshëm profesional për ta bërë këtë vepër të botueshme sipas parametrave të sotëm të botimit të mirëfilltë shkencor. Meqë – për arsye të cekura me lart (shih § II) – nuk kish si të arrihej në një mirëkuptim të menjëhershëm dypalësh, ky bashkëpunim u la më pas në harresë, njëlloj siç ndodh sot e zakonisht me shtëpitë botuese në hapësirën kompakte shqiptare. Gjithsesi kjo nxitje dhe dëshirë e mirë për të parë një ditë në tregun shkencor shqiptar veprën shkencore të kompletuar të Shaban Demirajt i mbeti shkruarit të këtyre radhëve vath në vesh, dhe ndikoi që – duke qenë edhe specialist i mirëfilltë në historinë e gjuhës shqipe –, të ndërmarrë me iniciativën private për realizimin e këtij projekti, që për vetë kushtet e veta të punës dhe të angazhimit të tij profesional, sikurse edhe për rrethanat në të cilat jetojmë, nuk mund të ishte veçse afatgjatë, duke u planifikuar si i tillë në tri faza, që lidhen fillimisht me digjitalizimin dhe më pas duke përgatitur për shtyp ribotimin e kësaj vepre.

Faza e parë e punës, që ka të bëjë me digjitalizimin e veprës, thuajse është përfunduar në dorë të parë për 14 monografi, ndër të cilat vetëm vepra madhore “Gramatikë historike e shqipes” (1986 1167 f.) është e vetmja e skanuar në versionin <pdf.>; ndërsa të tjerat janë digjitalizuar në versionin <word.doc(ument)>. Realizimi i kësaj faze u realizua sigurisht po ndonjë donator të jashtëm por thjesht dhe vetëm me mundësitë financiare që i vihen në dispozicion shkruarit të këtyre radhëve si bartës i postit të një profesori ordinar në një universitet elitari në RFGJ (: Universiteti Ludwig–Maximilian i Munihut), e në këtë mënyrë arrin të angazhojë me pagesën përkatëse forca ndihmëse, kryesisht studentë të Degës së Abanogjisë në atë universitet.

Puna e mirëfilltë redaksionale, pra faza e dytë e përgatitje për shtyp për çdo vepër, ka të bëjë me korrekturën drejtshkrimore të tekstit të rrjedhshëm, përkatësisht me verifikimin shkencor-gjuhësor të shembujve të marrë për krahasim nga gjuhë të ndryshme indoeuropiane, sikurse (e sidomos) me korrekturën e paraformave të rindërtuara për faza të ndryshme të padokumentuara të zhvillimit gjuhësor (para)historik; një punë kjo, me të cilën është obliguar vetëm shkruesi i këtyre radhëve. E ritheksojmë pikërisht këtë pikë të fundit si thembra e Akilit në botimet e derisotme shqip të autorit në fjalë, sigurisht jo vetëm për sosh të përfutuara në periudhën kur nuk funksiononte ende teknologjia kompjuterike e botimit të literaturës shkencore me sisteme shenjash dhe simbolesh specifike që përdoren në fushat e indoeuropianistikës, ballkanologjisë, dialektologjisë etj. Është pikërisht kjo punë e vështirë me karakter tejet profesional me tekstin, që mendojmë dhe besojmë se do ta çlirojë dikur veprën shkencore të Shaban Demirajt: a) së pari nga ato kritika dashamire që i janë bërë derisot e i bëhen herë pas here e rast pas rasti prej studiuesve vendës dhe të huaj, e b) së dyti nga ajo qesëndisje profesionale që u bëhet ndërkohë shumë studimeve albanologjike të kohës sonë, në të cilat merren *en bloc*, pra si të mirëqenë, shembuj (të botuar mirëfilli gabim) prej veprës së Demirajt, duke ua përcjellë si të tilla edhe lexuesve të interesuar sikurse (madje sidomos) edhe studentëve të degës përkatëse në universitetet shtetërore. Sa kohë që një procedurë e tillë, që vjen me thënë *copy and paste*, vështirë se do të jetë e mundur në një të ardhme të afërt në albanologjinë shqiptare, është shumë më efektiv botimi i përmirësuar i vetë veprës origjinale të Shaban Demirajt.

Faza e tretë dhe e fundit e projektit ka të bëjë me formatimin e tekstit sipas parametrave të botimeve moderne për tekste

shkencore—universitare, duke iu përmbajtur një formati dhe një *design*—i për të gjithë veprën, për të cilën do të flasim konkretisht në paragrafin e mëposhtëm (shih § 4).

Ritmika e punës së deritanishme lejon të hamendësojmë me një lloj probabiliteti deri diku të besueshëm fundvitin 2017, sa i përket përgatitjes për shtyp (vetëm) të veprave shkencore të Shaban Demiraj. Përsheptimi i këtij procesi varet kryekëput me mundësinë reale të botimit të veprës, së cilës po i përku—shtohemi më poshtë në paragrafin e fundit.

5. Mundësitë reale të botimit të veprës së Shaban Demirajt

Lidhur me sa u tha më lart, ribotimi i kësaj vepre parakupton e kërkon ende sot e kësaj dite jo thjesht dhe vetëm dëshirën e mirë për ta nxjerrë në treg — një dëshirë kjo që sigurisht ende nuk mungon!!! —; por pa dyshim edhe kohën dhe energjinë e duhur të personit a personave që duan angazhuar në përgatitjen e veprës për ribotim, e sidomos formimin shkencor përkatës të atyre forcave ndihmëse që do të mundësojnë realizimin e projektit në fjalë. E ata specialistë që janë ndërkohë të formuar dhe të aftë për të ndërmarrë një punë të tillë — sikurse cekëm më lart — numërohen sot për sot në hapësirën gjithëshqiptare me gishtat e njërës dorë; për më tepër ata kanë ndërkohë planet e veta të punës kërkimore—shkencore.

Ritheksojmë kështu fazën e tretë dhe të fundit të përgatitjes për botim të veprës, përkatësisht të sigurimit të një botuesi serioz dhe të ndershëm që do të marrë përsipër botimin e saj. Sa i përket kësaj faze të projektit në fjalë, mund të konsiderojmë tash të përfunduar punën vetëm me tri vepra të para, të cilat pjesërisht i kishte rishikuar me korrigjimet dhe shtesat përkatëse autori në gjallje të vet, e që sigurisht mungonin e mungojnë prej kohësh në tregun shkencor gjithëshqiptar: 1.

“Gjuha shqipe dhe historia e saj” (SHBLU, Tiranë 1988¹; ShB “Onufri” Tiranë 2013², 422f.) ; 2. “Prejardhja e shqiptarëve në dritën dëshmnive të gjuhës shqipe” (ASHSH, Tiranë 1999¹; parashikuar për ribotim nga ShB “Onufri” për vitin (?) 2014², 345f.) dhe “Gramatikë historike e gjuhës shqipe (version i shkurtuar)” (ASHSH, Tiranë 2002¹, (?) 2015², 520f.), për të cilën nuk kemi hyrë ende në bisedime me atë shtëpi botuese.

Bëjmë fjalë këtu, pa dyshim, për botime që synonin e synojnë një rreth deri diku më të gjerë lexuesish, me shpresën dhe dëshirën e mirë se duke arritur një qarkullim të kënaqshëm të librit ndër lexuesit e interesuar, do të kishim mundësi të mbledhnim mjete financiare të nevojshme për t’i investuar ato në botimin e atyre veprave, që janë të destinuara për një rreth edhe më të ngushtë lexuesish. Fakt është që ekonomia e egër në tregun shqiptar të librit në kohën tonë i ka shumëfishuar këto shpresa të botuesit, d.m.th. të shkruarit të këtyre radhëve me shifrën “zero”.

Një fat aspak fatlum rrezikojnë ndërkohë të përjetojnë seriozisht edhe ato vepra të tjera, që pritet të përgatiten për botim vitin/vitet në vazhdim, sa kohë që shkruesi i këtyre radhëve nuk ka mundur të gjejë e sigurojë ende mbështetjen aq të nevojshme financiare, qoftë prej institucionesh shtetërore përkatëse në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni, ashtu edhe prej ndonjë sponsori privat e dashamirës, që është i prirur të ndihmojnë mbarëvajtjen e albanologjisë si shkencë kulture kombëtare gjithëshqiptare. Urojmë që ky artikull sikurse edhe botimi i akteve të tubimit “Shaban Demiraj – figurë e shquar e albanologjisë dhe ballkanologjisë” (Shkup, më 21.11.2014) – do të mund të kontribuojë në sensibilizimin dhe gjetjen e rrugëve dhe të mundësive të financimit të këtij projekti të botimit të veprës së Shaban Demirajt, në mënyrë që edhe ky “shtërg i fundit” të jetë gjithherë i pranishëm mes nesh.

HAKE YMERI – BINA,

Shkup

NJË BISEDË ME PROF. SHABAN DEMIRAJN LIDHUR ME FONIN [Ë] NË REALITETIN LINGUISTIK MAQEDONAS

Përfundimin e vlerësimit botuar në revistën “Jehona” në vitin 1995 për veprën “Gjuhësi ballkanike” të akademikut Shaban Demiraj, të kësaj vepre madhore dhe shumë të rëndësishme për gjuhësinë shqiptare, ballkanike, po edhe më gjërë, e përfundoja me fjalët: “*vepër madhore shkencore që vjen në ndihmë, jo vetëm për studiuesit shqiptarë, por edhe për të huajt që merren me ballkanistikë dhe linguistikë në përgjithësi, prandaj ajo duhet përkthyer edhe në gjuhë të tjera, veçmas në gjuhët ballkanike, e me shumë arsye edhe në maqedonishte, përveç vlerës së saj shkencore edhe për qëndrimin e drejtë shkencor të profesorit ndaj kësaj gjuhe*”. Përfundova vlerësimin me këtë fjali, ndoshta me një çikë ngjyre politike, për atë kohë, me një qëllim të zbutjes së pezmit të madh të maqedonasve që e shprehën në të gjitha organet e shtypit kundër Akademikut dhe kryetarit të Akademisë së Shqipërisë, për shkak të potencimit të një kërkesë para opinionit maqedonas, për më tepër të drejta për shqiptarët e Maqedonisë. Me gjithë këtë, për fat të mirë, vepra u përkthye në maqedonishte, u botua në Shtetin botuese “Llogos-A”, ndërsa promovimi i saj nuk u bë në Akademinë e shkencave të Maqedonisë, pavarësisht kërkesës dhe lutjes që i bëra Akademikut *Bozhidar Vidoeski* për t’u bërë edhe promotor i saj, për shkak të presionit që kishte nga të tjerët, nuk pati sukses, prandaj promo-

vimi u bë në Fakultetin Filologjik të Shkupit, në prani të qindra profesorëve të këtij fakulteti.

Pas një kohe më erdhi një letër nga Akademiku i nderuar në të cilën përveç falënderimeve që m'i shprehte për përkthimin e veprës dhe punën e kryer lidhur me promovimin e saj, shprehte edhe një dëshirë për të kuptuar diç më tepër për problemin e fonemës /ë/ të gjuhës maqedonase, me siguri për shkak të mosdhënies së statusit fonemik të fonit [ë] në gjuhën standarde maqedonase, këtij foni të përmendur në këtë nënqiell të Ballkanit, në krye të herës nga linguisti sloven Kopitar (më 1829), më vonë nga A. Shleicheri (1850) dhe Micloshiçi (1870), ndërsa në mënyrë më të theksuar nga Kristian Sandfeldi më 1930, në veprën themelvënëse të gjuhësisë ballkanike *"Linguistique balkanique, problems et rezultats"*. Prandaj në këtë letër të shkurtër më drejtohet me këto fjalë: *"...Për punë të pranisë së fonemës /ë/ në maqedonishte do të kisha dëshirë të dija diçka më shumë dhe pikërisht nëse ajo ka karakter të kufizuar dialektor..."*

Problemi i fonemës /ë/ në maqedonishte më ishte i qartë, pavarësisht mosmarrëveshjes që kishin një numër relativisht i madh gjuhëtarësh maqedonas, për mospërfshirjen e kësaj foneme në sistemin fonemik të gjuhës standarde të tyre. Profesori dr. Velko Siljanovski i ndjerë kërkonte me këmbëngulje një revidim të punës që kishin bërë të parët, para tij, në krye me Bllazhe Koneskin e madh, të cilët fonit [ë] nuk ia pranuan forcën fonemëformuese në gjuhën standarde maqedonase. Në një situatë të këtillë, për t'iu përgjigjur kërkesës së Akademikut, Shaban Demiraj, vendosa t'i përmbahem të vërtetës në punimin *"Fonema /ë/ në gjuhën dialektore maqedonase"* të dr. Bozhidar Vidoeski, dialektologut me famë në linguistikën maqedonase. Kështu vendosa ta shkruaj letrën, drejtuar pro-

fesorit, me atë njohje që kisha unë për këtë dilemë, mbështetur me mendimin e një autoriteti të shkencës filologjike maqedonase, me këto fjalë:

I nderuar profesor,

Për t'u përgjigjur në pyetjen Tuaj po Ju dërgoj punimin e dr. Bozhidar Vidoeski, "Фонемата /ð/ во македонскуом дијалектен јазик" – "Fonema /ë/ në gjuhën dialektore maqedonase" nga i cili po Ju përkthej vetëm paragrafin e pare, që të shihni se ç' thotë autori për këtë problem që në fillim të punimit:

"Përveç vokaleve /i,e,a,o,u/ që na dalin në territorin e tërë gjuhësor maqedonas, areal më të gjerë zë fonema /ë/. Atë e njohin të gjitha të folmet lindore të Maqedonisë, të gjitha të folmet veriore, pjesa më e madhe e territorit të Kostur–Fëllorinës, ndërsa në Maqedoninë Perëndimore– rajoni i Gostivarit (Pollogu Verior), rajoni i Dibrës, i Strugës, i Ohrit dhe i Prespës pa fshatrat juglindorë. Si fonemë marginale me distribucion të kufizuar haset në anët e Velesit, në të folmen e qytetit të Shkupit së bashku me atë të Bllatës..."

Nga kjo që na e ofron dialektologu i dëgjuar maqedonas, dr. Bozhidar Vidoeski, shihet qartë se kjo fonemë nuk ka karakter të kufizuar dialektor, por përkundrazi mbulon mbi 90% të territorit të Maqedonisë. Mirëpo, ajo edhe pse ka një përdasi territoriale të gjërë, ka karakter të kufizuar përdorimi. Si duket, mu për këtë shkak, këtij tingulli zanor, nuk iu dha status foneme në kohë të konstituimit të gjuhës standarde maqedonase, ndoshta pa të drejtë, pavarësisht forcës së vogël fjalëformuese të kësaj foneme "ë". Nga ana tjetër, kur është fjala për një numër të vogël fjalësh të tipit: 'rkulec, 'rt, 'rz, za'rti, za'rka etj (lexo: ërkulec, ërt, ërz, zaërti, zaërka etj) ose për ca fjalë të

huazuara nga turqishtja si psh: *k'smet* (lexo: *kësmet*), *s'klet* (lexo: *sëklet*) në vend të grafemës <ë> në gjuhën standarde përdoret apostrofi për ta shënuar fonemën /ë/, e jo si shenjë për të shënuar aferezën (rënien e tingullit). Prej kësaj shohim se prania e fonemës /ë/, megjithatë tolerohet, por nuk shprehet me grafemë të veçantë. Prandaj, në gjuhën standarde maqedonase mund ta ndërtojmë këtë skemë të sistemit vokalik, edhe me fonemën diskutabile *`(ë)*:

<i>u(i)</i>	<i>.y(u)</i>	
<i>e(e)</i>	<i>`(ë)</i>	<i>o(o)</i>
	<i>a (a),</i>	

së cilës krahasuar me skemën vokalice të shqipes standarde i mungon vetëm zanorja [y], respektivisht fonema /y/:

<i>(i), (y)</i>	<i>(u)</i>	
<i>(e)</i>	<i>(ë)</i>	<i>(o)</i>
		<i>(a)</i>

Ndryshimet shihen sheshit në numër fonemash zanore, meqenëse maqedonishtja ka një fonemë zanore më pak se shqipja, asaj i mungon zanorja [y]. Ndryshimi esencial në këto dy skema vokalice të të dy gjuhëve standarde të maqedonishtes dhe të shqipes qëndron në funksionimin e fonit [ë], me të cilin realizohet fonema /ë/ në të dy gjuhët.

Ky fon në maqedonishte realizon një fonemë e cila ka vetëm funksion fjalëformues, si në rastet e lartëpërmendura, por jo

edhe funksion formëformuese (funksion gramatikor) ose për të ruajtur ndonjë element tradite karakteristike si në disa gjuhë të tjera sllave .

Në linguistikën maqedonase lidhur me statusin e kësaj fonme /ë/ ka mjaft dilema. Dikush për qëllime politike (për t'i ikur afërisë së maqedonishtes me bullgarishten) ose nga vetëdija e shtrembëruar, e shumica nga oportuniteti mbajnë qëndrim që nuk përkon me realitetin gjuhësor. Në aspekt të thjeshtësimit të sistenit dhe funksionimit sa më të lehtë të tij, unë mendoj se është bërë një hap, ndoshta pak para kohe, por megjithatë i qëlluar. Them parakohe sepse ky fon ende është gjallë dhe funksionues, por me tendencë zbehjeje të mëtejme të forcës fonemëformuese. Shikuar në këtë aspekt të thjeshtësimit të drejtshkrimit, puna e të parëve të linguistikës maqedonase, në krye me të madhin Bllazhe Koneski, është për t'u admiruar.

Kjo ishte për profesorin e madh, ajo që do të them më poshtë edhe ca fjalë është për një grup lingvistësh shqiptarë që në asnjë mënyrë nuk pajtohen për ndonjë intervenim, sado pak të vogël, me qëllim zvogëlimi të dendurisë së madhe të kësaj foneme, aty ku ajo paraqitet si parazitare, bashkë me numrin e madh të rregullave drejtshkrimore (me mbi 85% të rregullave të drejtshkrimit të zanoreve të shqipes lidhen me këtë fone-më). Ajo është më e shpeshtë se edhe fonema |e|. Provojeni këtë në tekste të gjata me kompjuterë që të bindeni se ajo që thuhet në të gjitha Fonetikat e gjuhës shqipe nuk është e vërtetë.

Realiteti lingvistik i maqedonishtes assesi nuk mund të barazohet me atë të shqipes, sepse kjo fonemë ka funksion shumë të kufizuar në maqedonishte, madje edhe më të kufizuar se në dialektin gegë, e të mos flasim për realitetin e dialektit toskë,

ose të gjuhës standarde shqipe ku ajo ka: *funksion fjalëformues (leksikor)*, *funksion formëformues (gramatikor)*, *funksion mbështetës, përdorim për ruajtjen e traditës, po edhe një funksion, po e them me pak hezitim, “funksion supërsegmentar”*. PRANDAJ HEQJA ARBITRARE E FONEMËS /Ë/, NJË HEQJE E PAKONTROLLUAR MIRË NË SHQIPEN STANDARDE, ËSHTË PLOTËSISHT E PAMUNDUR DHE JOSHKENCORE.

NEXHIP MËRKURI,

Universiteti "Ismail Qemali" – Vlorë

GJUHËSIA E PËRGJITHSHME DHE KËNDVËSHTRIMET BASHKËKOHORE PËR EPIRIN DHE MESAPËT

Gjuhësia e përgjithshme dhe si pjesë e qënësishme e kurseve në rrafshin universitar dhe pasuniversitar ka gjetur vend duke synuar tek modeli i Britanisë së Madhe, e cila ka edhe katedër të posaçme. Çdo brez gjuhëtarësh nuk e fillon punën nga zeroja, por mbi bazën e gjendjes që gjuhësia ka trashëguar deri në atë epokë apo kulturë. Mendimi historik për gjuhën konsiston në studimin e kohëzgjatjeve, periudhave të pandriçuara. Realizohen botime në vite nga breza gjuhëtarësh. Brez gjuhëtarësh që nxjerrin në pah priqe, hedhin dritë për t'u bashkuar me botimet që bëjnë kolegët në Europë dhe me tej, lënë trashëgimni.

Edhe gjuhësia si shkencat e tjera sjell referime nga kolegë të huaj për pikat e takimit të kërkimit për atë trevë ku jeton. Duke qënë njerëz të kohës dhe të vendit të tyre marrin pjesë në kulturën në të cilën jetojnë dhe punojnë. Jetësimet dhe qëllimet praktike u kanë paraprirë shpesh formulimeve teorike në botime të ndryshme duke përcaktuar qerthullin e fakteve duke formuluar pohime të rëndësishme.

Është shkruar nga autorët e gjuhësisë së përgjithshme për këndvështrimin sinkronik dhe diakronik dhe cili është parësor. Pati shkolla gjuhësore që i vlerësuan të dy këndvështrimet. Është i drejtë mendimi se nuk mund të kemi një ndarje

absolute midis sinkronisë dhe diakronisë⁶. Ka autorë që kanë mëshuar më shumë nga gjuhësia diakronike si: E.Çabej⁷, Sh.Demiraj, I.Ajeti etj.

Mjaft probleme, hipoteza të ngritura në konferenca shkencore nga fqinjët po edhe më tej, qenë shtysë për prof.Sh.Demiraj për t'iu përkushtuar studimit diakronik të shqipes dhe se në vitin 1980 nuk mund të shkruante më E.Çabej. Në këtë dekadë dhe në vitet që e pasuan do të vërejmë nxitjen edhe dëshirën e tij për të ndriçuar më tej disa probleme të historisë të kësaj gjuhe të lashtë të Ballkanit më disa vepra të plota, të cilat kanë zënë vend në tavolinat e studiuesve, dhe ligjëratave të pedagogëve dhe studentëve në Universitete brenda vendit si edhe në ato të Europës. Duke folur për E.Çabej, prof.Sh.Demiraj realizon një historik të shkurtër të gjuhëtarëve që punuan më shumë në fushën gjuhësisë diakronike *“Në këto vite studimet albanologjike jashtë Shqipërisë po pësonin një rënie të dukshme. N.Jokli, albanologu më prodhimtari i viteve njëzet e tridhjetë të këtij shekulli, u zhduk në mënyrë tragjike nga nazistët gjermanë në vitin 1942, H.Pedersen, tashmë i plakur, nuk merrej më prej kohësh me gjuhën shqipe”*².

Disa studiues të tjerë të shqipes në vende të tjera të Europës nuk kishin as kushtet e nevojshme, as përgatitjen e duhur për të ndërmarrë studime të gjera nga fusha e historisë së shqipes. Kjo zbrazëti e krijuar në këtë fushë studimesh duhej mbushur. Vendi ku mund të bëheshin përpjekje të suksesshme për këtë qëllim ishte katedra e gjuhës shqipe; përgjegjësi i katedrës së gjuhës shqipe për mëse tri dekada, pranë Universitetit të Tiranës, ku filloi të punonte krahas gjuhëtarëve të tjerë.

⁶ Rrokaj, Sh. *Hyrye në gjuhësinë e përgjithshme*. Tiranë, 2000.f.75.

⁷ Demiraj, Sh. *Eqerem Çabej*. Tiranë, 1990, f.33.

Në këtë mënyrë, krahas thellimit të mëtëjshëm të studimit sinkronik të shqipes, duke botuar vepra të përbashkëta, filloi edhe studini diakronik i kësaj gjuhe, i cili mori një hov të dukshëm gjatë mijëvjeçarit që lamë pas dhe fillimin e këtij mijëvjeçari me punën e palodhur dhe të frytshme të E.Çabejt dhe të disa gjuhëtarëve të tjerë, që ecën në gjurmët e tij; si bashkëkohësi, kolegu, prof. Sh.Demiraj.

Studimet diakronike të shqipes gjatë këtyre dhjetëvjeçarëve të fundit nuk janë konceptuar të shkëputura nga problemet e studimit sinkronik të kësaj gjuhe. Përkundrazi, ato janë konceptuar dhe trajtuar në mënyrë të tillë që të ndriçojnë më mirë edhe gjendjen e shqipes së sotme dhe të ndihmojnë kështu edhe për të përcaktuar sa më drejt standardin, duke u mbështetur edhe në rrugën që ka ndjekur evolucioni i fakteve dhe i dukurive të gjuhës shqipe.

Për më tepër, si në studimet e prof. Sh.Demirajt, gjatë këtyre dhjetëvjeçarëve të fundit, sqarimi historik i dukurive gjuhësore të shqipes sa herë paraqitej rasti, është vështruar edhe në përqsaje me dukuritë e ngjashme të gjuhëve të tjera, sidomos të gjuhëve ballkanike. Në këtë mënyrë arritjet e gjuhësisë së re shqiptare kanë bërë të mundur edhe zhvillimin e mëtëjshëm të një bashkëpunimi shkencor të frytshëm midis studiuesve shqiptarë dhe albanologëve, ballkanologëve dhe indoeuropianistëve në vende të ndryshme të botës. E në këtë pikë prof.Demiraj i ka çuar më tej me mjaft botime sidomos në vitet 80 e këtej.

Me interes është edhe rruga(metoda) e ndjekur nga prof. Demiraj në studimet e tij diakronike. Si në studimet për fonetikën, gramatikën dhe dialektologjinë historike, ai është mbështetur në parimin që, duke u nisur nga faza e dokumentuar e shqipes dhe duke shfrytëzuar të gjitha mjetet e mundshme, ngjitet

shkallë—shkallë, në fazat më të hershme të saj. Ka raste për probleme të veçanta që ndjek të ndërsjellën, por në vazhdimësi.

Pra, baza e metodës së tij hulumtuese është krahasimi i bren—dshëm, duke u nisur nga e njohura për të zbuluar të panjohurën. Për t’ia arritur sa më mirë këtij qëllimi, ai është mbështetur edhe në krahasimin me gjuhët e tjera indoeuropiane, por krahasimin e jashtëm ai e ka shfrytëzuar *si një mjet plotësues*. Gjithashtu në shqyrtimin historik të fjalëve ose të dukurive të shqipes ai ka marrë në vështirimin edhe përhapjen e tyre gjeografike duke u dhënë përgjigje mjaft pyetjeve si : a janë të mbarë shqipes, apo kanë pasur një shtrirje të kufizuar dialektore apo nëndialektore.

Viti që lamë pas shënoi botimin e veprës shumë të mirëpritur **“Epiri, Pellazgët, Etruskët dhe Shqiptarët”**. Ka pasur mjaft botime për Epirin, pellazgët, etruskët dhe mesapët. Tek fqinjët tanë në Itali janë zhvilluar disa konferenca shkencore për vite me radhë nga kërkues dhe profesorë të Universiteteve. Po kështu mund të themi edhe për në Greqi. Ka pasur jo pak botime edhe nga autorë shqiptarë më qëllimin e mirë për të gjetur vazhdimësinë nga pellazgët — ilirët — arbrit dhe shqiptarët. Të gjitha këto botime janë shfletuar me shumë kujdes edhe ato botime që u përkasin 100 vjet edhe më shumë.

Siç nënvizon vetë autori: *”në këtë vepër të re kushtuar kryesisht banorëve dhe gjuhës amtare të Epirit gjatë shekujve, u pa e nevojshme që një kapitull dhe pikërisht Kreu I ,t’ia kushtoj problemit të pellazgëve dhe etruskëve. Një kapitull i tillë u pa i nevojshëm, sepse në veprën e porsapërmendur, problemit të pellazgëve i ishte kushtuar pak hapësirë, ndërsa ai i etruskëve nuk ishte prekur fare.”*⁸

⁸ Demiraj, Sh. *Epiri, Pellazgët, Etruskët dhe Shqiptarët*. Tiranë, 2008, f.3

Shumë pyetje i janë drejtuar vite më parë profesorit po edhe në Konferencën e zhvilluar në Universitetin e Vlorës, për botime të ndryshme për pellazgët si një popull paragrek në Gadishullin e Ballkanit apo për të sqaruar gjuhën e pellazgëve me anë të mbishkrimeve etruske e këto të fundit me anë të gjuhës shqipe.

Autori gjen vendin dhe shkruan ndër të tjera se përpjekje të tilla të bëra shpesh me paragjykime jo shkencore dhe nuk e kanë kapërcyer prapenjë e fantazisë apo të dëshirës për të mbrojtur një tezë pa shfrytëzuar të paktën ç'është shkruar nga specialist të njohur. Vazhdon më tej autori: *“mjafton të përmendim këtu, sa për shembull, mendimin e shprehur nga disa studiues shqiptarë se emri toscana –s në Itali lidhet me emrin toskë të Shqipërisë Jugore. Prandaj ndaj përpjekjeve të tilla në këtë vepër është mbajtur qëndrim kritik.”*⁹

Shpjegohet nga autori pse i ka lënë shumë faqe në këtë vepër të re Epirit: *“prandaj në këtë vepër u është kushtuar edhe më shumë hapësirë temave që në një mënyrë apo në një tjetër lidheshin me problemin e Epirit.*

*Një gjë e tillë u pa e nevojshme edhe për arsye se në literaturën e botuar për Epirin, sidomos nga autorë grekë, bien në sy përpjekjet për ta paraqitur atë si një trevë burimesh greke, megjithëse përpjekje të tilla bien në kundërshtim me dëshmitë e autorëve të vjetër grekë dhe një gjë e tillë e ka vënë në dukje, ndër të tjerë edhe studiuesi i njohur anglez Hammond.”*¹⁰

Burimin e emrit *Epir* dhe përdorimin e tij në një periudhë të caktuar historike e shikon në shtrirjen hapësinore të fiseve kryesore si është përdorur kur shqipja ka qenë e dokumentuar nga Barleti, Frang Bardhi. Më tej trajton mendimet, argu-

⁹ Po aty, f.4.

¹⁰ Po aty, f.4.

mentet e të huajve për Epirin. Përqendrohet tek dallimet midis mbishkrimeve dhe gjuhës amtare popullore. Si ka evoluar kuptimi i fjalës *barbarë*¹¹ nga autorët e vjetër grekë dhe kuptimi i vërtetë. Cilat janë argumentet për origjinën greke të epirotëve dhe vërejtjet përkatëse. Vërejtjet i shtrin edhe për emrat e disa perëndive.

Trajton gjerë monumentet e kulturës dhe gjuhën amtare të Epirit të lashtë. Gjen argumente për mos qëndruar mendimet e Vajgandit për origjinën trake të shqiptarëve, si ka ndikuar kultura greke. Kjo e fundit shihet tek Epiri i lashtë duke e ballafaquar me mendimin e argumentet e sjellë nga një tjetër studiues Hammond. I jep përgjigje pyetjes se a e ka zëvendësuar gjuha shqipe greqishten në Epir.

Rruga e zgjedhur për argumente sa më pak të diskutueshme e vazhdon me pushtimet romake në Ballkan dhe në Epir, kur u bë zëvendësimi i latinishtes nga greqishtja në Perandorinë Bizantine. Mesjeta si periudhë a ka pasur gjuhë amtare, dhe popullsia shqipfolëse ka qenë e ardhur? Gjuhën amtare të kësaj periudhe e këndvështron me huazimet e vjetra greke dhe latine si ka ndikuar gjuha greke në popullsinë jugore të Epirit.

Duke u afruar në vite argumenton disa mendime të shprehura¹² nga D.Nicol mbi shtegtimet e arbëreshëve gjatë shekullit XIV.

¹¹ Ka zënë vend në fjalorët e tipeve të ndryshme me shënimin *hist*.

Emër me të cilin grekët dhe romakët e vjetër quanin me përbuzje të huajt që nuk flisnin gjuhën e tyre dhe që i mbanin si të pazhvilluar; shih më gjerë dhe kuptimet e tjera deri tek barbarizëm Fjalë dhe shprehje e huazuar pa nevojë nga ndonjë gjuhë tjetër. *Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe*. Tiranë, 1980, f.100.

¹² Demiraj, Sh. *Epiri, Pellazgët, Etruskët dhe Shqiptarët*. Tiranë, 2008, f.68.

Duke u afruar në kohë u drejtohet defterëve osmanë. Tek këta defterë ndalet tek emrat tipikë shqiptarë : *Lekë, Gjon*. Ky i fundit emërtohet mbarëshqiptar. Krahason këtë emri shikon edhe përhapjen e emrave: *Gjergj, Pal e Pjetër*. Emrat tipikë shqiptarë: *Bardhi, Drevi* i krahason me emrat dhe tinguj që i mungojnë greqishtes në viset jugore të Epirit. Ka disa faqe për ndikimin në onomastikën e Epirit.

Trajtimi nga lashtësia deri tek dokumentet e shkruara i lejon autorit të arrijë në përfundime:

Dallon shtresat e popullsisë që përdornin emrin *Epir*. Emri *Epir* me burim nga greqishtja Epeiros është përdorur kryesisht nga grekërit për të emërtuar viset në përfundim të trevave greke¹³. Ky emërtim ka pasur shtrirje edhe në disa qarqe përfundimore, si edhe nga disa shqiptarë të shkolluar, por popullsia vendëse nuk e ka përdorur emërtimin. Pozicioni gjeografik jepte mundësinë të banohej që nga pellazgët dhe të kalonin aty fise greke dhe fise të tjera para se të vendoseshin banorët e mirëfilltë të Epirit.

Duke u ndalur tek shpjegimi i fjalës *barbar*¹⁴ d.m.th. të huaj , pra, ata flisnin një gjuhë të ndryshme nga greqishtja e jo një dialekt i greqishtes¹⁵. E quan të pambështetur mendimin e disa dijetarëve grekë dhe të Jeriçekut duke nënvizuar që ende gjatë periudhës së sundimit romak, bizantin banorët e trevës së Epirit mundën t'i rezistonin procesit të helenizimit. Prosesi i zëvendësimit pak nga pak i gjuhës amtare të vendasve mori përpjesëtime më të mëdha sidomos gjatë krijimit të shtetit grek. Studiuesit e ardhshëm, duke ecur në këtë rrugë të çelur nga prof..Sh.Demiraj do të vërtetojnë edhe atë që ka lënë në

¹³ Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe .Tiranë,1980,f.100.

¹⁴ Demiraj,Sh. *Epiri, Pellazgët, Etruskët dhe Shqiptarët*.Tiranë, 2008,f.93

¹⁵ Demiraj,Sh. *Epiri, Pellazgët, Etruskët dhe Shqiptarët*.Tiranë, 2008,f.94.

mes profesori i gjuhësisë së përgjithshme R. Robins, cili ka shkruar: ”*Duke lënë mënjanë dialektet e folura , grekërit e kulturuar ishin të vetëdijshëm se gjuha e poemave homerike, Ilidës dhe Odisesë nuk njësohej me asnjërin prej dialekteve të kohës.*”¹⁶

Duke shfletuar arkivat autori nuk ka gjetur ndonjë dëshmi për shpërngulje shqiptarësh apo arbëreshësh. Dëshmohen shpërngulje nga viset e Epirit kryesisht në shekullin XIV për në vise të ndryshme të Greqisë dhe në More, ku ka edhe sot një numër të madh arvanitësh a më saktë thotë autori *arbëreshë*, që veçanërisht gjatë dy shekujve të fundit kanë ardhur duke e humbur gjuhën amtare të trashëguar.

Përhapja e emrave grekë si : *Jani, Jorgo, Pavllo* të përshtatur sipas strukturës gramatikore të shqipes ka shpjegimet e veta si zonë kufitare e me ndikim të fuqishëm të kishës ortodokse greke.

Regjistrimet osmane të emrave të vendbanimeve të shekujve XVI–XVII dëshmon se banorët e tyre mbartin në përgjithësi emra më trajta të vjetra shqiptare si : *Gjon ,Lekë, Gjini, Gjike, Gjer, Pal* etj.

Hipotezat e ngritura nga disa dijetarë që shqiptarët e sotëm janë pasardhësit e një popullsie tjetër të vendosur në këto treva, nuk ka mbështetje historike dhe gjuhësore. Augmentet e paraqitura për këtë hipotezë nuk mbështeten, nënvizon autori në dialektologjinë historike të gjuhës shqipe, por edhe nga huazimet e hershme prej greqishtes së vjetër dhe prej latinishtes që janë të përbashkëta për të gjitha të folmet e shqipes.¹⁷

Kanë kaluar vite dhe në takime me profesorin e Gramatikës historike, pjesëmarrës në konferencën ”*Vlora në rrjedhat e*

¹⁶ Robins, H.R. Historia e gjuhësisë. Dituria, 2007, f.30.

¹⁷ Po aty, f.94.

kohës”, apo në takime të tjera të shpallte si fushë për studiuesit : *mesapët dhe gjuha e tyre*.

Të duket në fillim sikur këtij problemi i ka kushtuar pak faqe. Në të vërtetë siç nënvizon autori: “ *duke qenë se gjatë gjithë kapitujve të kësaj vepre janë bërë krahasime edhe në gjuhën e mesapëve, u pa e nevojshme që në fund të botohet si shtojcë, edhe kapitulli kushtuar gjuhës së asaj popullsie të lashtë të Italisë Juglindore.*” ¹⁸

Në këtë kapitull kryesisht është ndalur në mbishkrimet mesa-pe; si i kanë interpretuar dhe argumentuar këto mbishkrime. Cili është mendimi i Herodotit mbi origjinën e mesapëve? Sa bindshëm për një gjuhëtar që e ka konsoliduar veten në gjuhësinë diakronike më shumë se 60 vjet ? Argumentet i shikon në detaje edhe për De Simones , Hamp-it , Pellegrinit, Suf-flay-t dhe Hammondit për origjinën ilire të mesapëve.

Bashkëpërkimet midis mesapishtes dhe shqipes i trajton duke u mbështetur në fonetikën historike e kryesisht në evolucionin o>a në mesapishte dhe në gjuhën shqipe, evolucionin m në mesapishte dhe në shqipe, çaspirimi i mbylltoreve të aspiruara dhe theksini nistor në mesapishte dhe gjuhën shqipe. Nuk lë pa trajtuar nëse ka qenë mesapishtja në gjuhët e tipit *saten*.

Autori rendit ata gjuhëtarë, të cilët e kanë pohuar pa rezerva lidhjet midis mesapishtes dhe ilirishtes, si Hamp(1957,f.74). Citon autori:”*Nuk mund të ketë asnjë dyshim që mesapishtja dhe ilirishja janë gjuhë motra, megjithëse të ndara nga një gjysmë mijëvjeçari ndryshimi dhe që në vija të përgjithshme çfarë themi për mesapishten, ndoshta vlen barabar edhe për ilirishten. Për ta bërë më të qartë pohimin tonë*”¹², - citon më tej autori, - *duhet të kuptojmë me ilirishte vetëm gjuhën që*

¹⁸ Demiraj,Sh. *Epiri, Pellazgët, Etruskët dhe Shqiptarët*. Tiranë, 2008,f.5.

flitej në Adriatikun Lindor dhe në Dardani ndoshta aq larg në veri sa të shumtën deri në Danub dhe jo në kuptimin e gjerë të adaptuar nga dijetarë të tillë si Pokomy dhe të kritikuar me të drejtë nga Whatmough-i” (Word 6, 242–1950)

Edhe dijetarë të tjerë kanë shkruar për origjinën ilire të mesapëve si Suflay –n dhe Hammond –in. Ndonëse në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit XX, Suflay do të shkruante se fise ilire të shpërngulur nga Bregdeti Ballkanik rreth shekullit IX para erës sonë u vendosën në Italinë Jugore në Abroce dhe Pulje.

Në gjysmën e dytë të shekullit XX studimet për mesapishten u shtuan dhe nxorën në dritë përkime në sistemim fonetik dhe gramatikor.

Mbështetësit e origjinës ilire të mesapëve kanë pohuar gjithashtu se ka edhe disa bashkëpërkime thelbësore midis mesapishtes dhe shqipes sidomos në fjalor. Autori ndalet më shumë tek dukuritë fonetike për të vërtetuar një çështje të diskutueshme lidhur me tipin *saten* apo *kentum* të këtyre dy gjuhëve duke arritur në përfundimin se nuk qëndrojnë mendimet për karakterin *kentum* për ilirishten dhe mesapishten.

Argumenti që sjell është vërtetuar edhe nga gjuhëtarë të tjerë që grykoret qiellëzore indeoeurpoiane janë çqellëzuar edhe në disa gjuhë indoeurpiane, ku përfshihen edhe mesapishtja, ilirishtja, shqipja, gjuhët baltike etj.

Dallon katër dukuri të përbashkëta fonetike midis mesapishtes dhe shqipes:¹⁹

1. Evolucion i /o / –së shkurtër indoeuropiane në /a/
2. Çaspirimi i bashkëtingëlloreve mbylltore të aspiruara indoeuropiane
3. Evolucion i /m/ > /n/ në pozicion fundor.

¹⁹ Demiraj, Sh. *Epiri, Pellazgët, Etruskët dhe Shqiptarët*. Tiranë, 2008, f.187.

4. Theksimi nistor në disa toponime shumëerrokëshe të lashta: Brindisi, Taranto, Otranto etj.

Parashtrimi i mësipërm për mesapishten e lejon autorin të arrijë në përfundimin: *“Gjuha e mesapëve ka qenë e ndryshme nga greqishtja; prandaj tregimi i Herododit është i pasaktë gjuhësisht (si edhe historikisht) me gjithë ndryshimet e mëdha të shkaktuara nga evolucioni i pavarur i mesapishtes dhe i shqipes në rrjedhë të shekujve në dy zona të ndryshme dhe pa kontakte midis tyre në këto dy gjuhë mund të vërehen disa bashkëpërkime të rëndësishme të cilat dëshmojnë se mesapët e lashtë dhe stërgjyshërit e shqiptarëve duhet të kenë pasur një origjinë të përbashkët etniko-gjuhësore.”*²⁰

Pavarësisht nga argumentet e mësipërme autori e lë problemin të hapur duke pritur një zgjidhje përfundimtare nga hulumtimi shkencorë të mëtejshme në vitet që do të vijnë.

Pra, këto hulumtime shkencore të kenë si bazë krahasimin e brendshëm, duke u nisur nga e njohura për të zbuluar të panjohurën. Për t’ia arritur sa më mirë këtë qëllim, krahasim me gjuhët e tjera indoevropiane, por krahasimin e jashtëm **si një mjet plotësues.**

Individë si prof. Sh.Demiraj i cili iu përkushtua analizës së thellë së fakteve të reja gjuhësore dhe ato të përmendura nga autorë të huaj ose kolegëve vendas lë trashëgim shumë botime të domosdoshme për nivelet e mësimdhënies në Universitet. Këto botime janë trashëgimni e vyer edhe për gjuhësinë e përgjithshme. Botimet për universitarët dhe pasuniversitarët e bën që të radhitet tek trashëgimtarët e mrekullisë që “veçansia, bukuria dhe domethënia e gjuhës njerëzore” që prej më tepër se dy mijëvjeçarësh vazhdon të ngjallë në mendjet e hapura dhe kërkuese.²¹

²⁰ Po aty, f.189.

²¹ Cituar sipas R.Robins, L.Bloommfield. *Language*. London, 1935, f.7.

XHEMALUDIN IDRIZI,

Shkup

DISA FJALË PËR KONTRIBUTIN E SHABAN
DEMIRAJT PËR GJUHËSINË BALLKANIKE

Shkurtimore

Profesor Shaban Demiraj është figurë e shquar e shkencave albanologjike. Puna e tij në këtë fushë pamëdyshje është e gjerë dhe e frytshme. Me interes njaft të madh është libri i shkruar nga profesor Shaban Demiraj kushtuar çështjes së gjuhësisë ballkanike në botimin Gjuhësi Ballkanike botuar nga Logos A në bashkëpunim me Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare në Fakultetin Filologjik të Shkupit (botuar në shqip dhe maqedonisht – përkthyer nga prof.dr. Haki Ymeri), me çrast thekson se duke pasur parasysh zhvillimin e studimeve krahasuese mbi gjuhët ballkanike sidomos pas botimit të veprës së Kristian Sandfeldit më 1930, m'u duk e arsyeshme të përgatis për lexuesin shqiptar një vepër sintetizuese mbi gjuhësinë ballkanike, ku pasqyrohen edhe ndihmesat e gjuhëtarëve të ndryshëm në këtë fushë studimesh.

1. Akademik Shaban Demiraj pamëdyshje është personalitet i shquar i shkencës, arsimit e kulturës shqiptare, një figurë e shquar e shkencave albanologjike, me një punë shumëvjeçare, të gjerë e të frytshme. Atë e dallon veprimtaria e tij kumtuese dhe botuese, brenda dhe jashtë vendit, sidomos në fushën e albanologjisë. Kontribut të rëndësishëm ndërmjet tjerash, dha edhe në përgatitjen dhe edukimin e disa brezave të mësuesve të gjuhës dhe letërsisë shqipe.

Akademik Shaban Demiraj lindi në Vlorë , më 11 janar 1920. Në vitin 1948 përfundon studimet në Institutin e Lartë Pedagogjik 2–vjeçar të Tiranës, ndërsa atë 4–vejçar në vitin 1954. Ka qenë nxënës i gjuhëtarëve të shquar Kostaq Cipos e Aleksandër Xhuvanit dhe më vonë edhe i Eqrem Çabejt. Aftësitë e tij në këtë sferë ndikojnë në emërimin e tij si pedagog në ish–Institutin e Lartë Pedagogjik. Në vitin 1957 emërohet në Fakultetin Histori–Filologji të Universitetit të sapokrijuar në Tiranë. Titullin “profesor” e meriton në vitin 1972.

Me krijimin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, më 1989 akademik Shaban Demiraj zgjidhet ndër anëtarët e parë të saj, ndërsa gjatë viteve 1962–1989, shërben si përgjegjës i Katedrës së Gjuhës Shqipe. Në vitin 1977 i jepet titulli i lartë “Mësues i Popullit”, mandej më 1979 nderohet me “Çmimin e Republikës” të klasit II dhe më 1989 me “Çmimin e Republikës” të klasit I.

Akademik Shaban Demiraj është njëri prej studiuesve më të shquar të albanologjisë të shekullit XX, njihet autor i shumë veprave shkencore në fushë të albanologjisë, sidomos në fushën e gjuhësisë dhe në këtë kontekst ai ka dhënë vepra kulmore në këtë sferë, që përgjithësisht e ka ndihmuar zhvillimin e gjithanshëm të gjuhësisë e të veprimtarisë kërkimore shkencore në këtë fushë. Proven e parë e jep me tekstin e gjuhës shqipe për shkollat e mesme pedagogjike (1953). Ndër këto, përmendim edhe: “Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe”(1961) dhe e ribotuar në Prishtinë (1971), “Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe”(1972), “Sistemi i lakimit në gjuhën shqipe”(1975), “Morfologjia historike e gjuhës shqipe”(I e II, 1973 e 1976) dhe ribotuar në Prishtinë (1980), “Gramatika historike e gjuhës shqipe”(1986) e ribotuar në Prishtinë (1988), “Gjuha shqipe dhe historia e saj”(1988) dhe

ribotuar në Prishtinë (1989). Studime të tij me interes të veçantë janë ato për filologjinë e arbëreshëve. Një libër të posaçëm (më 1990) i ka kushtuar jetës dhe veprës së dijetarit tonë të madh e kolegut shumëvjeçar të tij, prof.dr. Eqrem Çabej-Akademik. Ndërsa më 1994 boton në Shkup (shqip e maqedonisht) veprën “Gjuhësi ballkanike” dhe më 1996 “Fonologjia historike e gjuhës shqipe”.

Ja çfarë thoshte ai kohë më parë, në një bisedë të tij, që mbetet aktuale edhe sot:

“Të gjithë duhet të përpiqemi që ta përsosim vazhdimisht shqipen tonë letrare, e cila i ka përmbushur gjithnjë dhe më mirë kërkesat e një shoqërie me zhvillim të pandërprerë. Të gjithë duhet të përpiqemi ta zhvillojmë e ta pasurojmë atë dhe, njëkohësisht, ta ruajmë nga ndikimet e gjuhëve të tjera dhe sidomos nga vërshimi i fjalëve të huaja të panevojshme, dukuri kjo, që kohët e fundit ka marrë përmasa shqetësuese. Dhe, me këtë rast, një punë të madhe mund dhe duhet të bëjnë sidomos arsimtarët, shkrimtarët dhe gazetarët, të cilët ndikojnë drejtpërsëdrejti mbi brezin e ri dhe mbi masat e gjera të lexuesve”.

2. Me interes mjaft të madh është libri i shkruar nga akademik Shaban Demiraj kushtuar çështjes së gjuhësisë ballkanike në botimin Gjuhësi Ballkanike botuar nga Logos A në bashkëpunim me Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare në Fakultetin Filologjik të Shkupit (botuar në shqip dhe maqedonisht – përkthyer nga prof.dr. Haki Ymeri), me çrast thotë që duke pasur parasysh zhvillimin e studimeve krahasuese mbi gjuhët ballkanike sidomos pas botimit të veprës së Kristian Sandfeldit më 1930, më duket e arsyeshme të përgatis për lexuesin shqiptar një vepër sintetizuese mbi gjuhësinë ballkanike, ku pasqyrohen edhe ndihmesat e gjuhëtarëve të

ndryshëm në këtë fushë studimesh. Ai më tutje thekson se hartimi i një vepre të këtillë ishte i nevojshëm edhe për të vënë në dukje në mënyrë më të plotë se deri sot të dhënat e shqipes që dëshmojnë për tiparet ballkanike të saj. (Sh. Demiraj, Gjuhësi ballkanike, Shkup, 1994 f.5).

Në këtë punim do të them vetëm disa fjalë që i shtron autori për gjendjen e sotme gjuhësore në gadishullin e Ballkanit (kreu III). Këtu akademik Shaban Demiraj thekson pozitën gjeografike të gadishullit të Ballkanit si një urë ndërlidhëse midis Evropës dhe Azisë së Vogël qysh nga kohët e hershme e deri në Mesjetën e vonshme që është bërë arenë e dyndjeve nga popuj të ndryshëm . Ky fakt ka bërë që nga kohë në kohë të ndryshojë edhe gjendja e tij gjuhësore. Thekson faktin se në ndryshimin e gjendjes gjuhësore të këtij gadishulli një rol të rëndësishëm ka luajtur edhe vetë evolucioni i gjuhëve, që janë folur këtu gjatë periudhave të ndryshme historike. Krejt kjo ka ndikuar që në këtë gadishull sot fliten një numër jo i vogël gjuhësh të ndryshme duke përfshirë këtu edhe një gjuhë joindoevropiane, turqishten. Kështu ai thotë se kur krahasohet gjendja e sotme gjuhësore në këtë gadishull me atë të periudhës antike, bie në sy se përveç greqishtes (së re) dhe gjuhës shqipe, që janë vazhdueset e greqishtes së vjetër , përkatësisht të ilirishtes, gjuhët e tjera janë zhvilluar këtu si pasojë e pushtimeve, përkatësisht e dyndjeve të popujve gjatë periudhash të ndryshme historike. Thekson rumanishten si gjuhë që është përfutur nëpërmjet romanizimit të dakëve të vjetër, ndërsa për bullgarishten e maqedonishten dhe serbokroatishten e sllovenishten thotë se janë zhvilluar pas dyndjeve të sllavëve pas shekujve VI–VII në Ballkan, kurse turqishtja është shfaqur në këtë trevë pas pushtimeve të Perandorisë Osmane në shekullin XIV–XV. Përveç këtyre gjuhëve, në Ballkan fliten edhe gju-

hë të tjera nga grupe më të vogla popullsish, gjuha e romëve, armenishtja etj.

Mbi gjendjen e sotme gjuhësore të Gadishullit Ballkanik ai me të drejtë e mbështet faktin se në të gjitha trevat e këtij gadi-shulli ka “ishuj gjuhësorë” të ndryshëm. Këtë fenomen e mbështet në faktin e shpërnguljeve të masave pak a shumë të gjera popullsish nga një vend në tjetrin për arsye ekonomike ose politike. Kështu, si pasojë e ndikimeve të ndërsjella midis gjuhëve të Gadishullit të Ballkanit, si edhe i ndikimeve të kushtëzuara nga fatet e përbashkëta historike të popujve të gadishullit, në këto gjuhë janë përfutur një varg tiparësh të përbashkëta që nuk ndeshen në gjuhë të tjera indoevropiane, ose edhe kur ndeshen në ndonjë gjuhë tjetër, këtu ato janë një zhvillim i brendshëm ballkanik. Si element të përbashkët e thekson prapavendosjen e nyjes shquese. Konstaton se tipare të përbashkëta janë zhvilluar në gjuhën shqipe, rumanishte, bullgarishte, maqedonishte dhe greqishte, ndërsa në serbo-kroatishte, megjithëse edhe kjo është zhvilluar në truallin ballkanik, tiparet e përbashkëta të gjuhëve ballkanike janë më të pakta dhe janë të kufizuara sidomos në viset jugore të saj. (Gjuhësi Ballkanike, 1994, f.50).

3. Këtu autori na jep një pasqyrë të qartë në lidhje me vendet ku fliten gjuhët ballkanike dhe paraqet një statistikë , përkatësisht numrit të vetëve që i flasin këto gjuhë. Për gjuhën shqipe thekson se stërgjyshërit e shqiptarëve gjuhën e vet e emërtounin me mbiemrin e tyre arbëneshe e arbëreshe ose me ndajfoljen arbënisht/arbërisht dhe thekson se këto fjalë e kanë burimin te emri i fisit ilir të Arbanëve që banonin në lindje të DURRËSIT (Këtë fis ilir e përmend për herë të parë Ptolomeu, gjeografi grek i Aleksandrisë në shekullin II të erës sonë. Ai përmend ndër të tjera fisin Albanoi dhe qytetin Albanopo-

lis – Çabej Studime gjuhësore III, 1974, f. 65). Të huajt për të emërtuar popullin shqiptar për bazë kanë arban, alban (ndër dokumente latine ndeshen trajta me –lb dhe –rb (albanenses, arbanenses); italianët, francezët etj. Përdoren trajtat me –lb (albanese, albanais etj.) grekët përdorin trajtën arvanit–as (me shndërrimin e –b në –v – të greqishtes), sllavët trajtën arban–as, por dikur përdorën trajtën Rabënë <arbënë (me metatëzën e njohur ar → ra) dhe trajta turke arnaut mbështetet në trajtën greke arnavit.

Në lidhje me fjalën shqip, të cilën e gjejmë për herë të parë te Buzuku dhe atë vetëm një herë, thotë se ajo duhet të ketë pasur kuptimin e “qartë, kthjellët, troç” që duhet analizuar, erdh dhe zëvendësoi trajtën arbënisht, arbërisht, dhe prej saj u formuan edhe fjalët shqip–tar, Shqipëni/Shqipëri etj.

Në lidhje me prejardhjen e gjuhës shqipe ai e mbron mendimin më të përhapur dhe më të mbështetur se gjuha shqipe është përfutur nga evolucioni i ilirishtes, përkatësisht nga njëri ose disa dialekte të saj, tezë të cilën e kanë mbrojtur Thunmanni: 1774, 245 v., Leake–u: 1811 v., Xylander–i : 1835 , 311 v., Hahn–i: 1853, 1 213 v., Mikloshiçi: 1870/1, 8, Meyer–i 1888, 804, Pedersen i 1900, 299 v., Çabej: 1972/2 pasim, Cimohovski: 1976, 184 v., Humbtschmid–i: 1982, 79, Olberg–u : 1977, 626 , Katiçiç–i 1976, 185, Mihaescu: 1982, 57 v., etj. Këtë mendim e mbështet , ashtu siç e mbështetin edhe shumë gjuhëtarë të tjerë , edhe nga fakti që toponimet e vjetra të këtyre trevave paraqiten në gojën e shqiptarëve me trajta fonetike , që janë përfutur në pajtim të plotë me ligjësitë e evolucionit të sistemit fonetik të gjuhës shqipe, duke trajtuar emrat e vjetra të qyteteve Durrës, Shkodër, Lesh, Vlonë, Vlorë, Ishëm etj. Nuk i mbështet hipotezat sipas të cilave thuhet se shqipja është bijë e trakishtes (Një mendim të këtillë

kanë mbrojtur Hirti , 1898 179 v., Weigand–i BA III, 273 v., Bariçi , 1955 31 v. etj.) apo atë të ashtuquajturës dako–mizishte (Georgiev , BE II, 18 v.). Për këto thotë se janë hi–storikisht dhe gjuhësisht të papërmbajtura.

Për shndërrimin e shkallëshkallshëm të ilirishtes në bijën e saj, shqipen, e mbështet idenë se duhet të jetë kryer midis sheku–jve IV – VI të erës sonë , në fazën e fundit të ndikimit të fu–qishëm latin mbi ilirishten dhe ardhjes së sllavëve. Për atë që ky proces është kryer para ardhjes së sllavëve në Ballkan dë–shmojnë disa dukuri specifike të shqipes si ngulitja e theksit mbi një rrokje të caktuar të temës, lakimi në ballë të fjalës (mbiemrat e nyjshëm, përenrat pronorë të dy vetave të para – im, yt, ynë, juaj, dhe të vetës së tretë – i tij, i saj, i tyre , Sha–ban Demiraj: 1986, 316, v., 417,v., 477, v., ; 1988, 72 v.,) dhe metafoia në shumësin e emrave mashkullorë (është fjala për raste të tipit dash–desh, ka – qe, djalë– dje(l)m etj. dhe në kohën e tashme të mënyrës dëftore (është fjala për raste të tipit dal – del, marr – merr, ngas – nget etj.). Këtu ai thotë se lakimi në ballë të fjalës te mbiemrat e nyjshëm është shfaqur në një kohë kur gjinia asnjansë ishte akoma e gjallë në këtë gjuhë. (Mbiemrat e nyjshëm dikur kishin forma të veçanta edhe për gjininë asnjansë, kryesisht në numrin njëjës i mirë– e mirë – të mirë, ndërsa gjurmët e kësaj gjinie ruhen ende edhe te mbiemrat e emëruar të tipit të keq–të, të folurit etj. Demiraj, Gjuhësi ballkanike f. 53). Në kohën e kontakteve me gjuhët sllave kjo gjini veçmë ishte dobësuar shumë që e dëshmon edhe mungesa e gjurmëve të gjinisë asnjansë në huazimet sllave të shqipes, përkundrajt pranisë së gjinisë a–snjansë në fjalët e trashëguara dhe në fjalët latine . Në gjuhët sllave gjinia asnjansë është e pranishme edhe sot, emrat e huazuar sllavë në gjuhën shqipe janë integruar vetëm në gji–

ninë mashkullore ose femërore. Konstaton se mungesa e metafonisë në huazimet sllave të shqipes, përkundrajt prania e saj në fjalët e trashëguara dhe në huazimet latine dëshmon përfundimin e kësaj dukurie me rrugë fonetike qysh në periudhën parasllave të shqipes (Demiraj, vepra e cituar , f.54).

Lidhur me gjuhën e shkruar shqipe, autori thekson rrethanat historike që tregojnë shkakun e paraqitjes së vonshme të gjuhës së shkruar shqipe, Shqipëria në mënyrë të vazhdueshme ka qenë nën pushtimin e të huajve, ndërsa si gjuhë shkrimi administrate në këto vise pushtuesit kanë përdorur greqishten, latinishten dhe sllavishten.

Historia e letërsisë njihet Mesharin e Buzukut (1555) si libër të parë të shkruar në gjuhën shqipe. Por, përveç kësaj, ai thekson se ka të dhëna që dëshmojnë se gjuha shqipe ka qenë e shkruar të paktën qysh disa shekuj para Buzukut, gjë të cilën e vërtetojnë jo vetëm gjuha e përpunuar e Buzukut dhe e Matrëngës (1592), por edhe njoftime të tilla si ato të murgut francez Guillelmus (1332) , i cili thotë: “Sado që shqiptarët kanë një tjetër gjuhë , krejt të ndryshme nga latinishtja, megjithatë ata kanë në përdorim dhe në të gjithë librat e tyre shkronjën = alfabetin latin .”, (Mendimi i shprehur në veprën latinisht *Directorium ad passagium faciendam* – libri I, pjesa B) , Barletit (1504) etj. Në veprën *De opsidione Scodrensis* 1504 f.8 ai shprehet kështu:” Por pak kohë më parë na ranë në dorë disa fragmente më fort sesa anale, që bëjnë fjalë më fort për rindërtimin e këtij qyteti sesa për ndërtimin e tij nga stërgjyshërit tanë. Në të vërtetë në këto është shkruar në gjuhën popullore se një farë Roza me motrën e vet, Fa, kishin qenë themeluesit e parë të qytetit të Shkodrës , prandaj kështjella e saj quhet Rozafa...”

Autori në këtë pjesë thekson të shkruarit e gjuhës shqipe në dy dialektet kryesore deri në vitin 1972, përkatësisht në variantin verior (gegërishten) dhe në variantin jugor (toskërishten), kur u vendosën normat e një gjuhe të vetme me Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe. Thekson Franc Boppin (1854) i cili vërteton se gjuha shqipe bën pjesë në familjen e gjuhëve indoevropiane duke zënë vend më vete ashtu si greqishtja. Jep të dhëna se shqipja, si pasojë e zhvillimit evolutiv të saj, është si një gjuhë sintetike – analitike me një sistem lakimi në të dy trajtat (e pashquar dhe e shquar) si edhe me një sistem zgjedhimi të pasur në forma kohore dhe mënyrore, mandej me një sistem prej 36 fonemash, ngulitja e hershme e theksit mbi një rrokje të caktuar të temës, ndërsa te foljet theksi bie mbi rrokjen e fundit të temës, kurse te emrat ai mund të bjerë mbi çdo rrokje, megjithëse në shumicën e rasteve bie mbi rrokjen parafundore dhe nuk bie mbi formantet gramatikore (përgjashtimet janë të kufizuara, si p.sh. te shumësi i emrave të tipit: lëmë–lëm–enj, lumë – lum–enj, plaf–plëf–enj, baba – baba–llarë, sheh– sheh–lerë etj.)

Në lidhje me dukuritë ballkanike kryesore të gjuhës shqipe i veçon këto karakteristika: 1. Prania e zanores –ë; 2. Prapavendosja e nyjës shquese; 3. Formimi i kohës së ardhme me foljen ndihmëse dua në formë të ngurosur; 4. Rimmarrja e kundrinave nëpërmjet formave të patheksuara të përemrave vetorë; 5. Mënjanimi i pjesshëm i paskajores etj. Thekson edhe disa bashkëpërkime me rumanishten në fushën e gramatikës, si p.sh. prapavendosja e përcaktorëve të pavenjaftueshëm dhe në fjalor.

4. Lidhur me greqishten e re na jep të dhëna se ajo flitet në Greqi (9.400.000 vetë) dhe në Qipro (500.000 banorë), si edhe si minoritete greke në Shqipëri (58.758 vetë), Turqi

(1000.000 vetë), Itali (30.000 vetë), emigrantë grekë në SHBA (380.000 vetë), Kanada (40.000 vetë), Australi (80.000 vetë) etj. (Të dhënat autori i ka nxjerrë nga Lopashov, 1990, 10. Shifrën për minoritetin grek në Shqipëri e ka marrë nga vjetari 1990, 35).

Na sjell të dhëna se greqishtja e re është përfutur nëpërmjet evoluimit të greqishtes së mesme që në shekullin XV të erës sonë. Kjo gjuhë ka një dokumentim shkrimor shumë të pasur (edhe greqishtja e vjetër dhe e mesme kanë një dokumentin shkrimor shumë të pasur). Greqishtja e re për shkrimin e vet e përdor alfabetin e vjetër grek , i cili është mbështetur në alfabetin e vjetër të fenikasve të plotësuar edhe me shkronja të posaçme për zanoret. Në Greqi, gjatë dy shekujve të fundit në përdorim kanë qenë dy gjuhë letrare: letrarishtja popullore (dhimotiqi) dhe letrarishtja e plotësuar (katharevusa). Në vitin 1976 e sidomos në vitin 1982 , me një vendim qeveritar pothuajse mënjanohet fare nga përdorimi katharevusa në shkollat e larta , ku përdorej në mënyrë mbizotëruese. Shkak i mënjanimi të saj thotë se ishte një gjuhë e përpunuar dhe e mbushur me fjalë arkaike, e cila ishte e vështirë për t'u kuptuar nga masat e gjera popullore.

Greqishtja është gjuhë e familjes së gjuhëve indoevropiane dhe zë një vend më vete ashtu si gjuha shqipe. Është gjuhë sintetike – analitike me një sistem lakimi me dy trajta (të pasquar e të shquar) dhe me një sistem zgjedhimi relativisht të pasur në forma kohore dhe pjesërisht edhe mënyrore . Greqishtja e re ka vetëm mënyrat dëftore, urdhërore dhe lidhore, si edhe pjesoren e shkuar, ndërsa nga mënyrat vetëm dëftorja është e pasur në forma kohore: e tashme, e pakryer, aorist, e kryer dhe më se e kryer analitike , e ardhme dhe e ardhme e

së shkuarës (analitike); kjo e fundit shërben edhe si mënyrë kushtore (Demiraj, vepra e cituar, f.58).

Kur bëhet fjalë për theksin , greqishtja e re , ashtu si edhe greqishtja e vjetër, karakterizohet me një theks të lirë, që mund të lëvizë nga një rrokje në tjetrën edhe gjatë lakimit të një fjale (te emrat), ndërsa te rreshtorët dhe mbiemrat theksi nuk lëviz. Theksi në greqishten e re mund të bjerë edhe mbi mbaresën rasore ashtu siç ndodh në greqishten e vjetër. Në fjalët shumërokkëshe theksi zakonisht bie mbi një nga tri rrokjet e fundit.

Përveç që greqishtja e re ka ruajtur fondin e fjalëve të trashëguara nga greqishtja e vjetër dhe e mesme, ajo ka huazur edhe nga gjuhë të tjera si italishtja (kryesisht nga dialekti venecian), sllavishtja, turqishtja etj.

Lidhur me dukuritë kryesore ballkanike të greqishtes i veçon: 1. Mënjanimi i formës së rasës dhanore; 2. Formimi i kohës së ardhme me foljen ndihmëse dua në trajtë të ngurosur; 3. Rismarrja e kundrinave nëpërmjet formave të patheksuara të përrenrave vetorë; 4. Mënjanimi i paskajores nëpërmjet zëvendësimit të saj nga format vetore të mënyrës lidhore etj.

Demiraj këtu thekson një karakteristikë të veçantë të greqishtes, që ndryshe nga gjuhët tjera ballkanike , nyjën shquese e ka të paravendosur. Gjithashtu , ndryshe nga shqipja dhe rumanishtja , përcaktorët e pavetënjaftueshëm i përdor kryesisht të paravendosur.

5. Për gjuhën rumanishte na jep të dhëna se atë e flasin afro 21.000.000 vetësh dhe se shumica e këtyre vetëve banojnë në Rumani. Rumanishten e flasin edhe jashta kufijve të Rumanisë, si në Rusi (rreth 200.000 vetë), në Serbi (rreth 55 000 vetë), në Hungari (rreth 10 000 vetë) në SHBA (rreth 50 000 vetë), në Kanada (rreth 25.000 vetë) , në Argjentinë (

rreth 15 000 vetë), etj. Përveç këtyre ai përmend edhe aromunët , të cilët sipas tij dikur llogariteshin në rreth 300.000–350.000 vetë në vise të ndryshme të Ballkanit, sidomos në Greqi (150.000 vetë), në ish Jugosllavi (100.000 vetë) , në Bullgari (40.000 vetë), në Shqipëri (65. 000 vetë), etj. (Çerniak 1990, 193.”Siç pohohet edhe atje këto janë të dhëna të përafërta, sepse tashti mendohet që numri i përgjithshëm i aromunëve arrin në 110.000 vetë , nga të cilët në Shqipëri 15.000.(Demiraj , vepra e cituar f.59)”.Thekson se rumunët veten e quajnë romën. Kjo fjalë vjen nga rom–an. Gjuhën e vet e quajnë romëneshte, ndërsa popujt e tjerë i quajnë me emra të ndryshëm, si: vllah ose vallah, çoban etj.

Gjuha rumanishte është gjuhë neolatine e cila është përfutur nga evoluimi i latinishtes popullore të Ballkanit Lindor. Ky evoluim i shkallëshkallshëm mund të ketë zgjatur disa shekuj. Mendohet se ky process është zhvilluar aty brenda shekujve V– VIII. (Këtë e mbështet në burimin ILR II,15; Costeanu: 1969, 11 v., ku jepen edhe mendime gjuhëtarësh, që e shohin disi më të vonë formimin e gjuhës rumune). Për vendin se ku është kryer ky evolucion i përmend të tria hipotezat . Për disa dijetarë ky evolucion është kryer në trevat në jug të lumit Danub. Sipas disa dijetarëve të tjerë banorët që mbetën në veri të Danubit e që nuk arriti t’i tërheqë perandori Aureliani përbën bërthamën kryesore të popullit të sotëm rumun.Teza e tretë është ajo që disa dijetarë të tjerë, duke gjykuar si të pambështeshme edhe mendimin e parë dhe të dytin, kanë mbajtur një qëndrim të ndërmjetshëm që duket se është edhe më i mundshëm. Sipas këtyre dijetarëve rumunët e sotëm janë formuar si popull si në veri ashtu edhe në jug të lumit Danub. Edhe rumanishtja dokumentohet me shkrim aty nga shekulli XVI, por nuk mungojnë dëshmi për shkrimin e saj edhe para

kësaj kohe. Si arsye për paraqitjen e vonshme të shkrimit të rumanishtes duhen kërkuar në mospasjen e një administrate shtetërore vendëse, po edhe në përdorimin e sllavishtes si gjuhë shkrimi.

Rumanishtja e sotme është një gjuhë sintetike—analitike me një sistem lakimi shumë të reduktuar në forma rasore, por me dy trajta (të pashquar dhe të shquar) dhe me një sistem zgjedhimi relativisht të pasur në forma kohore sintetike dhe analitike. Në këtë gjuhë dalin me forma sintetike koha e tashme, e pakryera , e kryera e thjeshtë, si edhe më se e kryera e mënyrës dëftore. Prej mënyrave përveç mënyrës dëftore përdoren edhe mënyrat lidhore, urdhërore dhe e ashtuquajtura mënyrë kushtore (Demiraj ,vepra e cituar f.61).

Kjo gjuhë ka 29 fonema me 7 zanore dhe 22 bashkëtingëllore. Karakteristikë e kësaj gjuhe në sistemin zanor është ekzistimi i dy zanoreve të ngjashme – ë e gjuhës shqipe, njëra (a) prej të cilave është e ngritjes së mesme, ndërsa tjetra (i) e ngritjes së lartë. Zanoret tjera të saj janë a,e,i,o,u. Kjo gjuhë nuk e ka ruajtur kundërvënien zanore të gjata – zanore të shkurtra , që ka pasë karakterizuar latinishten. Gjithashtu dallon shumë në theksimin e fjalëve nga latinishtja. Ndryshe nga latinishtja në gjuhën rumanishte theksi mund të bjerë edhe në rrokjen fundore të fjalëve, po edhe mbi mbaresat (te foljet).

Rumanishtja , përveç që ka ruajtur një fond fjalësh të trashëguara nga latinishtja popullore, në të kanë depërtuar edhe një numër i madh fjalësh nga gjuhë të tjera, si nga gjuhët sllave (kryesisht nga bullgarishtja), turke, greke, hungareze, gjermane dhe romane perëndimore etj.(Për këtë autori thotë se mund të gjeni më tepër te Suhaçev: 1990, 163 v.).

Nga dukuritë ballkanike kryesore të rumanishtes veçohen: 1. Shfaqja e zanores – ë ;2. Njësimi i formave të rasave gjinore e

dhanore ;3. Prapavendosja e nyjes shquese; 4. Formimi i kohës së ardhme me anë të foljes ndihmëse “dua” ; 5. Rimarrja e kundrinave nëpërmjet formave të patheksuara të përemrave vetorë; 6. Mënjanimi i pjesshëm i paskajores nëpërmjet përdorimit të dendur të mënyrës lidhore etj.

Me shqipen rumanishtja ka disa bashkëpërkime të rëndësishme në fushën e gramatikës (lakimi në ballë të fjalës dhe prapavendosja e përcaktorëve të pavetënjafueshëm dhe në fushën e fjalorit).

6. Për gjuhët sllave të Ballkanit thotë se janë serbokroatishtja, bullgarishtja, maqedonishtja dhe sllovenishtja, që të gjitha këto bëjnë pjesë në grupin e gjuhëve sllave jugore. Nga këto gjuhë autori vëren se vetëm bullgarishtja dhe maqedonishtja kanë më shumë tipare ballkanike, andaj mund të quhen edhe gjuhë ballkanike. Për serbokroatishten mendon se ajo paraqitet më pak e ballkanizuar, ndërsa për sllovenishten thotë se nuk ka fare tipare ballkanike. Flet mbi formimin e gjuhëve sllave në gadishullin e Ballkanit aty nga shekulli VI–VII të erës sonë. Evoluimi i këtyre gjuhëve në truallin ballkanik ndikoi ndaj këtyre gjuhëve sa që ato u larguan shumë nga gjuhët sllave të grupit lindor e perëndimor. Gjithashtu ndryshime janë zhvilluar edhe midis vetë gjuhëve sllave ballkanike, bullgarishtes dhe maqedonishtes në njërën anë dhe serbokroatishtes e sllovenishtes në anën tjetër.

7. Në lidhje me gjuhën bullgarishte konstaton se ajo 85% flitet nga popullsia në Republikën e Bullgarisë (rreth 8.000.000 vetë), ndërsa jashta kufijve të Bullgarisë në Greqi ku thotë se ka rreth 20.000 bullgarë (Lopashov, 1990, 10). Thekson përftimin e bullgarishtes nëpërmjet evolucionit të gjuhës së folur sllave të vendosur në pjesën juglindore të Ballkanit pas shekullit VI të erës sonë, ndërsa emrin e ka marrë nga fisi turko-

tatar i bullgarëve, të cilët erdhën e u mbishtresuan mbi popullsinë e pjesës lindore të Ballkanit në vitet tetëdhjetë të shekullit VII të erës sonë. (Ata ishin të organizuar ushtarakisht nën drejtimin e të parit të tyre, Asparuhut, ndërsa St. Mladenov thotë se nga gjuha e bullgarëve të Asparuhut në bullgarishte kanë mbetur vetëm 11 fjalë– Gjuhësi ballkanike f.64– marrë nga Stojanov 1977, 20).

Kur flet për shkrimin e bullgarishtes thekson vëllezërit Cirili dhe Metodi si misionarë bullgarë nga rrethet e Selanikut në Moravi, të cilët në vitin 863 e përkthyen biblën në të folmen e tyre amtare (dialektin sllav të krahinës së Selanikut), i shkruar me alfabetin cirilik, të formuar nga Cirili dhe Metodi mbi bazën e alfabetit grek.

Sa i përket gjendjes së bullgarishtes së sotme, paraqitet si një gjuhë analitike–sintetike, që e ka humbur prej kohësh sistemin e lakimit, ndërsa tek emri ka zhvilluar kundërvënje trajtë e pa-shquar– trajtë e shquar , krijon nyjën e prapme shquese. Kjo gjuhë e ka ruajtur sistemin e zgjedhimit foljor të gjuhëve sllave.

Jep të dhëna mbi alfabetin e saj prej 28 fonemash, 6 zanore (a, e ,i,o,u,ë) dhe 22 bashkëtingëllore. Zanorja – ë është e ngjashme me shqipen dhe rumanishten. Bullgarishtja ka theks të lirë. Si edhe në gjuhët e tjera sllave,fjalja nuk mund të fillojë me fjalë të patheksuar (këtu bën përjashtim maqedonishtja).

Fjalori i bullgarishtes përbëhet kryesisht nga fjalë të burimit sllav. Në të kanë depërtuar shumë fjalë nga turqishtja, greqishtja, rusishtja etj.

Veçon dukuritë ballkanike kryesore të bullgarishtes si: 1. Prania e zanores –ë;2. Prapavendosja e nyjës shquese; 3. Formimi i kohës së ardhme nëpërmjet foljes ndihmëse “dua” ; 4. Rimarrja e kundrinave nëpërmjet formave të patheksuara të pë-

remrave vetorë; 5. Mënjanimi i paskajores nëpërmjet formave të kohës së tashme të prira nga pjesëza – da.

8. Maqedonishtja flitet në Republikën e Maqedonisë (përdor të dhënat statistikore të vitit 1981) , nga 1.910.000 banorësh 67% (ose 1.280.000 vetë) flisnin maqedonisht (Der Fischer Welt Almanach 1990,f.323). Përveç këtij ajo flitet edhe jashta kufijve të Maqedonisë, në Greqi (rreth 150.000 vetë) (Lopa–shov,1990,10), në Shqipëri (rreth 4700 vetë) (Vjetari statistikor ,1990,f.35) etj.

Për maqedonishten thotë se është konsideruar si një dialekt i bullgarishtes. Mirëpo, pas Luftës së Dytë Botërore nga disa dijetarë , sidomos maqedonas, maqedonishtja është trajtuar si gjuhë më vete me variantin e saj dialektor perëndimor (këtu e citon Bllazhe Koneskin, 1967/1,14). Kjo gjuhë karakterizohet nga një sistem prej 31 fonemash , nga të cilat 5 janë zanore (a,e,i,o,u), që ndryshe nga bullgarishtja nuk e ka zanoren – ë, ka një theks të ngulitur rregullisht mbi rrokjen e tretë nga fundi në fjalët shumërrokëshe dhe nuk bie kurrë mbi rrokje fundore(dallon nga bullgarishtja që ka theks të lirë). Në maqedonishte theksi mund të lëvizë vetëm në fjalët shumërrokëshe kur këtyre u shtohet ndonjë formant gramatikor, për të rënë rregullisht mbi rrokjen e tretë nga fundi, si p.sh. make–donci – makedonci–te. Gjuha maqedonase gjithashtu ka krijuar forma analitike të së kryerës të ndërtuara me foljen ndihmëse kam , si p.sh. imam begano “kam ikur”, imav begano, kisha ikur etj. Maqedonishtja, për dallim nga bullgarishtja , ka edhe një sistem prej tri nyjash të prapme, që shërbejnë për të treguar sendin e emërtuar afër ose larg folësit, ose pa mos e përcaktuar pozicionin e tij në raport me folësin , p.sh. çovekov, çovek–ot, çovek–on (= njeri–u afër, larg apo pa dallim

pozicioni), kniga–va, kniga–na, kniga–ta (=libr–i afër, larg apo pa dallim pozicioni).

Kur flet për dukuritë ballkanike gjuhësore kryesore thotë se janë të njëjtat që i kemi në bullgarishte me përjashtim të zanores –ë.

9. Në lidhje me serbokroatishten na jep një pasqyrë se ku flitet ajo si në Republikën e Serbisë, në Republikën e Kroacisë, në Republikën e Bosnjës e Hercegovinës, në Republikën e Malit të Zi dhe sipas statistikave të vitit 1981 në ish Jugosllavi flitej nga 18.310.000 vetë . Mirëpo , me shpërbërjen e Jugosllavisë nga gjuha serbokroatishte u formuan këto gjuhë: serbishtja, kroatishtja, bosnjakishtja dhe gjuha e malit të zi (vërejtja jonë). Serbokroatishtja është një gjuhë sllave jugore e cila u formua nga evoluimi i gjuhës së folur të fiseve sllave të jugut, serbe dhe kroate , që u vendosën në viset perëndimore të gadishullit të Ballkanit në fillim të shekullit VI të erës sonë. Për emrat serb dhe kroat thotë se (deri në shekullin VIII të erës sonë nuk ka të dhëna për këto dy fise sllave , Schaller: 1975, 69) dokumentohen për herë të parë në sllavishten e vjetër kishtare, në trajtat Srëbinë dhe Hrëvate që më vonë me metatezë dalin në Sërb dhe Hërvat.

Gjatë historisë serbët kanë qenë kryesisht nën ndikimin e Perandorisë Bizantine dhe të kishës ortodokse, ndërsa kroatët nën ndikimin e botës romane perëndimore dhe të kishës katolike të Romës. Kroatët përdorin alfabetin latin, ndërsa serbët cirilik. Shkrimet e para serbe i kemi pas shekullit IX. Një hov më të madh mori pas shekullit XII me formimin e shtetit të parë serb nga Stevan Nemanja nga fundi i shekullit XII. Kjo gjuhë shkruhej mbi baza dialektore deri me vënien e bazave themelore të serbishtes letrare nga Vuk Karaxhiqi të një

gjuhe të përbashkët të mbështetur mbi bazën e të folmes së Bosnjës që bën pjesë në dialektin shtokav.

Edhe serbokroatishtja është një gjuhë sintetiko-analitike. Ai vëren se ko gjuhë ka një sistem lakimi dhe një sistem zgjedhimi të pasur, por që edhe në këtë gjuhë format rasore janë zvogëluar. Karakterizohet me një sistem prej 30 fonemash, 5 zanore dhe 25 bashkëtingëllore. Ka një theks të lirë, që në disa raste mund edhe të lëvizë brenda formave flektive të së njëjtës fjalë. Edhe në këtë gjuhë, si në gjuhët tjera sllave, fjalia nuk mund të fillojë me një fjalë të patheksuar.

Në serbokroatishte dukuritë ballkanike janë të kufizuara. Duhet përmendur formimin e kohës së ardhme me anë të foljes ndihmëse “dua” (të zgjedhueshme por të reduktuar) të ndjekur nga paskajorja e foljes themelore – ja çu dati/ da-çu. Në serbokroatishte vërehet pjesërsiht edhe mënjanimi i paskajores.

Përfundim

Në këtë pjesë akademik Shaban Demiraj paraqet një pasqyrë të pozitës gjeografike të Gadishullit të Ballkanit si një urë ndërlidhëse midis Evropës dhe Azisë së Vogël qysh nga kohët e hershme e deri në Mesjetën e vonshme. Thotë se Gadishulli i Ballkanit është bërë arenë e dyndjeve nga popuj të ndryshëm, gjë që ka bërë që nga kohë në kohë të ndryshojë edhe gjendja e tij gjuhësore. Thekson faktin se në ndryshimin e gjendjes gjuhësore të këtij gadishulli një rol të rëndësishëm ka luajtur edhe vetë evolucioni i gjuhëve, që janë folur këtu gjatë periudhave të ndryshme historike. Krejt kjo ka ndikuar që në këtë gadishull sot të fliten një numër jo i vogël gjuhësh të ndryshme duke përfshirë këtu edhe një gjuhë joindoevropiane, turqishten. Kështu ai thotë se kur krahasohet gjendja e sotme gjuhësore në këtë gadishull me atë të periudhës antike,

mandej thekson se bie në sy që përveç greqishtes (së re) dhe gjuhës shqipe, që janë vazhdueset e greqishtes së vjetër , përkatësisht të ilirishtes, gjuhët tjera janë zhvilluar këtu si pasojë e pushtimeve, përkatësisht e dyndjeve të popujve gjatë periudhash të ndryshme historike. Thekson rumanishten si gjuhë që është përftuar nëpërmjet romanizimit të dakëve të vjetër, ndërsa bullgarishtja e maqedonishtja dhe serbokroatishtja e sllovenishtja janë zhvilluar pas dyndjeve të sllavëve pas shekujve VI–VII në Ballkan, kurse turqishtja është shfaqur në këtë trevë pas pushtimeve të Perandorisë Osmane në shekullin XIV–XV.

Akademik Shaban Demiraj me të drejtë konstaton se si pasojë e ndikimeve të ndërsjella midis gjuhëve të Gadishullit Ballkanik , si edhe ndikimeve të kushtëzuara nga fatet e përbashkëta historike të popujve të gadishullit, në këto gjuhë janë përftuar një varg tiparesh të përbashkëta që nuk ndeshen në gjuhë të tjera indoevropiane, ose edhe kur ndeshen në ndonjë gjuhë tjetër , këtu ato janë një zhvillim i brendshëm ballkanik. Si element të përbashkët, veç tjerash, e thekson prapavendosjen e nyjes shquese. Konstaton se tipare të përbashkëta janë zhvilluar në gjuhën shqipe, rumanishte, bullgarishte, maqedonishte dhe greqishte, ndërsa në serbokroatishte, megjithëse edhe kjo është zhvilluar në truallin ballkanik, tiparet e përbashkëta të gjuhëve ballkanike janë më të pakta dhe janë të kufizuara sidomos në viset jugore të saj, ndërsa për sllovenishten konstaton se ajo nuk ka fare tipare të përbashkëta gjuhësore ballkanike.

BARDHOSH GAÇE,

Universiteti “Ismail Qemali” – Vlorë

KONTRIBUTI I PROF. SHABAN DEMIRAJT NË STUDIMIN E LETËRSISË SHQIPE

Dijetari ynë i madh Shaban Demiraj, krahas kontributit të shquar në lëmin e albanologjisë dhe balkanistikës, qysh në fillimet e veta të veprimtarisë shkencore dëshmoi talentin e tij edhe në studimin e letërsisë popullore dhe asaj të kultivuar. Qysh në studimin e parë të tij mbi Jul Varibobën dhe veprën e tij “Gjella e Shën Mërisë së Virgjër” e në botimet më pas, prof. Shaban Demiraj, dëshmon se, vepra e tij diturore herë–herë gërshetohet mes shkencëtarit të gjuhës dhe talentit të studiuesit të letërsisë shqipe.

Kjo prirje e Prof. Shaban Demirajt shfaqet qysh në traskriptimet, përkthimet dhe përshtatjet e mjaft veprave të autorëve të huaj e atyre shqiptarë si te romani **“Martin Iden”** i Xhek Londonit, apo pajisja me shënime e veprave të Naim Frashërit: **“Lulet e Verësë”**, **“Bagëti e Bujqësia”**, dhe Sami Frashërit: **“Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhetë”**. Në fjalorin Enciklopedik Shqiptar 1985, krahas zërave për Gustav Majerin e Holger Pedersenin, studiuesi ynë ka hartuar edhe zërat për Pjetër Bogdanin, Lekë Matrëngën dhe Jul Varibobën. Jeta dhe krijimtaria letrare e Jul Varibobës, e ka tërhequr qysh herët Prof. Shaban Demiraj. Së bashku me një varg studimesh të tjerë mbi Frang Bardhin dhe Fjalorin e tij, Pjetër Bogdanin, Lekë Matrëngën, hulumtohet jo vetëm për vlerat leksikogra-

fike e dialektologjike të krijimtarisë së tij, por edhe për kontributin e tyre në fushën e folklorit e të etnografisë shqiptare.²² Ndriçimin e jetës dhe krijimtarisë letrare, të Jul Varibobës, dijetari e ka bërë në disa këndvështrime, qysh me botimin së pari të studimit **“Disa shënime të krahasuara rreth gjuhës së Jul Varibobës”**, në numrat 1–3 të “Buletinit të Shkencave Shoqërore”, Tiranë 1953, apo studimin tjetër: **“Rreth botimit të parë të vitit 1762 dhe traskriptimit të saj prej V.Librandit”** në **“Buletini i Universitetit të Tiranës”** 1956, nr. 3 (fq. 262–270), duke u mbështetur edhe në mjaft studime të tjera, si ai i Viçens Stratikoit, Maksimilian Lambercit, Mikele Markianoit etj. Me mjaft interes për letërsinë dhe kulturën tonë është edhe përcaktimi i prejardhjes së Varibobëve të ngulur në Mbuzat. Ashtu si Lamberci edhe Demiraj pranojnë se në Mallakastër, buzë Vjosës, ndodhet një katund me emrin Vari-bob, prej nga mendohet se kanë mërguar të parët e Jul Varibobës. Duke i ndjekur nga afër këto hulumtime, gjatë ekspe-ditave etnofolklorike që kemi kryer në vitet 1996, 1998 dhe 2003, në katundin Mbuzat, kemi vënë re mjaft elementë të jetës tradicionale që ofrojnë pika takimi me ato të Mallaka-strës, siç janë: dasmat, vajtimet, urimet dhe elementë të tjera folklorike e etnografike.

Duke gjurmuar jetën dhe veprën letrare të Jul Varibobës, di-jetari ynë, ndriçon natyrshëm edhe mjaft elemente të jetës zakonore e tradicionale të ngulmimit arbëresh të Mbuzatit, të cilat, së bashku edhe me të folmen e tij japin mjaft të dhëna,

²²Disa nga artikujt e Prof. Shaban Demirajt janë: “Frano Bardhi veprimtar i shquar i kulturës shqiptare”, “Kultura Popullore”, nr. 1/1980; “Me rastin e 295 vjetorit të vdekjes së P.Bogdanit”, Gazeta “Z.P” 1984, “Jul Variboba”, “Buletini i Universitetit të Tiranës”, 1958/1; “Dyqindvjetori i veprës letrare artistike shqipe”, “Nëntori” 1962/9, fq. 166–173.

për mërgimin prej Toskërisë në ato brigje. Në përcaktimin e jetës zakonore të Mbuzatit, studjuesi me të drejtë vë në dukje se: *“Dimë gjithashtu, se, arbëreshët e Mbuzatit i kanë ruajtur disa zakone të moçme të sjella nga Shqipëria. Ndër dasmat përshembull,, ushtrojnë vallet shqipe, e nëpër vdekje, rreth të vdekurit gjëmojnë “valtimet”, siç është zakoni edhe në shumë vise të Shqipërisë...”*²³

Prof. Shaban Demirajn në studimet e veta, përherë e ka tërhequr letërsia e rilindjes sonë kombëtare dhe sidomos pikatimkimet e romantizmit shqiptar me atë europian. Krahas artikullit “Jeronim De Rada – poet e patriot i shquar”, dijetari ynë është ndalur gjatë edhe në studimin e hulumtimitin e veprës së Gavril Dara i Riu “Kënga e Sprasme e Balës”, të cilën e ka pajisur me shënime dhe botuar disa herë. Me stilin e tij konciz e sintetik, për nevojat e shkollës sonë, ai zbërtheu subjektin e poemës, frymën e saj romantike, personazhet dhe tërë kontekstin romantik të saj.

Në studimin e kësaj vepre madhore të romantizmit arbëresh, autori nxit edhe studiuesit e tjerë se, vlerat e mëdha të poemës “Kënga e sprasme e Balës”, duhen këndvështruar edhe në rolin e veçantë që ka luajtur poezia popullore arbëreshe në të cilën është ngjizur frymëzimi i poetëve romantikë për të thurur veprat e tyre. Me të drejtë prof. Shaban Demiraj pohon: *“Ajo që e shquan si artist të madh është se ai (Gavril Dara i Riu–B.G), duke u mbështetur në poezinë popullore, ka ditur të marrë prej saj, jo thjesht formën e jashtme të saj, por të futet thellë në të e të njohë zemrën e madhe të popullit, të cilën na i zbulon pastaj me mjeshtëri të rrallë, me mendimet, ndjenjat dhe veprat e heronjve të tij...”*

²³ Prof. Shaban Demiraj: “Gjuha shqipe – probleme dhe disa figura të shquara të saj”, Tiranë 2003, fq. 183.

Ashtu si Jul Varibobës dhe veprës së tij “Gjella e Shën Mërisë së Virgjër”, edhe poemës “Kënga e Sprasme e Balës” të Darës, studjuesi ynë erudit u kthehet disa herë në studimet e veta. Në artikullin “*Rreth poemës “Kënga e sprasme e Balës”*” të botuar në gazetën “Drita”, 24 nëntor 1985, talenti i poetit Dara zbërthehet jo vetëm në pikatakimet e vargut të tij me frymëzimin popullor, por edhe në një aspekt tjetër të rëndësishëm, në shkrirjen dhe ndërthurjen e elementëve historikë e atyre legjendarë, i cili ne artin e vet e talentin e tij ringjall në sytë e lexuesve Motin e Madh të Skënderbeut me gjënimet e tij nëpër Europë.

Krahas transkriptimit të poemës “Kënga e Sprasme e Balës” të Gavril Dara I Riu në gjuhën e sotme shqipe (1961) dhe parathënies së saj, prof. Sh.Demiraj I thellon më tej studimet e veta për ta ndriçuar edhe më mirë talentin e këtij shkrimtari të shquar arbëresh, me artikuj të tjerë si: **“Rreth autorësisë së poemës “Kënga e sprasme e Balës”, botuar në “Studime Filologjike”²⁴**; në të cilën, nëpërmjet gjurmimeve të reja, sjell mjaft të dhëna e argumenta mbi autorësinë e kësaj poeme, si dhe mjaft dorëshkrime të panjohura të Gavril Darës (I Riu), të pabotuara deri në kohët tona, siç është edhe poema me titull “Ana Maria”, një princeshë shqiptare e pafat në Shqipërinë e viteve 1460–1485. Nga mjaft studime, dihet tashmë, se disa poetë arbëreshë, midis tyre edhe Gavril Dara i Riu, nën shembullin e romantizmit evropian, kujtimet e tyre i paraqitin si frymëzime të bardëve popullorë të kohës. Ky model krijimtari i përhapur në Europë nga ndikimi i fuqishëm i poetit skocez Makferson (1736–1796) me poemën e vetë “*Këngët e Osianit*”, “*si poezi të lashta të mbledhur në malë-*

²⁴ Sh.Demiraj: “Rreth autorësisë së poemës “Kënga e sprasme e Balës” në “Studime Filologjike”, nr. 3–4 Tiranë 1983, fq. 63–74.

sitë e Skocisë”, bëri që edhe Gavril Dara i Riu, poemën e vet ta vinte në gojën e bordit popullor *Balë*, vargjet e para të së cilës kishin humbur nëpër mjegullat e kohës.

Në një këndvështrim të ri, në studimin e vet hulumtues, prof. Sh.Demiraj bën përpjekje që të ndriçojë këtë pyetje, nëse krijuesi i vërtetë i poemës “Kënga e sprasme e Balës” ka qenë apo jo vetë Gavril Dara i Riu nëpërmjet analizës së gjuhës së tij. Nëpërmjet vështrimit krahasues me këngët e poemës, Parathënien dhe Pashënien, shënimet plotësuese, sipas tij kjo vepër “*fund e krye është shkruar nga një dorë...*”

Mbi të gjitha, në krijimtarinë e këtij poeti arbëresh, një ndikim të fuqishëm ka poezia popullore arbëreshe, sidomos në gjuhën dhe stilin e Darës, traditë kjo e mbartur thellë edhe nga vatra familjare e tij në katundet arbëreshe të Siçilië. Gjuha e përdorur prej tij në poemë paraqitet me disa tipare arkaike, të disa të folmeve arbëreshe. Kështu, fjalori i pasur i poetit në tërë krijimtarinë e tij dëshmon qartë, se Dara, jo vetëm e ka njohur mirë gjuhën amtare, por ka krijuar edhe fjalë të reja, të cilat e kanë pasuruar gjuhën shqipe.

Në mendimin kritik dhe letrar të dijetarit tonë, një vend të veçantë zë edhe jeta dhe vepra letrare e Naim Frashërit, Gjergj Fishtës, Fan Nolit, Ali Asllanit e poetëve të tjerë. Në artikujt mbi poetin Naim Frashëri: “Naimi – pishtar i madh”, “Naimi – pishtar i pashuar”, apo atë me titull: “Motivi patriotik në veprën e Naim Frashërit”, krahas aspekteve të pasurisë artistike, Shaban Demiraj e këndvështron këtë poet edhe si misionar e apostull të kombit të vet, për të ndriçuar rrugën e kulturës e të qytetërimit të shqiptarëve. Me të drejtë shkencëtari ynë nënvizon, se, shtysa kryesore e vetmohimit të Naimit për të hartuar veprën e vet, ishte “*dashuria e pakufishme e tij për Shqipërinë dhe shqiptarët*”. Krijimtarinë e pasur

e të larmishme të këtij poeti, ai e vështron të lidhur ngushtë me veprimtarinë e tij të gjerë në shërbim të çështjes shqiptare. Duke analizuar motivin patriotik në veprën letrare të Naim Frashërit, studiuesi vë në dukje edhe *optimizmin e madh të poetit për të ardhmen e Shqipërisë*. Këtë optimizëm poeti e shihte në përparimin dhe mbrothësinë e shqiptarëve, në bashkimin dhe sakrificat e tyre, për ta parë atdheun e tyre “zonjë” mes vendeve të tjera shoqe të Europës.

Akademik Shaban Demiraj, duke thelluar më tej mendimin e tij gjuhësor e letrar, poetin e madh Gjergj Fishta e këndvështron edhe në një aspekt tjetër, atë të ndihmesës së tij në shkrimin dhe lëvrimin e gjuhës shqipe.²⁵

Duke admiruar artin poetik të *Gjergj Fishtës*, sidomos kryeveprën e tij “Lahuta e Malcisë”, si dhe artikujt estetikë në revistën “Albania” të Faik Konicës, Demiraj i vë në dukje se, Gjergj Fishta, si përfaqësues i shoqërisë “Bashkimi” dhe Ndre Mjeda, si përfaqësues i shoqërisë “Agimi”, luajtën një rol të madh në Kongresin e Manastirit 1908. Aq më shumë Gjergj Fishta, si kryetar i Komisionit të Alfabetit në këtë Kongres,, që me të drejtë prof. Demiraj, këtë alfabet e quan “vepër të Gjergj Fishtës”, poetit e gjuhtarit erudit.

Për raportet e shkrimtarit dhe poetit me gjuhën shqipe, në studimet e tij Prof. Demiraj ndalet edhe te një figurë tjetër madhore e letërsisë shqipe, Fan S.Noli, “*Këtij mjeshtri të talentuar veprash origjinale në prozë e poezi, si dhe përkthimesh gjer më sot të paarrtshme...*”²⁶

²⁵Shaban Demiraj: “Ndihmesa e Gjergj Fishtës për shkrimin dhe lëvrimin e gjuhës shqipe”, në Revista “Gjuha jonë”, nr. 3–4, Tiranë 1991.

²⁶ Prof. Shaban Demiraj “Gjuha shqipe – probleme dhe disa figura të shquara të saj”, Tiranë 2003, fq. 293.

Te Noli, Prof. Demiraj, shikon “*Përpunuesin më të shquar të shqipes letrare*”, andaj në ngurimin e tij qortues, kërkon që, autorë të tillë të letërsisë shqipe, siç është fenomeni Noli, duhet të studjohen edhe në përpjekjet e tyre të mëdha, si dhe pasurinë që i kanë sjellë gjuhës shqipe. Sipas tij, veprat origjinale të Fan S. Nolit, por edhe përkthimet e tij, dëshmojnë një punë mjeshtërore të këtij shkrimtari për gjuhën amtare. Sidoqoftë, mendimi dhe merakut i Demirajt, se Noli ka qenë një mjeshtër i rrallë në përdorimin e mjeteve të larmishme stilistike, kërkon që kjo anë e gjuhës së tij të meritonte edhe studime të posaçme, siç mund të veprohet edhe me autorë të tjerë si Kuteli, Xoxa e Marko.²⁷

Në studimet e akademikut Shaban Demiraj, një vëmendje të veçantë të tërheqin edhe një varg artikujsh e punimesh në ndërrim të mjaft dijetarëve të shquar si: Koptar, Hahn, Bopp, Miklosich, Meyer, Weigand, Sandfeld, Selishqev, Mihaesku, Salta. Krahës këtyre, mjaft me interes janë edhe studimet e monografi-të për prof. Aleksandër Xhuvanin e Prof. Eqerem Çabej.

Monografia e Prof. Shaban Demirajt “Eqerem Çabej”, është një nga veprat e vyera, shkruan me mirënjohje të thellë e adhurim për Kurorën e Albanologjisë shqiptare, dijetarin Eqerem Çabej. E ndërtuar si monografi, në këtë vepër, ringjallet jeta e vepra e një dijetari të madh, i cili iu përkushtua shken-cës shqiptare me vetmohimin e tij deri në harrimin e vetvetes. Në të tetë kapitujt dhe shtesën e saj, kjo vepër monografike, pasqyron ndihmesën e Prof. Çabejt, në zbërthimin e problemeve kyçe të historisë së gjuhës shqipe, marrëdhëniet e saj me gjuhët e vjetra të Ballkanit, nën dritën e të cilave jepet edhe prejardhja dhe formimi i popullit shqiptar. Në faqet e kësaj

²⁷ Sh. Demiraj: “Fan S.Noli dhe gjuha e tij”, “Studime Filologjike”, 1982/1, fq. 87–91.

monografie, me të drejtë vihet në dukje se, Prof. Çabej, duke shfrytëzuar arritjet e albanologjisë, prejardhjen ilire të shqipes e ngriti në një teori të plotë, duke u mbështetur fuqishëm jo vetëm në lëmin e gjuhësisë, por edhe në argumentat që për-cjellin arkeologjia, historia, folklori, etnografia e fusha të tjera të jetës njerëzore.

Duke nxjerrë në dritë kontributin e jashtëzakonshëm të Prof. Eqrem Çabej në studimin e shqipes, monografia pasqyron edhe mjaft arritje të këtij dijetari, sidomos në fushën e studimeve etimologjike, si dhe në atë të fonetikës e të gramatikës historike.¹ Në këtë drejtim, kontributi i Çabejt është mjaft i çmuar, shkencëtari skrupuloz, duke qëmtuar nëpër dialektet e shqipes, në tekstet e autorëve të vjetër, zbulon mjaft fjalë të fondit të shqipes, duke paraqitur dhe etimologjinë e tyre. Krahas studimit dhe botimit të veprës monumentale “Mesha-ri”, i Gjon Buzukut, një vend të veçantë zë edhe përkushtimi i këtij shkencëtari me çështje të gjuhës së sotme, me drejtë-shkrimin, formimin e fjalëve dhe kulturën e gjuhës.

Libri “Eqrem Çabej” i Prof. Shaban Demirajt, nxjerr në dritë në mënyrë monografike jetën dhe veprimtarinë e këtij shkencëtari të madh, personalitetin e tij njerëzor dhe shkencor që po ndiqet nga të tjerë breza shkencëtarësh. Me mjaft interes janë edhe vlerësimet e personalitetit të Eqerem Çabejt prej studiuesve të tillë të njohur si: Pedersen, Jokli, Kreçmer, Lamberci, Devotoja, Georgievi etj.²⁸

Nga një lexim i shpejtë i disa studimeve, artikujve e kumtesave të Prof. Shaban Demiraj, kuptohet vetvetiu se krahas kontributit të vyer si gjuhëtar, ai shfaqet edhe si një njohës i thellë i kulturës popullore shqiptare. Në studimet “*Elemente gjuhë-*

²⁸ Shaban Demiraj: “Eqrem Çabej”, monografi, Tiranë 1990.

sore arkaike në këngët e kreshnikëve”²⁹ apo “*Dy fjalë për gjuhën dhe stilin e Selim Hasanit*”³⁰, shprehet qartë pikëpamja e tij se gjuhësia dhe folklori janë dy fusha shkencore në të cilat rezultatet e njëres dije i shërbejnë edhe tjetrës.

Sipas Demirajt, në eposin e kreshnikëve, të bien në sy fakte dhe dukuri gjuhësore, të cilat dëshmojnë faza të ndryshme “*të evolucionit të shqipes*”, sidomos të folmeve në të cilat kanë bërë jetën folklorike. Kjo pasuri letrare e artistike, duke u përcjellë nëpër shekuj nga njëri brez në tjetrin, ka mbartur edhe ndryshimet që kanë pësuar të folmet veriore të shqipes. Rapsodët dhe bardët popullorë, nëpër rrjedhat e shekujve të fundit, edhe pse janë përpjekur të ruajnë në vetvete frymën dhe motivet kryesore të këngëve të kreshnikëve, si njerëz të talentuar të këtij arti popullor, me aftësinë e tyre krijuese, u kanë ngjizur vargjeve edhe mbishtresime, në përputhje me “*kërkesat*” gjuhësore të kohës. Në këtë frymëzim artistik popullor, Demiraj heton edhe “*disa elemente arkaike*”, në fjalor dhe strukturën gramatikore të tyre, të cilat shprehin e ruajnë “*elemente gjuhësore të një faze më të vjetër të shqipes*”. Mëdis tyre, mjaft fjalë të Ciklit të Kreshnikëve përkrijnë edhe me ato të përdorura, prej autorëve të vjetër të letërsisë shqipe si: Budi, Bardhi e Bogdani. Pikërisht, prania e këtyre elementeve arkaike të gjuhës shqipe në eposin e kreshnikëve të shtyn në mendimin se këto këngë kanë një jetë të gjatë folklorike, “*duhet të kenë një zanafillë relativisht të hershme parashkri-
more...*”

²⁹ Shaban Demiraj: “Elemente gjuhësore arkaike në këngët e Kreshnikëve”, “Kultura Popullore”, 1983/2, fq. 59–63.

³⁰ Shaban Demiraj: “Dy fjalë për gjuhën dhe stilin e Selim Hasanit” në “Kënga popullore e Selim Hasanit”, Tiranë 1987, fq. 312.

Edhe në artikullin “*Dy fjalë për gjuhën dhe stilin e Selim Hasanit*”, një nga raspođet e famshëm të këngës polifonike të Labërisë, Prof. Demiraj bën përpjekje të argumentojë se, bardët dhe poetët e shquar popullorë krahas talentit të spikatur artistik shquhen edhe “*si njohës e lëvrues të mirë të gjuhës amtare...*” Në vargjet poetike të këtyre rapsodëve si Selim Hasani, si dhe në thesarin e çmuar të folklorit tonë, studiuesit mund të gjejnë një pasuri të madhe fjalësh të rralla e shprehje popullore, të cilat përcjellin në krijimtarinë poetike të tyre edhe “*një varg fjalësh e trajtash fonetike e gramatikore që paraqesin një inters të madh, jo vetëm për leksikologun e dialektologun, por edhe për historianin e gjuhës shqipe...*”³¹

Disa herë në studimet e tij prof. Demiraj përqendrohet në kontributin e poetëve e shkrimtarëve në pasurimin e gjuhës shqipe. Në studimin e tij: “*Roli i shkrimtarëve për zhvillimin e shqipes letrare në të kaluarën dhe sot*”³², duke u mbështetur edhe në përvojën e gjuhëve të tjera të Europës, edhe gjuha shqipe dëshmon se, gjuha letrare apo gjuha e standardizuar “*është fryt i punës së disa brezave lëvruesish të saj*”.

Krahas rolit të gjuhëtarëve që janë marrë me kualifikimin e normave të shqipes së sotme letrare, sipas tij, një rol të rëndësishëm kanë luajtur edhe njerëzit e shkolluar, si dhe shkrimtarët e poetët, si: Kristoforidhi, Naimi, Samiu, Konica, Fishta, Mjeda, Noli, Poradeci, Kuteli, etj. Për zgjedhjen e dialektit bazë të gjuhës së përbashkët, studiuesit e gjetën atë pothuajse të gatshme, ashtu siç e kishte përgatitur esteti e shkrimtari Faik Konica. Duke vënë në dukje rolin e Konicës në përpunimin e

³¹ B. Gaçe: “Kënga popullore e Selim Hasanit”, Tiranë 1987, fq. 313.

³² Sh.Demiraj: “Roli i shkrimtarëve për zhvillimin e shqipes letrare në të kaluarën dhe sot”, në “Letërsia shqipe dhe gjuha letrare”, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, Prishtinë 1998, fq. 25–28.

gjuhës letrare shqipe, Demiraj argumenton se ai u mbështet gjerësisht në traditën e krijuar nga shkrimtarët e mëparshëm, nga Kristoforidhi dhe rilindasit e tjerë.

Në kushtet e sotme të zhvillimit të shoqërisë shqiptare, prof. Demiraj këmbëngul me të drejtë, se ërsosja e mëtejshme e shqipes sonë letrare kërkon përpjekje nga të gjithë njerëzit e penës, jo vetëm me fjalë e shprehje të bukura të të folmeve popullore të veriut e të Jugut, *“por edhe me fjalë të reja të krijuara sipas gjedheve të fjalëformimit të gjuhës shqipe”*, e gjithashtu edhe për të mënjanuar përdorimin e fjalëve e shprehjeve të huaja të panevojshme.

Edhe në këtë aspekt të studimeve shkencore të akademik Shaban Demirajt, dëshmohet se, historiani i gjuhës shqipe, e ka të nevojshme që për nevoja të hulumtimit të tij, të studimeve të tij gjuhësore, të njoh thellë edhe folklorin e letërsinë e kultivuar, duke i këndvështuar e krahasuar ato me kulturën letrare të popujve të Ballkanit, siç bën dietari ynë.

MYRVETE DRESHAJ–BALIU & BEGZAD BALIU,

Fakulteti i Edukimit – Prishtinë

PROFESOR SHABAN DEMIRAJ: ÇËSHTJE TË METODËS

Rezyme: *Kumtesa jonë do të trajtojë karakterin metodologjik të hulumtimit dhe studimit të Profesor Shaban Demirajt. Objektiviteti i saj do të jenë një varg çështjesh të këtij karakteri, nga fillimet, në veprimtarinë kërimore–shkencore të Profesor Shaban Demirajt, si: çështjet e kritereve të hartimit të veprës së tij, të metodave studimore, të raporteve të ndërthurura historike dhe të reflektimit të tyre në studimet e përgjithshme albanologjike. Do të bëhet një prerje e modeleve të tij duke filluar me përshkrimet deskriptive të gjuhës së arbëreshëve të Italisë, për të vazhduar me sistemet gramatikore të shqipes dhe të gjuhëve ballkanike, për të përfunduar me kërkimet linguistike të fazës së fundit në fushë të historisë së gjuhës shqipe.*

Fjalët kyçe: *Shaban Demiraj, gjuhësia shqiptare, metodologjia e studimit, përshkrimi, ndërtimi i sistemit, evolimi, vlerësimi*
Dy dekadat e fundit është diskutuar shumë, sado më shumë në shtypin ditor, se sa në atë shkencor për shkollat gjuhësore që e kanë ndikuar gjuhësinë shqiptare. Në të vërtetë, duke diskutuar për ndikimin e shkollës socrealiste kryesisht në letërsinë shqipe, janë përjashtuar a mënjанuar disa faktorë të tjerë të rëndësishëm në dijen albanologjike, sikur janë: trashëgimia individuale shkollore e studiuesve shqiptarë (Aleksandër Xhuvani, Eqrem Çabej, Selman Riza, Mahir Domi, Idriz Ajeti, Remzi Parnaska etj.); formimi i tyre rinor dhe përkushtimi i mëpastajmë (Androkli Kostallari, Jorgji Gjinarë); si

dhe i ashtuquajturi “prodhim i brendshëm” i shkollës shqiptare (Shaban Demiraj, Emil Lafe, Seit Mansaku, Ethem Lika, Gjovalin Shkurtaj, Tomor Osmani, Kolec Topalli, David Luka etj).

Albanologjia e gjysmës së dytë të shekullit XX u karakterizua me disa veçori të rëndësishme edhe për arritjet dhe fatet e saj në kontekstin historik, organizues dhe metodologjik të studimit. E para, me shkuarjen nga kjo botë të një lagjeje indoevropianistësh e ballkanologësh, bartës të dijes gjuhësore edhe në fushë të albanistikës, si: Holger Pedersen, Norbert Jokl, Gustav Vaigandi, Maksimilian Lamberg etj.; e dyta, me institucionalizimin e saj në Tiranë dhe në Prishtinë mbi bazat e një brezi studiuesish shqiptarë të formuar në shkolla të ndryshme europiane dhe me ndikim, pavarësisht ndërhyrjeve ekstrapolitike, dhe e treta, me formimin e një brezi të ri pedagogësh e studiuesish brenda institucioneve të reja arsimore e shkencore të botës shqiptare, emrat e të cilëve u shquan më lartë.

Brezi i albanologëve të kësaj periudhe do të nxjerrë krye në rrethana të rëndësishme të zhvillimeve politike, arsimore, shkencore dhe kulturore të viteve '50, kur u përjashtuan përfaqësuesit më të rëndësishëm të shkollës së strukturalizmit: Sosyr, Jakobson, Trubeckoi, për shkak të “koncepteve borjeze”³³, dhe u zëvendësuan me përfaqësues ideologjikë të

³³ Në lidhje me këtë temë publicistika gjuhësore shqiptare zakonisht i referohet Sesionit të parë të Institutit të shkencave të vitit 1952 kushtuar veprës së Stalinit mbi gjuhësinë dhe problemet gjuhësore shqiptare në dritën e veprave të tij. Në këtë rast, po i referohemi mendimit të njëres prej studiueseve sovjetike, e cila më tej do të ketë ndikim të dukshëm në studimet shqiptare, dy artikujt e të cilës për fonologjinë dhe për gjuhësinë krahasimtare paraqesin traktate politike tipike të kohës. Në artikullin e vitit 1949, të përkthyer për nevoja të brendshme veç tjerash thuhet: “Strukturalizmi është nga korrentet (rrymat, vj.) më reaksionare në

shkollës ruse të kohës³⁴. Në vitet '60 kur u institucionalizua teoria e prejardhjes së popullit shqiptar dhe e gjuhës shqipe me metodën e gjuhësisë krahasuese, por jashtë përpjekjeve të kornizave staliniste të diktuar nga qarqet akademike dhe politike e ideologjike të kohës³⁵, duke i dhënë kështu fund kthimit të metodave folklorike e mitike³⁶; si dhe në vitet '70 kur u realizuan disa nga projektet nacionale, me ndihmën edhe të një brezi të rinjsh, si: Shaban Demiraj, Idriz Ajeti, Emil Lafe, Jup Kastrati, që në të vërtetë ishin brez i formuar në dy dekadat e fundit në Shqipëri dhe në Kosovë. Ky brez

linguistikën e sotme borgjeze. Kjo teori beliciste formaliste është drejtuar krejtësisht kundër marksizmit në shkencën e gjuhës (...)" (Desnickaja: 1949, 1 drsh.); Sistemi teorik dhe organizativ i strukturalizmit në linguistikë lidhet pazgjidhmërisht me emrat e njerëzve, që i kanë rënë mohit atdheut të tyre me emrat e shkencëtarëve – kozmopolitë borgjezë Roman Jakobson dhe Princ Trubeckoi" (Desnickaja: 1949, 1 dsh.); Konceptsjoni i strukturalizmit mbështetet në teorinë idealiste dhe antihistorike të De Susurit mbi gjuhën si sistem i pavarur shenjash(...)" (Desnickaja: 1949, 1 dsh.)

³⁴ Shih gjithashtu, vlerësimet e Desnickajes në artikullin e viteve 1952, të përkthyer për nevoja të brendshme: "Studimi historik i thellë i ligjeve të zhvillimit të gjuhës, i specifikës së saj, që formojnë sistemin gramatikor dhe fondin kryesor të fjalëve të trashëguara qysh në kohët e lashta, – kjo është rruga e zhvillimit të shkencës linguistike marksiste" (Desnickaja: 1952, 5 drsh.); "Në vargun e problemeve që sot tërheqin vëmendjen e linguistëve sovjetikë, një vend të math zë çështja e metodës historike krahasonjëse në studimet linguistike" (Desnickaja: 1952, 1 drsh.); "Në veprën e tij gjeniale "Marksizmi dhe çështjet e gjuhësisë" J. V. Stalini ka vënë në dukje gjithashtu rëndësinë pozitive që ka metoda historike krahasonjëse". (Desnickaja: 1952, 2 drsh.)

³⁵ Shih, Stalin, 1979 (513–551) = Stalin, Josip V. "Marksizmi dhe çështjet gjuhësore", në *Vepra të zgjedhura*, Tiranë.

³⁶ Shih reagimet për recensimin e veprës së Spiro Kondos nga Selman Riza, Eqrem Çabej etj., (Baliu: 2010, 2015)

do të dallohet për përpjekjet e tyre që të krijojnë metodën kombëtare të kërkimeve (Shqipëri)³⁷ dhe përvetësimin e me–todave bashkëkohore evropiane (Kosovë)³⁸.

Në këtë rrjedhë të zhvillimeve albanologjike nën ndikimin e shkollave gjermane, frenge, ruse, italiane etj., është formuar edhe personaliteti shkencor dhe intelektual i Profesor Shaban Demirajt. Bibliografia e botimeve të tij, si dhe prirjet konceptuale, metodologjike dhe shkencore na e mundësojnë të

³⁷ Shih, veç tjerash, diskutimet e Profesor Çabejt në fund të viteve '60 dhe fillim të viteve '70: "Objekti lind shpeshherë edhe metodën, prandaj edhe gjuhësia historike shqiptare në disa fusha problemesh mund të arrijë të ndërtojë një metodë kërkimore vetjake" (Çabej:1977, 288); "Në hetimin e tyre gjuhësia shqiptare nuk i quan monopol të vetin fushat kërkimore të kësaj disipline; në garë fisnike me përfaqësuesit e shkollave linguistike të vendeve të ndryshme ajo njeh dobinë e një bashkëpunimi të frytshëm në këtë degë të dijes. Si çdo disiplinë shkencore që gjendet në fillimet e saj, gjuhësia shqiptare ka edhe ajo të metat e veta, sidomos në punë të metodës, po ndërkaq ajo bën përpjekje – dhe duhet të bëjë edhe më shumë – për t'u çliruar nga modelet e huaja. Në përsosjen e metodave qëndron përparimi i vërtetë i shkencës. Gjuhësia jonë duhet më shumë se gjër më sot – jo të niset nga jashtë e të hyjë brenda, jo duke ia përshtatur studimit të shqipes disa parime e kritere të fituara me lexime në fushat e gjuhëve të tjera, duke veshur me lëndë shqiptare disa rregulla të marra së andejmi; po duhet të niset nga të dhënat konkrete të shqipes e nëpërmjet tyre të mbërrijë në konstatime që të kenë vlerë" (Çabej: 1976, 234).

³⁸ Shih para se gjithash veprat e këtij brezi në Prishtinë: Shefki Sejdiu nga semiologjia te kognitivistika, Besim Bokshi nga strukturalizimi te distribucionalizimi, Ruzhdi Ushaku nga filologu te linguisti, Rexhep Ismajli nga semiologu te strukturalisti, si dhe përkthimet e kësaj kohe në gjuhën shqipe dhe serbokroate, të cilat patën ndikim të drejtpërdrejtë në qasjes metodologjike të tyre: Martinet, 1974; Dekarti, 1975; De Saussure, 1977; Fuko, 1971; Hjelmslev, 1980; Derrida, 1973; Ducrot–Todorov, 1984, Barthes, 1987 etj.

vëmë në pah paradigmën kronologjike–historike të punës së tij, si dhe modelet shkencore të gjedhes së tij.

Në rastin e parë arrijmë të përshkallëzojmë arritjet përkatësisht fazat e ngritjes blumiane të personalitetit të tij dhe zhvillimet historiko–kulturore të kohës, ndërsa në rastin e dytë arrijmë të bëjmë tipologjinë e sintezave të tij. Në të vërtetë, në rastin e parë nxjerrin krye përmasat jo vetëm arsimore, kulturore, shkencore e politike të kohës, por edhe prirjet individuale apo trashëgimia shkencore dhe brenda tyre metodologjike e formimit të tyre të hershëm, dhe të atyre në formim. Në rrethana të një organizimi dhe funksionimi sistematik të institucioneve të asokohshme shqiptare, për Profesor Shaban Demirajn nuk ishte i lehtë as formimi shkencor as zgjedhja e metodës së punës shkencore. Megjithëse zyrtarisht në shkollën shqiptare instalohen konceptet e shkollës moskovite për gjuhësinë, në Tiranë diktojnë konceptet e tyre Aleksandër Xhuvani me filologjinë klasike evropiane, Eqrem Çabej me gjuhësinë krahasuese historiko–gjuhësore gjermane, Selam Riza me kryqëzimin e pashembullt të filozofisë dhe filologjisë perëndimore, Mahir Domi me shkollën franceze, Jup Kastrati me shkollën italiane, Androkli Kostallari me metodologjinë bashkëkohore të shkollës moskovite, etj. Përveç me metodologjinë e kërkimit shkencor, bashkëkohësit e tij do të shquhen edhe me individualizimin e fushave gjuhësore të studimit: Xhuvani në fushë të leksikologjisë historike, Domi në fushë të sintaksës, Çabej në fushë të historisë së gjuhës dhe etimologjisë, Riza në fushë të gramatologjisë, Kastrati në fushë të historisë së albanologjisë dhe të gramatologjisë, Kostallari në fushë të leksikografisë, teorisë së gjuhës dhe standardologjisë etj.

Në këtë rrjedhë fillon dhe realizohet edhe formimi arsimor e shkencor i Profesor Shaban Demirajt, i cili duke qenë më–

simdhënës dhe studiues njëkohësisht, ai zgjedh gramatikën si dije për nxënie dhe të njëjtën e realizon si arritje e vazhdueshme shkencore. Në rastin e parë ajo realizohet si dije doktrinare, prandaj edhe me metodën sinkronike, për nevoja të nxënies së saj nga brezi i ri, ndërsa në rastin e dytë ajo realizohet si dije historiko-gjuhësore, prandaj me metodën diakronike, madje sikur shprehej vetë ai me metodën sintetike brenda diakronisë. Te “rrafshet sinkronike, (Demiraj: 1985: 28), Profesor Demiraj shihte dy parimet themelore: (Demiraj: 1985, 27), e para, theksonte ai: “Dukuritë e veçanta duhen vështruar në lidhjet e tyre të shumanshme jo vetëm brenda strukturës gramatikore, por edhe brenda sistemit gjuhësor të shqipes në tërësi. Prandaj dukuritë morfologjike dhe sintaksore duhen parë jo vetëm në lidhjet e tyre të ngushta e të ndërsjella brenda strukturës gramatikore si tërësi, por edhe në lidhjet dhe kushtëzimet me dukuritë e nënsistemeve të tjera të gjuhës shqipe. (Demiraj: 1985, 29); ndërsa e dyta: këto lidhje dhe kushtëzime të shumanshme të dukurive morfologjike dhe sintaksore duhen vështruar në evolucionin e tyre të vazhdueshëm. Këto dy parime themelore duhen zbatuar me rreptësinë e duhur shkencore si në krahasimin historik të brendshëm, ashtu edhe në krahasimin historik të jashtëm. (Demiraj: 1985, 29)

Këtu përvijohet edhe modeli i gjedhes së tij mes bashkëkohësish, disa prej elementeve të së cilës këtu vetëm po i theksojmë në mënyrë të përgjithësuar:

- me sintezat e para studimore për struktura të caktuara gramatikore (shih *Habitorja*), ai çliron modelin e kërkimit nga filozofia dhe polemika e pafundme e modelit të Rizës;
- me gramatologjinë e tij, përkatësisht *Gramatikën historike të shqipes* realizoi sintezën e madhe shkencore dhe e çliroi atë nga modeli deskriptivist i Profesor Jup Kastratit. Për më tej,

ai realizoi projektin më të madh në fushë të gramatologjisë në studimet shqiptare, që nga Boppi e deri në shekullin XX, një projekt, i cili vështirë të mundë të përsëritet edhe në shekullin XXI, pavarësisht veprës mjaft gjithëpërfshirëse të Profesor Kolec Topallit;

- me *Fonologjinë historike të shqipes* Demiraj realizoi veprën historiko-gjuhësore që nuk po realizohej për më shumë se shtatë dekada, që nga Pedersenit e deri te Çabej, për të mos thënë, ai solli analizën dhe sintezën e fonologjisë shqipe, në të cilën pavarësisht arritjeve që kishte, ato ose mbeteshin në nivel të kapitujve kryesorë, si *Guturalet* e Pedersenit, ose realizoheshin në përmasa përgjithësuese për nevojat universitare, si *Fonetika historike e shqipes*, e Profesor Çabejt;

- me monografinë *Gjuha shqipe dhe historia e saj* ai bëri sintezën dhe analizën e madhe, si dhe zgjodhi metodën analitike dhe sintetike për ta çliruar *historinë e gjuhës shqipe* nga metodat pozitiviste dhe zhvillimet e jashtme të gjuhës shqipe, sado sinteza të tilla bazë ishin bërë përpjekje të shfaqeshin fillimisht te vepra e Çabejt (shih, Çabej: 1976/1977, I–VI) dhe të pak studiues të më pastajmë (Ajeti: =1994; Ajeti, 1997/2002, I–V etj.). Në këtë sintezë të madhe për dijen albanologjike ai shihte tri probleme themelore, përkatësisht tri tema të mëdha: a) prejardhjen e shqiptarëve; b) vendbanimin ballkanik të stërgjyshërve të tyre; c) emërtimin e tyre gjatë shekujve; (Demiraj: 1999, 36), ndërsa për shkak të mungesës së dokumenteve për periudhat më të hershme ai preferonte të ndiqte metodën që tashmë e kishte parathënë paraardhësi i tij Profesor Çabej, pra “të ndjek zakonisht rrugën e ngritjes shkallë–shkallë nga e njohura në të panjohurën (Demiraj: 1999, 36), dhe të cilën sikur do ta shohim më tej do ta paoj edhe pasardhësi i tij Profesor Kolec Topalli: “Të gjitha këto

rrethana bëjnë që studimi i historisë së gjuhës, dhe në veçanti i strukturës së saj gramatikore, të marrë si pikënisje gjuhën e sotme, duke u nisur nga faza e saj e dokumentuar, dhe, duke u ngjitur shkallë–shkallë në fazat e saj më të hershme, të lidhet me gjuhën indoeuropiane,” (Topalli: 2011, 107)

Sigurisht, edhe nuk është e rastit pse kjo vepër (pra, **Gjuha shqipe dhe prejardhja e saj**) konsiderohet një prurje deri më sot unike në historinë e albanologjisë. (Demiraj: 1988, 3) E veçanta e saj përcaktohet pikërisht në perspektivat e ndryshme të hulumtimit të tij diakronik, përkatësisht në mënyrën se si përthithen e ngjizen në një masë të përbashkët rezultatet e arritura prej saj. E kjo është “Shqipja një gjuhë sa indoeuropiane aq edhe ballkanike, pa cenuar aspak edhe mëvetësinë e saj si gjuhë e gjallë bashkëkohore”. (Demiraj: 2013, 3), për të shkruar më tej me konstatimin se ajo, pra shqipja, është pa-sqyrë e jetës shpirtërore e materiale e kësaj bashkësie nën ndikimet që vinin e vijnë prej Lindjes dhe Perëndimit. (Demiraj: 2013, 3) dhe për të përfunduar me konstatimin lapidar, por aspak romantik për rrethanat historike dhe gjendjen e sotme: për “shqipen dhe hapësirën kompakte shqipfolëse si pikë e Arkimedit”. (Demiraj: 2013, 3). I theksuam këta tre faktorë, jo për t’u përfshirë në diskutimet mbi përmasën Lindore dhe Perëndimore të qytetërimit shqiptar, as për të sforcuar tezën e homogjenitetit të shqipes historike, por për të reflektuar një dimension krejt të tretë: diskutimet mbi metodat shkencore të qasjes në *Historinë e Kosovës* dhe madje në *Historinë kombëtare*, si faktorë komplementar me zhvillimet e njëkohshme, që viteve të fundit sillen si metoda bashkëkohore nga disa studiues të huaj, ndërkohë që Profesor Demiraj këto koncepte i ka faktorizuar si modele kërkimi shkencor në katër dekadat e fundit në disa monografi gjuhësore të tij.

Kushti i parë i përcaktimit të objektit të gramatikës historike të shqipes (Demiraj:1985, 28), shkruante Profesor Demiraj, është, që ajo duhet të synojë të hedhë dritë edhe mbi evolucionin e strukturës së saj gramatikore në periudhën parashkriimore. (Demiraj: 1985, 28) Madje, synimi i fundit duhet të jetë që ajo ta gjurmojë këtë evolucion qysh nga koha e formimit të kësaj gjuhe. Me fjalë të tjera, duhen bërë përpjekje për të ndriçuar tërë historinë e evolucionit të strukturës gramatikore të shqipes, si edhe për të depërtuar sadopak edhe në parahistorinë e saj, (Demiraj: 1985, 28) E, ky synim mund të arrihet vetëm (...) duke u mbështetur në disa parime dhe metoda rreptësisht shkencore. (Demiraj: 1985, 28) Për më tej, këto arritje, Profesor Demiraj i mbështeste në burimet e brendshme: ato të shkrimtarëve të vjetër arbëreshë, të folmet e ndryshme të shqipes, të folmet e arbëreshëve të Greqisë, të Italisë, çamërishtes, labërishtes etj. (Demiraj: 1985, 28) dhe në burimet e jashtme: dukuritë e ngjashme gramatikore që ndeshen edhe në gjuhë të tjera me të cilat shqipja (përkatësisht <nëna> e saj) ka pasur kontakte të gjata historike, siç janë greqishtja, latinishtja. (Demiraj:1985, 28)

Në këtë rrjedhë profesor Demiraj, ashtu si edhe bashkëkohësit e tij, i jepte përparësi metodës së studimit të shkollës gjuhësore-historike me metodën krahasimtare. “Duke qenë se evolucionin e strukturës gramatikore të shqipes (ashtu si edhe të çdo gjuhë tjetër) është i kushtëzuar kryesisht nga veprimi i faktorëve brenda-gjuhësorë, – shkruante Demiraj, – është e natyrshme që në studimin diakronik të dukurive gramatikore si metodë themelore të zbatohet krahasimi historik i brendshëm, kurse krahasimi historik i jashtëm do të shërbejë vetëm si një mjet ndihmës në ato raste kur merren në shqyrtim dukuri që ndeshen edhe në gjuhë të tjera, sidomos ballkanike,

ose që janë shpjeguar nga disa studiues si ndikime nga gjuhë të tjera”. (Demiraj: 1985, 30)

Një vend më vete dhe arritje të veçanta në fushë të albanologjisë në studimet e Profesor Demirajt paraqesin studimet e tij për marrëdhëniet ndërmjet shqipes dhe rumanishtes, të cilat në të vërtetë janë hapi i parë i tij drejt ballkanologjisë. Njohës i mirë i këtyre gjuhëve Profesor Demiraj arriti të caktojë në mënyrë të qëndrueshme disa nga fenomenet dhe dukuritë që ndërlidhin strukturat fonetike dhe morfologjike e sintaksore të shqipes dhe të rumanishtes. Fjala është për studimet “Rreth ndërtimit të gjinisë së emrave në shumës në shqipe vështruar edhe në përqasje me rumanishten”, “Rreth *nyjave të përparme* të shqipes, vështruar edhe në përqasje me rumanishten” etj.

Në këtë rrjedhë Profesor Demiraj ka botuar edhe disa studime të një karakteri më të haptë në fushë të ballkanistikës, të cilat nuk shihen vetëm në kontekst të marrëdhënieve gjuhësore shqiptare dhe rumune, po edhe në kontekst të gjuhëve të tjera të Ballkanit. Njohësi i spikatur i morfologjisë historike të shqipes, Profesor Demiraj, shumë herë strukturën gjuhësore (kryesisht morfologjike) e ka parë edhe në dritën e marrëdhënieve të saj me gjuhët e tjera të Ballkanit. Fjala është për studimet: “A ka ndikime të huaja në strukturën morfologjike të shqipes?”, “Vendi (topika) i trajtave të patheksuara të përemrave vetorë në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të tjera”, “Rreth rimarrjes së kundrinave në gjuhët ballkanike”, “Vendi i formave të patheksuara të përemrave vetorë në shqipe dhe në disa gjuhë të tjera”, “Rreth së kryerës posesive në shqipe dhe në gjuhë të tjera”, “Rreth rimarrjes së kundrinave në shqipe dhe në gjuhë të tjera” etj.

Një kërkim më vete në studimet e Profesor Demirajt në fushë të ballkanologjisë, paraqesin temat me karakter gjuhësor e

historik njëkohësisht. Në studimet albanistike dhe ballkanistike të studiuesve shqiptarë, Profesor Demiraj bashkon në mënyrë sintetike konceptet teorike dhe metodat gjuhësore që para tij kishin shënuar bardët e ballkanistikës: Eqrem Çabej dhe Idriz Ajeti. Kërkimeve të tij ai nuk u dha as vetëm karakter thjesht historik, as vetëm karakter thjesht gjuhësor për fenomene të caktuara gjuhësore apo historike. Si asnjëri prej gjuhëtarëve tanë, ai e vuri mendimin e tij gjuhësor në interes të historisë dhe periudhën historike në interes të veçorive gjuhësore të kohës, për të sjellë më në fund edhe rezultatet e synuara. Studimet: “Shqipja në marrëdhëniet e saj me gjuhët fqinje në lashtësi dhe në mesjetë”, “Rreth marrëdhënieve të shqipes me gjuhët e tjera”, “Rreth disa problemeve të studimeve ballkanologjike”, “Rreth tipareve të përbashkëta të gjuhëve ballkanike” etj., dëshmojnë më së miri anën metodologjike të trajtimit të marrëdhënieve gjuhësore ballkanike në dritën e historisë, si hapësirë dhe në dritën e zhvillimit të tyre si struktura fqinjësore. Një arritje më vete dhe më të hapët për karakterin historik dhe etnik të Ballkanit paraqet studimi “Romanizimi në Europën Juglindore – kohëzgjatja, përmasat dhe pasojat”, në të cilin janë diskutuar disa çështje me rëndësi historike: përbërja etnike e Ballkanit në prag të pushtimeve romake, gjurmë të popujve të ndryshëm indoeuropianë në Ballkan, të ardhur gjatë shekujve të mëparshëm, pushtimi romak i Ballkanit, romanizimi i Dalmacisë dhe i Dakisë, arumunët dhe etnosi i tyre, mosromanizimi i grekëve dhe i shqiptarëve, pasojat e sundimit romak në Ballkan etj. Po këtu janë diskutuar edhe mendimet e shumë studiuesve për këto çështje, si: vlerësimet e Thunmanit, Hampit, apo edhe çështjet e natyrës gjuhësore sikur janë: huazimet e vjetra latine të shqipes, gjurmët e sundimit romak në gjuhën greke, hua-

zimet nga greqishtja e vjetër si dëshmi e autoktonisë së shqip-tarëve etj.

Në kërkim të veçorive gjuhësore dhe ndonjëherë edhe historike të gjuhës shqipe, si dhe përqasjes së saj me gjuhët e Ballkanit veç e veç, Profesor Shaban Demiraj arriti që të bëjë edhe një rrënjë prej sintezave të veçanta. Disa vjet para se të botojë monografinë e tij për gjuhësinë ballkanike, ai botoi një studim të gjerë dhe sintetizues njëkohësisht “Shqipja gjuhë ballkanike”, të cilin e kishte menduar edhe si kapitull më vete në një rrënjë prej veprave më të rëndësishme të tij “Gjuha shqipe dhe historia e saj”.

Kështu me studimet e gramatikës krahasuese njëherë të shqipes e të rumanishtes e pastaj të gjuhëve të tjera, Demirajt i shkoi përdore të realizonte një rrënjë prej veprave, të cilën më në fund nuk arritën ta realizojnë as paraardhësit as bashkëkohësit e tij: “Gjuhësia ballkanike”, një sintezë kjo emblematike e dijes shqiptare në këtë fushë dhe madje jo vetëm të saj³⁹.

Ndërsa, me dy veprat e fundit Profesor Demiraj arriti të kalonte kërkimet e tij nga hulumtimet gjuhësore, në të vërtetë brendagjuhësore, në kërkime linguistike, brenda të cilave pavarësisht metodës, nuk arrin asnjëherë të çlirohet prej sintezave përvijuese gjuhësore. Dhe është mirë që nuk çlirohet prej tyre, sepse duke ruajtur, respektivisht duke analizuar sistemin gramatikor të gjuhës shqipe ai ka ruajtur njëkohësisht edhe rrjedhën e evolucionit të saj prej përmbysjeve pozitiviste a thyerjeve mitike të zhvillimit kronologjik-historik të shqipes. Kontributi i Profesor Shaban Demirajt në fushë të gjuhësisë shqiptare është i veçantë dhe tashmë i vlerësuar edhe nga a-

³⁹ Kemi parasysh këtu një rrënjë prej veprave më të popullarizuara të kësaj natyre në hapësirën ballkanike *Balkan i balkanologjia: uvod u studije Jugoistočne Evrope* (2013), të autorit Predrag Mutavdžiq.

spekti i qasjes së tij në metodologjinë e kërkimit shkencor, si një trashëgimi e rëndësishme e albanologjisë së gjysmës së dytë të shekullit XX. Në gjuhësinë shqiptare, sigurisht vendin më të merituar zë për sintezat e mëdha të tij në fushë të morfologjisë dhe fonologjisë historike, si dhe në fushë të historisë së gjuhës shqipe, të vendit të formimit të saj e të prejardhjes së popullit shqiptar.

Në sintezat e tij për morfologjinë, fonologjinë dhe historinë e gjuhës shqipe jo rrallë janë përfshirë edhe veçori krahasuese të gramatikës së shqipes me gjuhët e tjera të Ballkanit, prandaj nuk është e rastit që kërkimet e tij t'i kulmojë edhe me një vepër, në të cilën gjuha shqipe, sigurisht më parë dhe më shumë se gjuhët e tjera do të trajtohen në kuadër të marrëdhënieve të tyre historike të arealit ballkanik dhe brenda zhvillimit të strukturave gjuhësore të familjes së gjuhëve ballkanike.

Vepra e tij “Gjuhësi ballkanike” ka përmbushur një zbrazëti të mjaft të madhe në gjuhësinë shqiptare, ndërsa këtu të gjitha dukuritë gjuhësore në gjuhësinë ballkanike janë shtruar me një akribi të rrallë shkencore, siç di t'i shtrojë metodologjikisht vetëm Profesor Demiraj, hap pas hapi: në fillim historia e dukurisë, pastaj gjendja e deritashme e studimit të kësaj dukurie, më pas analiza vetjake krahas kritikës dhe në fund rrumbullakimi i sintezës, ku në tërë këtë gjuha shqipe dhe dukuritë e saj zënë vendin kryesor. Në këtë vepër të Profesor Demirajt edhe njëherë dëshmohet mendimi, që më parë i pranuar se: “ballkanistika pa shqipen del gati e pamundshme” (Ismajli: 1996, 37–39).

Le të thuhet më në fund se veprat e periudhës së fundit “Gramatikë historike e gjuhës shqipe”, “Gjuha shqipe dhe historia e saj”, “Gjuhësi ballkanike”, “Fonologjia historike e gjuhës shqipe”, “Prejardhja e shqiptarëve në dritën e dëshmi-

ve të gjuhës shqipe”, “Epiri, pellazgët, etruskët dhe shqiptarët”, përbëjnë boshtin e një monografie të re aq të dëshirueshme në studimet shqiptare *Hyrye në indoeuropianistikë*, pjesa shqipe e së cilës në parim është formësuar në “Studimet etimologjike” të Çabejt, (1976: I, II) të veprat e Bardhyl Demirajt (1997a; 1997b) etj.⁴⁰

Në *Historinë e gjuhësisë* (Robins: 1997; Eko: 2008, 262–284), albanologët më të shquar shqiptarë të gjysmës së dytë të shekullit XX, më parë dhe më lehtë se sa në këtë kapitull (249–291), mund të vendosen në kapitullin që trajton gjuhësinë e shekullit XIX (292–342). Nga aspekti metodologjik dhe teorik në kuptimin klasik të fjalës në këtë kapitull, si për metodat ashtu edhe për realizimet do të mundë të vendosnim edhe Profesor Demirajn, një rilindas dhe një konceptualizues në kuptimin e plotë të fjalës (Herder: 2012, 5–155; Sapir: 2012, 157–2013; Fuko: 1971, 325–339).

Literatura

Ajeti: 1994 = Ajeti, Idriz. *Shqiptarët dhe gjuha e tyre*, Prishtinë.

Ajeti: 1997/2002 = Ajeti, Idriz. *Vepra*, I–V, Prishtinë.

Baliu: 2000 = Baliu, Begzad. *Gustav Majer dhe albanologjia*, Prishtinë.

Baliu: 2010 = Baliu, Begzad. *Kërkime albanologjike – sprovë për një histori të albanologjisë*, Prishtinë

⁴⁰ Mbështetur në arritjet e gjertanishme të dijes ballkanike, vepra e Profesor Shaban Demirajt nuk do të mbetet prapa botimeve të kësaj natyre në rajon. (Shih, veprat e studiuesve Kapović: 2008; Mutavgjiq: 2013; Stanishiq: 2006 etj.)

- Baliu: 2010 = Baliu, Begzad. *Referenca albanologjike* – sprovë për një histori të albanologjisë, Prishtinë
- Baliu: 2015 = Baliu, Begzad. *Hulumtime albanologjike* – sprovë për një histori të albanologjisë, Prishtinë.
- Çabej: 1976/77, Çabej, Eqrem. *Studime gjuhësore*, I–VI, Prishtinë
- De Saussure: 1977= De Saussure, Ferdinand. *Kurs i gjuhësisë së përgjithshme*, Prishtinë
- Demiraj: 1970 = Demiraj, Shaban. *Historia e gjuhës së shkruar shqipe*, Tiranë.
- Demiraj: 1972 = Demiraj, Shaban. *Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe*, Tiranë.
- Demiraj: 1973/76 = Demiraj, Shaban. *Morfologjia historike e gjuhës shqipe* I–II, Tiranë.
- Demiraj: 1975 = Demiraj, Shaban. *Sistemi i lakimit në gjuhën shqipe*, Tiranë.
- Demiraj: 1976 = Demiraj, Shaban. *Gramatika e gjuhës shqipe* (morfologjia – bashkautor dhe redaktor, Tiranë.
- Demiraj: 1986 = Demiraj, Shaban. *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë.
- Demiraj: 1988 = Demiraj, Shaban. *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë.
- Demiraj: 1990 = Demiraj, Shaban. *Eqrem Çabej – Një jetë kushtuar shkencës*, Tiranë.
- Demiraj: 1994 = Demiraj, Shaban. *Gjuhësi ballkanike*, Tiranë.
- Demiraj: 1996 = Demiraj, Shaban. *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë.
- Demiraj: 1997b = Demiraj, Bardhyl. *Albanische Etymologien. Untersuchungen zum Albanischen Erbwortschatz*, in der Serie "Leiden Studies in Indo-European", Bd 7, Editions Rodopi, Amsterdam – Atlanta.

Demiraj: 1997a = Demiraj, Bardhyl. *Sistemi i numërimit të gjuhës shqipe. Vështrim diakronik*, Verlag der Akademie der Wissenschaften Albaniens, Tirana.

Demiraj: 1999 = Demiraj, Shaban. *Prejardhja e shqiptarëve në dritën e dëshmnive të gjuhës shqipe*, Tiranë.

Demiraj: 2003 = Demiraj, Shaban. *Gjuha shqipe – Probleme dhe disa figura të shquara të saj*, Tiranë.

Demiraj: 2008 = Demiraj, Shaban. *Epiri, pellazgët, etruskët dhe shqiptarët*, Tiranë.

Desnickaja: 1949 = Desnickaja, Agnia V. *Kundër formalizmit në gjuhësi*. Botuar në “Izvestia” Akademiji Nauk SSSR, v. VIII, fash. 4. Cituar nga përkthimi shqip në dorëshkrim, në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë, Tiranë.

Desnickaja: 1951 = Desnickaja, Agnia V. *Metoda historike krahasuese dhe studimi i historisë së gjuhës*. “Buletini i Akademisë së Shkencave të BRSS – Seksioni i Letërsisë dhe i Gjuhës, Vëll. X, fashikulli 4. Përkthimi anonim në gjuhën shqipe, në dosjen E/16–2, nr. Inv. 424, Arkivi i Institutit të Gjuhësisë, Tiranë.

Eco: 2008 = Eco, Umberto. *Në kërkim të gjuhës së përkryer në kulturën europiane*, Tiranë

Fuko: 1971 = Fuko, Mishel. *Rijeci i stvari*, Beograd.

Herder: 2012 = Herder, Johan Gotfrid. *Rasprava o poreklu jezika*, Novi Sad.

Hjelmslev: 1980 = Hjelmslev, Louis. *Prolegomena teoriji jezika*, Zagreb.

Ismajli: 1996 (37–39) = Ismajli, Rexhep. *Ballkanistika, prejardhja e shqipes, hipotezat e Hampit*, “Ora”, Prishtinë.

Jashari–Bello: 2007 = Jashari, Ali & Dhimitri Bello. *Antologji për gjuhësinë e përgjithshme dhe filozofinë e gjuhës*, Korçë.

- Kapović: 2008 = Kapović, Mate. *Uvod u indoeurop-sku. lingvistiku. Pregled jezika i poredbeno fonologija*, Zagreb.
- Lyons: 2001 = Lyons, John. *Hyrtje në gjuhësinë teorike*, Tiranë.
- Mutavgjiq: 2013 = Mutavgjiq, Predrag. *Balkan i balkanologija: uvod u studije Jugoistočne Evrope*, Beograd
- Robins: 2007 = Robins H., Robert. *Historia e gjuhësisë*, Tiranë
- Sapir: 2012 = Sapir, Edvard. *Herderova rasprava o poreklu jezika*, Novi Sad.
- Schmitt – Frantz: 2012 = Schmitt, Oliver Jens – Frantz, Eva Ane. *Historia e shqiptarëve – Gjendja dhe perspektiva*, Tiranë.
- Stalin, 1979 (513–551) = Stalin, Josip V. “Marksizmi dhe çështjet gjuhësore”, në *Vepra të zgjedhura*, Tiranë.
- Stanishiq: 2006 = Stanishiq, Vanja. *Uvod u ondoeuropsku filologiju*, Beograd.
- Topalli, 2011 = Topalli, Kolec. *Fonetika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë

KUJTIM KAPLLANI,

Tiranë

NDERIMI I PROF.SHABAN DEMIRAJT PËR ALBANOLOGËT

Demiraj është klasiku i fundit, siç do t'i quante prof. I. Ajeti themeluesit e gjuhësisë moderne shqiptare. A. xhuvani, A. Hadri, A. Kostallari, E. Çabej, M. Domi, Sh. Demiraj etj. tashmë bëjnë pjesë në panteonin e perëndive antike – renditur e përzier me yjet! Krijimtaria e prof. Demirajt përbën një libër të gjerë tryeze. Unë kam pasur nderin të shkruaja një faqe të tërë të së përditshmes “*Shekulli*” më një janar 2000, me rastin e 80-vjetorit të lindjes. Akademia e Shkencave e Austrisë i ka botuar veprën “*Histori e gjuhës shqipe*” (**Histo-
rische Grammatik der albanischen Sprache**) më 1993. Për këtë studiuesi kroat Kadiçiç – anëtar i Akademisë së Austrisë – i shkruante prof. Shabanit (që e kishte përgatitur vetë botimin në gjermanisht): “*Akademiku Zolta dhe unë jemi të mendi-
mit se ky botim do të ishte i denjë për çdo akademi*”.

Tashmë do të ecij në drejtim të kundërt: i bindur se të gjithë do të flasin për arritjet e profesorit, unë nuk do të flas për to; por për vlerësimin e tij për të tjerët. Kështu ai ka dëshmuar jo vetëm shpirtgjërësinë, etikën e shkencëtarit; por edhe respektin për bashkëkombasit – duke ua bërë të qartë dhe sa më të kuptueshme krijimtarinë e tyre. Duke i përmbledhur tri në një, do të mundohem shkurt të përmend vlerësimin e tij për shkencëtarët E. Çabej, F. Mikloshiç dhe G. R. Solta. Ai i kushtoi pengun e nderit dijetarit E. Çabej me një përmbledhje dinjitoze (1990), njëherazi plotësoi etjen e bashkëkombaseve,

sidomos të lexuesve të zakonshëm; të cilët nuk mund ta kup-tonin dot atë. Vepra e Çabejt, vëren I. Kadare, ndonëse ka të bëjë me gjërat themelore të kombit shqiptar, është e paarritshme lehtë për lexuesit e gjerë. Ajo ka nevojë për një ndërmjetës të denjë që të arrijë tërësisht te lexuesi. “Libri për Çabejn, – nënvizon I. Kadare në parathënie, – i shkruar me dije, qartësi dhe fiksionikëri nga prof. Sh. Demiraj, e kryen më së mirë këtë rol. Ky libër është një akt kulturor dhe moral i admirueshëm”.

Idenë për të shkruar këtë libër, siç shprehej prof. Demiraj, ia kishte shtirë në mendje publicisti Arshin Xhezo. “Më vonë, – shtonte profesori, – kur mësova se ai kishte biseduar me I. Kadarenë për t’i bërë parathënie; u mrekullova”. Kadareja e kishte njohur më parë Çabejn nga bisedat me L. Poradecin, më pas ka mësuar të tjera për Lasgushin nga të thënat e prof. Çabejt. Në veprën “*E. Çabej*” redaktori A. Xhezo arriti të bashkonte një shkencëtar me një poet, që e shikojnë realitetin, siç thekson Kadareja për dyshen Çabej– Poradeci, “... nga dy optika të ndryshme: nga truri i kthjellët dhe i thellë i dijetarit dhe nga truri madhërisht i mjegulluar i poetit”.

Në këtë botim me karakter popullor prof. Demiraj thekson arritjet e rëndësishme të Çabejt në fushën e studimeve etimologjike. Nderon studimet e shkëlqyera të G. Majerit, të N. Joklit dhe vëren se me punë të palodhur shkencëtari ynë arriti ta pasuronte pasqyrën e fjalëve themelore indoeuropiane të shqipes. Çabej mundi t’i argumentonte si të burimit vendas disa etimologji që Majeri i trajtonte si huazime dhe një pjesë të mirë të atyre që kishin mbetur pa përgjigje, i argumentoi të burimit ilir. Duke trajtuar përmbajtjen e librit, vëren se në dy vëllimet e para përfshihen frytet e një pune të palodhur 40-vjeçare për *etimologjinë e shqipes*; në vëllimin II përfshihen *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe, Parashtesat dhe prapashte*–

sat dhe *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe*; në vëllimin IV përfshihet gjithë ç'u shkrua nga Çabej për *historinë e brendshme e të jashtme të gjuhës sonë*; vëllimi V përfshin vëzhgimet e studimet e Çabejt për *Buzukun dhe gjuhën e tij* dhe i gjashti përmbledh shkrimet e tij për *folklorin, letërsinë; biseda për gjuhën shqipe, vlerësime për A. Xhuvanın, M. Lambercin, N. Joklin, A. Leotin*; si edhe diskutime rreth kumtesave të kolegëve në kongrese e bashkë tubime të tjera për probleme të gjuhësisë ballkanike, të albanologjisë dhe të onomastikës. Nën vizohet se vepra e Çabejt është e paarritshme për nga formimin shkencor, për thellësinë e mendimit, për këmbënguljen dhe për arritjet e një pune më se gjysmëshekullore.

Gjuhëtari i shquar me origjinë sllovene, Frantisek Mikloshiči, është themeluesi i filologjisë sllave moderne. Ai ka dhënë ndihmesa të shquara edhe në filologjinë romane, në ballkanologji dhe në albanologji. Për ndihmesat në fushën e albanologjisë prof. Demiraj (S. F. 1991, n.1) përmend studimet *Albanische Forschungen* (Gjurmime shqiptare), ku trajtohen *Elementet sllave të shqipes me një Hyrje; II Elementet romane në shqipe; III Forma e foljeve të huazuara në shqipe dhe në disa gjuhë të tjera*. Probleme lidhur me shqipen ai ka botuar edhe në *Elementet sllave në rumanishte, Mbi ndikimin e turqishtes në gramatikën e gjuhëve të Europës Juglindore* etj. Në studimin e tij për elementet romane të shqipes, pasi paraqit 920 fjalë me burim latin dhe italian, bën disa vërejtje interesante për fonologjinë e elementeve romane të shqipes. Edhe në studimin e tretë, kushtuar formës së foljeve të huazuara të shqipes dhe të disa gjuhëve të tjera; ai ka parashtruar disa vlerësime për formën e huazimeve, në përgjithësi. Demiraj thekson se ai është ndër të parët gjuhëtarë që i kushtohet studimit të thelluar të disa çështjeve të rëndësishme të zhvillimit

mit historik të sistemit gjuhësor të shqipes. Për këtë përmend përpjekjet për të shpjeguar zhvillimin e sistemit fonologjik të shqipes në fjalët e saj të trashëguara e të huazuara nga gjuhët sllave dhe latine e italiane. Ai ka vënë në dukje se gjatë zhvillimit historik zaoret e patheksuara të shqipes janë dobësuar shkallëshkallshëm: në fillim janë rrudhur në *ë* dhe më pas në *mjaft* raste (sidomos në fillim të fjalës) kanë rënë fare. Nja dy shembuj: lat.: *altare* > *ëltër* > *ltër*, *amicus* > *ëmik* > *mik*, *ca-ballus* > *këval* > *kal*; *inganare* > *ëngënjej* > *gënjej* etj.

Gjithashtu, ka vërejtur se kjo zanore e “braktis” vendin e saj burimor pas bashkëtingëlloreve *r*, *l* dhe del para tyre, si: *christianus* > *kërshten*, *placere* > *pëlqej* etj. Ai ka vërejtur se në fillim dhe në mes të disa fjalëve shfaqet një *n*, si: *consolare* > *ngushëlloj*, *cicala* > *gjinkallë* etj. Bashkëtingëlloret e pazëshme *t*, *p*, *k* pas *n*-, *m*- janë zëshmuar, si: *contra* > *kundër*, *parentem* > *prind*, *mancare* > *mëngo* etj. *O* e theksuar e ndjekur nga *-n* fundore ka dhënë *ua* në toskërisht dhe *ue* në gegërishte, si: *cydon-iium* > *ftua*–*ftue*, *dracon-ein* > *dragua*–*drague* etj.

Ka mundur të shpjegojë sak zhvillimin historik të *mjaft* fjalëve, si ato ku një bashkëtingëllore a një rrokje ndërzanore ka rënë, si: *fides* > *fede* > *fe*, *padulem* > *pyll* etj. Në fushën e gramatikës historike vëren se shqipja foljet nga sllavishtja i ka huazuar në trajtën e paskajores më *-iti*, si: serb. *globiti* > shq. *gjobit*, *grabiti* > *grabit* etj. Nga greqishtja i ka huazuar në formën e aoristit sigmatik më *-s*, si: *ἀναχτόγω* > *nakátos*, *Υρεμνίξω* > *gremis* etj. Me të drejtë mendon se foljet e trashëguara nga turqishtja kanë depërtuar në trajtën e së kryerës së thjeshtë duke iu shtuar *-is* e së kryerës së thjeshtë të greqishtes, si: *brakt-is* < *brakmaq* > aor. *braktym*, *bezd-is* < *bezmek*, < aor. *bezdin* etj.

Sipas prof. Demirajt Mikloshiçi ka dhënë dy mendime me interes: 1) emrat e huazuar nga latinishtja kanë depërtuar në trajtën e kallëzores njëjës, si: *leon-em* > *luā* ~ *luan-i*, *sanitat-em* > *shëndet* etj. 2) Për morfemat eptimore *i* dhe *-u* në e-mërore njëjës thotë se janë të ngjashme me ato të së kryerës së thjeshtë: *erdh-i*, *prek-u*.

Mikloshiçi ka paraqitur një listë huazimesh: 316 të burimit sllav, 920 roman; duke paraqitur edhe një listë prapashtesash që kanë depërtuar në shqipe nëpërmjet sllavishtes dhe gjuhëve romane. Ai u ka kushtuar vëmendje të posaçme edhe dukuri-ve të përbashkëta të gjuhëve ballkanike dhe elementit të vjetër të përbashkët të shqipes dhe të rumanishtes.

Në rrjedhën e studimeve gjithnjë e më shumë është përvijuar mendimi se në qendër të marrëdhënieve gjuhësore ndërballkanike qëndron shqipja (ilirishtja), jo greqishtja. Ky nuk është përfundim kryesisht i studiuesve shqiptarë, por më shumë i studiuesve më të zellshëm të gjuhësisë botërore. Prof. Demiraj përmend akademikun Georg Renatus Solta, autor i “*EINFÜHRUNG IN DIE BALKANLINGUISTIK MIT BESONDERER BERÜCKSICHTIGUNG DES SUBSTRATS UND DES BALKANLATEINS*”, Darmstadt, 1980, X (Hyrje në gjuhësinë ballkanike me një vështrim të posaçëm të substratit dhe të latinishtes ballkanike. Wissenschaftliche Buchgesellschaft)⁴¹. Solta pranon emërtimin *gjuhësi ballkanike*, duke pasur parasysh afërsinë tipologjike, e cila në rastin e gjuhëve të Ballkanit e ka burimin

⁴¹) *Albanische walachische und bulgarische Sprache*, “*Jahrbücher der Literatur*”, 46, Band. Wien, 1829.

²) *Linguistique balkanique. Problèmes et résultats*, Paris, 1930; botuar më parë danisht më 1926, “*Balkanphilologien*”.

³) *Studime filologjike*, Tiranë, 1988, 1, f. 203–207.

te *fqinjësia gjuhësore—gjeografike*. Në kreun e dytë, vëren prof. Demiraj, autori shqyrton *fjalët e substratit të rumanishtes dhe lidhjen e tyre me shqipen*. Nga gjuhët e vjetra të Ballkanit, ndër të tjera, shqyrton *trakishten dhe ilirishten, ilirishten, peonishten, dardanishten*; përmend dhe të ashtuquajturën *pellazgjishte*. Vëmendje të veçantë u ka kushtuar fjalëve të moçme të rumanishtes që nuk janë prej burimi grek, latin, sllav e turk; të cilat përgjithësisht, kanë gjegjëset e tyre në gjuhën shqipe. Parashtron edhe pikëpamjet e gjuhëtarëve të ndryshëm, pra edhe të Çabejt, për burimin e tyre në rumanishte dhe në shqipe. Përmend se disa prej këtyre fjalëve *mund të burojnë prej një substrati paraindoeuropian*.

Vëmendje të veçantë u ka kushtuar fjalëve të moçme të rumanishtes që nuk janë prej burimi grek, latin, sllav e turk; të cilat përgjithësisht, kanë gjegjëset e tyre në gjuhën shqipe. Për këto çështje ka mbajtur qëndrim objektiv, duke u qëndruar besnik mendimeve të shkencëtarëve G. Hanit, G. Majerit, H. Hirtit, N. Jokli, G. Vajgandi, H. Bariçi, E. Çabej, V. Georgievi etj. I përmbahet mendimit se *vendbanimet e sotme të shqiptarëve i përkasin një hapësire të vjetër të ngulimit të tyre, të paktën që nga antikiteti klasik*. Përkrah edhe mendimin e gjuhëtarit rumun Mihăescu, sipas të cilit *stërgjyshërit e shqiptarëve dikur banonin në treva më të gjera se ato të sotmet*. Në paragrafin për *ballkanizmat në sistemin fonetik* autori ndalet në çështjen e zanores ë në shqipe, rumanishte dhe bullgarishte; si edhe në shfaqjen e rotacizmit në shqipe (toskërishte) dhe në rumanishte. Trajton shkurt edhe formimin e numërëve 11–19 në shqipe, rumanishte dhe në gjuhët sllave të Ballkanit, si edhe rimarrjen e kundrinave nëpërmjet formave të patheksuara, të folurit enumerativ, parapëlqimin për parataksën; rrudhjen e paskajores etj.

Këto dukuri, vëren autori, nuk kufizohen aspak në gjuhët ballkanike, por në to dëshmohen nëpërmjet shembujsh tipikë. Në përfundim, vëren se që nga fundi i antikitetit greqishtja ka ardhur duke u ballkanizuar gjithnjë e më shumë. Gjuha vendimtare e Ballkaneve duhet të jetë pikërisht shqipja, pranë së cilës mund të vendosen rumanishtja dhe bullgarishtja.

HYSEN MATOSHI,

Instituti Albanologjik – Prishtinë

SHABAN DEMIRAJ – LETRAR

Dy ndër figurat më të shquara të gjuhësisë shqiptare të shekullit XX, personalitete me të cilat u identifikua krijimi i kapaciteteve tona kombëtare për studimin e gjuhës shqipe, Eqrem Çabej dhe Shaban Demiraj, fillimet e tyre i bënë fushën e letërsisë. I pari si studiues dhe i dyti si autor i krijimeve letrare. Nëse për Çabejn dihej më shumë, në rend të parë, për faktin se kontributet e tij studimore në fushën e historisë së letërsisë, kritikës letrare dhe studimeve krahasimtare i kishte botuar me kohë, për sprovat autoriale letrare të Akad. Shaban Demirajt pakkush do të dinte deri në kohët e vonshme. Njohtja e këtij dimensionit të veprimtarisë së tij kulturore u përjetua si një ngjarje, si një rikthim në fillet e rrugës së tij të begatë intelektuale e shkencore përgjatë disa dekadave, gjatë së cilës morfologu i madh i gjuhësisë shqiptare, me arritjet e paçmueshme në fushën e albanologjisë, e kishte eklipsuar këtë pjesë kontributesh.

Kjo kumesë bazohet në tri krijime letrare të Shaban Demirajt, të cilat besoj të mos të vetmet e autorit tonë. Pohimet se në arkivin e tij ruhen më shumë krijime letrare të periudhës së rinisë dhe niveli i tyre artistik, si dëshmi e një pjekurie shprehëse letrare, e mbështesin këtë hipotezë, por edhe dëshirë tonën, për më shumë shkrime autoriale edhe në këtë fushë. Kuptohet nuk presim që kjo veprimtari ta zhvendosë vëmendjen nga kontributi i tij parësor, sepse Shaban Demiraj, megjithatë, do të mbetet njëri ndër klasikët e gjuhësisë shqiptare, asociacioni i parë i emrit të tij.

Gjithsesi botimi i trashëgimisë letrare të Shaban Demirajt, përtej rëndësisë që ka për njohjen komplete të punës së tij disadekadëshe shkencore, kulturore e autoriale, është me interes edhe për procesin letrar shqiptar, i cili në periudhën e botimit të këtyre fakteve letrare nuk shquhej për ndonjë shumësi autorësh, pastaj edhe për faktin tjetër se ato vinin në një kontekst interesant autorësh kulmorë e prirjesh të ndryshme stilistike në letërsinë shqipe.

Sot e kemi fjalën për sprova poetike të shkruara në moshën e re të autorit, në kohën kur ishte nxënës i Medresesë së Tiranës, ndërsa janë të titulluara “25-vjetorit në Vlorë” dhe “28 Nëntorit”, botuar në gazetën “Jeta e re”⁴² të Vlorës, më 1937 përkatësisht më 1938, që të dyja të botuara në ditën e Pavarësisë së shtetit shqiptar. Krijimi i tretë letrar është poema “Lindjes profetike”, shkruar në Vlorë dhe botuar në revistën “Kultura islame”, nr. 8 dhe ribotuar tani së voni në vëllimet që përfshijnë të gjithë numrat e kësaj reviste, e cila doli gjatë viteve 1939 – 1944.

Veçantia e një autori letërsie ndërtohet mbi njëte shprehëse, mbi prirjet e kuntimit letrar të botës ideore e emocionale të tij. Pikërisht simbioza ndërmjet botëkuptimeve dhe ndjenjave shpërfaqet në këto tri krijime dedikuese. Fryma solemne, kremtuese, lavdëruese, e shkruar me një stil të lartë të ligjërimit poetik, me një fjalës të zgjedhur, me një kompozicion të menduar mirë, janë në fakt vetëm disa nga veçantitë autoriale që i bëjnë këto krijime modele të odës, si lloj i lirikës, në poezinë shqipe.

⁴² Të dhënat për ekzistimin e poezive të tjera të Shaban Demirajt, sikundër edhe tekstet e këtyre dy poezive, u morën nga shkruimi i Duro Mustafait “Akademiku Shaban Demiraj ka qenë edhe poet...”, botuar në gazetën “Telegraf” të Tiranës, të datës 22 tetor 2014, por të cilat më parë, përkatësisht më 14 janar 2014, ishin botuar në versionin elektronik të gazetës “Dielli”.

Objekti letrar që e motivon autorin ndërlidhet pashkëputshëm me përbërësit e tij identitarë. Në rend të parë është Vlora – vendlindja e autorit dhe vendlindja e Pavarësisë së Shqipërisë, ajo që e rrëmben mendjen dhe zemrën e poetit; pastaj është flamuri, shenja e kombit, sinteza e identitetit, rrugëtimi historik i kombit nëpër të kaluarën e vështirë, perceptimi kohor i autorit dhe shpresa e tij për të ardhmen. Shtresimi botëkuptimor, në të cilin atdhedashuria zë vendin qendror, ka gjetur në dellin krijues të Demirajt të ri një zë kumbues, i cili, ndonëse shprehet në konditat e poetikës tradicionale letrare, vjen i artikuluar në një format të realizuar artistikisht. Jo rrallë ngjan që odat dhe himnet të ngufaten nga një ligjërim i përmbytur në patos, duke e shpërqendruar vëmendjen nga gjetjet e dhura ligjërimore poetike. Përqendrimi vetëm te përmbajtja dhe lënia e formës së shprehjes në plan të dytë është e meta më e madhe e tyre. Megjithatë, kur flasim për këto krijime letrare të Shaban Demirajt, vërejmë se kemi të bëjmë me një autor që ka kulturë të gjerë shprehëse, që e kupton thellësisht karakterin e veçantë të ligjërimit letrar, duke gjetur shpëtimin nga rëndomësia në një kumtim imagjinar me vizionarin e pavarësisë, me Ismail Qemalin që tashmë kishte mbyllur sytë:

Këndoni, vlonjat, rreth Varrit Historik,
Kurorën i thurni çliruesit Kombëtar,
I tregoni Plakut tonin melodik,
Lumturinë, që ndien sot populli shqiptar.
I thoni që shkuan njëzet e pesë vjet,
Që dor` e Tij Flamurin lartësoi,

Dhe shqiptarët sot falnderjen e vërtetë,
U bëjn` atdhetarëve, që kjo tokë ndriçoi.

Poezia atdhetare nuk mund të kuptohet pa dimensionin frymëzues për sakrificën sublime. Është një frymëzim që bu-

ron nga dashuria djaloshare për Atdheun. Ndonëse në temën e atdhedashurisë është shkruar njaft, letërsia shqipe do të ishte e varfër pa këto vargje lapidare, që të kujtojnë lirikat e Naimit dhe të Asdrenit të këtij krahu motivor:

Të gjithë për rreth Flamurit ju lidhuni me besë,
 Për nderin e Atdheut kushdo me gaz të vdesë,
 Kushdo me gaz të vdes për nderin e Atdheut,
 Siç bën` burrat e motit në koh` të Skënderbeut,
 Dhe, kur të jeni lidhur me besën Shqiptare,
 Prej sulmit të armikut mos u frikoni fare,
 Pse Bes` e Arbëreshëve nuk e lejon tradhtinë,
 Por burrërisht mbron Nderin, Atdheun dhe Lirinë.

Tani më lejoni të shtroj pyetjen: A mund të ishin vargjet e këtilla një stacion kalimtar i rrugëtimit intelektual të Shaban Demirajt dhe vetëm një shkreptimë arti në qiellin e tij shken-
 cor? Më parë mund të thuhet se ai do të ketë mbushur faqe të tëra me sprova poetike për të arritur këtë nivel, që, pak a shumë, ishte niveli i poetëve bashkëkohës të tij. Njëfarë evoluimi gjithnjë në ngritje i vlerave artistike të ligjërimit poetik të autorit vlonjat vërehet madje edhe në këto poezi që kemi para vetes e që mbajnë datat e viteve 37, 38 dhe 40. Pa asnjë dyshim poema *Lindjes profetike*⁴³ përbën kryeveprën e tij në këtë vazhdë, krijimin poetik më të arrirë të shkruar ndonjëherë për nder të lindjes, jetës dhe veprës së Pejgamberit Muhamedit a.s. Fjala është, gjithashtu, për një vepër të shkruar me dashuri dhe mjeshtëri artistike. Ligjërimi poetik është konceptuar nëpërmjet disa pyetjesh që i bëhet Engjëllit, të cilat kanë një përgjigje të vetme:

⁴³ Kultura Islame, nr. 8, Tiranë, prill 1940, f. 297–300.

Engjëll i bekuar nga i madhi Zot!
Ç'është ky gëzimë? Pse po këndon sot?
A mos është dita, që Ti je krijuar?
Dhe lëvdon Krijuesin? Qoftë lavdëruar!
- Jo nuk është dita, që unë jam krijuar
Por nga an' e Zotit jam i urdhëruar,
Që të gjithë këtë ditë t'shkoj duke kënduar
Profetin e fundit, qoftë i bekuar!
Mbasi qindra vjetë më par' mu si sot
Muhammed Profeti urdhëroi në botë!
Mu si sot ka lindur Drit' e gjithësisë,
Urdhëroi në bot' i dashtn i Perëndisë.⁴⁴

Përgjithësisht mund të thuhet se krijimtaria letrare e Shaban Demirajt përbën një dëshmi të simbiozës së mundshme ndër-mjetit dhe shkencës, e cila është provuar në përmasën botërore, ta zëmë, në emrat më të shquar të dijes dhe të artit, sikundër janë: Omar Khajami, Leonardo da Vinçi, Volfgang Gëte, Umberto Eko etj. Pra, shembujt e zënë ngoje dëshmojnë se këto veprimtari njerëzore nuk janë përjashtuese të njëra-tjetrës; përkundrazi, domethënia e tyre realizohet, në mënyrë më të plotë, në ndërveprim. Fundja, me të drejtë është thënë se “Arti pa shkencën është një varfanjak, ndërsa shkenca pa artin është barbari”.

Fatmirësisht, arti i Shaban Demirajt është diturak, njëkohësisht shkenca e tij është shpërfaqje e një universi kreativ.

⁴⁴ Kultura Islame, nr. 8, Tiranë, prill 1940, f. 298.

ZEQIRJA NEZIRI,

Fakulteti i Filologjisë “Blazhe Koneski” – Shkup

NDIHMESSA E AKADEMIK SHABAN DEMIRAJT PËR AFIRMIMIN E LETËRSISË ARBËRESHE

Kam nderin e kënaqësinë e veçantë dhe jam shumë i lumtur që marr pjesë në këtë manifestim që i kushtohet profesor Shaban Demirajt. Profesor Shaban Demiraj edhe pse vokacion të studimit ka pasur fushën e gjuhësisë, një ndihmesë të çmueshme ka dhënë edhe për letërsinë shqipe, sidomos për letërsinë arbëreshe. Katër janë studimet e profesor Shabanit të viteve të pesëdhjeta e të gjashtëdhjeta që kanë të bëjnë me temën në diskutim – afirmimin e letërsisë arbëreshe. Dy prej tyre lidhen me Jul Varibobbën dhe dy me Gavril Darën e Ri. Bëhet fjalë për dy autorë të rëndësishëm të letërsisë arbëreshe e shqiptare që i përkasin dy periudhave të ndryshme letrare: i pari Iluminizmit, ndërkaq i dyti Romantizmit Shqiptar.

1. Në njërin prej studimeve kushtuar Varibobbës merret me Librandin dhe me botimin prej tij të Jul Varibobbës; ndërkaq tjetri ka të bëjë me prezantimin e Jul Varibobbës si poet arbëresh i pararilindjes kombëtare.

1.1 Në këtë studim (“Gjella e Shën Mëris Virgjër” e Jul Varibobbës – rreth botimit të parë të 1762 dhe traskriptimit të saj prej V. Librandit) analizon punën botuese dhe interpretimin gjuhësor të vjershave të Varibobbës nga Librandi, botuesi i parë i “Gjellës”, i cili përkrah shumë të metave që i vëren profesor Shabani ka meritën se është autori i parë, i cili ndërmori një nisjativë të këtillë: ta botojë këtë vepër të rëndësishme

shme të letërsisë shqipe të shekullit XVIII, e vetnja vepër letrare e botuar tek arbëreshët e Italisë.

1.2. Ndërkaq, në studimin e dytë (Jul Varibobba (1762)) bën prezantimin e personalitetit krijues të Jul Varibobbës, me çka edhe mbetet autori i dytë nga shqiptarët, pas Namik Ressulit, që shkroi për jetën dhe veprën e këtij autori të çmueshëm të letërsisë arbëreshe dhe të Iluminizmit shqiptar.

2. Në dy studimet për Gavril Darën e Ri rrihen çështje të autorësisë dhe të transliterimit e të përshtatjes së poemës *Kënga e sprasme e Balës*. Është me rëndësi të theksohet se përshtatja e qëlluar e kësaj poeme në gjuhën e sotme e profesor do të luajë një rol shumë të rëndësishëm në njohjen e autorit dhe në afirmimin e veprës së tij.

Studimi i profesor Demirajt i shtrirë në një sasi prej 16 faqesh, të shoqëruara me një rezymë tri faqesh në frëngjisht cilësohet me përpjekjen për saktësi e korrektesi të pashembullt të shkencëtarit që përcaktojnë pikëpamjen e studiuesit për argumentimin e lidhjeve logjike të shkakut dhe pasojës: krijuesit dhe veprës së tij. Këtë e arrin me shfrytëzimin e një bibliografie të pasur (kuptohet të autorëve të lejuar atëherë) që ishin marrë me veprën e Varibobbës.

Kur flet për autorësinë e Darës, të cilën ai ia ka bartur personazhit, profesor Shabani këtë pikëpamje të Darës e sheh si ndikim të osianizmit e të makfersonizmit, domethënë, si pikëpamje të përgjithshme romantike. Te Varibobba, në anën tjetër, në rrafshin e subjektit shtron në diskutim çështjen e 'origjinalitetit' krijues të tij, që e gjenë në: lirizmin, humorin, koloritin arbëresh dhe në mjetet letrare. Me anë të këtyre faktorëve synohet të dëshmohet se Varibobba bën 'riprodhimin e ngjarjeve biblike'.

Punimi është ndërtuar në këtë mënyrë: nis me përshkrimin historik të shpërnguljeve arbëreshe në Kalabri, vendosjen në Kozencë dhe në Mbuzat. Pastaj kalon në shpjegimin e origjinës së familjes së Varibobbës, që fonetikisht, sipas Lambercit e lidh me katundin Varibop të Mallakastrës. Pas këtij njoftimi të përgjithshëm historik kalon në bashkëkohësi tek personi i Julit dhe i familjes së tij dhe përfundon me analizën e *Gjellës* me çka Juli mbetet poeti më i shquar kalabrez i letërsisë shqipe të shekullit të tetëmbëdhjetë.

Si zakonisht punimi ndahet në dy pjesë: (1) jeta dhe (2) vepra e Varibobbës. Teknikisht pjesa e jetës shtrihet në tri faqe e gjysmë, kurse pjesa e veprës në 12 faqe e gjysmë.

Në pjesën e jetës ndalet në këto pika: vendlindja (përshkruhet ambienti arbëresh) dhe origjina e familjes së tij (sipas Lambercit), datëlindja, gjenealogjia familjare, shkollimi, jetesa – jepet anekdota e përshpirtshmërisë, konflikti në Kozencë (anekdota e këtij konflikti), strehimi në Romë, botimi i librit dhe vdekja (prapë anekdoteske).

Në pjesën e analizës së veprës ndalet në këto pika: komenti i parathënies, anekdota e Skiroit (Zef) për një dorëshkrim tjetër, ribotimi nga Librandi (1897 dhe 1928), organizimi i veprës, personazhet (fshatarët, shenjtorët, shën Mëria, Krishti, Josifi, përgjithësimi i personazheve të tjerë); komentet dhe vlerësimet e studiuesve (Majeri, De Rada, Dora d'Istria, Zef Skiroi, M. Markiano, Stratikoi, Lamberci), vlerësimi i veprës, figuracioni dhe metrika.

Duke pasur pikënisje Stratikoin ndalet në çështje të 'origjina – litetit' si një rën ndërkategoritë më të diskutueshme letrare atëherë, që përpiqet ta shpjegojë në dy mënyrë: nga aspekti i brendisë dhe nga aspekti i shtjellimit të porosisë poetike. Këtu njëkohësisht ngre edhe tezën e huazimit, apo të përvetësimit

të lëndës nga autorë të tjerë. Tezë kjo tepër e pranishme deri në deklasin në studimet e atëhershme letrare jo vetëm shqip-tare, por edhe botërore.

Sipas pikëpamjes së parë nga aspekti i brendisë, në kontekst të pikëpamjeve teorike të kohës, si zakonisht, në mënyrë të përgjithësuar thuhej për secilin krijues, se ka përkthyer ose parafrazuar këtë apo atë autor ose vetë të tij. Por profesor Shabani, këtë pikëpamje të veten e jep në mënyrë kushtore, të hamendshme dhe jo bindëse, edhe pse synon tjetrën. Duke dialoguar me Stratikoin sa i përket tezës së ‘originalitetit’ profesori është i mendimit se: “Ka shumë të ngjarë që të paktën një pjesë e këtyre vjershave të jenë një përkthim a parafrazim vjershash fetare italiane”. Po nënvizoj kondicionalin *ka shumë të ngjarë që të paktën* për të kaluar te dilema që studiuesit i paraqitet rreth kësaj çështjeje, për të cilën është e domosdoshme të gjenden edhe argumente. E këta gjenden te titujt e disa vjershave që janë në latinisht ose italisht si dhe në shprehjet e vetë Varibobbës, ku shënimi “*prierrë arbërisht*” interpretohet si ‘përkthim’, ose ‘parafrazim’, ndërkaq vjersha na del e huazuar apo e parafrazuar “sigurisht nga ndonjë vjershë analoge italiane” (Demiraj, 1958: 133).

Sipas pikëpamjes së dytë origjinaliteti i Varibobbës shihet në pasqyrimin e figurës së shën Mërisë dhe të Krishtit. Kjo çështje argumentohet me dy faktorë. Këtë origjinalitet profesori e nxjerr si pasojë të dy traditave letrare në të cilat është formuar Varibobba si poet iluminist arbëresh e shqiptar: *njëra* është tradita e jashtme, pra italiane, e cila përvijohet përmes Jaccopone da Todit (një poet latin i shekullit të 13 – të, 1230–1306); kurse *tjetra* është tradita kombëtare, domethënë arbëreshe, e cila na del më e fuqishme se ajo italiane. Duke përmendur anekdotën e De Radës, për poetin (si duket më

shumë për rapsodin) Domenico Piro (që ka jetuar një shekull përpara Varibobbës, 1664–1696) profesori ynë, duke përdorur lidhësen e ndërsjellë përmbyllëse ‘por’ bind në këtë të fundit: “Por edhe në një rast të tillë nuk duhet kuptuar se Variboba ka qenë një kopjonjës i thjeshtë, që s’ka futur asgjë të tijën në vjershat e veta” (Demiraj, 1958:135).

Pasi ka zbërthyer këto nyja të personalitetit poetik të Jul Varibobbës, profesor Shabani kalon në argumentimin e ‘origjinalitetit’ krijues të tij. Këtë e sheh në veçoritë artistike të *Gjellës* së famshme. Këto janë: lirizmi, humori, koloriti arbëresh dhe mjetet letrare (nënkupto figurat stilore). Me anë të këtyre faktorëve synohet të dëshmohet se Varibobba bën ‘riprodhimin e ngjarjeve biblike’.

- (a) Elementin e lirizmit e gjen në ninullat, këngët okazionale dhe vajtimet arbëreshe,
- (b) Humorin e gjen në dy parathëniet e vëllimit;
- (c) Kurse koloritin arbëresh në toponiminë (mali i Polinit ose sheshi i Andonit) dhe në zakonet e vdekjes (përgatitjen e Josifit);
- (d) Ndërkaq kur është fjala për ‘mjetet letrare’ aty janë epiteti, krahasimi, apostrofi, përshkrimi metaforik dhe similituda.

Në fund flitet për metrikën, ku citohet vlerësimi i De Radës se rima dhe vargu të Varibobbës janë modern për kohën (Demiraj, 1958: 139), por këtu nuk e kemi të qartë në është fjala për vargun e këngës arbëreshe, apo për atë të poezisë italiane. Profesori i shmanget De Radës dhe duke përkrahur vlerësimin e Lambercit është i mendimit se vargu i Varibobbës “i është përshtatur metrikës italiane” (Demiraj, 1958: 139). Në këtë drejtim si argument sillet lloj-llojshmëria e vargjeve dhe rimave të poetit, të cilat “nuk janë punuar sa duhet”. Për

më tepër, gjithnjë në kontekst të formimit italian të Varibobës, përqafohet mendimi i Francesco Taianit (1915), që i duket se “s’është pa vend kritika” e tij dhe si argument përafrohen shenjat gjuhësore. F. Taiani mendonte se “Varibobba për ta gjetur rimën e bastardonte më shumë gjuhën”. Këtë pikëpamje të Taianit profesor Shabani e vë në dyshim, kur thëkson: “Ndofta edhe shumë nga barbarizmat (...) i ka përdorur kryesisht për punë të rimës” (Demiraj, 1958: 140). Në fund fare profesori nënvizonte se te Varibobba gjejmë vargje të bukura e të goditura.

Natyrisht nga perspektiva gjysmëshekullore e këtij studimi lindin pyetje të shumta dhe të natyrave të ndryshme. Njëra prej tyre do të ishte ç’është e diskutueshme në modelin e këtij studimi? Para se të jepej një përgjigje e çfarëdoshme pason pyetja shoqëruese: vallë kjo mënyrë e paraqitjes dhe e studimit të veprës së autorëve të traditës së Pararilindjes dhe të Rilindjes është dukuri vetëm e profesor Shabanit, apo është parim i përgjithshëm i studimit të letërsisë shqipe, në këtë kohë, pra në kohën e ndërtimit të shkencës shqiptare të letërsisë?

Fillimisht i përgjigjemi pyetjes së fundit: kjo metodologji ka qenë e përgjithshme dhe dominuese në të gjitha letërsisë e popujve të Ballkanit dhe bukur mirë edhe në të gjitha letërsitë evropiane dhe ky model i studimit të autorëve dhe të veprave të tyre letrare përvijohet gati deri në fund të viteve të tetëdhjeta të shekullit të kaluar. Prandaj, në këtë drejtim, edhe profesor Shabani nuk bën përjashtim dhe kjo dëshmon se është në rrjedhë të pikëpamjeve teorike të studimit të letërsisë në këtë kohë. Pavarësisht se që në vitet e tridhjeta të shekullit XX, si dhe më herët, kah fundi i shekullit XIX dhe sidomos në kohën e botimit të këtij studimi ishin paraqitur pikëpamje të reja dhe zhvilloheshin diskutime të një natyre tjetër, njëri

prej të cilëve ishte mënyra së jetesës së letërsisë që përfundon në përkufizimin: ç'është ajo që letërsinë e bën tjetër dhe gjithmonë të freskët e interesante për lexuesin dhe studiuesin? Si nënpyetje pastaj lind nevoja e gjetjes së përgjigjes në pyetjen pse në veprat letrare nuk është studiuar ajo që ato i bën ndryshe dhe të tjera prej njëra – tjetrës, por është kërkuar që ato si strukturë poetike të jenë të përhershme, të dhëna një herë e përgjithmonë dhe të pandryshueshme?

Tani kalojmë në një çështje shumë të ndjeshme, që e hasim edhe sot nëpër kritika e studime të ndryshme. Fjala është për *unitetin* dhe *fragmentaritetin kompozicional* të veprave letrare. Sa për ilustrim po marrim një citat nga profesor Shabani: “i gjithë vëllimi i vjershave të Varibobës nuk do marrë si një vepër me unitet të plotë artistik. Ajo do parë më tepër si një vëllim poezish, që përveç një poeme të gjatë epike – lirike të ndarë në dy pjesë si dhe një numri poezish të tjera lirike e lirike – epike, të lidhura ngushtë me të, ngërthen edhe disa vjersha të tjera, që nuk lidhen aqë ngushtë me poemën e lartpërmendur dhe që për këtë arsye e dobësojnë njaft unitetin artistik të veprës” (Demiraj, 1958:129).

Përkufizime të këtilla sot lexojmë edhe për *Milosaon* e De Radës, ose për *Balën* e Darës, si dhe për shumë e shumë vepra të tjera të cilat synohet të studiohen sipas modelit aristotelian të veprës letrare, i cili kërkonte unitetin e fabulës, të veprimin e të funksioneve të personazheve, përkundër parimit të mungës së tij, respektivisht të morcelimit që u paraqit në veprat letrare të shekullit XVIII.

Në teorinë e studimit historik të llojeve letrare është e ditur se formacionet, si dhe lëvizjet letrare lindin duke u kundërshtuar midis tyre: Humanizmi kundërshtoi Mesjetën, Baroku Humanizmin e kështu më tej. Bashkë me to janë paraqitur edhe

pikëpanje të ndryshme ose të kundërta ndaj ndërtimit të subjektit të veprës letrare. Përkundër këtij ndryshimi në strukturën kompozicionale të veprave letrare, studimi i këtyre veçorive sikur ka vendnumëruar: gjithmonë është kërkuar të bëhet sipas modelit të *Poetikës* së Aristotelit dhe aty ku mjetet e studimit kanë ndeshur në pengesë janë gjetur edhe argumente: shmangiet nga praktika aristoteliane janë parë si mangësi ose si dobësi e krijuesit. Është harruar me këtë rast se Varibobba me De Radën, p.sh. kanë krijuar në të kundërtën e praktikës aristoteliane, ndaj edhe nuk e kanë zbatuar parimin e unitetit, por të fragmentarizmit.

Ose rasti tjetër që na del në shembullin e Varibobbës, edhe pse profesor Shabanit i ka shpëtuar ta përmendë veçorinë stilore të këtij poeti të madh arbëresh: përdorimi me të madhe i formave të përkëdhelisë, që janë tipare të letërsisë iluministe: kujtoni këtu, Heloizën e Rusoit ose Gavroshin e Hygoit, Kandidin e Dideroit ose Emilin e Volterit, i kësaj kohe është edhe Vërteri i Gëtes. Edhe shën Bambini i Varibobbës, në sytë e shën Mërisë mbetet ‘Bambimth’, ‘faqefinth’, që fle në ‘djepthin’ prej kashte që ia kishte bërë Zepa. Kjo pse Jul Varibobba ka krijuar duke pasur parasysh modën ‘le charme de petit’ të Iluminizmit dhe jo manirin e kolosales baroke. Ai ka krijuar sipas mësimit të parabolës katekizmit të shekullit XVIII: «”A është Jezui i plotë në dukje të madhe apo në dukje të vogël” – e ka pyetur prifti nxënësin. Ky i është përgjigjur: “Jo, se edhe në thërmijat më të vogla Jezu Krishti është i plotë“». Edhe vjershërinë e Varibobbës *Gjella e shën Mërisë Virgjër* është një vepër letrare me unitet të plotë artistik, por që është ndërtuar me bashkimin e thërmijave të vogla: këngëve heterogjene, sipas numrit dhe llojit të vargjeve ose të rimave.

Do të ndalemi paksa në metodologjinë e punës së profesor Shabanit, e cila njëkohësisht është edhe pikëpamja e të gjithë studiuesve shqiptarë të periudhës së fillimit të gjysmës së dytë të shekullit XX, të kohës kur shkencat albanologjike, në përgjithësi dhe ajo e letërsisë shqipe, në veçanti hodhi themelet e ndërtimit të saj si disiplinë shkencore kombëtare. Meqë është studimi i parë i tipit monografik në miniaturë për Jul Varibobbën, ai shërben edhe si model për ta parë përsafërm mënyrën e studimit të personalitetit të krijuesit dhe të analizës së veprës letrare atëherë. Në këtë kontekst, këto studime të prof. Shabanit bëjnë pjesë midis studimeve të para të tipit monografik të paraqitjes e të studimit të veprimtarisë së Jul Varibobbës e të Gavril Darës së Ri. Ato për një kohë të gjatë do të shërbejnë si model i shtrirjes e shtruarjes së lëndës studimore, i njohjes përsëafërm të autorit e të veprës, si dhe e mënyrës së studimit të personalitetit të krijuesit dhe të analizës së tekstit letrar.

Do theksuar se, për arsye të ditura historike, si e thekson edhe Floresha Dado, shkencat letrare e albanologjisë edhe disa decenie prapa këtij studimi, përkundër prurjeve të reja botërore teorike e metodologjike studimore në fushën e letërsisë nuk do të jetë në gjendje t'i shmanget pozitivizmit historik të H. Tenit (fundit i shekullit XVIII), të cilin do ta modifikojë me komponentin shoqëror.

Nuk është vendi dhe momenti të ndalemi në qëndrueshmërinë ose jo të pikëpamjeve të këtilla. Ne vetëm po theksojmë se ky studim i profesor Shabanit ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm për afirmimin e Jul Varibobbës si njërin ndër poetët më të mëdhenj arbëreshë.

Studimet e profesor Demirajt të shtrirë në një sasi të kositueshme faqesh cilësohen me përpjekjen për saktësi e korre-

ktësi të pashembullt, përpikmëri e përkushtim të jashtëzakonshëm të shkencëtarit në përcaktimin e pikëpamjeve të studiuesit për argumentimin e lidhjeve logjike të shkakut dhe të pasojës: krijuesit dhe tekstit të tij. Këtë e arrin me shfrytëzimin dhe konsultimin e një bibliografie të pasur të gjithë atyre që janë marrë me veprën e Jul Varibobbës ose të Gavril Darës së Ri. Kjo shihet sidomos në përshtatjen e shkëlqyeshme të poemës *Kënga e sprasme Balës* të Gavril Darës së Ri. Sa për ilustrim po përmendim një citat me rastin e ribotimit të fundit (2010) të kësaj poeme. Në parathënien e këtij botimi veç tjerash thekson: “e pashë të nevojshme që t’i rishikoj me kujdes botimet e mia të mëparshme”, sepse “aty – këtu kishte ndonjë ndryshim jo të parëndësishëm të karakterit fonetik” (Demiraj 2010: 11).

Si përfundim tërheqim vëmendjen se këto studime të akademik Shaban Demirajt kanë luajtur një rol shumë të madh e të rëndësishëm në afirmimin e veprave të këtyre dy autorëve. Në aspektin praktik programor këto dy studime të viteve 1953, 1956 dhe 1958 të profesor Shaban Demirajt u inkorporuan pastaj në të dy historitë e letërsisë shqipe (1959) ose shqiptare (1983) dhe edhe sot qarkullojnë e janë të pranishme, në mënyra të ndryshme, në mjediset universitare e akademike, përkundër faktit se më 1984, nën përkujdesjen e profesor Italo Fortinos, doli vepra e plotë e Jul Varibobbës, e cila u shoqërua, në vitin 2005, me botimin kompjuterik të Viçenco Belmontos. Flasim, pra, për dy studime që kanë luajtur një rol shumë të madh e të rëndësishëm në afirmimin e këtyre dy autorëve të letërsisë arbëreshe, në edukimin e arsimimin letrar të disa brezave, si dhe të komunikimit të lexuesit shqiptar me veprat e tyre. Kjo vetvetiu nënkupton edhe meritën e madhe të profesor Shabanit për afirmimin si të Jul Varibobbës, ashtu

edhe të Gavril Darës së Ri në mjediset akademike, pastaj edhe midis nxënësve e studentëve, sidomos me përshtatjen e shkëlqyeshme në gjuhën e sotme të *Balës* së Gavril Darës së Ri, një metodologji, e cila, sa i përket përshtatjes meriton të ndiqet nga studiues të tjerë.

Burimet:

DADO, Floresha (2008), »Eqrem Çabej dhe historia e letërsisë sot«, *Panorama*, Tiranë, 27. 08. 2008.

DARA I RIU, Gavril (2010), *Vepra*, Toena, Tiranë.

DARA JUNIOR, Gabriele (2007), *Kënga e sprasëme e Balës*, Palazzo Adriano.

DEMIRAJ, Shaban (1953), »Disa shënime të krahasuara rreth gjuhës së J. Varibobës«, *Buletin për Shkencat Shoqërore*, nr. I, II, III.

DEMIRAJ, Shaban (1956), »“Gjella e Shën Mërius Virgjër” e Jul Varibobës – rreth botimit të parë të 1762 dhe traskriptimit të saj prej V. Librandit«, *Buletin për Shkencat Shoqërore*. Tiranë, 3.

DEMIRAJ, Shaban (1958), »Jul Varibobba (1762)«, *Buletin i Shkencave*, Tiranë, 1: 125 – 144.

NEZIRI, Zeqirja (2008), *Vjershërimi i Varibobbës*, Logos–5, Shkup.

AGIM POLOSKA,

Fakulteti i Filologjisë “Bllazhe Koneski” – Shkup

GJUHA SHQIPE NË KONTEKST BALLKANIK NË “GJUHËSINË BALLKANIKE” TË AKADEMIK SHABAN DEMIRAJT

Këtë vit mbushen plot 40 vjet nga vizita e parë e Akademik Shaban Demirajt pranë Katedrës së Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe në Fakultetin Filologjik të Universitetit Shën Qirili dhe Metodi në Shkup, dhe 20 vjet nga botimi i veprës së tij monumentalëe “Gjuhësi ballkanike”, Logos A, Shkup, 1994. Ky është një rast i mirë që të rikujtohen dhe rishqyrtohen aspektet e ndryshme të veprimtarisë së tij dhe kontributit të madh që ka dhënë në zhvillimin dhe lëvrimin e gjuhës shqipe në të gjitha sferat e saj (etimologjinë e gjuhës shqipe, morfologjinë dhe gramatikën historike të shqipes, leksikologjinë dhe leksikografinë etj.) Në kumtesën tonë do të përqëndrohemi në kontributin e tij që dha për afirmimin e gjuhës shqipe në veprën e tij monumentale “Gjuhësi ballkanike”.

Duke iu falënderuar njohurive të tij shumë të thella në fushën e teorisë së gjuhësisë së përgjithshme, ballkanologjisë dhe indoevropëistikës, Akademik Shaban Demiraj me autoritetin e tij të madh në Shqipëri dhe më gjerë, gjuhës shqipe i siguroi vend të merituar në familjen e gjuhëve bashkëkohore evropiane. Duke u nisur nga veprimtaria e tij shumë e gjerë dhe e thellë shkencore, Akademik Sh. Demiraj radhitet një ndër figurat më të shquara të gjuhësisë dhe kulturës shqiptare albanolog, ballkanolog dhe indoevropëist. Akademik Shaban Demiraj bën pjesë në grupin e pedagogëve dhe shkencëtarëve të

shquar, i cili në shkencat albanologjike dhe ballkanologjike zë vend të merituar për kontributin dhe meritat që ka dhënë në afirmimin e gjuhësisë dhe kulturës shqiptare në qarqe kombëtare dhe ndërkombëtare. Pikëpamjet, qëndrimet dhe gjykimet e tij gjuhësore karakterizohen me një akribi të reptë shkencore.. Në këtë kontekst, duke iu falënderuar humanizmit, sinqeritetit, ngrohtësisë dhe mirëkuptimit për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me gjuhën shqipe, si në aspektin sinkronik po ashtu edhe në aspektin diakronik, akademik Sh. Demiraj, u mundësoi shumë studiuesve (albanologëve, romanistëve, sllovishtëve, turkologëve e të tjerëve) që gjuhën shqipe ta përfshijnë (kyçin) edhe në materialet dhe studime e tyre shkencore. Në këtë drejtim, kontributi i tij është mjaft i madh, sidomos në fushën e ballkanistikës, të cilën e ngriti në një shkallë më të lartë. Në mënyrë të veçantë këtë e dëshmoi me veprën e tij monumentale **“Gjuhësi ballkanike”**, botuar në Shkup , në vitin 1904, e cila një vit më vonë (1995) doli edhe në gjuhën maqedonase.

Duke u nisur nga perspektiva e sotme çështjet e gjuhës shqipe, që trajtohen në këtë vepër, edhe sot mbeten aktuale. Ato, gjithashtu paraqesin bazë për studim, analizë, interpretim dhe elaborim të shumë çështjeve aktuale që kanë të bëjnë me diglosinë, bilinguizmin dhe shumëgjuhësinë (huazimeve) në hapësirat ballkanike, interferencat leksikore dhe gjuhësore të gjuhëve ballkanike, sidomos për rolin dhe statusin e gjuhës shqipe në kontekst ballkanik, aspekte të ndryshme të socio-linguistikës dhe etnolinguistikës etj. Vepra Gjuhësia ballkanike e akademik Sh. Demirajt mbetet burim i pashtershëm për të gjithë ata që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi merren me gjuhën shqipe dhe me gjuhët tjera ballkanike.

Profili lingvistik i akademik Sh. Demirajt për studimin e gjuhës shqipe në kontekst ballkanik, mund të shihet përmes kontributit të tij që ka dhënë në:

- fushën e etimologjisë së gjuhës shqipe,
- morfologjisë historike të gjuhës shqipe;
- projekti ballkanologjik i gjuhës shqipe
- angazhimi leksikologjik dhe leksikografik, dhe
- studimin e gjuhës së sotme shqipe, apo gjuhës standarde

Këto pesë fusha interesimi të akademik Sh. Demirajt asnjëherë nuk na dalin të izoluara, por përkundrazi ato plotësojnë njëra-tjetrën, gërshetohen dhe paraqiten si një e shëndoshë në veprimtarinë e tij shkencore.

Studimet ballkanologjike të akademik Sh. Demirajt në shkencën e gjuhës shqipe, kryesisht shtrihen në dy drejtime,

E para, çështjet aktuale që kanë të bëjnë me gjuhën shqipe në kontekst ballkanik i trajton nga aspekti diakronik dhe sinkronik, duke zgjidhur një varg çështjesh të rëndësishme të kontaktave leksikore dhe gjuhësore të gjuhëve ballkanike.

Së dyti, pjesëmarrja e tij në shumë konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, lingvistike dhe ballkanologjike, me karakter evropian dhe botëror, në masë të madhe, ka dhënë kontribut dhe rezultate të dukshme për afirmimin e shkencave albanologjike dhe ballkanologjike.

Interesimi i tij për çështjet ballkanologjike janë ngusht të lidhura me vendin e gjuhës shqipe në familjen e gjuhëve indoevropiane dhe veçanërisht me veprën e tij kapitale Gjuhësi ballkanike. Përmes kësaj vepre, akademik Sh. Demiraj i ka studiuar, analizuar dhe zbuluar mekanizmat zhvillimore të disa njësive leksikore, të ashtuquajtura ballkanizma, të cilat me shekuj janë penetruar dhe përdorur në disa gjuhë ballkanike,

me shumë impulse interferencuese në mjediset shumë-gjuhësore ballkanike.

Gjithë materiali leksikor dhe gjuhësor në këtë vepër mbarë-shtrohet nga aspekti etimologjik, leksikor, fjalëformues, semantik dhe gramatikor. Gjithashtu, në të autori me një akribi të repte shkencore i mbarështron dhe analizon problemetet më të rëndësishme të gjuhëve ballkanike, të kontakteve, gërshtimeve, bashkëpërkimeve, paralelizmave dhe ndikimeve ndër-gjuhësore dhe ndërleksikore të gjuhës shqipe me gjuhët tjera ballkanike (greqishten, latinishten, rumanishten, gjuhët sllave të jugut – maqedonishten serbishten dhe bullgarishten, turqishten etj.), të cilat në të kaluarën nuk kanë pasur ndonjë zgjidhje fatlume.

Rëndësi të veçantë autori u kushton distribuimit të ballkanizmave në gjuhën shqipe, sidomos interesimi i tij për statusin e tyre në rrafshin diakronik dhe sinkronik, respektivisht edhe të gjuhëve tjera ballkanike në Shqipëri dhe më gjerë. Në këtë kontekst, autori i ka përkufizuar faktorët jashtëgjuhësorë, që kanë lënë gjurmë të thellë në strukturën leksikore dhe gramatikore të gjuhës shqipe, duke dhënë referenca dhe bibliografi të pasur nga gjuhësia ballkanike. Leksikut të gjuhës shqipe, si një sistem i hapur, autori, duke qenë besnik dhe duke mbajtur llogari për metodat dhe metodologjinë bashkëkohore të studimit të shkencës së gjuhësisë, i qaset në përputhshmëri me rezultatet e arritjeve më të reja të studimit të gjuhësisë së përgjithshme.

Në këtë mënyrë akademik Sh. Demiraj (dhe sidomos E. Çabej) i vuri bazat e studimit të gjuhës shqipe në kuadrin e gjuhëve ballkanike. Në çdo gjykim, përpjekje, mendim apo vërejtje të tij mund ta vërejmë akribinë dhe parimin e shëndoshë gjuhësor me domethënie përmasash universale, që është rrën-

josur thellë në ballkanistikën bashkëkohore. Në veprën shkencore të akademik Sh. Demiraj jeton dhe pulson një eksperiencë (përvojë) ekzistenciale dhe historike e njeriut tonë dhe popullit tonë. Andaj kam guzimin të them se vepra e tij **“Gjuhësia ballkanike”** është një monument i shëndoshë për hulumtimin dhe studimin e gjuhës shqipe dhe gjuhëve tjera ballkanike.

Shikuar nga perspektiva e sotme vepra e tij edhe sot mbetet aktuale, koherente, kompakte dhe pragmatike, kështu që pikëpamjet dhe interesimi i tij zgjojnë interesim të posaçëm për shkencën e gjuhës shqipe edhe në opinionin më të gjerë maqedonas në Shkup. Shumë çështje që trajtohen në këtë vepër, në shumë qendra ballkanologjike dhe më gjerë, mbeten burrim i pashtershëm për hulumtime më të thella gjuhësore. Në lidhje me këtë shumica e gjuhëtarëve (albanologë, sllavistë, romanistë, gjermanistë, ballkanologë etj.) pandërprerë u rikthehen dhe vazhdimisht i analizojnë huazimet, dhe sidomos ballkanizmat që i ka trajtuar akademik Sh. Demiraj në veprën e tij Gjuhësi ballkanike. Përmes këtyre ballkanizmave zbulohen interferencat e llojllojshme leksikore dhe gjuhësore, që janë karakteristike për arealin gjuhësor ballkanik dhe në këtë kontekst disa gjuhëtarë me të drejtë gjuhën maqedonase e konsiderojnë si gjuhë më të ballkanizuar nga gjuhët sllave jugore. Nga gjuhët më të vjetra (greqishtja dhe latinishtja) që janë folur në Gadishullin Ballkanik, në shumë gjuhë të arealit ballkanik përdoren disa fjalë, si *sharrë*, *shtrigë*, *tërngallo* (shq., maqed. arom.) me burrim nga lat.

Gjatë punës së tij shkencore, frytdhënëse dhe të vazhdueshme, Akademik Shaban Demiraj i transmetoi njohuritë e fituara nga mësuesi i tij E. Çabej, një figurë e jashtëzakonshme që ndikoi drejtpërdrejt në angazhimin dhe intelektin e tij shkencor. Në

këtë kontekst, me eksperiencën dhe angazhimin e tij filologjik aftësoi një plejadë të tërë studentësh, punëtorë shkencorë, ligjërues, profesorë etj., që të merren me punë të pavarur humtuese—shkencore dhe zgjoi interesimin e gjallë për t'u marrë me jështje të ballkanologjisë. Puna shkencore e tij ka qenë e lidhur ngushtë me veprimtarinë e shumë qendrave dhe institucioneve shkencore në Tiranë, Gjirokastër, Korçë, Shkodër, Prishtinë, Tetovë, Shkup, Sofje, dhe në qendrat tjera shkencore që merren me albanologji, balkanologji dhe indoeuropianistikë.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

1. Çabej, E. *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, II, (A–B), Tiranë, 1976; *Studime gjuhësor*, I, (A–O), Prishtinë, 1986; II, (P–ZH), Tiranë, 1976.
2. Demiraj, SH., *Gjuhësi ballkanike*, Logos A, Shkup, 1904.
3. Vidoeski, B., *Kontaktet gjuhësore të maqedonishtes dhe shqipes (në rrafshin dialekor) si faktor për diferencimin dialektor të gjuhës maqedone*, Shqyrtime albanologjike, 2, Shkup, 1996.
4. Argirovski, M.: *Grcizmite vo makedonskiot jazik*, IMJ “Krstе Misirkov”, Skopje, 1998.
5. Bariç, H.: *O uzajamnim odnosima balkanskih jezika*, Biblioteka arhiva za arbanasku starinu, jezik i etnologiju IV, Lingvisti~ka serija 1, Beograd, 1937.
6. Basotova, Q.: *Latinizmite vo makedonskiot jazik*, doktorska disertacija, Fond na Filozofskiот fakultet vo Skopje, Skopje, 1993.
7. Ilievski, P.: *Balkanski lingvisti~ki studii*, IMJ, Skopje, 1987.
8. Koneski, B.: *Istorija na makedonskiот jazik*, Kultura, Skopje, 1981.

-
9. *Reçnik na makedonskiot jazik I, II, III*, IMJ, 1961.
 10. *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Akademia e shkencave e RPS të Shqipërisë; Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1980.
 11. Papahagi, T.: *Dictionarul dialectului Aromân*, Editura Academiei Republicii Socialiste România, Bucuresti, 1974.

ASLLAN HAMITI,

Fakulteti i Filologjisë “Bllazhe Koneski” – Shkup

NDIHMESA E PROF. SHABAN DEMIRAJT PËR BALLKANOLOGJINË

Akademiku Shaban Demiraj është një nga figurat më të shquara të albanologjisë, të shkencës e të kulturës shqiptare në përgjithësi. Ai ka botuar shumë studime, monografi dhe artikuj për gjuhën shqipe, për historinë dhe gramatikën e saj, për figura të shquara të kulturës shqiptare, për gjuhët ballkanike si dhe gjuhët e tjera indoevropiane, me theks të veçantë mbi marrëdhëniet e tyre me gjuhën shqipe.

Shkrimet e profesor Demirajt shquhen për akribi shkencore, maturi e njeshëteri të rrallë. Përveç në shqip, shumë nga veprat e prof. Shabanit janë botuar edhe në disa gjuhë të botës, veçmas në anglisht, gjermanisht, maqedonisht etj. Veç kësaj, ka marrë pjesë në shumë kongrese, simpoziume e takime ndërkombëtare. Me fjalë të tjera, akademik Demiraj zë vend të posaçëm në shkencat albanologjike, ballkanologjike e në gjuhësinë krahasuese indoevropiane.

Profesor Demiraj i dha një shtysë të fuqishme studimeve albanologjike. Vepra e tij përbën një vazhdim të punës së Gustav Meyer-it, Norbert Jokl-it, Eqrem Çabejt, Selman Rizës dhe shumë albanologëve të tjerë. Rezultatet shkencore të këtij gjuhëtari të njohur shqiptar, kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë gjatë viteve 1993–1997 përfaqësojnë vlera referuese ndër shumë vepra të rëndësishme të albanologjisë e të gjuhësisë ballanike e evropiane.

Në një intervistë akademik Shaban Demiraj tha: *"Parimi im është: "puno dhe hesht", i dua heronjtë e heshtur, prej të cilëve ke ç'të marrësh e të përfitosh pa qenë të njohur në politikë apo gjetkë". "Gramatika historike", e botuar e përmbledhur edhe në gjermanisht nga Akademia e Austrisë, "Fonologjia historike e shqipes", "Prejardhja e shqiptarëve", "Gjuha shqipe dhe historia e saj", botuar edhe nga Universiteti i Kalabrisë, "Gjuhësi ballkanike" botuar edhe në maqedonisht e shumë e shumë vepra me vlerë të qëndrueshme profesorin e nderuar e vënë në piedestalin më të lartë të shkencëtarëve shqiptarë e që ka një ndër rolet kryesore në studimet albanologjike.*

Akademik Demiraj ndihmesë të madhe ka dhënë edhe në fushën e studimeve ballkanologjike. Më vitin 1994 Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare e Fakultetit të Filologjisë në Shkup pati nderin dhe kënaqësinë të përkujdeset për botimin në shqip të veprës kapitale "Gjuhësi ballkanike". Këtë vepër madhore për gjuhësinë ballkanike nga shqipja në maqedonisht e përktheu prof. Haki Ymeri, pedagog dhe leksikograf i njohur në hartimin e fjalorëve shqip-maqedonisht e anasjelltas dhe më 08. qershor 1995 në lokalet e universitetit të përurojë këtë libër, botuar nga Logos – A nga Shkupi.

Përurimi u bë në praninë e një numri të madh pedagogësh të fakultetit (shqiptarë, maqedonas e të tjerë), intelektualë e shkencëtarë të shumtë, studentë dhe dashamirës të tjerë të librit e të kulturës në përgjithësi. Në fillim fjalën e mori dekani i fakultetit të Filologjisë "Bllazhe Koneski", prof. Atanas Vangellov, i cili i përshëndeti të pranishmit dhe i uroi mirëseardhje akademikut Shaban Demiraj e më pas veprën që promovohet e vlerësoi lart. Fjalë miradije tha edhe prof. Haki Ymeri, duke e cilësuar si vepër kapitale për gjuhësinë. Fjalë

rasti mbajti edhe prof. Petar Atanasov (rumunolog). Ai ndër të tjera tha se akademik Shaban Demiraj me këtë vepër ka bërë një punë kolosale për gjuhësinë ballkanike. Në fund fjala iu dha edhe akademik Shaban Demirajt, i cili pasi u falënderua për punën e respektin që kanë treguar ndaj tij e veprës tha se libri “Gjuhësi ballkanike” është rezultat i një pune shumë-vjeçare. Edhe kësaj radhe, si gjithnjë me modesti, tha: *“nuk pretendoj se çdo gjë e kam zbërthyer përfundimisht. Më tepër këtë duhet kuptuar si një përpjekje për t’i shtruar çështjet më kryesore me të cilat preokupohet gjuhësia ballkanike, që pastaj gjuhëtarët të merren më hollësisht.”*

Edhe nga gjuhëtarët maqedonas “Gjuhësia ballkanike” e akademik Shaban Demiraj e përkthyer në maqedonisht është vlerësuar lart dhe sot e kësaj dite shërben si vepër referuese, si për qëndrimin e drejtë dhe shpjegimin shkencor të çështjeve, ashtu edhe për faktin se në dallim nga disa studiues të tjerë, autori pranon se maqedonishtja është gjuhë sllave më vete. Jo vetëm për këtë vepër, por edhe për veprimtarinë e pasur shkencore kolegët tanë u mahnitën kur panë një mal veprash të albanologut tonë, të ekspozuara në dollapët e bibliotekës së Katedrës dhe me një lakmi të paparë shprehën dëshirën të kishin edhe ata një studiues kaq të madh.

Në parathënien e librit, prof. Demiraj thotë: *“Duke pasur parasysh zhvillimin e studimeve krahasuese mbi gjuhët ballkanike sidomos pas botimit të veprës së Kristian Sandfeldit më 1930, m’u duk e arsyeshme të përgatis për lexuesin shqiptar një vepër sintetizuese mbi gjuhësinë ballkanike, ku pasqyrohen edhe ndihmesat e gjuhëtarëve të ndryshëm në këtë fushë studimesh. Hartimi i një veprë të tillë ishte i nevojshëm edhe për të vënë në dukje në mënyrë më të plotë se deri sot të dhënat e shqipes, që dëshmojnë për tiparet ballkanike të saj.*

Por hartimi i kësaj vepre paraqiste edhe vështirësi të shumta, që kishin të bënin jo vetëm me përzgjedhjen e lëndës, por edhe më shumë me shpjegimin e çështjeve në mënyrë sa më të argumentuar. Uroj që kjo vepër të ndihmojë sadopak për zhvillimin e mëtejshëm të studimeve krahasuese në fushën e ballkanistikës.”

Hartimi i një vepre të tillë nga një gjuhëtar shqiptar me përgatitje të lartë shkencore, me njohjen 14 gjuhëve (ballkanike e joballkanike) ishte i nevojshëm jo vetëm për të plotësuar mungesën e një vepre sintetizuese objektive, pa paragjykimë e pa ngjyrimë politike për gjuhët ballkanike; por edhe për të çuar përpara studimet në këtë fushë, për të plotësuar ose për të saktësuar të dhënat e pakta që jepeshin nga disa studiues të huaj për shqipen dhe për shqiptarët.

Kjo vepër madhore shpreh pikëpamjet e një dijetari shqiptar për rolin e madh që ka pasur gjuha shqipe në krijimin e dukurive të përbashkëta në gjuhët ballkanike, një rol i cili jorrallë i është mohuar shqipes në disa artikuj krahasues autorësh të huaj.

Akademiku ynë ka bërë përzgjedhjen e duhur të lëndës dhe në mënyrë të argumentuar i shpjegon çështjet. Ato janë bindëse, të qëndrueshme saqë vështirë se mund të mos pranohen. Studimi përmbledhës e për gjendjen e sotme shterues “Gjuhësi ballkanike” është ndarë në XII krerë. Në fillim jepet historiku i studimeve, duke veçuar ndihmesën e Kopitarit, Mikloshiçit, Vaigandit, Sandfeldit, Selishçevit, rrethit gjuhësor të Pragës etj. Se çfarë temash të diskutueshme, me teza të ndryshme e shpeshherë kundërthënëse, të errëta, me shumë të panjohura e tejet të vështira për të dhënë arsyetime bindëse e argumente shkencore të qëndrueshme ka trajtuar prof. Demiraj në vepërën “Gjuhësi ballkanike”, mund të shihet nga pa-

sqyra e lëndës së kësaj vepre. Të tilla janë, si përpjekjet për shpjegimin e burimit të ballkanizmave: teza e ndikimit të greqishtes, të latinishtes, të substratit. Gjendja gjuhësore e Gadishullit Ballkanik në lashtësi: popujt dhe gjuhët që fliteshin në Gadishullin Ballkanik para dyndjes së fiseve indoevropiane; grekët e vjetër dhe gjuhët e tyre; fqinjët veriorë të grekëve – maqedonët dhe gjuha e tyre; fqinjët veriperëndimorë të grekëve – të ashtuquajturit epirotë dhe gjuha e tyre; ilirët – shtrirja e tyre tokësore; gjuhët e viseve lindore të Ballkanit – trakishtja, dakonizishtja dhe karakteri i tyre satem; gjendja gjuhësore e Gadishullit Ballkanik pas pushtimit romak.⁴⁵

Pas vrojtimit të gjendjes së sotme gjuhësore në Gadishullin Ballkanik (f. 49–70) dhe të dhënave të shumta për shqipen, greqishten e re, rumanishten, bullgarishten, maqedonishten e serbokroatishten, një kapitull i veçantë (kreu IV) i kushtohet bashkëpërkimeve ndërnjet gjuhëve ballkanike në fushën e fonetikës, duke shtjelluar gjerësisht theksin në gjuhët ballkanike, shfaqjen e zanores /ë/ në këto gjuhë si dhe dukurinë e rotacizmit në toskërishte krahasuar edhe me atë të rumanishtes. Në krerë të veçantë shtjellohen bashkëpërkimi i rasave gjinore e dhanore në gjuhët ballkanike, prapavendosja e nyjës shquese, format e kohës së ardhme, rimartja e kundrinave, mënjanimi i paskajores, disa bashkëpërkime të tjera midis gjuhëve ballkanike, duke veçuar në kapitull më vete bashkëpërkimet midis shqipes dhe rumanishtes, për të vazhduar në kreun e fundit për bashkëpërkimet në fushën e fjalorit në gjuhët ballkanike.

Vepra ka edhe një përmbledhje në anglisht në më shumë se 30 faqe (f. 201–234) ku në mënyrë të ngjeshur janë paraqitur

⁴⁵ Shaban Demiraj, *Gjuhësi ballkanike*, Logos – A, Shkup, 1994, f. 6–13.

të arriturat e këtij studimi krahasues, që plotëson e kapërcen studimet e derisotme për gjuhësinë ballkanike.

Tekstin e gjuhësisë ballkanike, si edhe të gjitha studimet e tjera të akademik Shabanit, i përshkon objektiviteti dhe rreptësia shkencore. Shkrimet e profesorit janë disa nga veprat më të mira albanologjike që e ngritën në një shkallë të re cilësore gjuhësinë shqiptare dhe mendimin shkencor.

Në to pasqyrohet jo vetëm puna këmbëngulëse dhe kultura e gjerë, por edhe përkushtimi i jashtëzakonshëm shkencor dhe logjika e argumentit, forca krijuese dhe origjinaliteti i spikatur, qëndrimi kritik e parimor. Ato shënojnë arritje shumëplanëshe, qortojnë një numër tezash e hipotezash të hedhura përpara tij nga studiues të ndryshëm dhe shtrojnë një numër jo të vogël tezash të reja vetjake, të argumentuara me një logjikë të pakundërshtueshme.

Me veprimtarinë shkencore, akademiku ynë dha ndihmesë të madhe për të ndriçuar shumë çështje të errëta të gjuhësisë shqiptare e ballkanike, për të hedhur dritë mbi dukuri të përbashkëta gjuhësore e kulturore midis popujve ballkanikë si dhe për të ngritur shkencat albanologjike krahas studimeve të tjera evropiane.

Vepra e akademik Shaban Demirajt është nga ato që koha nuk ua bjerr, por ua shton vlerat. Duke lexuar shkrimet e albanologut e ballkanologut të madh, jo vetëm që njihemi me të vërtetat shkencore për shqipen dhe shqiptarët, për popujt dhe gjuhët e Ballkanit, por ato na shërbejnë edhe si udhërrëfyes e pika referimi për punën tonë dhe të gjeneratave që do të vijnë.

MIRUSHE HOXHA,

Fakulteti i Filologjisë “Bllazhe Koneski” – Shkup

MËNYRA DËSHIRORE NË MORFOLOGJINË HISTORIKE TË GJUHËS SHQIPE NGA SHABAN DEMIRAJ

Trajta sintetike e mënyrës dëshirore në sistemin foljor të shqipërisë paraqet trajtë të posaçme për të shprehur modalitetin e dëshirës. Ky tip strukturor “nuk ka shoqe në asnjë gjuhë indoevropiane” – do të shprehet profesor Shaban Demiraj, duke bërë hyrjen në kapitullin e mënyrës dëshirore të Morfologjisë historike të gjuhës shqipe⁴⁶. Në gjuhët tjera indoevropiane mënyra dëshirore e dikurshme është zëvendësuar nga mënyra lidhore, ose është përzier me mënyrën lidhore.

Vështirësitë e trajtimit të formantit të posaçëm të së tashmes të dëshirores së shqipes⁴⁷ kanë të bëjnë me sqarimin e zanafillës së tij, pra me vetë origjinën e këtij formanti foljor të shqipes. Profesor Shaban Demiraj do të argumentojë se dëshirorja e shqipes është një formim i brendshëm i shqipes.

Proçesi i formimit të mënyrës dëshirore të shqipes duhet të ketë filluar me përfitimin e formës së vetës së dytë njëjës. Pastaj, mbi këtë bazë duhet të jetë ndërtuar forma e vetës së dytë

⁴⁶ Demiraj, Shaban, 1979, “Morfologjia historike e gjuhës shqipe”, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës: Prishtinë

⁴⁷ Bëhet fjalë për formantin **-sh-** për foljet me temë të dëshirores në bashkëtingëllore, dhe të formantit **-fsh-** për foljet me temë në zanore. Formanti karakteristik në vetën e tretë njëjës për temat foljore në zanore është formanti **-f-**.

shumës. Më vonë duhet të jenë ndërtuar format e tjera vetore të shumësit dhe ajo e vetës së parë njëjës. Dëshirorja (e tashme) e shqipes duhet të jetë përfituar nga kontaminimi i së kryerës së thjeshtë të dëfotres me të tashmen e lidhores – është pikënisja kryesore e profesor Demiraj.

Supozimi është dëshirorja (e tashme) të jetë ndërtuar mbi bazën e së kryerës së thjeshtë të **dëfotres**, që në thelb është një kohë e trashëguar, dhe jo mbi bazën e së kryerës së thjeshtë të lidhores, që duhet të mos ketë ekzistuar. Këtë e dëshmon prania e **-f-** së të dëshirores e foljeve me temë në zanore (p.sh. **kërkofsha**), si dhe fakti që kuptimi kohor i dëshirores takohet me një nga kuptimet e njohura të së kryerës së thejshtë të mënyrës **dëftore**. Duhet pasur parasysh edhe se e kryera e thjeshtë në gjuhën shqipe përdoret edhe me kuptimin e kohës së ardhme dhe kjo ndodh edhe në fjali kryesore, edhe në fjali të varura kushtore dhe lejore të ndërtuara me lidhëzën nënrenditëse *po ose edhe po*.

Supozimi tjetër është që e kryera e thjeshtë, në një fazë të hershme të zhvillimit të shqipes, të jetë përdorë edhe për të uruar kryerjen e një veprimi në të ardhmen, duke e paraqitur atë si të përfunduar, në mënyrë analogjike me rastet kur folësi e paraqet si të kryer një veprim që nuk e ka nisur ende. Me zhvillimin e brendshëm gjuhësor, duhet të jetë ndjere nevoja e përdorimit më të qartë të së kryerës së thjeshtë me vlerën e dëshirores. Për këtë arsye duhet të jetë zëvendësuar, në veten e dyte njëjës, që është veta më e përdorur e dëshirore, mbaresa vetore e së kryerës së thjeshtë me mbaresën **-sh** të lidhores së tashme, duke përfuar në këtë mënyrë forma të reja të tipit : **hap-sh-**, **kendof-sh**. Jo vetëm në gjuhën shqipe, e tashmja e lidhores është përdorë edhe me vlerën e mënyrës dëshirore – dhe ky fakt do ta ketë mundësuar edhe përdorimin

e mbaresës **-sh** të lidhores. Mbi bazën e këtij formimi të ri, shprehet profesor Shaban Demiraj (dhe njëjtë supozon edhe Pedersen), do të jenë ndërtuar pastaj forma e vetës së dytë shumës (**hap-sh-i**, **kerko-fsh-i**), format e vetës së parë e të tretë shumës (**hap-sh-im**, **hap-sh-in**, **kerko-fsh-im**, **kerko-fsh-in**) dhe forma e vetës së parë njëjës (**hap-sh-a**, **kerko-fsh-a**). Ndërkohë që forma e vetës së tretë njëjës (**hap-të**, **kerko-f-të**) duhet të jetë ndërtuar me anë të mbaresës vetore **-të**. Pra, formanti me prapashtesën trajtëformuese **-sh/-fsh** duhet të jetë ndërtuar, me kalimin e shekujve, në një formant të posaçëm, i cili e dallon temën e dëshirores (së tashme) nga temat e tjera të foljes. Për vetën e tretë njëjës ky formant është formanti **-f-** për foljet me temë në zanore dhe formanti zero për foljet me temë në bashkëtingëllore (**hap-të**, **kërko-f-të**). Parashtrohet pyetja: Pse disa folje e kanë formuar dëshiroren nga tema e pjesores? Përgjigja në këtë pyetje mbetet e pasqaruar deri në masë të duhur. Bëhet fjalë në radhë të parë për foljet që e formojnë pjesoren me formantin **-në**, si: **vënë - vënça**; **zë - zënë - zënça**; **jap - dhënë - dhënça** etj. Analogjia ka luajtur një rol të dukshëm në rindërtimin e dëshirores së shumë foljeve. P.sh., format e dëshirores së tipit **ven-ç-a**, **dhën-ç-a** janë forma analogjike. Kjo, sado që modeli, që ka shërbyer për këtë rindërtim analogjik, sot mund të mos jetë aq i kapshëm. Disa nga foljet me pjesore në **-në**, në dëshirore dalin me dy variante. Variant i cili nuk formohet nga tema e pjesores, duhet të jetë varianti më i vjetër. Që do të thotë se, psh, **qo-f-sha** apo **ra-fsh-a** janë më të vjetra se format me përhapje dialektore, psh, **qen-ç-a**, **rën-ç-a** dhe **shtën-ç-a**. Sa për krahasim, fjala **ha**, e cila e formon pjesoren me formantin **-në** (**ngrënë**), e ndërton dëshiroren (**hëngër-sh-a**) nga tema e së kryerës së thjeshtë (**hëngr-a**).

Mbi bazën e pjesores duhet të jenë ndërtuar format sekondare të dëshirores, që ndeshen në të folmet jugore, si **rruash**, **rrua-she**, **rruati**.

“Hoistoria morfologjike” do të theksojë edhe se në disa të folme fundorja **-sh**, përkatësisht **-s** e dëshirores duhet të jetë zhdukur para formantit të dëshirores, ose të jetë shkruar me te, duke dhënë p.sh, trajtat paça, godiça etj.

Mbi pikërisht bazën e formës sintetike të dëshirores, formës së pashoqe në gjuhët tjera indoevropiane, është ndërtuar e kryera analitike e dëshirores me përdorim të kufizuar. Kjo formë analitike është ndërtuar me anë të dëshirores së tashme të foljes ndihmëse **kam** (përkatësisht **jam**) dhe pjesores së foljes themelore, si p.sh. **paça larë** (**qofsha larë**).

Referencat e „Morfologjise historike te gjuhes shqipe,, jane studimet e Gustav Meyer – nga njëra anë, i cili formën e tipit **këndofsha** e nxjerr nga më se e kryera e lidhore latine e tipit **cantavissem** – dhe, nga ana tjetër, studimet e Bopp, Pedersen, Domi, Mihaescu etj., sipas të cilëve dëshiroreja e shqipes është një formim i brendshëm i kësaj gjuhe.

Në rrafshin e dilemave rreth origjinës latine të dëshirores së tipit **këndofsha** që e parashtron Meyer, njera nga pyetjet kyçe të profesor Demiraj, është: Si do të ketë qenë e mundur që më se e kryera e lidhore në latinishten vulgare ballkanike të jetë interpretuar si një e tashme e dëshirores në gjuhën shqipe? Në cilin rast më se e kryera e lidhore latine do të mund të interpretohej si një dëshirore e tashme në gjuhën shqipe?

Le të nisim nga përgjigja në pyetjen e fundit:

Më se e kryera e lidhore latine do të mund të interpretohej si një dëshirore e tashme në gjuhën shqipe, vetëm nëse në gjuhën shqipe në kohën e kontakteve të saja me latinishten ndjenja e dallimit formal të mënyrës dëshirore ishte shumë e fortë.

Ndërkohë që kalimi nga kuptimi i më se të kryerës së lidhore latine në kuptimin e kohës së ardhme, e që e shpreh e tashmja e dëshirores së shqipes, sipas profesor Demiraj, është pothuajse i pamundur. Bëhet fjalë për kalimin e një kohe relative në kohën e tashme, jo në kohën e ardhme për shembull⁴⁸. Sipas profesor Shaban Demiraj, mendimi i Meyerit është i pambështetur edhe për arsye të karakterit fonetik: format proparo-ksitone të tipit **cantavissem** nuk duhet të kenë ekzistuar në bazë të ligjeve të prozodise latine (në latinishte theksi binte detyrimisht mbi rrokjen e parafundit kur kjo ishte e gjatë), gjithashtu, ruajtja e **v**-së midis dy zanoreve është në kundërshtim me të dhënat e fonetikës historike të shqipes⁴⁹. I pambështetur fonetikiqist mbetet edhe evolucioni **-a- : -c-**. As forma e rregullt **cantavissem** nuk mund të jepte formën **këndofsha** ne gjuhen shqipe, argumenton profesor Demiraj, sepse **v**-ja midis dy zanoreve duhet të kishte rënë, kurse zanorja e theksuar **-i-** duhej të ishte ruajtur⁵⁰.

Duke i marrë parasysh faktet evidente, dëshirorja e shqipes rezulton të jetë një formim i brendshëm i shqipes – sado që mënyra e formimit të saj mbetet e pasqaruar deri në masë të duhur.

Si bazë do të merren mendimi i Boppit dhe i Pedersenit, se dëshirorja e shqipes e ka burimin tek “e kryera e thjeshtë e lidhore”⁵¹, për ta dëshmuar pastaj prejardhjen e dëshirores në të kryerën e thjeshtë të dëftores.

⁴⁸ Për krahasim, profesor Demiraj merr rastin e rastin e rumanishtes, trashëgueses së drejtpërdrejt të latinishtes vullgare ballkanike, e cila sipas studiuesit Sandfeld do të dëshmojë se në këtë gjuhë, më se e kryera e lidhore latine ka marrë vlerën e më se të kryerës së mënyrës dëftore.

⁴⁹ Demiraj, Shaban, *ibid.*, f. 315.

⁵⁰ *Ibid.*

⁵¹ *Ibid.*, f. 316–323.

Kjo dëshmi nis me argumentimin e tri çështjeve, duke filluar nga vërejtja e parë: A ka ekzistuar me të vërtetë një e kryer e thjeshtë e lidhore, e ndërtuar sipas modelit të së tashmes të lidhore dhe që është dalluar nga formimi korrespondues i mënyrës dëfotre vetëm në vetën e dytë dhe të tretë njëjës, ashtu siç ndodh në përgjithësi në kohën e tashme të këtyre dy mënyrave? Vërejtja e dytë: Si të argumentohet prania e mbaresës së vetës së parë **-a**, që është karakteristike për të kryerën e thjeshtë të dëftores (psh **hap-a**), krahas mbaresave tjera të dëshirores që përkojnë me ato të kohës së tashme? Dhe, vërejtja e tretë: A është shpjeguar bindshëm mendimi se disa folje e formojnë dëshiroren nga tema e pjesores?

Është shumë e dyshimtë, në mos e pamundur, do të argumentojë profesor Demiraj, që të ketë ekzistuar në gjuhën shqipe një e kryer e thjeshtë e lidhore, në mënyrën siç e koncepton Pedersen. Kuptimi i një kohe të tillë është i papajtueshem me modalitetin e lidhore: e kryera e thjeshtë e shqipes e paraqet veprimin të përfunduar, kurse mënyra lidhore e paraqet veprimin si të mundshëm. Kjo duhet të jetë dhe arsyeja që në shumicën e gjuhëve indoevropiane të jenë përfutur kryesisht koha e tashme e lidhore dhe, pastaj, mbi bazen e kësaj, e pakryera e lidhore, si dhe format analogjike të së kryerës dhe të më se të kryerës.

Sipas profesor Demiraj, i pambështetur është shpjegimi i dhënë nga Pedersen për ndërtimin e dëshirores së disa foljeve nga tema e pjesores, nëse “kuptimi i dëshirores në fjalinë e varur është takuar me atë të formave perifrastike të tipit **kam li-dhur**”⁵², ndërkohë që duhet marrë në vështrim supozimin e Pedersen se “bashkimi me pjesoren ishte edhe më i lehtë,

⁵² Ibid., f. 317

sepse e kryera e thjeshtë në shumë raste përkon me pjesoren: **lidh-a, lidh-ur**”⁵³.

Si përfundim, “Morfologjia historike e gjuhës shqipe” nga profesor Shaban Demiraj do të rritet se vjetërsia e dëshirës së gjuhës shqipe, zanafilla e saj, dëshirorja e shqipes së dokumentuar është përfituar shumë shekuj para Buzukut e Matrëngës. Megjithatë, format e dëshirores të tipit **punofsha** nuk mund të jenë kështu para se të shfaqej tingulli parahiatit – **v**– te e kryera e thjeshtë e foljeve me temë në zanore. Pra, zanafilla e formave të këtij tipi duhet kërkuar pas shfaqjes së këtij tingulli antihiatizues – në periudhën paslatine të shqipes.

Referencat:

Demiraj, Shaban, 1979, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe*, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës: Prishtinë.

Bop, Franc, te: Shaban Demiraj, 1979, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe*, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës: Prishtinë.

Meyer, Gustav te: Shaban Demiraj, 1979, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe*, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës: Prishtinë.

Pedersen, Holger, te: Shaban Demiraj, 1979, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe*, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës: Prishtinë.

⁵³ Ibid.

VALBONA TOSKA,

Fakulteti i Filologjisë “Bllazhe Koneski” – Shkup

**ÇËSHTJA E RIMARRJES SË KUNDRINËS NË
„GJUHËSINË BALLKANIKE” TË SHABAN DEMIRAJT**

Opusi i gjerë dhe niveli i lartë shkencor i veprave të akademik Shaban Demirajt, gjuhëtarit që depërtoi thellë në esencën e problemeve më të rëndësishme të gjuhësisë shqiptare dhe jo vetëm të saj, flasin për përkushtimin e tij të madh dhe për seriozitetin në trajtimet plot kompetencë.

Një prej kontributeve të tij shumë të rëndësishme gjithësesi është edhe ai i dhënë në fushën e balkanologjisë, kontribut ky që i siguroi vend të merituar edhe në kulturën dhe shkencën evropiane. Vepra „Gjuhësi ballkanike” paraqet një sintezë të studimeve të shumë temave mbi gjuhësinë ballkanike, siç janë: gjendja gjuhësore në Gadishullin Ballkanik, disa bashkëpërkime në fushën e fonetikës dhe në kuadër të rasave gjinore dhe dhanore, prapavendosja e nyjës shquese, format e kohës së ardhme, rimarrja e kundrinave, mënjanimi i paskajores, si dhe disa bashkëpërkime të tjera.

Rimarrjen e kundrinës, në këtë vepër, prof. Shaban Demiraj e trajton në kreun VIII, në kapitullin që paraqet një tërësi studimi sinkronik dhe diakronik të këtij tipari të përbashkët sintaksor të gjuhëve të arealit ballkanik.

Në fillim prof. Sh. Demiraj hedh dritë mbi historikun e kësaj dukurie, duke konstatuar se “kjo dukuri sintaksore, që është përhapur ku më shumë e ku më pak në të gjitha gjuhët ballkanike, është vështuar në përgjithësi si një ballkanizëm, sado që ajo është shfaqur edhe në gjuhët romane perëndimore”. Vlen të theksohet edhe konstatimi se “një zhvillim më të

madh kjo dukuri sintaksore ka marrë sidomos në shqipe dhe maqedonishte⁵⁴.

Në vijim prof. Demiraj shqyrton rimarrjen e kundrinës së drejtë në gjuhën shqipe, të shprehur nëpërmjet vetorëve të dy vetave të para, duke e trajtuar “si një dukuri të përgjithësuar, kur ajo shprehet me anë të formave të theksuara, pavarësisht nga topika e tyre *para* apo *pas* foljes kallëzues. Në këtë përdorim kundrina e drejtë përfaqëson *remën* e kumtimit. Kurse në rolin e *temës* së kumtimit në këtë rast ajo shprehet rregullisht vetëm nëpërmjet formave të patheksuara të përenrave vetorë të dy vetave të para në rasën kallëzore: *më, të, na, ju*”⁵⁵.

Ndryshe qëndron puna, thotë dijetari ynë, me kundrinën e drejtë të shprehur nëpërmjet fjalësh të tjera (përveç përenrave vetorë të dy vetave të para), kur përfaqëson temën e kumtimit, atëherë shprehet ose vetëm nëpërmjet formës së patheksuar të përenrit vetor të vetës së tretë, njëjës apo shumës (*e, i*) ose njëkohësisht edhe me formën e plotë të saj, që mund të jetë një emër, një togfjalësh emëror a një fjali e nënrenditur, apo një përemër çfarëdo (përfashtuar vetorët e dy vetave të para).⁵⁶

Rreth rimarrjes së kundrinës së zhdrejtë, Demiraj thotë se në shqipen e sotme “kundrina e zhdrejtë rimerret pavarësisht nga topika e saj *para* apo *pas* foljes kallëzues. Në këtë përdorim ajo përfaqëson *remën* e kumtimit, kur shprehet nëpërmjet përenrave vetorë të dy vetave të para (p.sh. *Po të flas ty* (e jo atij). *Ty po të flas. M’i jep mua ato* (dhe jo atij). *Mua mos m’i kallëzo ato gjëra*)⁵⁷. Rimarrja e kundrinës së zhdrejtë në shqipen e sotme

⁵⁴ Demiraj, Shaban, Gjuhësi ballkanike, Logos-A, Shkup, 1994: 127

⁵⁵ Ibid.: 128

⁵⁶ Ibid.

⁵⁷ Ibid. :129

bëhet jo vetëm kur përfaqëson *remën*, por edhe kur përfaqëson *temën* e kumtimit, vazhdon prof. Demiraj.

Si faktori kryesor që i ka dhënë shkas rimarrjes së kundrinave të shprehura nëpërmjet përenrave vetorë të dy vetave të para, Demiraj e konsideron synimin e folësit për të vënë në dukje sa më shumë gjymtyrën plotësuese kryesore të kallëzuesit, kur ajo ka përbërë gjënë e re të kumtimit, *remën*.

Duke u nisur nga fakti që rimarrja e kundrinës paraqet pjesë përbërëse të strukturës morfo-sintaksore të gjuhëve ballkanike, këtë dukuri, dijetari ynë, nuk e shqyrton në formë të izoluar vetëm në njërin nga këto gjuhë, por mban llogari për të edhe në gjuhët e tjera. Prandaj, në paragrafët në vijim, jepet një pasqyrë e rimarrjes së kundrinave në rumanishte, bullgarishte, maqedonishte dhe në greqishte dhe sillen argumente për kohën e shfaqjes së saj në gjuhët përkatëse, duke pasur parasysh faktin se përkrah tipareve të përbashkëta, ky ndërtim në gjuhët përkatëse ballkanike ka edhe karakteristika specifike, si në mënyrën e përdorimit, ashtu edhe në domosdoshmërinë e përdorimit të tij.

Studimi vazhdon me prezantimin e mendimeve të ndryshme mbi burimin e rimarrjes së kundrinave në gjuhët ballkanike, duke shprehur mendim të argumentuar kritik për hipotezën e Mikloshiçit dhe të Leskien-it mbi ndikimin e substratit, për mendimet e Ilievskit, Boissin-it, Budagovit dhe të Lopashovit, si dhe për teorinë e gjymtiritimit aktual të fjalisë.

Kapitulli mbaron me vështrimet e autorit si duhet të shpjegohet rimarrja e kundrinave në gjuhët ballkanike dhe në gjuhët romane perëndimore.

Përfundimet e akademik Shaban Demirajt se “rimarrja, përkatësisht anticipimi i kundrinave nëpërmjet formave të patheksuara të përenrave vetorë në gjuhët ballkanike, në thelb,

s'është gjë tjetër veçse një përdorim ridondant i mjeteve leksiko-sintaksore për qëllime të caktuara kumtimore.; Kundërvënies morfo-sintaksore kundrinë e dyfishuar kundrinë e padyfishuar, në thelb, i përgjigjet edhe një kundërvënie me karakter kumtimor.; Këto dy kundërvënie s'janë gjë tjetër veçse dy anë të ndryshme të një dukurie të vetme, në vështrimin që secila nga të dy gjymtyrët e njërës kundërvënie nuk mund të mendohet e shkëputur nga gjymtyra gjegjëse e kundërvënies tjetër" dhe përfundimet se "një dukuri e tillë nuk mund të shfaqej, në rast se në gjuhët, ku ajo është përftuar, nuk do të ishte zhvilluar prirja për një qartësim sa më të madh të kumtimit gojor nëpërmjet përdorimit ridondant të mjeteve leksiko-gramatikore ose thjesht gramatikore", paraqesin një konstatim se rimarrja e kundrinave dhe mjetet gjuhësore që e shprehin atë duhet shqyrtuar jo vetëm në kuadër të gramatikës formale, por edhe në kuadër të perspektivës dhe funksionit komunikativ të ligjërimit.

Thënë shkurt, çështja e rimarrjes së kundrinave në „Gjuhësinë ballkanike” të prof. Shaban Demirajt paraqet një analizë gjithëpërfshirëse të gjuhëve të *lidhjes gjuhësore ballkanike*, në të cilën bëhet një studim i brendshëm i kësaj dukurie në gjuhët përkatëse, duke shqyrtuar kohën e paraqitjes, rrugën e zhvillimit, nivelin e gramatikalizimit dhe karakteristikat e përdorimit të saj.

Kontributi i akademik Shaban Demirajt në sqarimin e rrugës që ka përshkuar dukuria e rimarrjes së kundrinave, kontributi i tij në dëshmimin që shqipja, si një nga gjuhët më të vjetra në Ballkan, ka një rol domethënës në bartjen e kësaj dukurie, si dhe prezantimi i rimarrjes së kundrinës në gjuhët ballkanike në një platformë të përbashkët, pa dyshim që paraqet një pikënisje për studimet e mëtejme në këtë drejtim. Kjo më së

miri dëshmohej me faktin që edhe studimet bashkëkohore për rimarrjen e kundrinës si dukuri ballkanike, në fakt u referohen konstimeve të prof. Shaban Demirajt. Edhe pse në këto studime rimarrja e kundrinës shtjellohet me nocione të terminologjisë bashkëkohore, si p.sh. *Rimarrja e kundrinës së drejtë varet nga prezenca ose mosprezenca e fokusit/fokusimit të objektit* (Kallulli) ose *Rimarrja e kundrinës së drejtë në gjuhën shqipe varet nga topikalizimi i kundrinës së drejtë në trajtën e shquar, përkatësisht nga lidhja mes strukturës së tekstit dhe situatës kumtuese që e ka krijuar atë* (Fridman), prapë se prapë edhe këto qasje i referohen pikërisht **strukturës informative të ligjërimin**, apo, atyre, që akademik Shaban Demiraj në studimet e tij, i emërtonte me termat tradicionale *temë ~ remë; situatë përdorimi; situatë ligjërimi; synimi i folësit për ta vënë në dukje sa më shumë gjymtyrën plotësuese kryesore të kallëzuesit kur ajo përbën gjënë e re të kumtimit; (dukuria është përfutur në fillim nëpër) fjali emfatike; dëshira e folësit për ta konkretizuar e për ta përcaktuar më mirë përmbajtjen kuptimore të atyre përemrave, të cilët kanë një kuptim shumë të pacaktuar; theks logjik*.

Çështja e rimarrjes së kundrinave, veçanërisht në fushën e interferencave gjuhësore, mbetet një çështje shumë interesante për studiuesit, ashtu siç mbetet i pamohueshëm fakti që dijetari ynë i nderuar Shaban Demiraj këtë dukuri e pasqyroi shkencërisht dhe me një peshë të madhe argumentimi.

ISMET OSMANI,

Fakulteti i Filologjisë “Bllazhe Koneski” – Shkup

STUDIME TË PROF. SHABAN DEMIRAJT NË LËMË TË TRASHËGIMISË KULTURORE

Prof. Shaban Demiraj është një ndër gjuhëtarët që i solli shkencës gjuhësore shqiptare, por edhe asaj ballkanike, vlera të mëdha shkencore. Prof. Sh. Demiraj, në studimet e tij në fushën e gjuhësisë shqiptare lë një trashëgimi të vyer shkencore. Ndër studimet e tij shquhen veprat monumentale ku veçohen: “Gramatika historike e gjuhës shqipe”, “Gjuha shqipe dhe historia e saj”, “Epiri, Pellazgët, Etruskët dhe Shqiptarët”, “Fonologjia historike e gjuhës shqipe”, “Prejardhja e Shqiptarëve në dritën e dëshmive të gjuhës shqipe”, “Gjuhësi ballkanike” etj. Ndër studimet e prof. Shaban Demirajt, tërheqin vëmendjen edhe artikuj të shumtë studimor të botuar në revista të ndryshme.

Ndër studimet e tij që lënë gjurmë të pashlyera në fushën e gjuhësisë shqiptare, janë edhe veprat në fushën e gramatikës dhe fonetikës historike, ku autori rrah problemet historike të shqipes duke mbështetur apo hedhur poshtë me argumente gjuhësore teza të ndryshme që kanë të bëjnë me gjuhën gjuhën shqipe dhe me historinë e gjuhës. Kontributi i tij në fushën e gjuhësisë historike, përkatësisht në fushën e morfologjisë historike, lidhjet e shqipes me gjuhët tjera fqinje, është një ndihmesë e vyer e prof. Shaban Demirajt për të dëshmuar autoktoninë e shqiptarëve në këto troje. Nëpërmjet studimeve të tij zbardhen të dhëna të dokumentuara të zbuluara nga fazat

e hershme të gjuhës shqipe. Kështu, prof. Shaban Demiraj jep një kontribut të veçantë për etnogenezën e shqiptarëve.

Studimet e tij mbi historinë e gjuhës duke filluar tek autorët e vjetër, te rilindësit e deri në ditët tona, trajtohen në mënyrë të gërshtetuar dhe të dokumentuar. Kështu, në studimet e tij në mënyrë të qartë vihen në dukje marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera, që është një kontribut i vyer i prof. Demirajt në studimin e marrëdhënieve të shqipes me pellazgjishten, me greqishten, me latinishten, me sllavishten, për çështje që lidhen me Epirin dhe me mesapët, të cilët e vendosin shqipen në shtratin e saj iliri. Në dy veprat e tij "Gjuha shqipe dhe historia e saj" (1988) dhe "Gjuhësi ballkanike" (1994), e përkthyer edhe në maqedonisht, prof. Sh. Demiraj synon të vë shqipen ilirishten në kontekstin historik dhe gjeografik të Ballkanit. Ndërsa, në dy veprat tjera "Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmimeve të gjuhës shqipe" (1999) dhe "Epiri, pellazgët, etruskët dhe shqiptarët" vihen në spikamë tezat mbi lidhjet historike të shqiptarëve me popuj tjerë. Në këtë të fundit "Epiri, pellazgët, etruskët dhe shqiptarët", prof. Sh. Demiraj, përpiket t'i zbardh shumë probleme të cilat kanë mbetur të pasqaruara, siç janë etruskët, pellazgët dhe mesapët dhe lidhjet e tyre me shqiptarët. Prof. Shaban Demiraj, në këtë vepër trajton pellazgët dhe lidhjet e tyre me etruskët dhe shqiptarët. Lidhur me prejardhjen pellazgjike të shqipes, autori arrin në përfundimin se pellazgjishtja ka qenë një gjuhë e ndryshme edhe nga greqishtja, edhe nga shqipja. Në këtë vepër porf. Demiraj, përpiket të jetë objektiv në qëndrimet e tij, i zhveshur nga notat e patriotizmit, gjë që i bën më të besueshme dhe më të qëndrueshme qëndrimet e tij.

Prof. Shaban Demiraj, në vazhden e studimeve të tij mbi gjuhën, trajton edhe tema nga fusha e dialektologjisë, duke dhë-

në një kontribut të madh për sa i përket dialektologjisë historike, dialekteve aktuale të shqipes, marrëdhënieve mes tyre, të folmeve arbëreshe e, posaçërisht edhe për vendlindjen ka bërë disa hulumtime rreth gjuhës së fshatrave të bregut në dritën e arritjeve gjuhësore. Të gjitha analizat dhe arsyetimet në këtë fushë qëndrojnë në bazë të punës së studiuesve të gjuhës shqipe qofshin shqiptarë a të huaj, mbi të gjitha flet për një objektivitet shkencor të trajtimit të historisë së gjuhës shqipe dhe të dialekteve të saj.

Në fund, duhet veçuar edhe qëndrimin e tij të palëkundur rreth çështjes shumë të debatuar aktualisht, mbi standardin e shqipes. Prof. Demiraj në mënyrë të argumentuar dhe të qartë përmes studimeve teorike e praktike vë në dukje domosdoshmërinë e standardit, i cili hodhi themelet e drejtshkrimit, si një gjuhë e njësuar qysh në 1908 dhe u kurorëzuar më tej me Kongresin e Drejtshkrimit. Vepra e prof. Demirajt është një kontribut i vyer, që do të vijojë të formojë me dije brezat e ardhshëm si dhe do të jetë një hapësirë e madhe referimi për këdo që do të merret me çështje të albanologjisë.

Literatura

1. DEMIRAJ, Shaban (1968), Historia e gjuhës së shkruar shqipe, Tiranë.
2. DEMIRAJ, Shaban (1956), Leksikologjia dhe fonetika e gjuhës shqipe, Tiranë.
3. DEMIRAJ, Shaban (1960), Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe, Tiranë.
4. DEMIRAJ, Shaban (1973, 1976), Morfologjia historike e gjuhës shqipe I, II, Tiranë.

5. DEMIRAJ, Shaban (1986), Gramatika historike e gjuhës shqipe, Tiranë.
6. DEMIRAJ, Shaban (1988), Gjuha shqipe dhe historia e saj, Tiranë.
7. DEMIRAJ, Shaban (1990), Eqrem Çabej—një jetë ku—shtuar shkencës, Tiranë.

MUSTAFA IBRAHIMI,

UEJL – Tetovë

SHABAN DEMIRAJ PËR ETNOSIN ARBËRESH DHE PËR RËNDËSINË E GJUHËS ARBËRESHE

Duke ecur në hullinë e çelur nga dijetarë paraardhës shqiptarë dhe nga albanologë të huaj të mirënjohur të cilët u morën me historinë dhe parahistorinë e popullit shqiptarë, Shaban Demiraj do ta shqyrtoj këtë problematikë duke marr në vështrim kohën *kur* dhe *ku* është formësuar etnosi shqiptarë si një etnos më vete.

Kontribut të çmuar do të japë edhe lidhur me emrin e lashtë të popullit dhe të gjuhës sonë dhe sidomos për vijimësinë e etnonimit arbër duke ditur se specialisti i ngushtë i Akademikut Demiraj është ai i historianit të shqipes.

Në studimet e tij, Demiraj sjell edhe të dhëna të rëndësishme për rëndësinë e të folmeve arbëreshe në historinë e gjuhës shqipe, duke theksuar se *të dhënat e arbërishtes kanë një rëndësi të dyfishtë për historinë e gjuhës shqipe*. Në njërën anë shërbejnë për të pasuruar trashëgiminë evropiane të gjuhës shqipe dhe në anën tjetër për të kuptuar më mirë prirjet e evolucionit të gjuhës shqipe.

1. Formësimi i etnosit arbëresh

Koha e formësimit të etnosit arbëresh sipas Demirajt paraqitet mjaft e ndërlikuar, pasi njohuritë për stërgjyshërit e drejtpërdrejtë të tyre janë ende të mbuluara nga një mjegull të dendur. Për këtë arsye për prejardhjen e etnosit arbëresh janë

parashtruar shumë mendime dhe është bërë objekt studimi nga shumë studiues (shih Çabej 1972; Demiraj 1999). Si shumë studiues të huaj dhe të vendit, edhe Demiraj pajtohet se “nëpërmjet një shqyrtimi të vetë dëshmnive të gjuhës shqipe mund të pohohet se stërgjyshërit e pandërmjetëm të arbëreshëve kanë qenë ilirët e jugut (Demiraj 2003:88) ose ilirët e mirëfilltë (Illyroi proprie diti – siç i quan ata historiani romak Pomponius Mela (Katiçiq 1976:158).

Sipas Shaban Demirajt, pyetjeve *ku* dhe *kur* është formësuar etnosi arbëresh s’mund të ndriçohet, pa sqaruar edhe pyetjen se *cilët* kanë qenë stërgjyshërit e pandërmjetëm të arbëreshëve. Kjo do të ishte shumë lehtë të përgjigjej, pohon më tutje Demiraj sikur të kishim dëshmi historike të qarta apo materiale të shkruara nga popullsia a fiset, që banonin në lashtësi në trojet e banuara sot nga shqiptarët. Megjithatë, në këtë rast, në mungesë të dëshmnive të tilla të drejtpërdrejta, janë shfrytëzuar dëshmi të tërthorta kryesisht të karakterit historik dhe gjuhësor. Studiuesi Demiraj, për këtë çështje mbështet studiuesit e huaj, sidomos Johannes Thunmann dhe Hahni të cilët përkrahin tezën e prejardhjes ilire të shqiptarëve të sotëm.

Në studimet e veta, Shaban Demiraj na sjell edhe shumë dëshmi që na jep gjuha shqipe për një prani të hershme të tyre në brigjet lindore të Adriatikut dhe të Jonit, siç janë:

1. Në gjuhën shqipe ka një numër jo aq të vogël huazimesh nga greqishtja e vjetër, që kanë depërtuar drejtpërdrejt. Për këtë dëshmojnë disa ndërrime të lashta fonetike, siç është ndërrimi $a > o$ te huazimi *mokën(ë)/mokër(ë)* nga trajta e dialektit dorik *mak^hana*. Në këtë huazim bie në sy edhe lëvizja e theksit nga rrokja fundore e greqishtes në rrokjen nistore, kjo vjetërsi dëshmohet edhe nga evolucioni $/k^h/ > /k/$. (Demiraj 2003:91).

2. Depërtimi i një numri të madh huazimesh latine në gjuhën shqipe, që kanë hyrë që nga shekulli II p.e. është dëshmi e qartë e kontakteve të hershme dhe të gjata midis stërgjyshërve të shqiptarëve dhe romakëve në brigjet lindore të Adriatikut e të Jonit. Një përfundim të tillë vërtetohet edhe nëpërmjet disa ndërrimeve të lashta fonetike, që kanë pësuar huazimet latine të shqipes, si janë: /o/ > /e/ (p.sh. *pomum* > *pemë*, *hora* > *herë* etj.) dhe ndërrimi /au/ > /a/ (p.sh. *gau-dium* > *gaz*, *agrum* > *ar*) etj.

3. Një tjetër dëshmi për praninë hershme të shqiptarëve në brigjet e Adriatikut dhe Jonit na japin edhe emrat e disa vendbanimeve të lashta, si *Durrësi*, *Shkodra*, *Leshi*, *Ishmi*, *Vlona/Vlora* etj. që kanë pasuar ndryshime fonetike në përputhje të plotë me ligjësitë e evolucionit fonetik të gjuhës shqipe.

4. Edhe ndarja dialektore e shqipes është një dëshmi e pranisë së hershme të shqiptarëve në trojet e tyre të sotme. Mjafton të kihet parasysh se rotacizmi /n/ > /r/ dhe /a- / > /ë- / nuk janë shfaqur në huazimet sllave të shqipes por i takojnë periudhës parasllave të gjuhës sonë. (shih edhe Hamp 1966:98).

Si rrjedhim i kësaj, Demiraj mbështet mendimin se stërgjyshërit e pandërmjetëm të shqiptarëve duhet kërkuar tek ilirët e jugut.

Profesor Demiraj, megjithatë parashtron edhe një pyetje mjaft interesante, se si është e mundshme që stërgjyshërit e shqiptarëve t'i kanë shpëtuar procesit të romanizimit, kur dihet se trevat e Ilirisë së Jugut u pushtuan shumë herët nga romakët dhe mbetën për një kohë të gjatë nën sundimin e tyre? Kurse, nga ana tjetër, stërgjyshërit e rumunëve, dakët, megjithëse u pushtuan më pas dhe nuk qëndruan gjatë nën sundimin romak, u romanizuan. Një nga argumentimet e Demirajt për

këtë çështje është se një pjesë e mirë e stërgjyshërve shqiptarë që kanë jetuar nëpër qytetet bregdetare, kanë qenë romani-zuar, por banorët e viseve malore, mundën ta ruanin gjuhën dhe identitetin e tyre etnik. (Demiraj 2003:93; shih për këtë edhe Pellagrini 1995:198). Ndër faktorët tjerë, Demiraj përmend edhe karakterin konservues i këtij etnosi, si shembull i merr arbëreshët në Itali dhe Greqi të cilët edhe pas disa shekujsh e kanë ruajtur gjuhën amtare deri në ditët tona, sepse kanë bërë një jetë të izoluar.

Se kur duhet të jetë kryer ky proces kalimi nga paraarbëreshët a ilirët e jugut në atë bashkësi etnike, që u quajt *e arbëreshe* / *e arbëreshe*? Shaban Demiraj në ndihmë merr disa dëshmi gjuhësore mbarëshqiptare në sistemin fonologjik dhe në strukturën gramatikore, siç janë shfaqja e zanoreve /y/ dhe /ë/. Sipas Demirajt, që të dyja janë shfaqur para kontakteve të shqipes me sllavishten, d.m.th para shekujve VI–VII të erës sonë. Në nënsistemin bashkëtingëllor duhet përmendur shfaqja e bashkëtingëlloreve mbylltore qiellzore /q/ dhe /gj/ dhe e bashkëtingëlloreve afrikate /c/ – /x/ dhe /ç/ – /xh/, gjithnjë para kontakteve të shqipes me sllavishten.

2. Rreth trajtave të etnonimit “Arbër”

Pyetjes për vijimësinë e etnonimit arbër në jetën e përditshme dhe dokumentet e ndryshme, ashtu si Eqrem Çabej edhe Shaban Demiraj, u janë përgjigjur se kjo ka ndodhur me mënyrën e jetesës së popullit shqiptar (në fise dhe në një homologjenitet të pamjaftueshëm për të shtrirë dhe mbajtur gjallë një emër etnik të përbashkët). Ndryshe nga Çabej, Demiraj e studiues të tjerë dhe sidomos M. Pirraku, që e vejnë në dyshim një emër të mundshëm për tërë popullin, Osman Myderrizi homogjenitetin e mundshëm e gjen te rreziku nga

ndërhyrjet e sllavëve në mesjetë: «Kundërshtimi e fërkimi i pandamë me këta të huaj (sllavët) zgjoi ndjenjën e solidarësisë etnike ndër fise të ndryshme ilire të Epirit, të Maqedonisë e të Ilirisë e si konsekuencë duel edhe pranimi i një emri të përbashkët, për t'u paraqitur si një fuqi e bashkuar kundra tyre.

Profesor Shaban Demiraj mendon se trajta latine: «Arbanum, Albanum (-r->-l-) lidhet me trajtën më të herëshme Arban», por mendon gjithashtu se «me sa duket trajta me nisto-ren /-al/ ka pasur një përdorim më të dendur ndër banorët e përtej Adriatikut, sepse ndër italianët dhe nëpërmjet këtyre edhe ndër popujt e tjerë të Evropës, është përhapur me nisto-ren /-al/». I vetmi problem i paqartësuar nga këto trajta, sipas Demirajt është burimi i trajtave greke Alvanoi (a Albanoi?), Arvanon (a Arbanon?), arvanitis, që dëshmohen në shekujt XI-XII».

Sipas tij Vuku e mori emrin arnaut nga turqishtja dhe e shënoi në pajtim me gjuhën popullore, që është në pajtim edhe me mendimin e Sh. Demirajt për dy trajta paralele të emrit arbër në gjuhën popullore dhe në gjuhën e shkruar edhe të krahut oksidental.

Kur jemi këtu, te disa procese gramatikore e fonetike, është interesant një mendim i Shaban Demirajt për trajtën më të vjetër sllave Rabënë dhe arbanas. Sipas tij «trajta më e vjetër sllave është Rabënë, -është krijuar më herët, pra kur janë takuar stërgjyshërit e shqiptarëve dhe sllavëve, ndërsa trajta arbanas është pranuar nga forma librore dhe njerëzit e shkolluar në vise evropiane». Një pyetjeje të mundshme, sepse këtë trajtë Rabënë e kanë vetëm dokumentet serbe, e jo edhe ato bullgare, kur dihet se shenjat më të moçme sllave janë pikërisht të ndikimit bullgar, do të mund t'i përgjigjeshim në interes të saktësisimit të problemit në fjalë. Trajta Rabënë u kri-

jua, jo kur sllavët u dynden në trojet shqiptare, por kur jetonin në fqinjësi me ta dhe natyrisht këmbenin marrëdhëniet materiale dhe shpirtërore të tyre.

3. Kontributi për të folmet e arbëreshëve të Italisë

Edhe pse Shaban Demiraj nuk është marrë drejtpërdrejt me studimin e dialekteve të shqipes, në studimet dhe hulumtimet e tij, u është qasur e referuar dendur të dhënave të dialekteve të shqipes. Në mënyrë të veçantë, ai u është referuar të dhënave të të folmeve arbëreshe të Italisë. Të parin vështrim mbi të folmet arbëreshe të Italisë, Sh. Demiraj na e ka dhënë në tekstin *“Historia e gjuhës së shkruar shqipe”*, (botuar në formë dispense më 1962 nga Katedra e Gjuhës Shqipe e Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë), ku trajton gjerë historinë e gjuhës së shkruar të arbëreshëve të Italisë dhe, në fakt nis me një hyrje të titulluar *“Një vështrim mbi të folmet arbëreshe të Italisë”* (Demiraj 1962:1–51).

Me aq literaturë sa dispononte, Sh.Demiraj arrinë të na japë një ide mjaft të qartë të situatës dialektore të diasporës arbëreshe të Italisë. Ai thotë: *Të folmet e arbëreshëve të Italisë paraqiten si ishuj të vegjël gjuhësor me kontakte të pakta midis syresh. Ato, megjithatë kanë disa ndryshime nga të folmet e Shqipërisë, janë të folme të gjuhës shqipe: struktura gramatike e tyre është po ajo e gjuhës shqipe dhe fjalori i tyre, megjithëse është ndikuar mjaft nga italishtja dhe nga greqishtja, e ka ruajtur fondin themelor të fjalëve të vjetra shqipe*. (Demiraj 1962:1). Me këtë, të folmet arbëreshe kanë karakter arkaik, duke ruajtur ende disa tipare të shqipes a arbërishtes së periudhës së mesme, që me kalimin e kohës ose janë zhdukur fare në të folmet e Shqipërisë, ose janë ruajtur pjesërisht në ndonjë nëndialekt konservator, siç është çamërishtja. (Demiraj 1962:1).

Shaban Demiraj dallon dy lloj arkaizmach: *arkaizma leksikore dhe arkaizma kuptimore*. Si arkaizma leksikore, përmend: *delmer, përderës, gjegj, prier, m'u ndot "m'u duk"* etj., kurse si arkaizma kuptimore sjell: *gjellë "jetë", petëk "pronë", botë dhe tokë, ndëlkomj "kuptoj", çel "ndez", çonj "gjej"* etj.

Shaban Demiraj paraqet dhe tiparet arkaike në sistemin fonetik të ligjëtimeve arbëreshe të Italisë, duke renditur: a) Ruajtja e grupeve të bashkëtingëlloreve **kl, gl** në disa të folme. b) Ruajtja e tingullit **l** në fjalë të tipit: *golë, bilë, ndalesë*.

Tipare arkaike, sipas Demirajt arbëreshët kanë ruajtur edhe në fushën e formave gramatikore, si: a) Rrjedhja e shquar shumë me mbaresën **-shit**: *thirmëshit, turqëshit*. b). *Të ashtuqajturën rasë vendore: ndë dhet, ndë kamaret* etj.

Me interes është edhe konstatimi i Demirajt, se konstruktet e të folmeve arbëreshe kanë një "*karakter më sintetik që vihet re sidomos në të përdorurit e rasës rrjedhore pa parafjalë më shumë se në shqipen e sotme*. P.sh. *u ngre Kostantini varrit... Vashën e dua t'arbëreshë gjuhje e zakonëshi...*".

Edhe pse nuk ishin realizuar asnjë nga ato kërkime e studime që do të ndërmerrnin më vonë studiuesit arbëreshë dhe shqiptarë, si dhe albanologë të huaj, megjithatë Demiraj në tekstin "*Historia e gjuhës së shkruar shqipe*" në shënimet e tij sado të shkurtra për të folmet arbëreshe, arrin të fiksojë ato gjëra që ishin të mbështetura e të faktuara mirë. Edhe pas botimeve të shumta shumë qëndrime të Demirajt mbetën ashtu siç i kishte paraqitur ai. Kështu, ai thotë se "*të folmet e katundeve arbëreshe të Italisë në përgjithësi kanë karakteristike gjuhësore të përbashkëta, por ato kanë edhe ndryshime midis tyre*." Këto ndryshime, i shpjegon në këto dy fakte: a) Bano-rët e katundeve arbëreshe të Italisë kanë prejardhje të ndryshme. Disa e kanë origjinën prej visesh të Shqipërisë ju-

gore, disa të tjerë prej visesh të Shqipërisë veriore dhe disa të tjerë prej kolonish arbëreshe të Greqisë. b) Gjatë zhvillimit të tyre historik, të folmet e katundeve arbëreshe të Italisë, duke mos pasur kontakte të ngushta midis tyre, kanë pësuar edhe ndryshime që nuk kanë shkuar paralelisht. Ai përmend këtu grupet **kl**, **gl** që ruhen në Horën e Arbëreshëve e gjetkë në Sicili, si dhe në Molise etj., por në viset tjera janë asimiluar në **q**, **gj**. Vlerësimi i tij për këtë fenomen është si vion: “*Themelonjësit e katundeve Hora e Arbëreshëve, Pallac Adrianit etj, kanë qenë shpërngulur prej visesh të Shqipërisë, ku grupet e bashkëtingëlloreve kl, gl në kohën e shpërnguljes së tyre ruheshin të paevo-luara, kurse themelonjësit e katundeve të tjera si Makji, Shën Mitri, Mbuzati etj. kanë qenë prej visesh të Shqipërisë ku këto grupe bashkëtingëlloresh në kohën e shpërnguljes së tyre kishin evoluar në q, gj.* (Demiraj 1962:4).

Mbi bazën e të dhënave të kohës, Demiraj thotë se në diasporën arbëreshe të Italisë ka edhe “*katunde me origjinë geqe*”, si Va-karico, Kavallerico et. (Demiraj 1962:4) dhe se ato kanë disa trajta fonetike karakteristike të gegërishtes, p.sh. ruajtja e zanores **a** para bashkëtingëlloreve hundore. Për këtë dukuri, Demiraj jep dëshmi në verprat e ndryshme, si dëshmia e Zef de Radës në gramatikën e tij, në veprën e Jul Varibobës prej profesorit arbëresh V.Librandi, nga katundi Vakarico, i cili i ka bërë ndryshime të shumta fonetike gjuhës së Varibobës, duke paraqitur si një përzjerje të toskërishtes me gegërishten. (Demiraj 1962:4).

Përfundim

Profesor Shaban Demiraj, me studimet e tij shkencore ka arritur të jep një kontribut të jashtëzakonshëm për çështje të shumta që lidhen me formësimin e etnosit arbëresh, trajtave të këtij emërtimi dhe mbi të gjitha edhe për të folmet arbëreshe.

Sa i përket kalimit nga para-arbëreshët në etnosin arbëresh, sipas Demirajt ka qenë i shkallëshkallshëm dhe është bërë nëpërmjet një varg ndryshimesh në gjuhën e tyre. Ky ndryshim është kryer gjatë periudhës midis fazës së fundit të ndikimit latin dhe para dyndjes së sllavëve në Ballkan, d.m.th. aty midis shekujve IV–VI të erës së re. (Demiraj 2003:97).

Për trajtat e shumta që lidhen me etnonimin “Arbër”, profesor Shaban Demiraj pohon se trajta latine «Arbanum, Albanum (–r–>–l–) lidhet me trajtën më të herëshme Arban», duke theksuar se trajta me nistoren /–al/ ka pasur një përdorim më të dendur ndër banorët e përtej Adriatikut. I vetmi problem i paqartësuar nga këto trajta, është burimi i trajtave greke Alvanoi (a Albanoi?), Arvanon (a Arbanon?), arvanitis, që dëshmohen në shekujt XI–XII». Kurse nga dy trajtat që përdorin sllavët *Rabënë* dhe *Arbanas* «trajta më e vjetër sllave është *Rabënë*, e cila është krijuar më herët, pra kur janë takuar stërgjyshërit e shqiptarëve dhe sllavëve, ndërsa trajta *Arbanas* është pranuar nga forma librore dhe njerëzit e shkolluar në vise evropiane»

Në mënyrë indirekte Shaban Demiraj është marrë edhe me studimin e të folmeve arbëreshe të Italisë. Të parin vështrim mbi të folmet arbëreshe të Italisë, të cilët i konsideron *si ishuj të vegjël gjuhësor, ku të folmet e katundeve arbëreshe të Italisë në përgjithësi kanë karakteristike gjuhësore të përbashkëta, por ato kanë edhe ndryshime midis tyre, sidomos në fjalorin e tyre, i cili është ndikuar mjaft nga italishtja dhe nga greqishtja, por duke ruajtur fondin themelor të fjalëve të vjetra shqipe*”.

Literatura:

SHKURTAJ, Gjovalin. (2006). *Ligjërimet arbëreshe “Gjuha e bukës” dhe “gjuha e zemrës” (shqyrtime dialektologjike dhe sociolinguistike në ngulimet arbëreshe të Italisë)*. Tiranë.

DEMIRAJ, Shaban. (1962). *Historia e gjuhës së shkruar shqipe*. Tiranë.

DEMIRAJ, Shaban. (2003). *Gjuha shqipe – Probleme dhe disa figura të shquara të saj*. Globus R: Tiranë.

DEMIRAJ, Shaban (1986), *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë.

DEMIRAJ, Shaban (1988), *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë.

BALIU, Begzad Etnonimi arbër – shqiptar – Emri kombëtar shqiptar në studimet e profesor Çabejt. http://www.sakra.ch/etnonimi_arber.htm

BERTON SULEJMANI,

Universiteti Shtetëror i Tetovës

TERMINOLOGJIA GJUHËSORE NË TEKSTET MËSIMORE PËR SHKOLLAT TONA TË MESME TË PROF. SHABAN DEMIRAJT

Gramatika dhe pasqyrimi i terminologjisë së saj në tekstet tona⁵⁸ shkollore ka qenë vazhdimisht element i rëndësishëm, madje me rol parësor gjatë hartimit të tyre. Shpjegimi i saktë e i qartë i termave gjuhësorë në tekstet tona shkollore ndikon drejtpërdrejt jo vetëm në formimin gjuhësor të nxënësit, por edhe në përvetësimin e saktë të dijeve. Por, kur terminologjia gjuhësore e teksteve shkollore ndërlikohet a nuk përputhet me terminologjinë gjuhësore të teksteve universitare,⁵⁹ atëherë ato bëhen të paqarta e të pakuptueshme për nxënësit, e më vonë (ata që studiojnë gjuhën) edhe për studentët. Thënë shkurt, ndërlikohen dijet gjuhësore, në përgjithësi. Problemet rreth terminologjisë gjuhësore në tekstet tona shkollore janë të shumta e të mëdha, por, me këtë rast, do të vëmë në pah terminologjinë që prof. Shaban Demiraj e ka përdorur në tekstin shkollor:

1. **“Gramatika e gjuhës shqipe” (FONETIKA – MORFOLOGJIA)** për shkollat e mesme, Enti i botimeve shkollore i Republikës Socialiste të Serbisë Reparti – Prishtinë, 1968.

⁵⁸ Me termin tekstet tona shkollore, kupto tekstet në gjuhën shqipe që përdoren në të gjitha trevat shqiptare e më gjerë.

⁵⁹ E kemi fjalën për terminologji unike në të gjitha tekstet e jo në ato shkollore të quhen fjali të përbëra e në ato universitare periudha.

Periodizim të gjuhësisë shqiptare në përgjithësi kanë bërë gjuhëtar si Domi,⁶⁰ Kostallari,⁶¹ Çeliku⁶² të cilët zhvillimin e gjuhësisë shqiptare e kanë lidhur me periudha historike: para Çlirimit dhe pas Çlirimit, ndërkohë që periodizimin vetëm të terminologjisë gjuhësore e bëri Lirak Dodbibaj⁶³. Mahir Domi⁶⁴, thotë se zhvillimi i gjuhësisë shqiptare pas Çlirimit njihet tri etapa: etapa I (1944 – 1954) ku veçon tekstet e Kostaq Cipos “*Gramatika shqipe*”, Tiranë, 1949 dhe “*Sintaksa*”, Tiranë, 1952; në etapën II dhe III veçon këto tekste: “*Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*” – Shaban Demirajt, Tiranë 1961, “*Fonetika e gjuhës së sotme shqipe*” – Stefan Priftit, Tiranë, I–1959, II–1962 dhe “*Sintaksa e gjuhës shqipe*” – M. Domit (Tiranë, 1970). Hartimin i tekstit “*Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe*” (në tri pjesë) e konsideron si “*kurorëzim e sintezë e gjithë punës së bërë gjer atëherë... dhe ... si gramatikë normative që përgjithëson arritjet e rëndësishme të shënuara për kristalizimin dhe njësimin e gjuhës letrare dhe e shpie edhe më tutje kodifikimin e saj*”⁶⁵. Edhe Kostallari⁶⁶ për peridhën pas Çlirimit⁶⁷ dallon këto faza:

⁶⁰ Mahir Domi, Gjuhësia shqiptare në 35-vjetorin e Çlirimit, SF, nr. 4, 1997.

⁶¹ Androkli Kostallari, Mbi arritjet kryesore të gjuhësisë sonë dhe mbi disa drejtime të zhvillimit të saj të mëtejshëm, SF, nr. 2, 1976.

⁶² Mehmet Çeliku, Tri vepra madhore të gjuhësisë shqiptare në gjysmën e dytë të shekullit XX, Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, nr. 24/1, Prishtinë, 2005.

⁶³ Lirak Dodbibaj, Zhvillimi i terminologjisë gjuhësore shqipe nga Rilindja deri sot, Konferenca e parë e Studimeve Albanologjike (Tiranë 15 – 21 nëntor 1962), Tiranë 1965.

⁶⁴ M. Domi, vep. e cituar., f. 5.

⁶⁵ Po aty, f. 8.

⁶⁶ A. Kostallari, vep. e cit. f. 5.

⁶⁷ Edhe pse zhvillimin e shkencës së gjuhësisë, Kostallari e ndan sipas periudhave historike: para dhe pas Çlirimit.

faza I (1945 – 1955), faza II (1955 – 1975) dhe faza III (1975 e më tutje). Për dallim nga këta dy të parët, Çeliku bën një periodizim më ndryshe të gjuhësisë shqiptare. Ai gjithnjë nisët nga periudha e pasçlirimit. Faza e parë përfshin vitet 1945 – 1962 dhe e dyta 1962 – 1990⁶⁸.

Lirak Dodbibaj dallon dallon dy faza të zhvillimit të terminologjisë gjuhësore: “... *një fazë të kryeme, e cila mund të konsiderohet si një kapitull i përfunduem në këtë fushë të aktivitetit gjuhësor, dhe një fazë të dytë të re që asht në trajtim e sipër*”⁶⁹. Sipas këtij gjuhëtari, faza e parë fillon në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe mbaron në vitin 1945 (periudha e pas Çlirimit). Sipas tij kjo fazë e përfunduar dhe e njëjta mund të studiohet historikisht, terminologjia e së cilës kufizohet me terna të një gjuhësie fillestare, pra me ato të gramatikave të filloreve dhe të mesmeve. Ndërsa, faza e dytë, sipas këtij gjuhëtari, nis me themelimin e ish-Institutit të Shkencave dhe Universitetin e Tiranës, periudhe e cila karakterizohet me plotësime dhe zgjerime të terminologjisë gjuhësore, e kjo si rezultat i shtimit dhe i zgjerimit të studimeve gjuhësore.

Flutura Çitaku⁷⁰ ka bërë një periodizim tjetër të zhvillimit të gramatografisë dhe të terminologjisë gramatikore. Ajo e ndan në dy periudha. Periudha e parë përfshin gramatikat të botuara deri në vitin 1975 dhe periudha e dytë që nga vit 1976 e deri më sot. Periudhën e dytë e fillon me botimin e parë të Gr. së Akademisë, vëllimi I, Morfologjia. Në këtë periudhë, sipas

⁶⁸ M. Çeliku, vep. e cit. f. 243.

⁶⁹ L. Dodbibaj, vep. e cit. f. 184

⁷⁰ F. Çitaku, Përpjekje për periodizimin e gramatografisë shqiptare, materialet e punimeve të Seminarit XXX Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, gusht, 2011, f. 261.

Çitakut, përfshihen gramatikat të hartuara sipas modelit të Gr. së Akad., që nënkupton gjithashtu edhe përdorimin e terminologjisë së kësaj gramatike.

Megjithatë, mendojmë se një grup të veçantë brenda kësaj periudhe do të përbënin gramatika ose pjesë të gramatikave të gjuhës shqipe që nuk marrin për gjedhe Gr. e Akad. Aty do të hynin Gramatika e autorëve Buholc–Fidler, një pjesë e gramatikës së Becit, pikërisht pjesa hyrëse e sintaksës që fillon me ndarjen e fjalisë së thjeshtë në përbërës, si: GE, GF, GEP, pastaj Gramatika e Çelikut, e Memushajt, një pjesë e Gramatikës së Dhimajt, të cilat në pika të caktuara nuk përputhen me terminologjinë e Gr. së Akad. Diskutimet rreth dallimit sintaksor të termit togfjalësh dhe sintagmë mendojmë se kanë marrë fund. Dua të them se para 10 vjetëve, disa gjuhëtarë mendonin se është e njëjta gjë, d.m.th. mendonin se është ndërruar vetëm termi dhe tani po quhet me termin sintagmë. Kjo gjë veçse është tejkaluar dhe pajtohemi se nuk janë të njëjta, pra nuk keni të bëjmë me zëvendësimin e termit togfjalësh në sintagmë. Madje, mendojmë se termi togfjalësh duhet të largohet nga tekstet e sintaksave të gjuhës shqipe dhe i njëjti do të ishte mirë të përdorej vetën në fushën e leksikologjisë. A do ta quajmë sintagmë, grup emëror grup foljor, mbetet që të diskutohet në ndonjë simpozium të veçantë i cili do t'i kushtojë terminologjisë gjuhësore. Këtë po e ilustruam edhe me atë që prof. M. Çeliku në librin e tij “*Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksor) – vështrim i ri teorik*”, Tiranë, 2012, në vend të termit *sintagmë*, propozon të përdoret termi *përbërës sintaksorë*.

Nga kjo që u tha më lart, mund të vijmë në përfundim se gramatikat e prof. Shaban Demirajt, edhe sipas periodizimit të gjuhësisë shqiptare, edhe sipas zhvillimit të terminologjisë

gjuhësore, i takojnë fazës së dytë të periudhës së pas Çlirimit, përkatësisht periudhës së dytë pas vitit 1945 (kjo e fundit sipas L. Dodbibajt, shih më lart).

Terminologjinë që prof. Shaban Demiraj e ka përdorur në tekstet shkollore (pra në gramatikën që e përmendëm në fillim të këtij punimi) do ta krahasojmë me terminologjinë e Gr. së Akad. dhe ndonjë tekst tjetër që i takon periudhës pas botimit të kësaj vepre kolosale, për të cilën, pa kurrfarë hamendje mund të themi se ka qenë dhe është (fjalën e kemi për Gr. e Akad.) si “një balon i fryrë” nga e cila janë ushqyer të gjithë autorët që kanë hartuar tekste shkollore dhe universitare pas vitit 1976. Po e fillojmë me këtë pyetje:

Sa pjesë të ligjërates përfshihen në librin shkollor “Gramatika e gjuhës shqipe (Fonetika – Morfologjia)”? Nga ajo që shohim, në këtë tekst shkollor janë përfshirë 11 pjesë të ligjërates. Autori, *pjesët e ligjërates i ndan në dy grupe të mëdha sipas mundësisë ose pamundësisë për të marrë forma të ndryshme gramatikore. Disa prej tyre gjatë përdorimit në fjali marrin forma të ndryshme gramatikore, d.m.th. lakohen **emrat, nyjet, mbiemrat, numërorët, përemrat** ose zgjedhohen (**foljet**). Këto quhen pjesë të ndryshueshme të ligjërates. Kurse **ndajfoljet, parafjalët, lidhëzat, pjesëzat dhe pasthirmat** përdoren kurdoherë në forma gramatikore të ngurosur, d.m.th. as lakohen, as zgjedhohen; prandaj ato quhen pjesë të pandryshueshme të ligjërates*⁷¹. Deri te gramatikat e Demirajt, kuptohet duke i përfshirë edhe këto vetë, *nyja* është konsideruar si pjesë e veçantë e ligjërates. Zvogëlimi i pjesëve të ligjërates nga 11 në 10 e konsiderojmë si një kapërcim të rëndësishëm në historinë e gramatografisë shqiptare. Në Gr. e Akad. sqarohet se në këtë

⁷¹ Shaban Demiraj, *Gramatika e gjuhës shqipe (Fonetika dhe Morfologjia)* për shkollat e mesme, f. 34–35, Prishtinë, 1968

tekst *nyjat e prapme* do të trajtohen si mbaresa të trajtës së shquar të emrit. Kurse për *nyjat e përparme*, në mungesë të një termi më të përshtatshëm, do të përdoret vetëm konvencionalisht termi *nyjë*. Ato në të vërtetë kryejnë funksione morfemash.⁷² Për sa i takon fjalëzës *një*, të pranuar si *nyjë* e trajtës së pashquar, kjo në thelb është një përemër i pacaktuar i përdorur para një emri të pashquar.⁷³

Në tekstin shkollor të Demirajt për numërorët që tregojnë sasi të caktuara frymorësh, sendesh etj., quhen **numërorë theme-lorë**⁷⁴, ndërsa në Gr. e Akad. quhen **numërorë të mirëfilltë**⁷⁵. Ndërsa, *numërorët rreshtorë* që Demiraj i trajton te klasa e numërorëve, nga Gr. e Akad. e këndeje ata trajtohen në kuadër të *mbienrave marrëdhëniorë* (në botimin e vitit 1976 janë quajtur *mbienra të ndërnjetuar*).

Në gramatikën e Demirajt **numri i rasave** është **gjashtë**, edhe atë: *emërorja, gjindorja, dhanorja, kallëzorja, thirrorja e rrjedhorja*. Me botimin e Gr. e Akad. zvogëlohet numri i rasave në **pesë**. *Thirrorja* s'konsiderohet si rasë e mirëfilltë.

*Për klasifikimin e emrave ndër lakime do të mbështetemi në nyjën e sprasme shquese që ata e marrin në rasën emërore të numrit njëjës*⁷⁶. Në Gr. e Akad. e këndeje, kjo çështje quhet e zgjidhur përfundimisht dhe kriter për klasifikimin e emrave në lakime merret mbaresa e trajtës së shquar njëjës e rasës emërore. Kategoritë gramatikore (të cilat prof. Sh. Demiraj i quan kuptime gramatikore) të emrit në tekstin e prof. Shaban De-

⁷² Për më tepër shih në *Gramatikën e gjuhës shqipe 1*, ASHSH, IGJL, Tiranë, 2002, f. 37–38.

⁷³ Po aty, f. 38.

⁷⁴ Sh. Demiraj, vep. e cit. f. 95.

⁷⁵ Gr. e Akad. vep. e cit. f. 204.

⁷⁶ Sh. Demiraj, vep. e cit. f. 52.

mirajt janë: ajo e *gjinisë*, *numrit e rasës*, d.m.th. kategorinë gramatikore **të shquarsisë** dhe **të pashquarsisë** nuk e konsideron si kategori të veçantë gramatikore. Në Gr. e Akad. ajo radhitet bashkë me kategoritë e tjera gramatikore të emrit.

Në vend të termit **mbiemra të emërzuar** (i cili përdoret në Gr. e Akad.) që nënkupton kalimin e mbiemrit në klasën e emrit pa ndryshim të jashtëm fjalëformues, pra pa ndajshtesa, në tekstin shkollor të cilin po e studiojmë përdoret termi **të substantivuarit e mbiemrave** “... mbiemrat shpesh herë substantivohen, d.m.th. përdoren si emra”.

Në gramatikën e Demirajt, në klasën e mbiemrit, përkthësisht *mbiemrave përcaktonjës dëftorë* dhe *përcaktonjës pronorë* dalin edhe përemrat që dalin në bashkëvajtje me emër, si: **Ky** libër është me vlerë. Shkolla **jonë** ka shumë nxënës. Nga Gr. e Akad. trajtohen vetëm si përemra, pa marrë parasysh se a dalin bashkë me emra ose jo.

Mbaresat e rasave të gjinorës, të dhanorës dhe të rrjedhorës së shquar shumë, në gramatikën e Demirajt (më poshtë vetëm gram e ...), ishte me – **vet**. Kjo gjë me botimin e Gr. së Akad. u vendos përfundimditë të ishte – **ve**, dhe, nga kjo del që shquarësia dhe pashquarësia të dallohen jo përmes mbaresës, por përmes mjeteve të tjera gjuhësore.

Në gram e ... për më se të kryerën (që e gjejmë në gramatikat pas Gr. së Akad.) e foljeve përdoret termi e kryera e plotë.

Në vend të termit **bashkëtingëllore të shurdhëta**, te Demiraj përdoret termi **bashkëtingëllore të pazëshme**.

Mbiemra cilësonjës në gram. e ..., ndërsa në Gr. e Akad. mbiemra cilësorë.

Përemra të pakufishëm në gram. e ..., përemra të pacaktuar në Gr. e Akad e këndej.

Kuptimet gramatikore të foljeve, emrave, përemrave etj. në gram. e ... sot kategoritë gramatikore të foljeve, emrave, përemrave etj.

Në tekstet e autorit në fjalë, përdoret termi foljet moskalimtare në vend të termit folje jokalinimtare i cili përdoret në Gr. e Akad. e tekstet tjera pas tij.

Te gram. e ... ndajfoljet ndahen në katër grupe kryesore: ndajfolje mënyre, sasi, kohe dhe vendi. Në Gr. e Akad. ndajfoljet janë pesë lloje, këto katër plus ndajfoljet e shkakut.

Nëngrupet e lidhëzave bashkërenditëse në gram. e ... i gjejmë me këto terma: shtonjëse (sot këpujore), veçonjëse (sot veçuese). Ato nënrenditëse i gjejmë në këtë terminologji: ftilonjëse (sot filluese), rrjedhore (sot rrjedhimore).

Shtojcë

Terma të nxjerrë nga gramatika e prof. Shaban Demirajt që sot ose nuk përdoren ose termi ka pësuar ndonjë ndryshim të vogël të së njëjtës fjalë:

Termi i Demirajt në

tekstin shkollor (1968)

numërorë themelorë
gjindorja (rasa gjindore)
mbiemra të substantivuar
kryera e plotë
bashkëtingëllore të pazëshme
Mbiemra cilësonjës
Përemra të pakufishëm
Kuptimet gramatikore
Foljet moskalimtare
Lidhëza shtonjëse

termi i Gr. së Akad.

numërorë të mirëfilltë
gjinorja (rasa gjinore)
mbiemra të emëruar
më se të kryera
bashkëtingëllore të shurdhëta
mbiemra cilësues
përemra të pacaktuar
kategoritë gramatikore
foljet jokalinimtare
lidhëza këpujore

Lidhëza veçonjëse

lidhëza veçuese

Lidhëza ffillonjëse

lidhëza ffilluese

Lidhëza rrjedhore

lidhëza rrjedhimore.

Tekset shkollore të prof. Shaban Demirajt një gjedhe e mirë për tekstet që do të botoheshin tani e në të ardhmen. E ndiej të nevojshme që brenda këtij punimi t'i them ose më mirë t'u bëj një porosi hartuesve të gramatikave të shkollave tona fillore e të mesme që të marrin si gjedhe tekstet e autorit në fjalë, posaçërisht për çështjet e drejtshkrimit dhe të drejtshqiptimit të gjuhës shqipe. Po e ilustrojmë me disa elemente të marra nga libri i profesorit.

Çështje drejtshkrimore në tekstin e prof. Sh. Demirajt në tekstin shkollor *Gramatika e gjuhës shqipe (Fonetika – Morfologjia)* për shkollat e mesme (Prishtinë, 1968), ashtu siç e përmendëm më lart, pas çdo njësie mësimore jepen edhe rregulla drejtshkrimore. Në pjesën e morfologjisë fillon me drejtshkrimin e fjalëve të përbëra edhe atë tregon se duhet të shkruhen njësh fjalët e prejardhura, me parashtesa ose prapashtesa, si: **përhëndet, përgëzoj, shqep, shkul, stërgjiysh, stërmbesë, nënkryetar, nëndrejtor, mosardhje, mosbesim, i paditur, i papunë, papunësi** etj.⁷⁷ Në vazhdim jepen edhe këto rregulla drejtshkrimore: fjalët e përbëra dhe fjalët e përngjitur, si rregull, shkruhen më njësh, pa i ndarë në pjesët e tyre përbërëse si: **kryeministër, kryeqytet, kryengritje, udhëheqës, mëmëdhe, atdhe, atdhedashuri, atdhedashës, sypishë, dritëshkurtër, vetëdije, vetëvendosje** etj.⁷⁸

Rreth **drejtshkrimit të emrave.** Në kapitullin e kushtuar emrit janë përfshirë këto rregulla drejtshkrimore:

⁷⁷ Shaban Demiraj, *Gramatika e gjuhës shqipe (Fonetika dhe Morfologjia) për shkollat e mesme*, f. 28, Prishtinë, 1968

⁷⁸ Po aty, f. 29.

Drejtskrimi i emrave të përveçëm – emrat e njerëzve, kafshëve, vendeve etj., shkruhen kurdoherë me shkronjë të mëdhe: Dedë, Dritë, Murro, Balash, Shqipëri, Durrës, Shkumbin, Trebeshinë, Sazan etj.

Vërejtje rreth drejtskrimit të disa emrave të gjinisë mashkullore, femërore e asnjëse – a. Emrat e gjinisë mashkullore **burrë, djalë, kalë, lumë, lëmë** shkruhen me zanoren **–ë** në fund; b. Edhe emrat e gjinisë asnjëse të tipit **djathë, ujë, drithë, dyllë, brumë, mjaltë gjalpë** shkruhen me zanoren **–ë** në fund; këto fjalë do të shkruhen me **–ë** në fund edhe kur përdoren si emra të gjinisë mashkullore; c. Emrat e gjinisë femërore të tipit **flutur, kumbull, motër, kodër, vegël, thnegël** etj., nuk shkruhen me **–ë** në fund, d.m.th. nuk shkruhen **flutur–ë, kumbull–ë** etj.

I paraqitëm vetëm disa për të treguar se në tekstin e prof. Dermirajt pas çdo njësie mësimore, jepen edhe rregullat drejtskrimore të asaj njësie. Kjo praktikë nuk do të ishte e keqe që edhe në tekstet e sotme, pas çdo njësie të ketë rregull drejtskrimore e drejtsqiptimore sepse në këtë mënyrë, mendojmë se do të ngrihej niveli i zotërimit të standardit të shqipes.

Përfundim:

Nëse mbështetemi në periodizimin e gramatografisë dhe terminologjisë gjuhësore të bërë sipas F. Çitakut, e cila dallonte dy faza, atë para botimit të Gr. së Akad. dhe atë pas botimit të saj, në fazën e tretë të gramatografisë shqiptare, fillet e së cilës tanimë janë të dukshme, do të ishte mirë të rihartoj një gramatikë shkencore tradicionale, terminologjia e së cilës do të ishte plotësisht e standardizuar dhe e cila do t'i merrte parasysh të gjitha gramatikat si dhe studimet e bëra deri më sot lidhur me çështjet e gramatikës tradicionale. Nëse do të arrihej që të

hartohej një tekst i tillë, atëherë do të ishte mirë që të bënim edhe një unifikim të termave gjuhësorë për tekstet shkollore. Pse dhe kjo gjë të mos i ngjajë projektit “një abetare për të gjithë shqiptarët”, edhe pse e njëjta (tani për tani) s’u bë realitet për të gjitha trevat shqiptare, duke i përfshirë edhe shqiptarët në Maqedoni.

Bibliografi:

Hajdaraj, Adem, *Çështje të terminologjisë së sintaksës së shqipes*, botuar në materialet e Seminarit XIX Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, f. 439 – 442, Prishtinë–Prizren, 2000.

Çitaku, Flutura, *Togfjalëshat e qëndrueshëm në terminologjinë gramatikore*, botuar në materialet e Seminarit XXIX Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, f. 59 – 67, Prishtinë, 2010.

Çitaku, Flutura, *Termet e gramatikës në rrafshin konceptor*, botuar në materialet e Seminarit XXVII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, f. 131 – 147, Prishtinë, 2008.

Çitaku, Flutura, *Ndihmesa e Selman Rizës për terminologjinë gramatikore*, botuar në materialet e Seminarit XXVII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, f. 55 – 65, Prishtinë, 2009.

Çitaku, Flutura, *Gramatika praktike në përfaqje me Gramatikën e Akademisë (me theks të veçantë në terminologji)*, botuar në materialet e Seminarit XXVII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, f. 397 – 408, Prishtinë, 2013.

Elezi, Shpëtim, *Terminologjia gjuhësore në tekstet shkollore*, botuar në materialet e Seminarit XXX Ndërkombëtar për

Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, f. 209 – 213, Prishtinë, 2011.

Rexhep, Osmani, *Sintaksa e Justin Rrotës, një model për tekstologjinë shqiptare*, botuar në materialet e Seminarit XXX Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, f. 489 – 503, Prishtinë, 2011.

Zymberi, Abdullah, *Të përdorurit e leksikut të huaj në disa gramatika tona*, botuar në materialet e Seminarit XXVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, f. 133 – 137, Prishtinë, 2009.

Çerpja, Adelina, *Një vështrim për gramatikat shkollore të shqipes të periudhës 1913 – 1944*, botuar në materialet e Seminarit XXVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, f. 629 – 639, Prishtinë, 2012.

Çepani, Anila, *Gjymtyrët e fjalisë në traditën e gramatikave të shqipes*, botuar në materialet e Seminarit XXVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, f. 539 – 547, Prishtinë, 2012.

BUKURIE MUSTAFA,

ITSHK – Shkup

STUDIUES ME KONTRIBUTE THELBËSORE NË FUSHËN E MORFOLOGJISË HISTORIKE TË SHQIPES DHE TË BALLKANOLOGJISË

Albanologjia dhe ballkanologjia shkencore te profesor Shaban Demiraj kanë gjetur studiuesin më të ditur e më të përkushtuar, në të cilat fusha ai punoi pa u ndalur një jetë të tërë njeriu dhe ku ka dhënë kontribute thelbësore. Nga ky këndvështrim, Demiraj ka arritur që problemet dhe çështjet gjuhësore t'i shtrijë në një hapësirë më të gjerë të gjeografisë gjuhësore, gjithnjë duke u nisur nga gjuha shqipe dhe duke u bërë pikë referimi shkencor edhe për çështje e probleme gjuhësore të sllavistikës, ashtu si edhe të ballkanistikës.

Analiza e tij studimore përqendrohet në rrethin gjuhësor të ballkanistikës, duke treguar kujdes gjatë argumentimit të çështjeve të veçanta gjuhësore, por pa iu larguar mbështetjes shkencore të trajtimit të problemeve. Për të kuptuar personalitetin e një shkencëtari, siç ishte Demiraj, të pranuar edhe nga rrethet e huaja gjuhësore është mënyra e trajtimit të problemeve gjuhësore të mbështetura në argumente e dëshmi, por gjithnjë në funksion të një të vërtete, pa vlerësime e gjykime subjektive, që shkencës mund t'i japë një drejtim tjetër. Në këtë pikë, ai gjendet me studiuesit e huaj, për të cilët është i rëndësishëm studini i argumentuar i çështjeve gjuhësore, i nisur nga problemet e gjuhës së tij, për t'u zgjeruar dhe vendosur në një bashkësi më të gjerë gjuhësore, siç është ai i gjuhësisë ballkanike. Interesimi i vazhdueshëm i Demirajt, që nga

fillimi për zhvillimin historik të gjuhës shqipe dhe trajtimi i çështjeve gramatikore historike të saja, mundësoi trajtimin e hollësishëm të problemeve të hapura në lëmë të gjuhësisë së përgjithshme të rrethit jo vetëm albanologjik, por edhe ballkanistikë.

Historia e zhvillimit të ballkanistikës dhe të dukurive ballkanike është i njohur dhe i trajtuar nga studiues të ndryshëm dhe si të tillë kanë pasur tendencë të pasqyrojnë probleme komplekse gjuhësore në lidhjen e gjuhëve që përbëjnë këtë rreth gjuhësor. Studimet gjuhësore të zhvilluara nga Demiraj, kontribuojnë në sqarimin e lidhjes të dukurive të përbashkëta të kësaj bashkësie gjuhësore përmes studimit të krahasuar të gjuhëve, nga të cilat dalin mendime e ide të përmbajtura shkencore. Në këtë kontekst gjuhësor, Demiraj arrin të trajtojë historinë e dukurive gjuhësore nëpër gjuhë të veçanta, për të arritur në një vepër sintetizuese, siç shprehet vetë Demiraj për librin e tij ***Gjuhësia ballkanike/Балканска лингвистика***, e cila e përkthyer dhe e botuar në Shkup në vitin 1994, u bë i njohur e i rëndësishëm jo vetëm për studiuesit e hulumtuesit shqiptarë, por gjithashtu edhe për rrethin shkencor maqedonas. Përkthimi i këtij libri lehtëson të kuptuarit, i afrohet lexuesit maqedonas, për të mos pasur keqinterpretime, kur shtrohen çështje të ndjeshme, siç është gjuha, ngase jo gjithmonë, të shkruarit në një gjuhë apo referimi në një gjuhë tjetër të huaj, bart rrezikun e keqkuptimit dhe fakti tjetër i rëndësishëm është trajtimi i maqedonishtes dhe i historikut të saj si gjuhë ballkanike.

Për mënyrën se si trajtohen probleme të caktuara gjuhësore dhe historiku i dukurive ballkanike në libër, duhet marrë në konsideratë si referues për pyetje, të cilat kërkojnë sqarime me teza të mbështetura dhe të argumentuara. Vlera e librit, si dhe

e studimeve të Demirajt, mbështetet në qëndrim të matur lidhur me trajtimet gjuhësore në rrethana kur mungojnë dëshmi e dokumente konkrete, siç janë gjuhët e vdekura ballkanike, maqedonishtja e vjetër dhe gjuha e epirotëve⁷⁹, duke mos dashur të spekulojë në vlerësimet historike e gjuhësore.

Çdo dukuri ballkanike nga Demiraj trajtohet në hollësi për çdonjërin nga gjuhët dhe idetë e ndryshme të lindjes, të ndikimit dhe të përhapjes, të cilat i jep në funksion të diskutimit, të sqarimit e të argumentimit shkencor. Kështu, dukuritë ballkanike që i ka maqedonishtja dhe bullgarishtja, i bëjnë ato të ndryshojnë nga dega e tyre gjuhësore dhe të afrohen me gjuhët tjera, si rumanishtja, shqipja, greqishtja, me të cilat nuk kanë një prejardhje apo origjinë. Dukuri të caktuara ballkanike, Demiraj i vëren si më intensive në gjuhën maqedonase perëndimore, duke e dalluar në të njëjtën kohë nga ajo bullgare, siç është mënjanimi i paskajores, për të cilën Demiraj flet edhe në kumtesën e tij, *Ç'dëshmon mënjanimi i paskajores në gjuhët ballkanike?* gjatë konferencës shkencore *Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit*, të mbajtur më 10–11 nëntor të vitit 2011 në Prishtinë.

Studimet e Demirajt rreth dukurive ballkanike ka nxitur interesimin edhe te sllavisti i shquar Petar Hr. Ilievski, i cili merret me problemin e zhvillimit historik të gjuhës maqedonase në librin “Балканолошки лингвистички студии” (Studime linguistike ballkanike) të vitit 1988. Ilievski i interesuar për fatin e paskajores në gjuhët ballkanike e sheh të arsyeshme të trajtojë çështjen e “infinitivit të dytë” /“вторичната инфинитовност” në dakorumanishten dhe në shqipen, për të cilën flet gjuhëtari i ballkanistikës M. A. Gabinski. Edhe vetë

⁷⁹ Demiraj, 1994, 37.

Ilievski, shpreh mospajtimin lidhur me tezën e Gabinskit dhe e arsyeton kundërshtimin nga një numër i madh i ballkanologëve dhe albanologëve. Më i vendosur, sipas Ilievskit, ishte Sh. Demirajt, të cilit edhe i referohet: „Këto forma foljore (*me ba* dhe *për të bërë*) të ardhur nga një pjesore, por me vlerë të paskajores, nuk kishin mundur të formohen në një gjuhë ku ka qenë e panjohur vetëdija për paskajoren”⁸⁰. Teza se shqipja nuk ka pasur paskajore, që del nga një grup autorësh, si Hahni, Meyeri, Weigandi e Gabinski, Demiraj i përmend edhe në librin e tij “Gjuhësia ballkanike”⁸¹, duke i hedhur poshtë këto mendime dhe në mënyrë të argumentuar tregon rrugën e mënjanimin të paskajores në gjuhën shqipe. Ilievski, po në këtë libër, shtron çështjen e ndikimit të greqishtes në mënjanimin e paskajores në gjuhët që kanë qenë në kontakt më të afërt me greqishten dhe me këtë rast sërish drejtohet te Demiraj, për të forcuar mendimin e tij dhe duke thënë se Sanfeldi ka mbivlerësuar ndikimin grek⁸². Lidhur me shfaqjen e dukurive ballkanike dhe ndikimeve gjuhësore, dalin teza të ndryshme, duke krijuar ndasi të ithtarëve të njëjës apo tjetrës ide. Mbrojtësit mbi ndikimin grek të dukurive ballkanike, mbështeten në idenë se greqishtja si gjuhë kulturre dhe kishtare, ka pasur një pozitë mbizotëruese në Ballkan, ndërsa kundërshtimi i Demirajt qëndron në karakterin popullor të dukurive ballkanike dhe se gjuha greke ka qenë e panjohur për masat e gjera popullore ballkanike⁸³. Mirëpo, ndryshe

⁸⁰ Илиевски, Балканолошки лингвистички студии со посебен осврт кон историскиот развој на македонскиот јазик, 1988, 206.

⁸¹ Demiraj, 1994, 154.

⁸² Илиевски, Балканолошки лингвистички студии со посебен осврт кон историскиот развој на македонскиот јазик, 1988, 200.

⁸³ Demiraj, 1994, 159.

qëndron puna me maqedonishten e bullgarishten, te të cilat mënjanimi i paskajores dhe zëvendësimi me lidhoren, merret si një nga dukurit që e dallon nga gjuhët tjera sllave dhe me këtë rast Demiraj pajtohet me gjuhëtarët që mendojnë se bëhet fjalë për ndikim të jashtëm, duke u mbështetur në zhvillimet konkrete të bullgare-maqedonishtes⁸⁴.

Kur bëhet fjalë për dukuritë ballkanike dhe kontaktet gjuhësore, sërish merren parasysh sqarimet e Demirajt dhe me këtë rast e gjejmë shpesh në bibliografinë e studiuesit të ri Marjan Markoviq, i cili merret me problemet morfosintaksore në gjuhën arumune në kontekstin ballkanik. Në punimin e tij *За граматичките функции на предлозите во македонскиот и во ароманскиот охридски говор*⁸⁵ / *Për funksionet gramatikore të parafjalëve në të folmen maqedonase dhe në arumanishten e Ohrit*, Markoviqi trajton interferencën gjuhësore të arumanishtes dhe maqedonishtes dhe gramatikalizmin e disa parafjalëve në kallëzore, dhanore e gjinore në disa dialekte e të folme të maqedonishtes. Shfaqja e kësaj çështje, merret si rezultat i kontaktit të gjuhëve ballkanike. Nga ana tjetër, përmes kësaj vërtetohen ndikimet dhe dukuritë ballkanike për të cilat flet Demiraj e që i vëren në maqedonishten perëndimore dhe për problemin konkret Demiraj shprehet: “Edhe në bullgarishte-maqedonishte mund të supozohet më fort një zhvillim i pavarur, megjithëse në këtë rast nuk është për t’u përjashtuar krejt një ndikim i mundshëm nga ana e gjuhëve fqinje, rumanishtes dhe greqishtes”⁸⁶. Në punimin tjetër, po të Marjanoviqit, me titull *Субјунктивом*

⁸⁴ Po aty, 162.

⁸⁵ <http://www.rastko.rs/cms/files/books/488988dc2de35>

⁸⁶ Demiraj, 1994, 97

*во ароманскиот / Lidhorja në arumanishten*⁸⁷, sërish në bibliografi e gjejmë emrin e Demirajt. Kjo edhe një herë vërteton rëndësinë e botimit dhe përkthimit të librit “Gjuhësia ballkanike”, duke u përfshirë edhe në çështje të historikut të studimeve që bën Sh. Demiraj për zhvillim e ballkanistikës, kështu gjuhëtarja Violeta Nikollovska te libri i saj “**Македонски јазик со култура на изразување**”⁸⁸ / “Gjuha maqedonase me kulturë të të shprehurit”, lexuesit i drejton te libri i Demirajt (1994).

Trajtimin e çështjeve historike të gjuhës shqipe Demiraj nuk i sheh si të veçuara, por gjithnjë në një kontekst më të gjerë gjeografik–gjuhësor. Ai e vendos atë në një kontekst ballkanik, duke trajtuar çështjen e burimit ballkanik si: “*procese shumë komplekse*”⁸⁹, ndërsa “*për dukuritë e përbashkëta ballkanike*”, thotë se: “*duhen bërë hulumtime gjithnjë e më të thelluara në secilën nga këto gjuhë (gjuhët ballkanike), si edhe përpjekje për t’i shpjeguar ato në një mënyrë sa më të argumentuar shkencërisht*”⁹⁰.

Në kumtesa, si dhe libra të tij, ai thotë se puna në fushën e ballkanistikës nuk ka mbaruar, por që ende ka për t’u hulumtuar dhe mendon se sadopak studimet e tij do t’u ndihmojë studiuesve dhe studimeve krahasuese të ballkanistikës.

Profesor Shaban Demiraj me veprat dhe kontributet e tij thelbësore ka lënë gjurmë në gjuhësinë shqiptare, ashtu si dhe në gju-

⁸⁷ Марјан Марковиќ, Субјунктивот во ароманскиот, Местото на македонскиот јазик во словенскиот и во балканскиот јазичен свет, Скопје, 2014

⁸⁸ Виолета Николовска, Македонскиот јазик со култура на изразувањето, Штип, 2012, 18.

⁸⁹ Demiraj, 2002, Tiranë, 62.

⁹⁰ По ату, 64.

hësinë ballkanike, si njëri nga studiuesit më kompetent në fushën e morfologjisë historike të shqipes dhe të ballkanologjisë.

Bibliografia:

- Demiraj, Shaban. Gjuhësi ballkanike, Logos-A, Shkup, 1994.
Демирај, Шабан. Балканска лингвистика, Логос-А, Скопје, 1994.
Demiraj, Shaban. Gramatikë historike e gjuhës shqipe, Tiranë, 2002.
Demiraj, Shaban. Ç’dëshmon mënjanimi i paskajores në gjuhët ballkanike?, Konferencë shkencore: Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit, Prishtinë, 10-11 nëntor 2011.
Илиевски, Хр. Петар. Балканолошки лингвистички студии со посебен осврт кон историскиот развој на македонскиот јазик, Скопје, 1988.
Марковиќ, Марјан. Субјунктивот во ароманскиот, Местото на македонскиот јазик во словенскиот и во балканскиот јазичен свет, Скопје, 2014.
Марковиќ, Марјан. За граматичките функции на предлозите во македонскиот и во ароманскиот охридски говор, <http://www.rastko.rs/cms/files/books/488988dc2de35>, 15.12.2014.
Николовска, Виолета. Македонскиот јазик со култура на изразувањето, Штип, 2012.

HIDAJETE AZIZI,

ITSHK – Shkup

NJË BALLKANIZËM NGA PIKËPAMJA E PROF. DEMIRAJT

Shaban Demiraj, një emër që patëm nderin ta njohim që nga fillimet e studimeve gjuhësore e që jo rastësisht na shoqëroi gjatë tërë studimeve në vijim, duke qenë se vepra e tij ishte dhe mbetet një vepër e pashmangshme për shkencën gjuhësore, me të drejtë konsiderohet si autoritet shkencor elitar dhe me po kaq të drejtë u laurua me titullin e lartë “Mësues i Popullit” e “Mjeshtër i Madh i Punës”.

Duke qenë një gjuhëtar i madh, profesor e akademik, pas një pune të palodhshme edhe në moshë të shtyrë, ai na la trashëgim një varg veprash, të cilat në qarqet shkencore shqiptare, me meritë do të quhen edhe monumentale e enciklopedike. Kontributi i tij i jashtëzakonshëm në lëmin e gjuhësisë dhe të kulturës sonë kombëtare në përgjithësi, do të shfaqet sidomos në fushën e gjuhësisë historike, pas çka edhe do të cilësohet si *njeriu që bëri histori* në gjuhësinë shqiptare. Me veprat si “*Gramatikë historike e gjuhës shqipe*”, “*Gjuha shqipe dhe historia e saj*”, “*Fonologjia historike e gjuhës shqipe*” do të trajtojë historinë e shqipes duke përcaktuar këshqitu, vendin e shqipes mes gjuhëve indoevropiane. Një ndihmesë jashtëzakonisht e madhe për argumentimin e autoktonisë së shqiptarëve do të shfaqet me veprën e tij “*Prejardhja e shqiptarëve, nën dritën e dëshmnive të gjuhës shqipe*”. Çështja e prejardhjes së shqiptarëve si dhe përfundimi që del nga kjo vepër se shqiptarët janë vendës në trojet ku jetojnë sot dhe

pasardhës të stërgjyshërve që kanë jetuar pandërprerë në to, vështrohet kryesisht në dritën e dëshmimeve të gjuhës shqipe me anë të analizave faktike e të argumentuara. Ky bagazh i madh shkencor me vlerë kombëtare, i cili doli si fryt i penës së tij, shton në peshë edhe me kontributin e dhënë për pastrimin dhe pasurimin e gjuhës letrare shqipe, ndihmesë kjo e cila dëshmohet me përfshirjen e tij aktive në organizimin dhe zhvillimin e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe dhe me kontributin e tij të pandërprerë në këtë drejtim, me kontributin për filologjinë e arbëreshëve si dhe me shumë studime të tjera. Si i tillë, ky kontribut i solli shkencës gjuhësore shqiptare vlera të mëdha, prandaj edhe sot e gjithë ditën i referohet, jo vetëm brenda por dhe jashtë vendit, elita e gjuhësisë së sotme dhe e gjuhësisë historike.

Mirëpo, me një maturi të pashoqe dhe tani më me një pjekuri shkencore, figura e tij do të bëhet edhe më e njohur për shkencën gjuhësore edhe në Ballkan e Evropë, sidomos për kontributin e shquar që dha për zhvillimin e studimeve krahasuese mbi gjuhët ballkanike. Falë prof. Demirajt, fusha e studimeve të ballkanistikës pasurohet me një vepër të karakterit sintetizues mbi gjuhësinë ballkanike, një vepër me shumë vlerë dhe e pashmangshme për këtë fushë. Në veprën *“Gjuhësi ballkanike”*, me një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme, por të një shkencëtari me përvojë, me një modesti të rrallë por me një interpretim të thellë, me argumente të qëndrueshme e bindëse, duke u mbështetur në njohuritë e mëdha e të thella që kishte, jo vetëm për historinë e gjuhës shqipe por edhe të gjuhëve ballkanike, prof. Demiraj dëshmon për tiparet ballkanike të gjuhës shqipe dhe për vendin e saj brenda lidhjes së gjuhëve ballkanike.

Duke studiuar këtë vepër takohemi me përballjet e Demirajt me teori e qëndrime të shumë studiuesve, si Kopitar, Mikloshiq, Meyer, Weigand, Pedersen, Jokël, Skok, Georgiev, Çabej, Sandfeld, Selishçev etj., të cilat përshkojnë tërë veprën e që ia rrisin vlerën edhe më shumë. Pikat kyç të trajtimit në këtë vepër, evidentimi i tipareve ballkanike dhe sidomos burimi i tyre nga një gjuhë substrat apo nga ndikimi i ndërsjellë midis gjuhëve fqinje gjatë marrëdhënieve të tyre shekullore, sipas prof. Demirajt, duhet të hetohen nga pikëpamja e përputhjes ose jo, të secilit ballkanizëm veç e veç, me prirjet e evolucionit të sistemit gjuhësor për secilën gjuhë në kohën e shfaqjes së tij⁹¹. Jo rrallë vihet në dukje edhe fakti se një gjë e tillë është jashtëzakonisht e vështirë, jo vetëm për gjuhët me një dokumentim shkrimor të vonë, siç është shqipja, por edhe për gjuhët me dokumentim më të hershëm⁹².

Çështja e cila do të trajtohet këtu ka të bëjë pikërisht me kontributin e prof. Demirajt për një ndër ballkanizmat e shumtë që karakterizojnë gjuhët ballkanike. Objekt studini do të jetë nyja e prapavendosur shquese në gjuhën shqipe dhe në gjuhën maqedonase.

Se nyja shquese e prapavendosur është radhitur ndër ballkanizmat më tipikë, megjithëse ndeshet edhe në gjuhë të tjera indoevropiane jashtë Ballkanit, tashmë është e njohur dhe çështje që nuk kërkon diskutime të mëtejshme. Por, nuk është arritur në një mendim të përbashkët për sa i takon burimit dhe rrugës së përhapjes së këtij ballkanizmi në gjuhët e ashtuquajtura ballkanike. Për këtë çështje, prof. Demiraj, në cilësinë e një studiuesi të mirëfilltë, dha një kontribut me shumë interes.

⁹¹ Shaban Demiraj, *Gjuhësi Ballkanike*, Shkup, Logos A, 1994 f. 102

⁹² *Po aty*. f. 102

Para se të nxjerrim në pah pikëpamjet e Demirajt për praninë dhe procesin e prapavendosjes së nyjës shquese në këto dy gjuhë, ne do të dalim me një pasqyrë të përgjithshme e cila del si rezultat i trajtimit sinkronik e përqasës të nyjës shquese në gjuhën shqipe dhe në atë maqedonase, përkatësisht si rezultat i analizës për formën dhe funksionin e nyjës shquese në këto dy gjuhë. Gjatë kësaj analize, është konstatuar se ndërmjet shqipes e maqedonishtes dalin në sipërfaqe njaft përkime e paralelizma, sa i përket morfologjisë e funksionit të nyjës shquese, por edhe dallime të cilat do të trajtohen edhe nga aspekti diakronik, duke iu referuar burimeve dhe arritjeve me shumë vlerë të studiuesit tonë të madh, akademik Demirajt.

Nga studimi krahasues në rrafshin sinkronik për nyjën shquese në gjuhën shqipe dhe në gjuhën maqedonase janë konstatuar këto përkime: në rrafshin funksional është konstatuar se, në të dyja këto gjuhë, informacioni identifikues apo shënimin i referencës është funksioni i cili mbetet parësor. Pra, nyja shquese, si operator i referencës, shërben si sinjalizues sipërfaqësor i referentëve të veçantë e të identifikuar nga realiteti. P.sh.: *një njeri – njeri–u; një vajzë – vajz–a. / човек – човек–om; девојка – девојка–та*; në rrafshin morfologjik, në të dyja gjuhët, informacioni identifikues është gramatikalizuar përmes nyjës shquese të prapavendosur e cila nuk përdoret ndaras, por i bashkëngjitet leksemës me të cilën përdoret: *njeriu, vajza / човекот, девојката*; në rrafshin motivues është konstatuar se motivet për përdorimin e këtij sinjalizuesi, si motivi i përdorimit të nyjës në funksion anaforik (Dje pashë një grua me *një djalë. Djali* në dorë mbante... / Вчера видов една жена со едно момче. Момчето во рака држеше...), përdorimi i nyjës i motivuar nga përvoja individuale (Ku i lash syzet? / Каде ги оставив очилата?) dhe për të sinjalizuar referentë

unikë (Ata flisnin për *universin*. / Тие зборуваа за *универзумот*.), përdorimi i nyjës në funksion deiktik, për të referuar elementë që janë prezentë në aktin e të folurit (Shikoi *zogjtë* sa të bukur janë! / Погледни ги *птиците* колку се убави!) si dhe përdorimi i nyjës në funksion kataforik (E lexova *librin* të cilin ma propozove. / Ја прочитав *книгата* што ми ја препорача.), janë të pranishëm në të dyja këto gjuhë, që do të thotë se motivet për përdorimin e nyjës shquese të prapavendosur janë të njëjta; nga aspekti i gjenezës së nyjës së prapavendosur shquese është konstatuar se në të dyja gjuhët, nyja shquese është përfutur nga evolucioni i përemrave dëftorë në përdorim anaforik (në gjuhën shqipe, për gjininë mashkullore: $a-i/a-y > -i, -u$; për gjininë femërore: $a-j-o > -a$; për gjininë asnanëse: $a-ta > -të/-t$ ⁹³ dhe në gjuhën maqedonase, për gjininë mashkullore: *moj > om*; për gjininë femërore: *maa > ma*; për gjininë asnjane: *moa > mo*).⁹⁴

Dallimet të cilat janë konstatuar gjatë analizës së nyjës shquese të prapavendosur në gjuhën shqipe dhe në gjuhën maqedonase janë si në vijim: në rrafshin funksional, në gjuhën shqipe dhe në atë maqedonase, përveç funksionit parësor, atij të sinjalizimit të referencës që u përmend më parë, nyja e prapavendosur del edhe në funksion dytësor, në përdorim me emrat e përveçëm dhe me emrat me kuptim të përgjithësuar. Në gjuhën shqipe është konstatuar se nyja shquese është përgjithësisht e gjeneralizuar, si në funksion përgjithësues, ashtu edhe në bashkëvjatje me emrat e përveçëm, në të gjitha ato funksione sintaksore ku përdoren edhe emrat e përgjithshëm

⁹³ Shaban Demiraj, Gramatikë historike e gjuhës shqipe, Tiranë 2002, f. 173

⁹⁴ Blazhe Koneski, Istorija na makedonskiot jazik, Skopje, Kultura, 1967 f. 150

me nyjë shquese. Për shembull, në funksion përgjithësues, nyjën shquese e takojmë si në funksion të kryefjalës: *Njeriu nuk është i gjithëdijshëm*, ashtu edhe në funksion të kundërnorit: *Prindin duhet respektuar! Fëmijës duhet t'i kushtohet shumë vëmendje!* e në funksion të përcaktorit: *Lëkura e zebrës është e bukur*. Edhe te emrat e përveçëm nyja e prapavendosur përdoret po në këto funksione, si bie fjala: *Teuta na befaso!* *Do ta befasojmë Teutën.* *Do t'i bëjmë befasi Teutës.* *Do të takohemi afër shtëpisë së Teutës.* Ndërkaq, në maqedonishten, përdorimi i kësaj nyje nuk është e përgjithësuar ashtu si në gjuhën shqipe, as në funksion përgjithësues, sepse përdorimi i saj në këtë funksion nuk është i domosdoshëm, pra ka mundësi të mospërdorimit, si bie fjala: *Човек не е сезнаен. Родител треба да се почитува! На дете треба да му се обрне големо внимание! Кожата на зебра е многу убава*, e as me emrat e përveçëm, megjithëse në raste më të rralla edhe mund të përdoret, kryesisht me ngjyrim ekspresiv. P.sh.: *Весна не изненади; Ќе ја изненадима Весна; Ќе и направиме изненадување на Весна. Ќе се сретнеме близу куќата на Весна.* Por, me ngjyrim ekspresiv në kuptim pozitiv, përkatësisht te disa emra diminutiv që mbarojnë me *-e* dhe që shprehin intimitet, takojmë edhe: *Марето, Колето* etj. si dhe me kuptim negativ, si: *Натема ти Стојанот; Ај да се невиди и Скопјево*⁹⁵ e të ngjashme; në rrafshin morfologjik janë konstatuar dallime për sa i përket inventarit të formave me të cilat paraqitet nyja shquese në të dyja gjuhët. Në këtë kontekst, gjuha shqipe është më e pasur se maqedonishtja për shkak se

⁹⁵ Blazhe Koneski, Gramatikata na makedonskiot jazik, Skopje, Detska radost, 1999 f. 228

në shqipen, për gjininë mashkullore, takojmë dy forma me të cilat realizohet nyja shquese: *-i* (*djal-i*) dhe *-u* (*dhe-u*) ndërkaq për gjininë femërore dhe asnjënëse takojmë vetëm nga një formë, përkatësisht *-a* (*vajz-a*) për gjininë femërore dhe *-t* (*të ecur-it*) për gjininë asnjënëse. Maqedonishtja në këtë rast, për të tria gjinitë ka vetëm nga një formë me të cilat realizohet nyja shquese, përkatësisht *-om* (*сун-om*) për gjininë mashkullore, *-ma* (*кепка-ma*) për gjininë femërore dhe *-mo* (*дете-mo*) për gjininë asnjënëse. Mirëpo, nga ana tjetër, maqedonishtja na del më e pasur për sa i përket lokalizimit hapësinor. Përkatësisht, në gjuhën shqipe nyja e shquar është neutrale dhe nuk ka forma të ndryshme për të përçaktuar edhe lokalizimin hapësinor, për dallim nga maqedonishtja, e cila ka tri forma për një funksion të tillë. Morfologjia e nyjës shquese, në këtë rast, në maqedonishte, ka një paradigme me tri forma, të cilat reflektojnë me tipare të trefishta deiktike-anaforike, përkatësisht me format *-ov*, *-va* dhe *-vo* (*молив-ов*, *книга-ва*, *дете-во*) nga përemri *овој*, për referentë që janë pranë, *-он*, *-на* dhe *-но* (*молив-он*, *книга-на*, *дете-но*) nga përemri *оној*, për referentë që janë larg dhe *-om*, *-ma* dhe *-mo* (*молив-om*, *книга-ma*, *дете-mo*) nga përemri dëftor *тој*, për referentë që janë neutralë për nga aspekti i lokalizimit hapësinor. Edhe prania e nyjës së paravendosur në gjuhën shqipe, e cila nuk i bashkëngjitet leksemës me të cilën përdoret dhe e cila, edhe pse e ka burimin te përemri dëftor nga i cili rrjedh edhe nyja shquese e prapavendosur, në shqipen del si morfemë shumëfunktionale (me emra që shprehin lidhje fafesisnore: *i ati*, *e ëma* etj.; me emra në rasën gjinore: *e Agimit*, *i punës* etj.; me emra të gjinisë asnjënëse dhe të gjinisë femërore: *të folurit*, *e qeshura* etj.; me emra që emërtojnë ditët e javës: *e hënë*, *e martë* etj.; me

mblenra: *i mirë, e bukur, të shpejtë* etj.; me përmira të ndryshëm: *i (e) tij, i sati* etj. dhe me klasa të tjera të fjalëve) por jo edhe me funksion shqes si dhe mungesa e saj në gjuhën maqedonase është një tipar që dukshëm dallon këto dy gjuhë nga njëra tjetra; nga aspekti i gjenezës së nyjës shqese u konstatua se në të dyja gjuhët, nyja shqese e prapavendosur e ka gjenezën nga përmiri dëftor në përdorim anaforik, megjithatë në këtë pikë hetohet edhe një dallim me rëndësi kur kihet parasysh shkalla e gramatikalizimit të këtij dëftori, pra lidhja aktuale e formave të nyjës shqese me format gjegjëse të përmirit dëftor përkatës nga i cili është përfutur. Në gjuhën shqipe kjo lidhje është shumë më e zbehtë se sa në maqedonishten, ku kjo lidhje është mjaft e qartë, gjë që flet për faktin se procesi i gramatikalizimit të nyjës shqese është më i mocëm se sa në gjuhën maqedonase.

Tani, po t'i shikojmë përmblendhtas këto tipare të përbashkëta dhe të atyre që dallojnë këto dy gjuhë nga njëra tjetra, shikuar nga këndvështrimi i prof. Demirajt, mund të arrijmë në dy konstatime.

Konstatimi i parë është se nyja shqese e prapavendosur në këto dy gjuhë duhet të trajtohet si një tipar ballkanik për shkak të ndarjes së hapësirës së përbashkët. Këtë edhe më tepër e vërteton fakti që maqedonishtja së bashku me bullgarishten, të cilat edhe trajtohen si gjuhë ballkanike, janë të vetmet gjuhë nga grupi i gjuhëve sllave të cilat në sistemin e tyre gjuhësor kanë zhvilluar një shqese.

Konstatimi i dytë flet për dy aspekte. I pari ka të bëjë me aspektin e ndikimit të gjuhëve ballkanike mbi maqedonishten, përkatësisht mbi bullgarishten, në procesin e përfutimit të këtij tipari ballkanik, ose të gjuhës (a gjuhëve) substrat, mbi të cilën (a të cilat) ato janë mbishtresuar, e që lidhet me faktin që në

gjuhët e tjera sllave simotra, përveç në bullgarishte, nuk është zhvilluar nyja shquese, ndërkaq, aspekti i dytë ka të bëjë me të dhënat për vjetërsinë e këtij tipari në gjuhën shqipe, në krahasim me maqedonishten, e që lidhet me faktin e reduktimeve të mëdha fonetike të formave rasore të përenmrave dëftorë përkatës në gjuhën shqipe për dallim nga maqedonishtja, ku këto reduktime janë shumë më të vogla.

Me këto fakte, dhe me faktin që në gjuhët sllave, sipas prof. Demirajt, *'prapavendosja e nyjës shquese dokumentohet më vonë se në shqipe dhe në rumanishte'* dhe duke e mbështetur mendimin se *'për një zgjidhje sa më të saktë të këtij problemi është e nevojshme të sqarohet më parë se sa e vjetër është prapavendosja e nyjës shquese në secilën nga gjuhët ballkanike'*,⁹⁶ prof. Demiraj hedh poshtë edhe hipotezat që shpalosen nga ana e studiuesve, si Piotrovski, Miljetiçi, Gëlëbovi etj. për burimin sllav të këtij ballkanizmi. Në këto rrethana, Demiraj do të shprehet kështu: *'...në rast se burimi i dukurisë në shqyrtim duhet kërkuar patjetër në një gjuhë të vetme, atëherë këtu vijnë në vështrim ose shqipja, ose rumanishtja'*.⁹⁷

Për shqipen dhe rumanishten prof. Demiraj shpreh mendimin se nyja shquese mund të jetë një zhvillim i pavarur në këto gjuhë dhe se krijimi i saj *'duhet vështruar si një zhvillim i brendshëm i secilës prej tyre, i përfutur në pajtim të plotë me rregullsitë e prapavendosjes së përcaktorëve të pavetënjaftueshëm në to'*, rregullsi kjo e dikurshme e gjuhëve i.e. për të mos e filluar frazën me një fjalë të patheksuar. Vjetërsinë e nyjës së prapme në gjuhën shqipe prof. Demiraj e shpie para fillimit të dokumentimit të saj shkrimor, d.m.th. para shekullit XVI, madje edhe para periudhës së shpërnguljeve të arbëre-

⁹⁶ Shaban Demiraj, Gjuhësi ballkanike, Shkup, Logos A, f. 102

⁹⁷ Po aty. f. 102

shëve të Italisë (XV) e Greqisë (XIV), gjë që e lidh me faktin e evolucionit të njëjtë fonetik të formave rasore të nyjave të prapme edhe në shkrimet më të vjetra edhe në të folmet e arbëreshëve të Greqisë, që do të thotë se zanafilla e formave rasore të nyjës së prapme është relativisht mjaft e vjetër. Më dje, këtë vjetërsi e shpie edhe para përfundimit të dukurisë së rotacizmit, përkatësisht para shekullit VII–VIII, duke u mbështetur në faktin se *‘procesi i përngjitjes së formave rasore të nyjave të prapme me format rasore gjegjëse të emrit është zhvilluar para se të pushonte së vepruari dukuria e rotacizmit, si për shembull: zan–i ~ zër–i, pen–i ~ per–i etj’*,⁹⁸ si dhe në faktin e mungesës së parashtesës deiktike të dëftorëve, ashtu siç takohet në maqedonishten, që do të thotë se ato janë përfutuar, para se dëftorët të merrnin këto parashtesa deiktike. Duke u mbështetur në këtë vjetërsi, prof. Demiraj parashtron pyetjen, nëse kjo dukuri është një fakt gjuhësor i vetë shqipes, apo kjo e ka trashëguar atë nga ‘nëna’ e saj, ndërkaq si përfundim, ai anon nga e dyta. Ndërkaq për vjetërsinë e prapavendosjes së nyjës shquese në gjuhët sllave, Demiraj shprehet se *‘në gjuhët sllave të Ballkanit nyja e prapavendosur nuk duhet të jetë fort e hershme’*, me faktin që, sipas tij, *‘gjurmë të një nyje të tillë nuk ndeshen në shkrimet e Qirilit e të Metodit’*, që do të thotë se *‘ajo në bullgarishte ka zënë të shfaqet pas shekullit IX të e.r. Përveç kësaj, prof. Demiraj ka parasysh edhe faktin që akoma nuk është zbuluar ‘që në bullgarishten e vjetër të ketë pasur edhe ndonjë nyjë të përparme’*,⁹⁹ ashtu siç e ka shqipja sepse edhe çështja, nëse treguesi i shquarsisë në ndonjë nga gjuhët ballkanike ka qenë më përpara i paravendosur ose jo, është një fakt me rëndësi për zgjidhjen sa më të

⁹⁸ *Po aty*. f. 103

⁹⁹ *Po aty*. f. 102

saktë të këtij problemi. Sipas kësaj, *‘lindja e nyjës shquese në gjuhët sllave, përkundrejt mungesës së saj në gjuhët e tjera sllave’*, sipas Demirajt, *‘mund të shpjegohet si një zhvillim i brendshëm i atyre gjuhëve’* duke krijuar kundërvënien trajtë e shquar/e pashquar me mjetet e brendshme, përkatësisht nëpërmjet përemrave dëftorë përkatës, por nën ndikimin e gjuhës (a gjuhëve) substrat, mbi të cilën (a mbi të cilat) ato janë mbështetur, ose nën ndikimin e gjuhëve ballkanike rreth e rrotull e në këtë rast ka parasysh shqipen e rumanishten, ndikimi i të dyjave ose njëres nga këto, sepse në këto dy gjuhë prapavendosja është më e hershme se në maqedonishten. Për rumanishten, prof. Demiraj nxjerr në pah të dhënat e studimeve të deriatëhershme se nyja shquese shfaqet në rumanishten e përbashkët pas shekullit VII, por edhe se zhvillimi i nyjës duhet të ketë qenë një fakt i kryer para shekullit X si dhe mendimet e veta se *‘për vjetërsinë relativisht të madhe të nyjës shquese në rumanishte dëshmojnë edhe reduktimet e mëdha fonetike, që kanë pësuar format rasore...’*¹⁰⁰

Ndërkaq, ndikimi nga gjuhët e vjetra të Ballkanit si ilirishtja e trakishtja, sipas Demirajt, mbetet një hipotezë e pavërtetueshme sepse nuk ka dokumentim që do të dëshmonte për prapavendosjen e nyjës prepozitive a postpozitive në ato gjuhë, por edhe hipotezë e cila nuk duhet të përjashtohet kategorikisht¹⁰¹. Si rrjedhim, burini i prapavendosjes së nyjës shquese në gjuhët ballkanike edhe për prof. Demirajn mbetet çështje e pazgjidhur bindshëm.

¹⁰⁰ Po aty. f. 103

¹⁰¹ Po aty. f. 106

ZEQIRIJA IBRAHIMI,

ITSHK – Shkup

“GJUHËSIA BALLKANIKE” – NJË SHEMBULL PËR BALLKANISTIKËN

Studimi, të themi pa modesti, monumental “Gjuhësia ballkanike” i prof Shaban Demirajt, përveç rëndësisë së madhe gjuhësore që e ka dhe sfidës së vazhdueshme që ua bën gjuhëtarëve ballkanikë, paraqet edhe një sfidë tjetër, që autori i saj mund të mos e ketë menduar në kohën kur e ka krijuar këtë vepër – duke u përqendruar e thelluar në argumentimet filologjike të dhëna aty, por që sot mund të interpretohet në një dimension tjetër dhe të na shpërfaqë një aspekt krejt tjetër të rëndësishëm të kësaj vepre.

Ballkani – “tjetri” i Perëndimit

Viteve të fundit, veçmas pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, pas shpërbërjes së ish Jugosllavisë dhe rënies së sistemit komunist në shtetet ballkanike, Ballkani filloi të perceptohet nga Perëndimi si një zorrë qorre e Evropës, si një zonë e problemeve, luftërave, masakrave e si një zonë që e ka vështirë t’i pranojë vlerat “qytetëruese” perëndimore.

Në këtë drejtim bën fjalë veçmas studimi i autores bullgaro-amerikane Maria Todorova “Ballkani imagjinar”, e cila në hyrje të kësaj vepre shprehet kështu: “‘Ballkanizimi’ jo vetëm që ka marrë kuptimin e copëzimit të njësive politike të mëdha e të qëndrueshme, porse është bërë sinonim i kthimit në

gjendje tribale, të prapambetur, primitive, barbare”.¹⁰² Dhe, për shkak se ky fakt është sforcuar detyrimisht nga mediat dhe opinioni i përgjithshëm perëndimor, për një qytetar ordiner të Perëndimit kjo ka marrë nuanca aksiomatike dhe gati të palëkundura. Në këtë drejtim Todorova bën elaborime edhe më të hollësishme, duke shpjeguar se si janë krijuar këto stereotipa, ndonëse ato mbeten të paargumentuara sa duhet. Fjala bie, siç argumenton edhe Torodova, luftërat ballkanike kanë krijuar imazhin e zonës luftarake e konfliktuoze, ndërsa harrohen disa shifra që e demantojnë fuqishëm këtë fakt. Kështu, nëse dy luftërat ballkanike shënojnë vrasje të shumta, që kanë lënë pas vetes viktimë që e kanë ndihmuar stereotipin e “tjetrit”, ato megjithatë nuk as janë të përafërta me shifrat e vrasjeve që kanë ndodhur vetëm në një javë të vetme në Luftën e Gjirit. Ose, përballë vrasjeve në luftën e Bosnjës, që kapin shifra deri në 250.000 njerëz, këto megjithatë nuk janë asgjë në krahasim me luftën e Vietnamit, ku u vranë më shumë se tre milionë njerëz. Këto, por edhe shumë shembuj të tjerë që nuk po i përmendim për shkak të hapësirës së ngushtë dhe natyrës së kumtesës, janë dëshmi e bollshme se nuk mjaftojnë shifrat e vrasjeve që Ballkani të përliqet si zona e luftërave dhe konflikteve që e tmerrojnë botën.

Madje, në këtë drejtim – duke ndërtuar një apologji për Ballkanin – është edhe një artikull që filozofi boshnjak nga Shkupi Ferid Muhiq e ka botuar në revistën “Shenja”. Ai pasi argumenton në stilin e Todorovës se, megjithatë, dëmet më të mëdha ndaj qenies njerëzore nuk janë kryer në Ballkan, porse diku tjetër, duke përmendur Spanjën e inkuizicionit, Japoninë

¹⁰² Maria Todorova, *Ballkani imagjinar*, Instituti i Dialogut dhe Komunikimit (e përkthyer nga anglishtja: Bashkim Shehu), Tiranë, 2006, fq. 13.

e bombës atomike, holokaustin e Gjermanisë, vjen në konstatimin se në Ballkan edhe vrasjet, edhe krimet, por edhe dashuritë kanë logjikën e tyre që nuk gjendet askund tjetër në botë. Prandaj ai deklaroi: “Mbase Ballkani është vendi i fundit në të cilin ekziston akoma apejroni i fundit autentik antropologjik, ajo protoplazmë, ai brumë primordial (i kryeherëshëm) në të cilin ruhet akoma bashkësia burimore e të gjitha elementeve nga të cilat është gatuar njeriu.”¹⁰³ Kjo do të thotë se *homo balkanikusi* është njeri që nuk vret për asnjë projekt ideologjik apo ideal të dikujt, pa mos e urryer viktimen. Nëse bëhet një paralele mes ushtarit amerikan që e hodhi bombën atomike në Hiroshimë dhe një vrasësi serb në Srebrenicë, dallimi është se i pari thjesht e realizoi një urdhër në emër të një projekti të madh – pa pasur ndonjë urrejtje të veçantë ndaj japonezëve poshtë, ndërsa i dyti e bëri atë dhunë, sepse ndjente urrejtje të madhe – deri në patologji – ndaj boshnjakëve myslimanë. Kjo mund të interpretohet edhe në terma të dashurisë.

Duke e shtuar argumentin e tij, prof. Muhiqi para do kohe ka nxjerrë në dritë edhe një vepër, të botuar në gjuhën maqedonase, që në gjuhën shqipe përkthehet “Gjak në mjaltë”. Me këtë i referohet enrit të Gadishullit – *bal* në turqisht *mjaltë* dhe *kan* po ashtu në turqisht – *gjak*. Qëndrimi i prof. Muhiqit është se stereotipi i Ballkanit, që tashmë jehon në Perëndim, është krejt i padrejtë dhe tendencioz. Në të vërtetë kur flasim për dhunën, na vijnë ndër mend shumë autorë që ia përshkruajnë Ballkanit atë si të jetë tipari kryesor identifikues i tij, siç sjell një citat edhe Mark Mazower në veprën “Ballkani”, me fjalinë e Rebecca West-it se “gjithçka që dija ishte se

¹⁰³ Ferid Muhiq, *Apologjia e Ballkanit*, “Shenja” nr 34., Shkup, fq. 65–67.

ballkanasit s'bënin dot pa dhunë..."¹⁰⁴. Madje, Mazower-i përmend edhe raportimin që kishte bërë Trocki në kohën e Luftës së Parë Ballkanike, kur duke udhëtuar nëpër Ballkan, në bazë të dhunës që e kishte parë në ato zona, kishte mundur të konstatojë "Ja, më në fund Lindja!"¹⁰⁵.

Se Ballkani është një Lindje e Evropës ose një Orient tjetër, këtë e pohon edhe Maria Todorova, ajo duke marrë për bazë kriteret e orientalizmit që i ka vendosur Eduard Said-i në veprën e famshme "Orientalizmi".¹⁰⁶

Por, me këto konstatime nuk pajtohet në asnjë mënyrë prof. Muhiqi. Ai madje konstaton se Evropa as nuk do të quhej ashtu po të mos ishte Ballkani. Sepse, siç e dimë, edhe emri i saj lindi në Ballkan – në mitologjinë greke. Vetëm në Ballkan është i mundur Sokrati, Platoni, Aristoteli, pa të cilit nuk do të bëhej filozofia.

Prandaj, duke u nisur nga këto që u thanë më sipër, me të drejtë mund të konstatojmë se Ballkani le që nuk është zorra qorre e Evropës, por ai është vetë Evropa, Ballkani është kërthiza e Evropës, madje Evropa nuk do të ishte e mundur pa Ballkanin. Shprehur në terma të prof. Muhiqit, do të thoshim se "Ballkani është modeli i suksesshëm i primordiales, i njerëzores"¹⁰⁷. Rrjedhimisht, nuk ka asnjë arsye për inferioritet dhe faj që ne kemi rastisur të jemi banorë të Ballkanit, ndonëse nuk do të kishim thënë edhe se duhet të mburremi që jemi ballkanas. Kjo nuk ka qenë zgjedhja jonë, andaj kujtojmë se

¹⁰⁴ Mark Mazower, *Ballkani – një histori e shkurtër* (e përkthet: Klodian Boriçi), Skanderbeg Books, Tiranë, 2010, fq. 21.

¹⁰⁵ Po aty, fq. 26

¹⁰⁶ Ky libër është botuar edhe në gjuhën shqipe nga SHB "Logos-A" në Shkup në vitin 2009 me përkthim të prof. Xevat Lloshit.

¹⁰⁷ Shih artikullin e cituar.

duhet ta vlerësojmë drejt atë që jemi pa qenë të ndikuar nga paragjykimet dhe stereotipat perëndimore mbi Ballkanin.

“Gjuhësi ballkanike” – model evropian i bashkëjetesës

Pasi që kemi shpjeguar se si na është imponuar inferioriteti i të qenit banor i Ballkanit, kujtoj se tash mund ta kuptojmë më saktë e më drejt rëndësinë që ka vepra “Gjuhësi ballkanike” e prof. Shaban Demirajt. Dhe, në këtë drejtim ne kujtojmë se janë dy dimensione kaq të rëndësishme që duhet të vihen në pah: e para është njohja që prof. Demiraj ia bën maqedonishtes si gjuhë sllave më vete dhe, e dyta, modeli i studimit të afrive gjuhësore, që mund të shërbejnë edhe për studime të tjera ballkanike.

Sa i takon çështjes së parë, siç tashmë e dimë, maqedonishtja u kodifikua si gjuhë më vete vetëm pas Luftës së Dytë Botërore, kur edhe u formua njësia federale e Maqedonisë. Por, konteksti ndaj kësaj gjuhe ka vazhduar. Bullgarët ende e konsiderojnë si dialekt të bullgarishtes, ndërsa vetë maqedonasit sot i kanë hyrë zbulimit të gjuhës antike maqedonase, që me të të lidhen mbase për t’i shpëtuar këtij pretendimi bullgar. Dhe, sado që maqedonasit e sotëm e kanë ende problem çështjen e gjuhës e të historisë (që i konteston Bullgaria), çështjen e autorefalisë së kishës (që e konteston Serbia) dhe çështjen e identitetit dhe të emrit (që i konteston Greqia), shqiptarët janë të vetmit që kanë qasje krejt miqësore ndaj maqedonasve. Këtë më së miri e dëshmon sidomos studini i lartpërmendur i prof. Demirajt. Ai, përveç shqipes, greqishtes së re, rumanishtes, serbo-kroatishtes dhe bullgarishtes, e ka vendosur edhe maqedonishten si gjuhë më vete sllave, duke e analizuar edhe atë në pikëpanje të tipareve të përbashkëta ballkanike që i kanë krijuar gjuhët në kontakt në Gadishullin Ballkanik.

Prandaj, në frymë të asaj që Perëndimi e promovon si vlerë, pra bashkekzistencën, fqinjësinë e mirë dhe respektimin e tjetrit, mbase më mirë se pakkush tjetër në këtë hapësira e dëshmojnë shqiptarët dhe, në këtë rast, e dëshmon vepra “Gjuhësi ballkanike” e prof. Shaban Demirajt.

Ndonëse disiplina e gjuhësisë ballkanike nuk është shpikur së pari nga prof. Demiraj, ngase atë edhe më parë e kanë vënë re gjuhëtarë si Sanfledi, Kopitari etj.,¹⁰⁸ ajo që duhet të theksohet dhe përshëndetet është fakti se prof. Demiraj ka përfshirë më shumë gjuhë në këtë analizë krahasimtare, pa bërë asnjë dallim ose përjashtim të ndonjë gjuhe për çfarëdo arsye. Dhe, kjo qasje pastër shkencore pa asnjë tendencë mbase është arsyeja që prof. Demirajt ia ka dhënë atë rëndësi të madhe që ka emri i tij jo vetëm për albanologjinë e ballkanologjinë, por edhe më gjerë për mbarë gjuhësinë.

Ndërkaq, kur flasim për aspektin e dytë të këtij shqyrtimi, do të kishim thënë se vepra “Gjuhësi ballkanike” mund të shërbejë si një model i mirë për studimin edhe të fushave të tjera të jetës shoqërore të popujve të Ballkanit. Tashmë shumëkush e di dokumentarin e bullgares Adela Peva me titull “E kujt është kjo këngë?”, që është dëshmia më mirë se si janë të plesksura mes vete kulturat ballkanike. Bëhet fjalë për një këngë, të cilën e gjen te secili komb në Ballkan dhe secili prej tyre ngulmon se ajo këngë është e kombit të tij. Duke e pasur para vetes nja shembull të tillë, si dhe veprën e prof. Demirajt, na vijnë në mend se sa janë të ndërthurura mes vete kulturat kombëtare të popujve ballkanikë. Duke filluar nga veshja, ushqimet, orënditë shtëpiake, artet, jeta shoqërore, familja, ritet zakonore, festat etj., janë material i bollshëm që mund të

¹⁰⁸ Shaban Demiraj, *Gjuhësi ballkanike*, Logos–A, Shkup, 2006, fq. 46.

sjellë në skenë vepra të tipit “Ushqimet ballkanike”, “Veshja ballkanike”, “Urat në Ballkan”, “Epidemitë dhe sëmundjet në Ballkan”, “Historia e arsimit në Ballkan”, “Letërsia e Ballkanit”, “Ritet e motmotit në Ballkan”, “Jeta religjioze-shpirtërore në Ballkan”, “Shpërnguljet dhe zhvendosjet e popullsisë në Ballkan”, “Shtëpia ballkanike”, “Familja ballkanike”, “Përralla ballkanike”, “Barsoleta ballkanike”, libra me këngë ballkanike etj.

Kur gjithë kësaj ia shtojmë faktin e rëndësishëm se kërkesa e Bashkimit European është pikërisht integrimi dhe gjetja e pikave që na bashkojnë (e asaj që në botë njihet si *common ground*) e jo e atyre që na ndajnë, kujtojmë se modeli i *Gjuhësisë ballkanike* është mjaft i qëlluar për secilin studiues tjetër, që i distancuar nga paragjykimet e stereotipat perëndimore për Ballkanin, por edhe nga paragjykimet dhe urrejtjet ndërballkanike, do të na sillte vepra që do të ishin po kaq të rëndësishme për historinë e shkencës e të kulturës jo vetëm në suaza ballkanike, por edhe më gjerë.

Kundruar kështu do të mund të themi se prof. Shaban Demiraj, duke shkruar më shumë si shkencëtar sesa si shqiptar, me këtë vepër i ka paraprirë kohës se tij dhe ka dhënë shembullin më të mirë se si një studiues i mirëfilltë mund të prodhojë vepër që shkon përtej stereotipave të të tjerëve mbi popujt e Ballkanit. Prandaj ai meriton mirënjohje jo vetëm nga shqiptarët, madje jo vetëm edhe ballkanasit. Nëse këtë do ta kishim interpretuar me fjalorin e prof. Muhiqit, do të thoshim se prof. Demiraj, ashtu si Sokrati, ishte i mundur vetëm në Ballkan. Ai do të mbetet një sokrat i kohës sonë, prej të cilit edhe Perëndimi mund të marrë mësim dhe ta ketë model për shembujt e bashkekzistencës, të cilën e ka bërë kryefjalë të kohës sonë.

Burimet dhe referimet:

- Demiraj Shaban, *Gjuhësi ballkanike*, Logos–A, Shkup, 2006
- Muhiq Ferid, Apologjia e Ballkanit, “Shenja” nr 34., Shkup
- Mazower Mark, *Ballkani – një histori e shkurtër* (e përktheu: Klodian Boriçi), Skanderbeg Books, Tiranë, 2010
- Todorova Maria, *Ballkani imagjinar*, Instituti i Dialogut dhe Komunikimit (e përktheu nga anglishtja: Bashkim Shehu), Tiranë, 2006.

BIBLIOGRAFIA E BOTIMEVE TË PROFESOR SHABAN DEMIRAJT¹⁰⁹

I. Vepra shkencore

a) Pa ndonjë bashkëpunim

1. Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe. Botim i Universitetit të Tiranës. Tiranë 1972, f. 296 (me një përmbledhje frëngjisht).
2. Sistemi i lakimit në gjuhën shqipe. Botim i Universitetit të Tiranës. Tiranë 1975, f. 275 (me një përmbledhje frëngjisht).
3. Gramatikë historike e gjuhës shqipe. Botim i Universitetit të Tiranës. Shtëpia Botuese “8 Nëntori”. Tiranë 1986, f. 1167 (me një përmbledhje anglisht); Shtëpia Botuese “Rilindja”. Prishtinë 1988², f. 1047.
4. Gjuha shqipe dhe historia e saj. Botim i Universitetit të Tiranës. Tiranë 1988, f. 321 (me një përmbledhje anglisht); “Rilindja”. Prishtinë 1989², f. 290.
5. Eqrem Çabej – një jetë kushtuar shkencës. Shtëpia Botuese “8 Nëntori”. Tiranë 1990, f. 272; Shtëpia Botuese “Akademia e Shkencave të Shqipërisë”. Tiranë 2008², f. 322.

¹⁰⁹ Kjo listë e botimeve dhe referimeve të autorit është botuar për herë të parë (me shumë gabime) në vëllimin e akteve të konferencës “Akademik Shaban Demiraj dhe kontributi i tij në arsimin dhe shkencën shqiptare” (bot. Bardhosh Gaçe et al.) “Triptik”, Vlorë 2011 181vv. Regjistrimi i bibliografisë së punimeve, edhe pse në shumicën e tyre dërrmuese janë realizuar nga autori, mund të konsiderohet deri diku i ezauruar deri në vitin 2002. Regjistrimet e bëra për vitet 2002–2008 janë thjesht rastësore. Korrekturën e domosdoshme të tekstit e kreu Bardhyl Demiraj.

6. Historische Grammatik der albanischen Sprache (kurze Fassung). Botuar nga Österreichische Akademie der Wissenschaften; Philosophisch – historische Klasse. Schriften der Balkan-Kommission. Verlag der Österreichischen Akademie der Wissenschaften. Wien 1993, f. 366.
7. Gjuhësi ballkanike. Shtëpia Botuese Logos-A, në bashkëpunim me Katedrën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare të Universitetit të Shkupit. Shkup 1994, f. 277 (me një përmbledhje anglisht).
8. Balkanska lingvistika = Gjuhësi ballkanike. Shtëpia botuese “Logos A”. Shkup 1994, f. 294 (me një përmbledhje anglisht).
9. Fonologjia historike e gjuhës shqipe. Botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Shtëpia Botuese “Toena”. Tiranë 1996, f. 332 (me një përmbledhje anglisht).
10. La lingua albanese – origine, storia, strutture. Centro Editoriale e Librario – Università degli Studi della Calabria. Rende – Italia 1997, f. 302.
11. Prejardhja e shqiptarëve në dritën e dëshmnive të gjuhës shqipe. Botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Shtëpia Botuese “Shkenca”. Tiranë 1999, f. 284 (me një përmbledhje anglisht).
12. Gramatikë historike e gjuhës shqipe (version i ri i përmbledhur). Botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Shtëpia Botuese “Lilo”. Tiranë 2002, f. 510 (me një përmbledhje anglisht).
13. The origin of the Albanians (linguistically investigated), Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë 2008, f. 246.
14. Epiri, Pellazgët, Etruskët dhe Shqiptarët. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Infobotues. Tiranë 2008.

15. Gjuha shqipe dhe historia e saj. Botim i tretë – i përmirësuar. Përgatitur për botim nga Bardhyl Demiraj. Shtëpia Botuese “Onufri”. Tiranë 2013³, f. 422. (me një përmbledhje anglisht).
16. Prejardhja e shqiptarëve në dritën e dëshmnive të gjuhës shqipe. Botim i dytë – i rishikuar. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Universiteti Shtetëror i Tiranës (f. 344 – me një përmbledhje anglisht).

b) Në bashkëpunim me të tjerë

1. Sh. Demiraj – K. Prifti. Kongresi i Manastirit – ngjarje e rëndësishme e lëvizjes kombëtare shqiptare. Shtëpia Botuese “8 Nëntori”. Tiranë 1968, f. 71
2. Gramatika e gjuhës shqipe. vëll. II, Morfologjia. Botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Tiranë 1976, [Botimi I]. Kreu I – Njohuri të përgjithshme, f. 30 dhe Kreu VII – Folja, faqe 98; Tiranë 1995², f. 452; Tiranë 2002³, f. 452.
3. Sh. Demiraj – K. Prifti. Kongresi i Manastirit – ngjarje e rëndësishme e lëvizjes kombëtare shqiptare (ribotim i përmirësuar). Shtëpia Botuese “8 Nëntori”. Tiranë, 1978², f. 118; ASHSH, Instituti i Historisë; Tiranë 2004³, f. 204; ASHSH Instituti i Historisë, Tiranë 2008⁴, f. 206.
4. La formazione dell’Europa linguistica. Le lingue d’Europa tra la fine del I e del II millennio. A cura di Emanuele Banfi. Shtëpia Botuese “La Nuova Italia”. Firenze 1993. (Kreu: La lingua albanese, f. 413–424).
5. Le lingue indoeuropee. A cura di Anna Giacalone Ramat e Paolo Ramat. Shtëpia Botuese “II Mulino”, Bologna 1994. (Kreu XVI: L’albanese, f. 507–530).

6. Langues indo-européennes. Sous la direction de Françoise Bader. CNRS Editions. Paris 1994. (Kreu XI: L'albanais, f. 223–234). Ribotuar në 1997².
7. The Indo-European Languages. Edited by Anna Giacalone Ramat and Paolo Ramat. "Routledge", London and New York. (Kreu 16: Albanian, f. 480–501).
8. Ш. Демирај & К. Прифти: Битолски Конгрес, Национална Установа Музеј на Албанската Азбука – Битола 2012, f. 206.

II. Tekste mësimore

a) Pa ndonjë bashkëpunim

1. Për shkollën e lartë

1. Leksikologjia dhe fonetika e gjuhës shqipe (Për studentët me korrespondencë). Konspekt leksionesh. Tiranë 1956, f. 58.
2. Historia e gjuhës së shkruar të arbëreshëve të Italisë. (Shek XVI–XIX). Konspekt leksionesh. (Dispensë). Tiranë 1956, f. 77; Tiranë 1962², f. 77; Tiranë 1967³, f. 77; Prishtinë 1970⁴, f. 77.
3. Historia e gjuhës së shkruar shqipe. Shekujt XVIII–XIX. Konspekt leksionesh. (Dispensë). Tiranë 1956, f. 89; Prishtinë 1970², f. 88.
4. Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe. Pjesa e 1–rë, Universiteti i Tiranës, (Dispensë). Tiranë 1960, f. 95; Tiranë 1964², f. 97; Tiranë 1967³, f. 97; Tiranë 1970⁴, f. 97.
5. Histori e gjuhës së shkruar shqipe.
 - a) Histori e gjuhës së shkruar të arbëreshëve të Italisë; b) Lëvrimi i gjuhës shqipe gjatë shekullit XIX. (Dispensë). Botim i Universitetit të Tiranës. Tiranë 1962, f. 99 1968, f. 99; Prishtinë 1970², f. 87.

6. Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe. Pjesa e 11-të. Universiteti i Tiranës. (Dispensë), Tiranë 1963, f. 96–304; Tiranë 1967², f. 96–304; Tiranë 1969³, f. 96–304; Tiranë 1970⁴, f. 98–304.
7. Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe. [Ribotuar si libër në një vëllim nga Universiteti i Prishtinës]. Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës. Prishtinë 1971, f. 403.
8. Morfologjia historike e gjuhës shqipe (pjesa I). Botuar nga Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë i Universitetit të Tiranës. Tiranë 1973, f. 184.
9. Morfologjia historike e gjuhës shqipe (pjesa II). Botuar nga Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë i Universitetit të Tiranës. Tiranë 1976, f. 219.
10. Morfologjia historike e gjuhës shqipe. Pjesa I dhe II. Ribotuar nga Fakulteti Filozofik i Universitetit të Prishtinës. Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSA të Kosovës. Prishtinë 1979², f. 403; Prishtinë 1989³, f. 403.

2. Për shkollat e mesme.

1. Gramatika e gjuhës shqipe. Pjesa I. Morfologjia. Drejtorja e Botimeve Shkollore. Tiranë 1962, f. 228; Tiranë 1966², f. 236.
2. Gramatika e gjuhës shqipe. Pjesa I. Fonetika, Morfologjia; Botimi 2-të. Drejtorja e Botimeve Shkollore. Tiranë, 1962, f. 230; Tiranë 1964², f. 236; Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë 1968³, f. 172.
3. Gramatika e gjuhës shqipe. Për shkollat e mesme pedagogjike. [Ribotim]. Shtëpia Botuese e Librit Shkollor. Tiranë 1970³, f. 260.
4. Gramatika e gjuhës shqipe. Fonetika, morfologjia. Doracak për shkollat e mesme. Enti i Teksteve dhe i Mjeteve

Mësimore i KSA të Kosovës. Prishtinë 1968, f. 218; Prishtinë 1969², f. 219; Prishtinë 1971³, f. 218.

b) Në bashkëpunim me të tjerë

1. Letërsia klasike (greke dhe latine). Për klasën e parë të shkollave të mesme (botim i dytë). Botim i Ministrisë s'Arsimit. Përgatitur nga Mahir Domi dhe Shaban Demiraj. Tiranë 1953, f. 296.
2. Gramatika e gjuhës shqipe. I. Për shkollën e mesme pedagogjike. Nga Shaban Demiraj dhe Nikoleta Cikuli. Shtëpia Botuese e Librit Shkollor. Tiranë 1971, f. 344.
3. Gramatika e gjuhës shqipe. I. Për Shkollën Pedagogjike. Nga Shaban Demiraj dhe Nikoleta Cikuli. Shtëpia Botuese e Librit Shkollor. Tiranë 1973, f. 318.
4. Libri i gjuhës shqipe. 1. (Për shkollat e mesme pedagogjike dhe të gjuhëve të huaja). Nga: Shaban Demiraj, Ali Jashari, Virgjini Lafe dhe Liljana Harito. Shtëpia Botuese e Librit Shkollor. Tiranë 1984; Tiranë 1985²; Tiranë 1987³ (maket); Tiranë 1989⁴, f. 184; Tiranë 1994⁵, f. 134; Tiranë 1995⁶ (ribotim i përmirësuar – red. E. Likaj), f. 135.
5. Libri i gjuhës shqipe. 2. Për shkollat e mesme pedagogjike dhe të gjuhëve të huaja. Tiranë 1985; Tiranë 1987²; Tiranë 1988³; Tiranë 1994⁴, f. 172; Tiranë 1995⁵, f. 175.

III Transkribime dhe përshtatje veprash letrare

1. Naim Frashëri. “Bagëti e Bujqësija”. Redaktuar sipas botimit të parë dhe pajisur me shënime nga Shaban Demiraj. Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve. Tiranë 1956, f. 32.
2. Naim Frashëri. “Lulet’ e Verësë”. Redaktuar në bazë të botimit të parë dhe pajisur me shënime nga Shaban

- Demiraj. Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve. Tiranë 1956, f. 67; Tiranë 1961², f. 76; Prishtinë 1972³, f. 88.
3. Gavril Dara (i Riu). “Kënga e sprasme e Balës” Përshtatur në shqipen e sotme dhe pajisur me shënime për nxënësit e shkollave të mesme nga Shaban Demiraj. Drejtorja e Botimeve Shkollore. Tiranë 1961, f. 92; Tiranë 1965², f. 89; Prishtinë 1976³, f. 111.
 4. Sami Frashëri. “Shqipëria ç’ka qenë, ç’eshtë e ç’do të bëhetë”. Redaktuar e pajisur me shënime nga Shaban Demiraj, Tiranë 1962, f. 110.
 5. G. Dara (Junior). “Il canto ultimo di Bala”. Tiranë, 1966, f. 117.
 6. Gavril Dara (i Riu). “Kënga e sprasme e Balës”. Transkribuar në bazë të botimit të Katanaxaros të vitit 1906 dhe përshtatur edhe në shqipen e sotme nga Shaban Demiraj. Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”. Tiranë 1994, f. 227.
 7. Gavril Dara (i Riu). “Kënga e sprasme e Balës” Përshtatur në shqipen e sotme dhe pajisur me shënime për nxënësit e shkollave të mesme nga Shaban Demiraj. Drejtorja e Botimeve Shkollore. Toena (me fallsifikim të dhënash, si gjoja e përgatitur për botim nga Jorgo Bullo), Tiranë 2005⁴, f. ...; ASHAK, Prishtinë 2006⁵, f. 260.

IV. Përkthime

1. Imlach, Gladys M. “Jeta dhe lundrimet e Kristofor Kolombit”. Ismail Malosmani Botonjës. Tiranë 1944, f. 113. (Përkthyer nga anglishtja).
2. Jack London. “Martin Iden” (Martin Eden). Përkthyer nga anglishtja. Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”. Tiranë 1959, f. 439; Tiranë 1967², 428; Tiranë 1975³, f. 426; Tiranë 2002⁴, f...

3. "Tales from Shakespeare" (Tregime prej Shekspirit) – të drama të përmbledhura në prozë. By Charles and Mary Lamb. G. Bell & Sons, LTD. (dorëshkrim). London. 1927. Faqe 162. Përkthyer nga anglishtja në vitin 1944 (e pabotuar).

V. Artikuj-kumtesa

1. 25 vjetorit në Vlorë. – Në: "Jeta e Re", nr. 59, 28 nëntor, 1937, f. 4.
2. 28 Nëntorit. – Në "Jeta e re", nr. 149, 28 nëntor.
3. Nikolla Vasiljeviç Gogol (1809–1852). – Në: "Arsimi popullor", nr. 2–3, 1952, f. 66–70.
4. Disa shënime të krahasuara mbi gjuhën e Jul Varibobës (1. Fonetika, II. Morfologjia, III. Leksiku, IV. Vërejtje rreth disa elementeve ku gjuha e Varibobës përpjekje me të folurat e gegërishtes). – Në: "Buletin për Shkencat Shoqërore", 1953, nr. 1, f. 66–75; nr. 2, f. 16–31; nr. 3, f. 39–50.
5. Edukata nëpërmjet mësimi të letërsisë. – Në: "Arsimi popullor", nr. 10, 1953, f. 13–19.
6. Gavril Dara i Riu (me rastin e 70-vjetorit të vdekjes). – Në: "Nëntori", nr. 12, 1955, f. 78–80.
7. Gjuha e Sami Frashërit (Leksiku. Derivatet. Vërejtje rreth parashtesave. Mbiemrat e substantivuar. Kompozitat. Konkluzion). – Në: "Buletin për Shkencat Shoqërore", nr. 3, 1955, f. 191–234. (Përmbledhje frëngjisht).
8. "Gjella e Shën Mëris virgjër" e Jul Varibobës. Rreth botimit të parë të vitit 1762 dhe transkriptimit të saj prej V. Librandit. – Në "Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës". "Seria Shkencat Shoqërore", nr. 3, 1956, f. 262–270. (Përmbledhje frëngjisht).

9. Disa shënime rreth lëvrimit të gjuhës shqipe gjatë shekullit XIX (Fjalori. Ortografia. Përpjekje për të afruar të dy dialektet e shqipes në të shkruar. Disa vërejtje rreth formave. Konstruktet. Përfundime). – Në: “Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës”, “Seria për Shkencat Shoqërore”, nr. 4, 1958, f. 120–137. [Vijon në vitin 1959, nr. 1, f. 49–79].
10. Jul Variboba (1762). – Në: “Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës”. “Seria për Shkencat Shoqërore”, nr. 1, 1958, f. 125vv.
11. Disa shënime rreth lëvrimit të gjuhës shqipe gjatë shekullit XIX. – Në: “Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Serie për Shkencat Shoqërore”, nr. 1, 1959, f. 49–79. [Vijon nga nr. 4 i vitit 1958].
12. Përpjekjet për vendosjen e një alfabeti të vetëm për shkrimin e gjuhës shqipe. – Në: “Arsimi popullor”, nr. 10, 1961, f. 49–52. (Përmbledhje frëngjisht).
13. Dyqindvjetori i botimit të veprës së parë letrare artistike shqipe “Gjella e Shën Mëris virgjër” e J. Varibobës. – Në: “Nëntori”, nr. 9, 1962, f. 166–173.
14. Si të përmirësojmë studimin me korrespondencë të arsimtarëve. Në: “Mësuesi”, ★30 mars, 1962, f. 2–3.
15. Dua të theksoj dy gjëra të rëndësishme. [Mbi përgatitjen gjuhësore të nxënësit dhe ngritjen profesionale të mësuesit.] Në: “Mësuesi”, 9 tetor, 1964, f. 3.
16. Forma gramatikore perifrastike për + emër foljor i gjinisë asnjane në trajtë të pashquar. – Në: “Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike, 15–21 nëntor 1962”, Tiranë 1965, f. 213–220.
17. Diskutim rreth kumtesës së A. Kostallarit “Mbi disa veçori të strukturës semantike të kompozitave pronësore

- të shqipes”. – Në: “Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike, 15–21 nëntor 1962”, Tiranë 1965, f. 359–360.
18. Diskutim rreth kumtesës së D. G. Svane-s “Lëvizjet në fushën e sistemit foljor të shqipes”. – Në: “Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike, 15–21 nëntor 1962”, Tiranë 1965, f. 375–376.
 19. G. Dara il Giovane. = Gavril Dara i Riut. – Në: “Albania nuova” Anno XII, nr. 1, 1965, f. 12–13 .
 20. A propos du changement de genre des substantifs au pluriel dans l’albanais confronté aussi avec le roumain. = Rreth ndërrimit të gjinisë së emrave në shumës në shqipe, krahasuar edhe me rumanishten. – Në: “Studia albanica”, nr. 2, 1966. f. 97–111.
 21. Pochi cenni sulla vita e sull’ opera di Gabriele Dara (Iunior). = Disa shënime mbi jetën dhe veprën e Gavril Darës të Riut. – Në: G. Dara (Iunior), “Il canto ultimo di Bala” (Poema albanese) Tiranë 1966, f. 3–20.
 22. Rreth ndërrimit të gjinisë së emrave, në shumës në shqipe vështruar edhe në përqsje me rumanishten. – Në: “Studime filologjike” nr. 4, 1966, f. 83–97, (Përmbledhje frëngjisht).
 23. Shaban Demiraj & Dodi Anastas: Një kontribut me vlerë për kristalizimin e gjuhës letrare. Diskutim rreth “Rregullave të drejtshkrimit të shqipes”. – Në: “Mësuesi” 21 korrik, 1967, f. 2.
 24. A propos du changement de genre des substantifs au pluriel dans l’albanais, confronté aussi avec le roumain – Në: “Actes du Premier Congrès International des Études Balkaniques et Sud-Est Européennes”, VI, Linguistique, Sofia 1968, f. 371–384.

25. Diskutim rreth kumtesës së Oda Buchholz “Zur Frage der Verdoppelung der Objekte im Albanischen“. = Mbi çështjen e përsëritjes së kundrinave në gjuhën shqipe – Një: “Actes du Premier Congrès International des Études Balkaniques et Sud-Est Européennes”. VI. Linguistique. Sofia 1968, f. 726–727.
26. Demiraj, Shaban & Prifti, Kristaq. Kongresi i Manastirit. – Një: “Jeta e re”, Prishtinë, nr. 6, 1968. f. 1212–1224.
27. Le Congrès de Manastir = Kongresi i Manastirit. – Një: “Studia albanica”, nr. 2, 1968, f. 79–87.
28. Rreth mbaresave të shumësit të emrave asnjës në gjuhën shqipe. – Një: “Studime filologjike”, nr. 2, 1968, f. 137–148. (Përmbledhje frëngjisht).
29. A propos du changement de genre des substantifs au pluriel dans l'albanais, coufronté aussi avec le roumain. – Një: “Actes du Premier Congrès International des Études Balkaniques et Sud Est Européennes”, VI, Linguistique, Sofia 1968, f. 371–384.
30. A propos des désinences du neutre pluriel en albanais. = Rreth mbaresave të shumësit asnjës në shqipe. – Një: “Deuxième Conférence des Études Albanologiques. Tiranë 2–18 janar 1968”, Tiranë 1970, vëll. III, f. 157–167.
31. Diskutim mbi kumtesën e Eqrem Çabejt “Ngulimet arbëreshe në Itali dhe gjuha e tyre”. – Një: “Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike”, Tiranë 12–18 janar 1968”, Tiranë 1969, vëll. III, f. 319–320.
32. Diskutim mbi kumtesën e Vittore Pisanit. “L’articolo posposto in albanese e questioni connesse” = Nyja e prapme në shqipe dhe çështje të lidhura me të. – Një: “Studia albanica”, nr. 1, 1968, f. 143–145.

33. Diskutimi mbi kumtesën e Vittore Pisanit “Nyja e prapme në shqipe dhe çështje të lidhura me të” – Në: “Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike , Tiranë 12–18 janar 1968”, Tiranë 1969, vëll. III, f. 325–327.
34. Emrat prejfoljorë asnjës dhe togjet me vlerë foljore të formuara me pjesëmarrjen e tyre (punim historik). – Në: “Studime filologjike”, nr. 2, 1969, f. 39–74. (Përmbledhje frëngjisht)
35. Rreth disa problemeve të paskajores në gjuhën shqipe (punim historik). – Në: “Studime filologjike”, nr. 1, 1969, 181–120 (Përmbledhje frëngjisht).
36. Rreth kategorisë së shquarsisë e të pashquarsisë në gjuhën shqipe. – Në: “Studime filologjike”, nr. 4, 1969, f. 145–159. (Përmbledhje frëngjisht).
37. Rreth klasifikimit të foljeve në zgjedhime. – Në: “Studime filologjike”, nr. 3, 1969, f. 193–201. (Përmbledhje frëngjisht).
38. Rreth mbaresave të shumësit të emrave asnjës në gjuhën shqipe. – Në: “Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike. Tiranë 12–18 janar 1968”. Tiranë 1969, vëll. III, f. 131–139.
39. Rreth mbaresave të shumësit të emrave asnjës në gjuhën shqipe. – Në: “Përparimi”, Prishtinë, nr. 4, 1969, f. 279–290.
40. The change of gender in Albanian nouns = Ndërrimi i gjinisë së emrave në gjuhën shqipe. – Në: “Albanian life”, Iford, nr. 2, 1969, f. 14–16.
41. The introduction of the Albanian alphabet. = Vendosija e alfabetit shqip. – Në: “Albanian life”, Iford, nr. 2, 1969, f. 4–6.

42. De la perte de l'infinif en albanais. = Rreth zhdukjes së paskajores në shqipe. Në: "Studia albanica", nr. 2, 1970, f. 125–136.
43. Diskutim mbi kumtesën e Eqrem Çabejt: "Les colonies albanaises en Italie et leurs parlers" = Ngulimet shqiptare në Itali dhe gjuha e tyre. – Në: "Deuxième Conférence des Études Albanologiques". Tiranë 1970, vëll. III, f. 397–398.
44. Diskutim mbi kumtesën e Vittore Pisani-t: "L'articolo posposto in albanese e questioni connesse" = Nyja e prapme në shqipe dhe çështje të lidhura me të. – Në: "Deuxième Conférence des Etudes Albanologiques". Tiranë 1970, vëll. III, f. 401–403.
45. Rreth formave të së ardhmes në gjuhën shqipe. – Në: "Studime filologjike", 1970, nr. 3. f. 69–84. (përmbledhje frëngjisht); "Jehona", Shkup, nr. 7–8, 1970², f. 41–55.
46. Rreth kategorisë së shquarsisë e të pashquarsisë në gjuhën shqipe. – Në: "Jehona", Shkup, nr. 7–8, 1970, f. 20–38.
47. Rreth ndajfoljëzimit (adverbializimit) të disa formave gramatikore dhe të disa togjeve të tipit parafjalë + emër. – Në: "Studime filologjike", nr. 1, 1970, f. 137–150. (përmbledhje frëngjisht).
48. A propos des formes du futur en albanais = Rreth formave të së ardhmes në gjuhën shqipe. – Në: "Studia albanica", nr. 2. 1971, f. 137–151.
49. De la catégorie du défini et de l'indéfini en albanais = Rreth kategorisë së shquarsisë e të pashquarsisë në gjuhën shqipe. – Në: "Studia albanica", nr. 1, 1971, f. 41–55.
50. Habitorja dhe mosha e saj (punim historik). – Në: "Studime filologjike", nr. 3, 1971, f. 31–49. (Përmbledhje frëngjisht).

51. Kuptimet kryesore të kohëve të mënyrës dëftore në gjuhën shqipe. – Në: “Studime filologjike”. nr. 4, 1971, f. 49–62 (Përmbledhje frëngjisht).
52. Le système des articles en albanais. Confronté a celui du roumain = Sistemi i nyjave në shqipe, krahasuar me atë të rumanishtes. Kumtesë e mbajtur në Universitetin e Cluj-it (Rumani) në tetor 1971 (18 faqe dorëshkrim).
53. Rreth formave të së ardhmes në gjuhën shqipe. – Në “Përparimi”, Prishtinë, nr. 5, f. 385–400.
54. Rreth ndërrimit të gjinisë së emrave në shumës në shqipe, vështuar edhe në përqasje me rumanishten. – Në: “Probleme të historisë së gjuhës shqipe”. Prishtinë 1971, f. 355–374.
55. Rreth zhdukjes së paskajores në gjuhën shqipe. – Në: “Studime filologjike”, nr. 1. 1971, f. 71–77 (Përmbledhje frëngjisht).
56. The forms of the future in Albanian. = Rreth formave të së ardhmes në gjuhën shqipe. – Në: “Albanian life”, Iford, nr. 6, 1971, f. 44–45.
57. Çintegrimi i gjinisë asnjane. – Në: “Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe”, Tiranë 1972, f. 307–318.
58. De l’origine des formes du futur en albanais = Rreth formave të së ardhmes në gjuhën shqipe. – Në: “Cerçetări de lingvistică”. nr. 1. Cluj. 1972, f. 21–31.
59. Disa vërejtje rreth foljeve *jam*, *kam* e *thom* dhe rreth alternimit $-e-/-ie \sim -i-$ në sistemin foljor të shqipes (punim historik). – Në: “Studime filologjike”, nr. 1. 1972, f. 13–33. (Përmbledhje frëngjisht).
60. Kuptimet kryesore të kohëve të mënyrës dëftore në gjuhën shqipe. – Në: “Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme”. (Përmbledhje studimesh

- e artikujsh), Tiranë 1972, f. 254–274. (Përmbledhje frëngjisht).
61. Demiraj, Shaban & Dodi, Anastas. Një kontribut me vlerë për kristalizimin e gjuhës letrare. – Në: "Problemët e gjuhës letrare shqipe dhe të drejtshkrimit të saj. (Studime dhe artikuj)". Tiranë, vëll. II, 1972, f. 452–457.
 62. Rreth klasifikimit të foljeve në zgjedhime. – Në: "Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme", Tiranë 1972. f. 218–230.
 63. Rreth ndajfoljësimit (adverbializimit) të disa formave gramatikore dhe të disa togjeve të tipit *parafjalë + emër*. – Në: "Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme", (Përmbledhje studimesh e artikujsh). Tiranë 1972, f. 68–84. (Përmbledhje frëngjisht).
 64. Rreth ndërrimit të gjinisë së emrave në shumës në shqipe vështruar edhe në përqasje me rumanishten. – Në: "Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe." Tiranë 1972, f. 319–336.
 65. Çintegrimi i gjinisë asnjane. – Në: "Studime rreth historisë së gjuhës shqipe". Akademia e Shkencave e RPSSH. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 1973, f. 272–318.
 66. Disa vërejtje rreth foljeve *jam, kam e thom* dhe rreth alternimit *-e- ~ -ie- ~ -i-* në sistemin foljor të shqipes. – Në: "Studime rreth historisë së gjuhës shqipe", Tiranë 1973, f. 349–374.
 67. Habitorja dhe mosha e saj. – Në: "Studime rreth historisë së gjuhës shqipe" Tiranë 1973, f. 398–418.
 68. Kuptimet kryesore të kohëve të mënyrës dëftore në gjuhën shqipe. – Në: "Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme" Tiranë 1973, f. 254–272.

69. Rreth disa çështjeve gramatikore në “Rregullat e drejtshkrimit të shqipes”. – Në: “Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe (20–25 nëntor 1972)”, Akademia e Shkencave e RPSSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 1973, vëll. II, f. 323–329.
70. Rreth formave të së ardhmes në gjuhën shqipe. – Në: “Studime rreth historisë së gjuhës shqipe” Tiranë 1973, f. 375–392.
71. Rreth ndërrimit të gjinisë së emrave në shumës në gjuhën shqipe, vështruar edhe në përqasje me rumanishten. – Në: “Studime rreth historisë së gjuhës shqipe” Tiranë 1973, f. 319–336.
72. Rreth risive kryesore në sistemin e rasave të gjuhës shqipe. – Në: “Studime filologjike”, nr. 2, 1973, f. 65–93. (Përmbledhje. frëngjisht).
73. Rreth shumësit të emrit *kalë*. – Në: “Studime filologjike”, nr. 3, 1973, f. 77–82. (Përmbledhje frëngjisht).
74. Rreth zhdukjes së paskajores në gjuhën shqipe. – Në: “Studime rreth historisë së gjuhës shqipe” Tiranë 1973, f. 419–426.
75. Veçoritë e lakimit në sistemin përemëror të gjuhës shqipe. (vështruar historikisht). – Në: “Studime filologjike”, nr. 4, 1973, f. 67–93. (Përmbledhje frëngjisht).
76. Rreth risivet kryesore në sistemin e rasavet të gjuhës shqipe. – Në: “Studime filologjike”, nr. 2, 1973, f. 65–93. (Përmbledhje. frëngjisht).
77. Veçoritë e lakimit në sistemin përemëror të gjuhës shqipe. (Vështruar historikisht) – Në: “Studime filologjike”, nr. 4, 1973, f. 67–93. (Përmbledhje frëngjisht).
78. A propos de quelques questions grammaticales dans les “Règles de l’orthographe albanaise” = Rreth disa

- çështjeve gramatikore në “Rregullat e drejtshkrimit të shqipes”. – Në “Le Congrès de l’orthographe de la langue albanaise”, Tirana 1974, f. 363–369.
79. Diskutim rreth kumtesës së Jorgji Gjinarit. – Në: “Kuvendi i Studimeve Ilire. (Tiranë 15–20 shtator 1972)” II, Akademia e Shkencave e RPSSH, Tiranë 1974, f. 310–315.
80. Rreth disa çështjeve gramatikore në “Rregullat e drejtshkrimit të shqipes”. – Në: “Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe (20–25 nëntor 1972)” II. Instituti Albanologjik i Prishtinës. Prishtinë 1974. f. 407–411.
81. Rreth disa çështjeve themelore të morfologjisë historike të shqipes. – Në: “Gjurmime albanologjike”, Seria e shkencave filologjike 11–1972. Prishtinë 1974, f. 69–84.
82. A propos de trois innovations dans le système de la déclinaison en albanais. – Në: “Studia albanica”, nr. 2, 1975, f. 87–93
83. De la question du neutre en albanais. = Rreth çështjes së gjinisë asnjansë në shqipe. – Në: “Akten des Internationalen Albanologischen Kolloquiums, Innsbruck 1972, zum Gedächtnis an Norbert Jokl”, Innsbruck 1977, f. 235–245.
84. Diskussionsbeitrag = Ndhimesë për diskutim. – Në: “Akten des Internationalen Albanologischen Kolloquiums Innsbruck 1972, zum Gedächtnis an Norbert Jokl Innsbruck 1977, f. 402–404.
85. Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe. – Në: “Studime filologjike”, nr. 3, 1977, f. 101–129 (Përmbledhje frëngjisht).
86. De la perte de l’infinitif en albanais. = Rreth zhdukjes së paskajores në shqipe. – Në: “Actes II Congrès

- international des Études du Sud-Est. Européennes (Athènes 7–13 mai 1970”. T. IV. Linguistique et littérature). Athènes 1978, f. 45–51.
87. Rreth “nyjave të përparme” të shqipes, vështruar edhe në përqasje me rumanishten. – Në: “Gjurmime albanologjike”. Seria shkencat filologjike VII, 1977; Prishtinë, 1978, f. 65–74. (Përmbledhje frëngjisht) [Numër kushtuar Akademikut Prof. Dr. Idriz Ajeti me rastin e 60-vjetorit të lindjes].
 88. Alfabetarja e gjuhës shqipe. (Me rastin e 100-vjetorit të botimit). – Në: “Nëntori”, nr. 5, 1979, f. 203–210.
 89. Ndihmesa e Sani Frashërit në lëvrimin e gjuhës shqipe. – Në: “Studime filologjike”, nr. 3, 1979, f. 3–12 (Përmbledhje frëngjisht).
 90. Veprimtaria pedagogjike dhe arsimore e profesor Eqrem Çabejt. – Në: “Studime filologjike”, nr. 1, 1979, f. 199. [Pjesë nga fjala e mbajtur në mbledhjen jubilarë organizuar me rastin e 70-vjetorit të lindjes së Eqrem Çabejt].
 91. Aleksandër Xhuvani si vazhdues i veprës së Konstandin Kristoforidhit. – Në: “Studime filologjike”, nr. 1, 1980, f. 63–67 (Përmbledhje frëngjisht).
 92. A ka ndikime të huaja në strukturën morfologjike të shqipes? – Në: “Gjuha jonë”, nr. 2, 1989, f. 87–91.
 93. Rreth diftonginit të ★-o-së në gjuhën shqipe. – Në: “Studime filologjike”, nr. 2, 1981, f. 69–86. (Përmbledhje frëngjisht).
 94. Rreth vendit të përcaktorëve në gjuhën shqipe. “Studime filologjike”, nr. 2, 1981, f. 69–86. (Përmbledhje frëngjisht).

95. Fan Noli dhe gjuha e tij. – Në “Studime filologjike”, nr. 1, 1982, f. 87–91 1982, f. 27–34. (Përmbledhje frëngjisht).
96. La place des déterminatifs en albanais vue historiquement et en comparaison avec les langues romanes. = Vendi i përcaktorëve në shqipe vështruar historikisht dhe në përqasje me gjuhët romane. – Në: “Festschrift für Johannes Hubschmid zum 65. Geburtstag”. Franke–Verlag–Bermud. München 1982, f. 225–236.
97. Rreth së ashtuquajturës kategori e masës në gjuhën shqipe. – Në: “Studime filologjike”, nr. 2, 1982, f. 37–49.
98. Shqipja gjuhë indoeuropiane. – Në: “Gjuha jonë”, nr. 1, 1982, f. 5–12.
99. Vendi (/topika) i trajtave të patheksuara të përemrave vetorë në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të tjera. – Në: “Seminari ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare”. Prishtinë, 1982, f. 173–178.
100. Albanian: an Indo–european Language. – Në: “Albanian Life” Iford, nr. 1, 1983, f. 5–12.
101. Elemente gjuhësore arkaike në këngët e kreshnikëve. – Në: “Kultura popullore”, nr. 2, 1983, f. 59–64. .
102. Kolokuium në Paris me temë “Letërsia shqiptare dhe identiteti kombëtar” [ku nga Shaban Demiraj u mbajt kumtesa “Ndihmesa e letërsisë në zhvillimin e gjuhës letërore shqipe”]. – Në: “Studime filologjike”, nr. 4, 1983.
103. L’apport de la littérature dans le développement de la langue albanaise. = Ndihmesa e letërsisë në zhvillimin e gjuhës shqipe. Kumtesë e mbajtur në Paris më 1983 (7 faqe dorëshkrim).

104. La place des déterminatifs en albanais. = Vendi i përcaktorëve në shqipe. – Në: “Studia albanica”, nr. 2, 1983, f. 97–113.
105. Rreth emrit të lashtë të popullit dhe të gjuhës sonë. – Në: “Gjuha jonë”, nr. 1, 1983, f. 17–24.
106. Rreth rimarrjes së kundrinave në gjuhën shqipe. – Në: “Studime filologjike” nr. 3, 1983, f. 31–51.
107. Rreth rimarrjes së kundrinave në gjuhët ballkanike. – Në: “Studime filologjike”, nr.4, 1983, f. 26–47 (Përmbledhje frëngjisht).
108. Shqipja gjuhë ballkanike. – Në: “Gjuha jonë”, nr. 1, 1983, f. 38vv.
109. Vendi i formave të patheksuara të përemrave vetorë në shqipe dhe në disa gjuhë të tjera. – Në: “Studime filologjike”, nr. 1, 1983. f. 3–18 (Përmbledhje frëngjisht).
110. Dëshmi e qëndresës (Me rastin e 295-vjetorit të vdekjes së Pjetër Bogdanit). – Në: “Zëri i popullit”, 7 dhjetor, 1984, f 2–3.
111. Prijet kryesore në strukturën morfologjike të shqipes së sotme letrare. – Në: “Studime filologjike”, nr. 4; 1984, f. 71–77 (përmbledhje frëngjisht).
112. Theksi në gjuhën shqipe (Vështrim historik). – Në: “Studime filologjike”, nr. 2, 1984, f. 23–37 (Përmbledhje anglisht).
113. L’abanais dans ses relations avec les langues voisines daus l’antiquité et au moyen-age. = Shqipja në marrëdhëniet e saj me gjuhët fqinje në lashtësi dhe në mesjetë. Kumbësë e mbajtur në Kongresin V të A.I.E.S.E.E. në Beograd më 1984, (14 faqe dorëshkrim).
114. L’albanais dans ses relations avec les langues voisines dans l’antiquité et au moyen âge = Shqipja në marrëdhëniet e

- saj me gjuhët fqinje në lashtësi dhe në mesjetë. – Në: “Studia albanica”, nr. 2, 1984, f. 139–147.
115. Harallamb Mihëjesku (= Haralambie Mihăescu). – Nekrologji. – Në: “Studime filologjike”, nr. 4, 1985, f. 179–181.
116. La lingua albanese nella sua evoluzione storica. = Gjuha shqipe në evolucionin e saj historik. Kumbësë e mbajtur në: Istituto di Studi Albanesi pranë La Facoltà di Lettere e Filosofia dell' Università degli Studi di Roma “La Sapienza” më 1985, (19 faqe dorëshkrini).
117. Les tendances principales dans la structure morphologique de l'albanais à l'époque actuelle. = Prirjet kryesore në strukturën morfologjike të shqipes në kohën e sotme. – Në: “Studia albanica”, nr. 1, 1985, f. 109–112.
118. Prirjet kryesore në strukturën morfologjike të gjuhës së sotme letrare shqipe. – Në: “Gjuha jonë”, nr. 1, 1985, f. 56–62.
119. Prirjet kryesore në strukturën morfologjike të gjuhës së sotme letrare shqipe. – Në: “Gjuha dhe letërsia në shko-llë”, nr. 13, 1985, f. 65–72.
120. Gjuha shqipe dhe historia e popullit shqiptar. – Në: “Shkenca dhe jeta”, nr. 5, 1985, f. 48–50.
121. About the origin of the Possessive Perfect in Albanian and in some other languages = Rreth së kryerës posesive në shqipe dhe në disa gjuhë të tjera. – Në: “Festschrift für Johann Knobloch”. Innsbrucker Beiträge zur Kulturwissenschaft. Band 23. Innsbruck 1985, f. 81–85.
122. [Zërat e hartuar për Fjalorin Enciklopedik Shqiptar]. Budi, Pjetër, f. 124; Majer (Meyer), Gustav, f. 658; Matrënga, Lukë, f. 680; Pedersen, Holger, f. 814;

- Variboba, Jul, f. 1153. – Në: “Fjalori Enciklopedik Shqiptar”. Tiranë, 1985.
123. Poezia e gjuhës sonë (çfarë po krijoj) [Bisedë me Prof. Shaban Demiraj, që punon prej vitesh në fushë të gjuhësisë]. – Në: “Zëri i popullit”, 9 mars, 1985, f. 2–3.
 124. Rreth poemës “Kënga e Sprasme e Balës” (Në 100–vjetorin e vdekjes së Gavril Darës (i Riu). – Në: “Drita”, 24 nëntor, 1985, f. 10–11.
 125. Gjuha shqipe dhe historia e popullit shqiptar. – Në: “Shkenca dhe jeta”, nr. 5, 1985, f. 48–50.
 126. Singularizimi i shumësit të emrave në gjuhën shqipe (Vështrim historik). – Në: “Studime filologjike”, nr. 4, 1985, f. 13–22.
 127. Aleksandër Xhuvani si vazhdues i veprës së Kostandin Kristoforidhit. – Në: “Studime filologjike”, nr. 1, 1986, f. 127–131.
 128. Frang Bardhi – veprimtar i shquar i kulturës shqiptare. – Në: “Kultura popullore”, nr. 1, 1986, f. 141–146.
 129. On some Balkan linguistic phenomena in Albanian = Mbi disa dukuri gjuhësore ballkanike në shqipe. [Kumtesë e mbajtur në Universitetin e Kopenhagës dhe në atë të Aarhus-it më 1986], (18 faqe dorëshkrim).
 130. Reçension për librin: “Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes”. (Libër i Besim Bokshit, Prishtinë 1980, f. 395). – Në: “Studime filologjike”, nr. 1, 1986, f. 173–182.
 131. Rreth apofonisë në gjuhën shqipe. – Në: “Studime filologjike”, nr. 3, 1986, f. 12vv.
 132. La singularisation du pluriel des noms dans la langue albanaise. = Singularizimi i shumësit të emrave në gjuhën shqipe. – Në: “Studia Albanica”, nr. 2, 1986, f. 127–138.

133. Some questions of the history of the Albanian language, = Disa çështje të historisë së gjuhës shqipe. – Në: “Albania Today”, nr. 4, 1986, f. 53–55.
134. The Albanian language in its evolution. = Gjuha shqipe në evolucionin e saj. [Kumtesë e mbajtur në Universitetin e Kopenhagës dhe në atë të Aarhus-it (Danimarkë) më 1986], (17 faqe dorëshkrim).
135. Sur l’apophonie dans la langue albanaise. = Rreth apofonisë në gjuhën shqipe. – Në: “Studia albanica” nr. 2, 1987, f. 125–140.
136. The time and place of the formation of the Albanian language and its historical relation with other languages. – Në: “Albania Today”, nr. 1, 1987, f. 117–127.
137. Roli i shkollës sonë për njësimin e gjuhës letrare shqipe (Referat i mbajtur në konferencën shkencore kushtuar 100–vjetorit të Mësonjëtores së Parë Shqipe në Korçë). – Në: “Gjuha jonë”, nr. 2, 1987, f. 5–13; si edhe në: “Revista pedagogjike”, nr. 2, 1987, f. 79–86.
138. Roli i shkollës sonë për njësimin e gjuhës letrare shqipe (Referat i mbajtur në konferencën shkencore kushtuar 100–vjetorit të Mësonjëtores së Parë Shqipe në Korçë). – Në: “Studime filologjike”, nr. 1, 1987, f. 33–38.
139. Dy fjalë për gjuhën dhe stilin e Selim Hasanit. – Në librin: “Kënga popullore e Selim Hasanit” Botim i Akademisë së Shkencave të RPS Shqipërisë. Përgatitur nga Bardhosh Gaçe. Tiranë, 1987, f. 212–215.
140. Recension për librin “Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes”. (Libër i Besim Bokshit, Prishtinë 1980, f. 395). Në: “Studia albanica”, nr. 1, 1987, f. 167–177.

141. Recension mbi studimin monografik të Ethem Likajt “Analogjia gramatikore në strukturën morfologjike të gjuhës shqipe (Tiranë 1984)”. – Në: “Gjuha jonë”, nr. 4, 1987, f. 99–103.
142. Risi karakteristike të gjuhës shqipe. – Në: “Gjuha jonë”, nr. 1, 1987, f. 5–15.
143. Roli i shkollës sonë për njësimin e gjuhës letrare shqipe. – Në: “Studime filologjike” nr. 1, 1987, f. 33–38.
144. Ndhimesa e Eqrem Çabejt në fushën e gramatikës historike të gjuhës shqipe. Në: “Studime filologjike”, nr. 3, 1988, f. 65–68.
145. Die Beziehungen der albanischen Sprache zu den übrigen Balkansprachen. = Lidhjet e shqipes me gjuhët tjera ballkanike [Kumtesë e mbajtur në Institutin e Sllavistikës të Universitetit të Vjenës, më 31.05.1988], (21 faqe dorëshkrim).
146. Die Stellung des Albanischen in der Indogermania. = Vendi i shqipes në rrethin e gjuhëve indoeuropiane. [Kumtesë e mbajtur në Institutin e Sllavistikës të Universitetit të Vjenës, më 01.06.1988], (20 faqe dorëshkrim).
147. Rezension mbi librin “Einführung in die Balkanlinguistik mit besonderer Berücksichtigung des Substrats und des Balkanlateins” Wissenschaftliche Buchgesellschaft, Darmstadt, 1980, x + 261f. “Hyrje në gjuhësinë ballkanike, ...” të Georg Renatus Solta. – Në: “Studime filologjike”, nr. 1, 1988, f. 203–207.
148. Formime karakteristike në sistemin foljor të gjuhës shqipe. – Në: “Gjuha jonë”, nr. 3, 1989, f. 5–11.
149. Johann Georg von Hahn dhe kontributi i tij në fushën e Albanologjisë. – Në “Shqipëria e re”, nr. 4, 1989, f. 3–5.

150. Reçension rreth librit të Georg Renatus Solta-s: "Einführung in die Balkan-linguistik mit besonder Berücksichtigung des Substrats und des Balkanlateins". Wissenschaftliche Buchgesellschaft, Darmstadt, 1980, x + 261 f. "Hyrje në gjuhësinë ballkanike...". – Në: "Studia albanica". nr.2. 1989. f. 173–177.
151. The Congress which sanctioned the unification of the alphabet of the Albanian language (on the 80-th anniversary of the Congress of Manastir). = Kongresi që sanksionoi njësimin e alfabetit të gjuhës shqipe.... – Në: "Albania Today", nr. 6, 1989, f. 44–46.
152. Prof. Mahir Domi – përfaqësues i shquar i shkencës shqiptare. (Me rastin e 75- vjetorit të lindjes). – Në: "Gjuha jonë", nr. 2, 1990, f. 14–19.
153. Të jemi gjithmonë nxënës... (Bisedë me Mësuesin e Popullit Shaban Demiraj). – Në: "Mësuesi", 25 shtator, 1990, f. 3.
154. Das Problem des Ursprungs der albanischen Sprache. = Problemi i prejardhjes së gjuhës shqipe. [Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare me temën "Stand und Aufgaben der Albanologie heute", organizuar nga Universiteti i Köln-it (Gjermani), 3–5 tetor 1988]. – Në: "Stand und Aufgaben der Albanologie heute", Berlin 1991, f. 111–120.
155. Ndihmesat e Gjergj Fishtës për shkrimin dhe lëvrimin e gjuhës shqipe. – Në: "Gjuha jonë", nr. 3–4, 1991, (1994), f. 5–10.
156. Ndihmesat kryesore të Frantishek (Franz) Mikloshiçit në fushën e albanologjisë dhe të ballkanologjisë. – Në: "Studime filologjike", nr. 1, 1991, f. 191–197 (Përm-bledhje anglisht).

157. L'importanza delle parlate degli Arbëreshë d'Italia per la storia della lingua albanese. = Rëndësia e të folmeve të arbëreshëve të Italisë për historinë e gjuhës shqipe. [Kumtesë e mbajtur në "Congresso Internazionale di Studi Albanesi" në Palermo më 1990], (10 faqe dorëshkrim).
158. Die Stellung des albanischen im Kreise der indogermanischen Sprachen. = Vendi i shqipes në rrethin e gjuhëve indoeuropiane. [Kumtesë e mbajtur në Universitetin e Bonn-it në nëntor 1992], (18 faqe dorëshkrim).
159. Franz Miklosić's main contributions in Albanology. = Ndhimesat kryesore të Franc Mikloshiçit në albanologji. – Në: "Studia albanica", nr. 1–2, 1992, f. 3–9.
160. Gjuha letrare shqipe e njësuar dhe çështja e paskajores. – Në: "Gjuha jonë", nr. 3–4, 1992, f. 36–39.
161. Miklosić's main contributions Albanology. = Ndhimesat e Franc Miklosiçit në albanologji. – Në: Miklošičev Zbornik, Ljubjana 1992, f. 415–422.
162. Prof. Kostaq Cipoja – përfaqësues i nderuar i gjuhësisë dhe kulturës shqiptare. (1882–1952). (Përkujtimore) – Në: "Gjuha jonë", nr. 3–4, 1992, f. 79–85.
163. Rëndësia e arbërishtes për historinë e gjuhës shqipe. – Në: "Gjuha jonë", nr. 1–2, 1992, f. 19–24.
164. Studimi i gjuhës shqipe në Itali (dje dhe sot). Tiranë, 1992 (7 faqe dorëshkrim).
165. Über einige Sprachbesonderheiten des Albanischen. = Mbi disa veçori gjuhësore të shqipes. Kumtesë e mbajtur në Institutin e Sllavistikës të Universitetit të Vjenës, më 25.06.1992]. (21 faqe dorëshkrim).
166. E keni për detyrë që të vëmë në vend gabimet e së kaluarës. Intervistë me Shaban Demirajn, Kryetar i Akademisë së Shkencave. – Në "Rilindja", 17 gusht, 1993, f. 8.

167. Për historinë e popullit shqiptar: gjuha tregues i padis-kutueshëm. – Në: “Mbrojtja” nr.. 9–10, 1993, f. 38–39.
168. Su alcuni problemi dell’evoluzione storica della lingua albanese. = Mbi disa probleme të evolucionit historik të gjuhës shqipe. Università della Calabria. – Në: “Quaderni del Dipartimento di linguistica”. 7 Serie Albanistica 1 Studi Albanesi (Rende–S. Demetrio C, 7–8 giugno 1991). Aktet e Seminarit të Parë Ndërkombëtar për Studimet Shqiptare (Rende–Shën Mitër, 7–8 qershor 1991]; a cura di Francesco Altimari, Rende (Cs), 1993, f. 93–103.
169. Albanese. – Në: “Le lingue indoeuropee”. A cura di: Anna Gracalone Ramat e Paolo Ramat. Societa Editrice “11 Mulino”. Bologna, 1994, f. 507–530. Nuova edizione.
170. L’importanza delle parlate arbëreshe d’Italia per la storia della lingua albanese. – Në: “I dialetti italo-albanesi. Studi linguistici e storico-culturali sulle comunità arbëreshe. A cura di Francesco Altimari e Leonardo M. Savoia”. Biblioteca di cultura – 448 – Bulzoni Editore, Roma, 1994, f. 121–128.
171. On two ancient Greek loanwords in Albanian and Rumanian. Mbi dy huazime të greqishtes së vjetër në shqipe dhe në rumanishte. – Në: “Septième Congrès International d’Études du Sud-Est Européen”. (Thessalonique 29 aout – 4. septembre 1994) Athènes, 1994. Përmbledhjet e kumtesave, f. 140. (Origjinali i plotë 6 faqe i pabotuar).
172. Për veprimtarinë shkencore të Prof. Selman Rizës. – Në: “Gjuha jonë”, nr. 1–4, 1994, f. 11–16.
173. Sami Frashëri – one of the founders of the contemporary standard Albanian = Sami Frashëri – një nga

- themeluesit e shqipes së sotme standarde. [Kumtesë e mbajtur në një Konferencë Shkencore Ndërkombëtare organizuar nga Katedra e Gjuhës Shqipe pranë Universitetit të San-Petërburgut me 20–27 qershor 1994 me rastin e 90–vjetorit të vdekjes së Sami Frashërit dhe në përkujtim të gjuhëtares ruse A. V. Desnickaja] (5 faqe dorëshkrim).
174. A ka pasur një traditë shkrimi të gjuhës shqipe para Buzukut? – Në: “Meshari i Gjon Buzukut – monument i kulturës shqiptare (1555–1995) Art Club Ulqin 1995”, f. 35–41. [Kumtesë e mbajtur në Sesionin shkencor dt. 19 maj 1995 në Ulqin, me rastin e 450– vjetorit të botimit), f. 35–41.
175. About the main objectives and difficulties of the Albanian Academy of Sciences. = Rreth objektivave dhe vështirësive kryesore të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. [Diskutim i mbajtur në Akademinë e Shkencave të Rumanisë në vitin 1995}. (5 faqe dorëshkrim).
176. Diskutim rreth referimeve të Bahri Becit, Jolanda Mindak–ut, Victor Friedmann–it dhe Istvan Schutze–it. – Në: “Seminari XVII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Tiranë 16–31 gusht 1995”, Tiranë, 1995, f. 33–38.
177. Flet Shaban Demiraj – Gjuha, trashëgimi më i çmuar që na lanë të parët. [Intervistë e tij]. – Në: “AKS”, nr. 27, 8–9 korrik, 1995, f. 8.
178. Njohuri të përgjithshme (Kreu 1); Folja (Kreu VII). – Në: “Gramatika e gjuhës shqipe”, vëll. I. Morfologjia. Akademia e Shkencave e RSH. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë, 1995, f. 29–41; 259–355.

179. Rëndësia e veprës së Buzukut për studimet historike të gjuhës shqipe. – Në: “Seminari XVII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare”, Tiranë, 1995, f. 365–369.
180. Roli i shkrimtarëve për zhvillimin e shqipes letrare në të kaluarën dhe sot. – Në: “Gjuha jonë”, nr. 1–4, 1995, f. 33–35.
181. Conservations et innovations dans les parlers des Arbëreshë d’Italie et de Sicile. = Konservime dhe risi në të folmet e arbëreshëve të Italisë dhe të Sicilisë. – Në: “Praktika tou ellino–alvanikou symposium”. Botim i Qendrës së Studimeve të Evropës Juglindore. Athinë, 1996, f. 11–21.
182. J. Kopitar’s main contributions in albanology. = Ndhimesat kryesore të J. Kopitarit në albanologji. – Në: “Kopitarjev Zbornik. Mednarodni Simpoziju” Ljubjani 1994; Jernej Kopitar in njegove doba Simpozij... Ljubjana, 1996, f. 19–28.
183. Problemi i prejardhjes së gjuhës shqipe. – Në “Perla” nr. 1, janar–mars 1996, f. 28–40.
184. About the common traits of the Balkan Languages. – Në: “Studia albanica”, nr. 1; 1995–1998, f. 65–87.
185. A propos des innovations principales dans le système consonantique de l’albanais par rapport à l’indoeuropéen. = Rreth disa risive kryesore në sistemin bashkëtingëllor të shqipes në krahasim me indoeuropiauishten. – Në: “Studi și cercetări lingvistice” (Bucarest), nr. 1–4, 1997, f. 111–116.
186. About the common traits of the Balkan languages. = Rreth tipareve të përbashkëta të gjuhëve ballkanike. (Referat – 25 faqe dorëshkrim).

187. Disa mendime rreth procesit të diftongimit në gjuhën shqipe. [Mbajtur në tubimin e organizuar me rastin e 80-vjetorit të lindjes së Akademikut Idriz Ajeti, viti 1997 – 6 faqe dorëshkrim].
188. Personalitet poliedrik i gjuhësisë shqiptare [Shkrim për gjuhëtarin e shquar Idriz Ajeti]. – Në: “Rilindja”, nr. 1322, 21 tetor, 1997.
189. Prof. A. V. Desnickaja. (Përshëndetja e Prof. Shaban Demirajt në Konferencën Ndërkombëtare të Sant Petersburgut me rastin e 85-vjetorit të lindjes dhe 5-vjetorit të vdekjes, në maj 1997]. (2 faqe dorëshkrim).
190. Prof. Akad. Idriz Ajeti në 80-vjetorin e lindjes. [Referat i mbajtur në tubimin e organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë në Tiranë më 20 tetor, 1971.] (5 faqe dorëshkrim).
191. Sami Frashëri, një ndër themelvënësit e shqipes së sotme letrare. – Në: “Perla” nr. 1, 1997, f. 33–38.
192. Eqrem Çabej dhe shkolla albanologjike austriake. – Në: “Rilindja”, nr. 1520, 27 qershor, 1998, f. 10.
193. Shkolla fillore nr. 1, Vlorë. [Mesazh dërguar në gusht 1998 shkollës fillore, ku ka filluar së pari herë mësimet Shaban Demiraj.] (1 faqe dorëshkrim).
194. Nderim të thellë për lagjen time në Vlorë. [Mesazh dërguar në gusht 1998 lagjes, ku lindi dhe u rrit]. (1 faqe dorëshkrim).
195. Emërtimi i shqiptarëve në shekuj. – Në: “Perla”, nr. 3, 1998, f. 21–49.
196. Roli i Eqrem Çabejt në zhvillimin e gjuhësisë shqiptare. [Kumtesë e mbajtur në Sesionin Shkencor Jubilar të organizuar më 12 gusht 1998 me rastin e 90-vjetorit të

- lindjes së atij gjuhëtari.] – Në: "Studime filologjike", nr. 3–4, 1998, f. 81–83.
197. Roli i shkrimtarëve për zhvillimin e shqipes letrare në të kaluarën dhe sot. Në: "Letërsia shqipe dhe gjuha letrare". Simpozium i mbajtur më 1–2 nëntor 1966, Prishtinë 1998, f. 25–28.
198. Rreth emrit të Durrësit. (Vështrim gjuhësor historik). – Në: "Studime filologjike", nr. 1–2, 1998, f. 31–42.
199. Rreth dy huazimeve të vjetra të gjuhës shqipe. – Në: "Eqrem Çabej personalitet i shquar i shkencës dhe i kulturës shqiptare", Tiranë, "Çabej", 1998, f. 53–59.
200. Shqipja e sotme letrare në prag të shek. XXI. – Në: "Gjuha jonë", nr. 1–4, 1998, f. 21–24.
201. Rreth disa hidronimeve të lashta të Shqipërisë. – Në: "Studime filologjike", nr. 3–4, 1999, f. 13–43 (Përmbledhje anglisht).
202. Rreth çështjes së romanizimit të Gadishullit Ballkanik. – Në: "Studime historike", nr. 3–4, 1999, f. 7–19.
203. Selman Riza, gjuhëtar dhe atdhetar i shquar. – Në librin "Selman Riza, gjuhëtar, dhe atdhetar i shquar" të Engjëll Angonit. Botimet Toena. Tiranë 1999. Parathënie, f. 5–8.
204. Alcune note su Giulio Variboba e sulla sua opera. = Disa shënime mbi Jul Varibobën dhe veprën e tij. [Kumtesë e mbajtur në katundin Mbuzat të Kozencës (Itali), në përkujtim të poetit arbëresh Jul Variboba, më 1999]. (4 faqe dorëshkrim).
205. Disa zhvillime paralele në evolucionin e shqipes dhe të iranishtes. – Në: "Perla", nr. 1, 1999, f. 13–23.
206. Dy fjalë nderimi për Prof. Selman Rizën. – Në: "Gjuha jonë" nr. 3–4, 1999, f. 19–20.

207. Dy fjalë për një vepër me vlera shkencore. – Në: Fatmir Agalliu “Gjuha e Fan Nolit në veprat origjinale”. Tiranë. 1999. [Parathënie. f. 7–9].
208. Kongresi i Manastirit dhe rëndësia e tij. – Në: “Studime filologjike”, nr. 1–2, 1999, f. 5–10.
209. Mesazhi im për intelektualët e rinj është të punojmë me atdhetarizëm e përkushtim (Intervistë e Shaban Demirajt) – “Mësuesi”, nr. 39, 17 nëntor, 1999, f. 5.
210. Rëndësia e alfabetit të Shoqërisë “Bashkimi” (1999). [Diskutim] (3 faqe dorëshkrim).
211. About the redoubling of the objects in Albanian and in the other Balkan languages = Rreth rimarrjes së kundrinave në shqipe dhe në gjuhët e tjera. Ballkanike. [Kumtesë e mbajtur në një Konferencë shkencore Ndërkombëtare në Selanik, 1999] – Në: “Balkanlinguistik. Synchronie und Diachronie” [Botim i Departamentit të Gjuhësisë të Fakultetit të Filozofisë të Universitetit “Aristotel” të Selanikut]. Thessaloniki, 2000, f. 59–63.
212. A propos de la romanisation des anciens peuples de la Peninsule Balcanique. – Në: “Studia albanica”, nr. 1, 2000, f. 1–6.
213. E ndiej veten shumë të gëzuar dhe mirënjohës. (Fjala e mbajtur në mbledhjen solemne të organizuar në Prishtinë, më 15 tetor, 2000, me rastin e 80-vjetorit të lindjes së Shaban Demirajt]. (3 faqe dorëshkrim).
214. Ikën i fundmi i të shquarve linguistë. – Prof. Mahir Domi. [Autorë të shkrimit: Ylli Popa, Jorgo Bullo, Shaban Demiraj, Zija Xholi]. – Në: “Koha jonë”, nr. 222, 21 shkurt, 2000, f. 26.
215. I dashur mësues. [Letër dërguar ish mësuesit të tij të shkollës fillore, zotit Musa Muho, më 4 prill 1977]. – Në:

- Musa Muho, "Dallgët joniane të jetës", Tiranë, 2000, f. 87–89.
216. Mirënjohje të thellë qytetit tim të lindjes. Vlorës. [Fjala e mbajtur në mbledhjen solemne, më 20 tetor 2000, kur shpallet Qytetar Nderi i qytetit të Vlorës – 3 faqe, dorëshkrim].
217. Ndhimesat e Naim Frashërit për lëvrimin e gjuhës shqipe. – Në: "Naim Frashëri 100 vjet pas". Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës & Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Prishtinë 2000, f. 25–30.
218. Pasion për shkencën dhe lirinë. Në: Engjëll Angoni, "Selman Riza gjuhëtar dhe atdhetar i shquar (Recension për librin). – Në: "Universi shqiptar i librit", nr. 1, 2000.
219. Rreth disa bashkëpërkimeve midis mesapishtes dhe shqipes. – Në: "Studime filologjike", nr. 3–4, 2000, f. 91–103 (Përmbledhje anglisht).
220. Rreth emrit të qytetit të Shkodrës. Kumtesë e mbajtur në Seminarin IV "Shkodra në shekuj", Shkodër 2000). (3 faqe dorëshkrim).
221. Rreth emrit të Pultit. (Kumtesë e mbajtur në Seminarin V "Shkodra në shekuj"). Shkodër 2001. (6 faqe dorëshkrim).
222. Rreth risive kryesore në sistemin zanor të gjuhës shqipe. – Në: "Shqyrtime Albanologjike 6". Shkup, 2000, f. 23–28 (Përmbledhje anglisht).
223. Shqipja një gjuhë indoeuropiane "lindore" në lidhje të hershme me gjuhët indoeuropiane "perëndimore" – Në: "Perla", nr. 1, 2000, faqe 90–96.
224. Shqipja e sotme letrare në prag të shekullit XXI. – Në: "Konferenca Shkencore kushtuar 25-vjetorit të

- Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, Tiranë 12 dhjetor 1977”, “Shkenca”, Tiranë, 2000, f. 39–43.
225. Dy fjalë për Osman Haxhiun. [Parathënie për monografinë e Bardhosh Gaçes mbi Osman Haxhiun, shkruar më 2001]. (5 faqe dorëshkrim).
226. Fjala e mbylljes. – Në: “Konferenca shkencore – Vlorë në rrjedhat e kohës”, Tiranë 2001.
227. Gjuha shqipe është zhvilluar nga njëri apo disa dialekte të Ilirishtes së Jugut. Në: “Flaka”, Shkup, nr. 6713, 10 janar, 2001, f. 8.
228. Ndihmesat kryesore të prof. Jup Kastratit. – Në: Diana Kastrati, “Bibliografia e Botimeve të Prof. Dr. Jup Kastratit”, Shkodër 2001, f. 157–159.
229. Pak fjalë rreth gramatikës së Ilia Dilo Sheperit. – Në: “Ilia Dilo Sheperi, Gramatika dhe sintaksa e gjuhës shqipe”, (ribotim), Tiranë, 2001, f. 1.
230. Prof. Mahir Domi – personalitet i shquar i arsimit, kulturës dhe shkencës shqiptare. – Në: “Studime filologjike”, nr. 3–4, 2001. f. 19–23.
231. Rreth huazimeve prej burimi turk, arab dhe persian në gjuhën shqipe. – Në: “Univers”. Tiranë, nr. 1, 2001, f. 15–30. (Përmbledhje anglisht).
232. Rreth emrit të qytetit të Vlorës dhe lashtësisë së tij. – Në: “Vlorë në rrjedhat e kohës”. Universiteti Teknologjik “Ismael Qemal Vlorë”, Shoqata kulturore “Ismael Qemal Vlorë”, Bashkia e Vlorës. Tiranë 2001. Toena. f. 15– 22.
233. Rreth evolucionit të grykoreve (guturaleve) indoeuropiane në gjuhën shqipe. [Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare në përkujtim të gjuhëtares ruse A. V. Desnickaja në Sant Petersburg në

- maj 1997]. – Në: “Studia Linguistica et Balcanica”, nga Instituti i Studimeve gjuhësore i Akademisë së Shkencave të Rusisë “Nauka”, Sant Petersburg, 2001, f. 118–122.
234. Rreth gramatikës së Kristoforidhit. [Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare “Kristoforidhi, figurë e ndritur e Rilindjes Kombëtare Shqiptare”, e organizuar nga Universiteti “Aleksandër Xhuvani” dhe Bashkia e qytetit Elbasan, 21 mars 2001]. (8 faqe dorëshkrim).
235. Rreth qiellzorëzimit të bashkëtingëlloreve grykore në gjuhën shqipe [Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare në përkujtim të albanologes ruse A. V. Desnickaja, në Sant Petersburg, maj 1997]. – Në: “Studime filologjike”, nr. 1–2, 2001, f. 5–13. (Përmbledhje anglishtë).
236. Arbën/Arbër. – Në: “Historia e Popullit Shqiptar” I. Tiranë, Toena 2002, f. 346–348.
237. Ç’na kujton e ç’na mëson 28 Nëntori i vitit 1912. [Fjala e mbajtur në mbledhjen solemne të zhvilluar në Vlorë me rastin e 90–vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë. në nëntor 2002 – 2 faqe dorëshkrim]
238. Fjala e mbylljes në Konferencën shkencore me temë: “Vlora në rrjedhën e kohës”. Në “Buletin Shkencor” nr. 2, .f. 371–372. Universiteti Teknologjik. “Ismail Qemali” Vlorë.
239. Gavril Dara. Jeta dhe vepra. [Studim i përgatitur për parathënien e re të librit “Kënga e Sprapme e Balës”] (17 faqe dorëshkrim).
240. Gjuha letrare shqipe e njësuar dhe çështja e paskajores. – Në: “Konferenca shkencore “Gjuha letrare kombëtare

- dhe bota shqiptare sot””. Tiranë 20–21 nëntor 1992. Tiranë 2002, f. 56–59.
241. Il rapporto tra conservazione e innovazione nella lingua albanese. – Në: “Variazioni linguistiche in albanese. A cura di Addolorata Landi. Pubblicazioni dell’ Università degli studi di Salerno, f. 25–42. Napoli. Edizioni Scien- tifiche Italiane, 2002.
 242. Ku dhe kur është formëzuar etnosi arbëresh (shqiptar). [Kumtesë e mbajtur në Konferencën shkencore me temë: “Vlora në rrjedhë të kohërave”]. – Në: “Buletini shken- cor” nr. 2. prill 2002, f. 3–10. [Universiteti Teknologjik “Ismail Qemali”, Vlorë]
 243. Mesapët dhe gjuha e tyre. Përgatitur brenda vitit 2002 dhe dërguar për botim në revistën e Universitetit Tek- nologjik “Ismail Qemali”, Vlorë (6 faqe dorëshkrim).
 244. Ndihmesa e Joklit në përcaktimin e kronologjisë së disa dukurive të vjetra të gjuhës shqipe. [Kumtesë e mbajtur në Simpoziumin ndërkombëtar kushtuar N. Joklit në Shkodër, qershor 2002] (4 faqe dorëshkrim).
 245. Romanizimi në Europën Juglindore. Kohëzgjatja, përmasat dhe pasojat. [Bisedë e zhvilluar në Akademinë e Shkencave më 2002] (12 faqe dorëshkrim).
 246. Sull’origine dei Messapi. = Mbi origjinën e mesapëve. – Në: “Studi in onore di Antonino Guzzeta. Cattedra di Lingua e Letteratura Albanese. Università di Palermo, Helix media Editore, Palermo 2002. f. 131–135.
 247. Shoqëria nuk mund të përparojë pa zhvillimin e gjithanshëm të arsimit, kulturës dhe shkencës. – Në: “Ligji dhe jeta”, nr. 1. 2002, f. 37–40.
 248. Rreth disa çështjeve thelbësore të shqipes standarde [Kumtesë e mbajtur në Konferencën Kombëtare të

- Gjuhës Shqipe. Nëntor 2002]. – Në: “Studime filologjike”, nr. 3–4, 2002, f. 37–42.
249. Rreth disa ndihmesave të rëndësishme të Milan Shuflajit në fushën e albanologjisë. [Kumtesë e mbajtur në Konferencën ndërkombëtare për Shuflajin në Tiranë në vitin 2002].
250. V. Cimočovski rreth dy risive në sistemin emëror të shqipes. – Në: “Studime filologjike”, nr. 1–2, 2002, f. 103–109. (Përmbledhje anglisht).
251. Rreth disa ndihmesave të Milan Shuflajt në fushën e albanologjisë. – Në: “Studime filologjike”, 1–2, 2003, f. 81–87.
252. Rreth autorësisë së poemës “Kënga e sprasme e Balës”. – Në: “Studime filologjike”, 3–4, 2003, f. 63–74.
253. Rreth huazimeve turke në gjuhën shqipe. – Në: “Studime filologjike”, 3–4, 2004, f. 19–28.
254. Kongresi i alfabetit të gjuhës shqipe dhe vendi i tij në kulturën shqiptare, (në bashkëpunim me Kristaq Priftin). – në: “Studime filologjike”, 3–4, 2008, f. 5–16.
255. Rreth emrave të fshatrave të Dropullit e të Vurgut dhe të banorëve të tyre gjatë shekujve. – Në: “Studime filologjike”, 1–2, 2008, f. 73–90.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека
"Св. Климент Охридски", Скопје

811.18(062)
811(497)(062)

SHABAN Demiraj - figurë e shquar e albanologjisë dhe
ballkanologjisë : (sesion shkencor - 21 nëntor 2014). V. 8 /
[kryeredaktor Zeqirija Ibrahim]. - Shkup : Instituti i trashëgimisë
shpirtërore e kulturore të Shqiptarëve, 2015. - 263 стр. ; 21 см. -
(Biblioteka Scupi)

Фусноти кон текстот. - Библиографија кон повеќето трудови. -
Bibliografia e botimeve të profesor Shaban Demirajt: стр. 227-263

ISBN 978-608-4653-24-0

а) Албански јазик - Собири б) Балкански јазици - Собири
COBISS.MK-ID 98178058